



INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT  
INSTITUCIJA OMBUDSMANA  
OMBUDSPERSON INSTITUTION

# RAPORTI VJETOR 2022 NR. 22



# Përmbajtja

<b>Fjala e Avokatit të Popullit</b> .....	<b>9</b>
<b>Hyrje</b> .....	<b>11</b>
<b>Mandati i Avokatit të Popullit</b> .....	<b>12</b>
Mandati i mbrojtjes së të drejtave të njeriut .....	12
Mandati i mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut.....	12
Mandati promovues i të drejtave të njeriut .....	12
Mandati si mekanizëm kombëtar për parandalimin e torturës .....	13
Mandati si mekanizëm i barazisë.....	13
<b>Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve</b> .....	<b>14</b>
Paraqitja grafike e statistikave të ankesave të paraqitura te Avokati i Popullit.....	22
<b>Mbrojtja e të drejtave të njeriut nga Avokati i Popullit</b> .....	<b>29</b>
<b>Të drejtat fundamentale</b> .....	<b>30</b>
Dinjiteti i Njeriut .....	30
E Drejta për Jetën .....	31
E Drejta e Integritetit Personal .....	32
Liria e Lëvizjes.....	33
Mbrojtja e Pronës.....	34
E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë.....	35
E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm.....	36
<i>Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe e prokurorëve</i> .....	37
E Drejta për Mjete Juridike .....	37
E Drejta e Privatësisë.....	38
E Drejta e Martesës dhe Familjes .....	39
Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë .....	40
Liria e Shprehjes .....	40
E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike .....	42
Liria e Medieve.....	42
Liria e Tubimit.....	43
Liria e Asociimit .....	43
Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes.....	45
<b>Institucioni i Avokatit të Popullit si mekanizëm i barazisë</b> .....	<b>47</b>
Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi .....	49
Gjetjet e Avokatit të Popullit lidhur me diskriminimin në Kosovë .....	49
Aktet normative në raport me parimin e mosdiskriminimit.....	51
Praktikat e përgjithshme të cilat bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit .....	52
<b>Të Drejtat e Fëmijës</b> .....	<b>54</b>
Ankesat e parashtruara lidhur me të drejtat e fëmijëve .....	54
E drejta e fëmijëve për arsim .....	55

Të drejtat e fëmijëve në procedurat pranë gjykatave .....	55
Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla .....	57
Fëmijët me aftësi të kufizuara .....	58
Mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve.....	59
<b>E Drejta për Arsimin .....</b>	<b>61</b>
<b>Liria e Artit dhe e Shkencës .....</b>	<b>65</b>
<b>E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit.....</b>	<b>66</b>
<b>Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale .....</b>	<b>69</b>
<b>Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor.....</b>	<b>72</b>
<b>Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës.....</b>	<b>75</b>
Monitorimi i qendrave të mbajtjes dhe i stacioneve policore .....	76
Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit .....	77
Institucionet e shëndetit mendor dhe ato të kujdesit social.....	82
<i>Klinika e Psikiatrisë në Prishtinë - Reparti i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik .....</i>	<i>83</i>
Qendrat e shëndetit mendor dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi .....	83
<i>Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP) .....</i>	<i>84</i>
Institucionet e kujdesit social .....	84
<b>Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve joshumicë.....</b>	<b>86</b>
Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian .....	90
<b>Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.....</b>	<b>92</b>
<b>Mbikëqyrja e të drejtave të njeriut në Forcën e Sigurisë së Kosovës .....</b>	<b>95</b>
<b>Të Drejtat e të Huajve .....</b>	<b>97</b>
<b>Të drejtat e personave në kuptim të “drejtësisë tranzicionale” .....</b>	<b>99</b>
<b>Kufizimi dhe shmangia nga të drejtat e njeriut .....</b>	<b>104</b>
<b>Barazia Gjinore .....</b>	<b>106</b>
Barazia gjinore në të drejtën në punë.....	107
Barazia gjinore në të drejtën në pronë dhe në trashëgimi.....	108
Përgjegjësia e autoriteteve publike për mbrojtje nga dhuna në familje .....	109
Gratë viktimat/të mbijetuarat të dhunës seksuale gjatë luftës .....	111
<b>Të drejtat e personave LGBTI+ .....</b>	<b>112</b>
<b>Çështjet e iniciuara në Gjykatën Kushtetuese.....</b>	<b>113</b>
<b>Mbikëqyrja e politikave legislative në përputhje me të drejtat e njeriut dhe me standardet ndërkombëtare ....</b>	<b>115</b>
<b>Qëndrimet e Avokatit të Popullit të shprehura nëpërmjet raporteve për rastet e hetuara gjatë vitit 2022.....</b>	<b>119</b>
Dinjiteti i Njeriut, Barazia para Ligjit dhe Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale .....	120
<i>Raport për rastin ex officio nr. 176/2020, ndryshimi i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 10/2014 për punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet .....</i>	<i>120</i>



<i>Raport për rastin ex officio nr. 577/2021, të drejtat në Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në Republikën e Kosovës, me fokus qasjen në informata dhe në shërbime në kontracepsion, qasjen në abort dhe në kujdesin pas abortit, si dhe kujdesin për shëndetin e nënës.....</i>	124
<i>Raport për rastin ex officio nr. 262/2018 lidhur me pengesën për qasje fizike të personave me aftësi të kufizuara në hapësirat e Administratës Pensionale të Kosovës, Zyra Regjionale e Pensioneve në Prishtinë.....</i>	127
<i>Opinion i Avokatit të Popullit për rastin ex officio nr. 39/2022, vlerësimi i strukturës së re tarifore në Kosovë kundrejt të drejtave të njeriut.....</i>	129
<i>Opinion i Avokatit të Popullit për rastin ex officio nr. 307/2022, lidhur me njohjen e marrëdhënieve familjare të personave me sekse të njëjta me Projektkodin Civil.....</i>	132
<i>Raport për rastin A. nr. 676/2021 lidhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2020 për Procedurën e Emërimit të Nënkrjetarëve në Komuna.....</i>	136
<i>Raport për rastin A. nr. 125/2021 lidhur me kriterin diskriminues në Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".....</i>	137
<i>Raport për rastin A. nr. 444/2021 lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.....</i>	138
<i>Opinion i Avokatit të Popullit për kërkesën e Gjykatës Supreme dërguar në Gjykatën Kushtetuese lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të nenit 17, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, që ndërlihet me nenin 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës.....</i>	140
<i>Letër rekomandimi për rastin A. nr. 675/2021, lidhur me ndryshimin e Rregullores 01.Nr. 154 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale të Komunës së Ferizajt dhe harmonizimin e saj me legjislacionin përkatës.....</i>	143
<b>E Drejta për Jetën dhe E Drejta e Integritetit Personal.....</b>	<b>145</b>
<i>Raport për rastin ex officio nr. 13/2022 përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën në jetë dhe për të siguruar mbrojtje nga dhuna në familje.....</i>	145
<b>Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruese.....</b>	<b>147</b>
<i>Raportet e Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.....</i>	147
<i>Raport për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë.....</i>	147
<i>Raport për vizitën në Qendrën Edukuese-Korrektuese për të Mitur dhe në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan.....</i>	149
<i>Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë.....</i>	151
<i>Raport për vizitën në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan.....</i>	151
<i>Raport për vizitën në Qendrën e Mbajtjes për të Huaj në Vranidoll.....</i>	152
<i>Raport për vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë.....</i>	153
<i>Raport për vizitën në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë.....</i>	154
<b>E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm dhe Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave.....</b>	<b>156</b>
<i>Raport për rastin A. nr. 642/2018, zvarritje e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë.....</i>	156
<i>Raport për rastin A. nr. 469/2020, zvarritje e procedurës gjyqësore në Gjykatën e Apelit.....</i>	157
<i>Raport për rastin A. nr. 703/2020, zvarritje e procedurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.....</i>	157
<i>Letër rekomandimi për rastin A. nr. 585/2021, zvarritje e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë.....</i>	158
<i>Letër rekomandimi për rastin A. nr. 230/2021, zvarritje e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogvc.....</i>	159
<i>Mendim juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) për rastin A. nr. 30/2022 lidhur me zhvillimin e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë.....</i>	160

<i>Mendim juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) për rastin A. nr. 274/2022, lidhur me Padinë e parashtruar nga Avokatura Shtetërore në çështjen e emërimit të nënkryetarit të komunës për komunitete në Fushë Kosovë.....</i>	161
<b>E Drejta për Mjete Juridike .....</b>	<b>163</b>
<i>Raport për rastin ex officio nr. 412/2022 lidhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr. 01/2022 mbi Përcaktimin e Procedurave për Funkcionimin e Njësive Organizative për Gjoba dhe Ndëshkime e Administratës Tatimore të Kosovës .....</i>	163
<i>Raport për rastin A. nr. 700/2020 përkitazi me pretendimet e ankuesit për mospërgjigje në kërkesë dhe në ankesë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.....</i>	164
<i>Raport për rastin A. nr. 723/2021 në lidhje me cenimin e së drejtës për informim dhe ushtrim të mjeteve juridike..</i>	165
<i>Raport për rastin A. nr. 369/2021 lidhur me moszbatimin e vendimit të plotfuqishëm të organit të shkallës së dytë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor .....</i>	166
<i>Letër rekomandimi për rastin A. nr. 114/2021 që ka të bëjë shkeljen e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative .....</i>	167
<i>Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me Kërkesën KI 10/22 të Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme .....</i>	168
<b>E Drejta e Privatësisë .....</b>	<b>170</b>
<i>Raport për rastin ex officio nr. 95/2022 lidhur me instalimin e kamerave në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur .....</i>	170
<b>E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike .....</b>	<b>171</b>
<i>Raport për rastin A. nr. 418/2022, e drejta e qasjes në dokumente publike .....</i>	171
<b>Liria e Asociimit .....</b>	<b>172</b>
<i>Raport për rastin A. nr. 474/2021 lidhur me pretendimet për diskriminim në bazë të lirisë së asociimit si anëtarë në Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës .....</i>	172
<b>Mbrojtja e Pronës .....</b>	<b>173</b>
<i>Raport për rastin A. nr. 353/2021 lidhur me Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 01. Nr. 110-2782 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale .....</i>	173
<i>Raport për rastin A. nr. 700/2021 lidhur me obligimet e organeve të administratës komunale për ndërmarrjen e veprimeve për sa i përket procesit të kthimit.....</i>	174
<i>Kërkesë e Avokatit të Popullit për pezullimin e zbatimit të vendimit mbi lirim dhe pronës dhe kthimin e saj në Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahasim të Pronës.....</i>	176
<b>E Drejta për Arsimin dhe Të Drejtat e Fëmijës .....</b>	<b>177</b>
<i>Raport për rastin ex officio nr. 331/2022 lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar të Kosovës me të drejtat e fëmijëve në arsim .....</i>	177
<i>Raport për rastin ex officio nr. 411/2021 lidhur me themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara.....</i>	181
<b>E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit.....</b>	<b>184</b>
<i>Opinion i Avokatit të Popullit për rastet A. nr. 505/2021 dhe A. nr. 712/2021 lidhur me llogaritjen e pushimit vjetor në bazë të përvojës së punës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë.....</i>	184
<i>Opinion i Avokatit të Popullit për rastin A. nr. 473/2021 lidhur me çështjen e interpretimit të konceptit “përvoja e punës profesionale” në kontekstin e vlerësimit në konkurset për punësim në institucione publike .....</i>	185
<i>Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me llogaritjen e përvojës profesionale të punës në rastin e konkursit për drejtor të Baletit Kombëtar të Kosovës .....</i>	187

<b>Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore.....</b>	<b>189</b>
<i>Opinion i Avokatit të Popullit për rastin ex officio nr. 40/2022, përkitazi me arsyeshmërinë e masave të marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas Vendimit nr. 01/55, të datës 21 janar 2022, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës, në raport me kufizimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut.....</i>	<i>190</i>
<b>Promovimi i drejtave dhe i lirive themelore të njeriut nga IAP-ja gjatë vitit 2022 .....</b>	<b>193</b>
IAP-ja, si promovuese e të drejtave të njeriut dhe barazisë.....	194
Edukimi mbi të drejtat e njeriut .....	198
Fuqizimi i edukimit mbi të drejtat e njeriut dhe marrja e praktikave më të mira.....	200
Arritjet në promovimin e të drejtave të njeriut dhe të barazisë si dhe planifikimet për vitin 2023.....	201
Bashkëpunimi me shoqërinë civile.....	202
<b>Bashkëpunimi ndërkombëtar i IAP-së .....</b>	<b>208</b>
Bashkëpunimi me homologë dhe me organizata të tjera ndërkombëtare .....	213
Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare.....	217
Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë.....	219
<b>Agjenda 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit, si Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut .....</b>	<b>220</b>
<b>Komunikimi me publikun .....</b>	<b>225</b>
<b>Strategjia e Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2025 dhe Plani i Zbatimit të Strategjisë së Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2023 .....</b>	<b>226</b>
<b>Buxheti i IAP-së .....</b>	<b>228</b>
Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës.....	228



# Fjala e Avokatit të Popullit

Republika e Kosovës është ndërtuar si shtet që garanton “të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligji”.<sup>1</sup> Themelet e Republikës së Kosovës janë vendosur mbi vlerat më të avancuara demokratike, që në qendër kanë respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut. Vendi ynë, në fazat e shtetndërtimit, jo rrallë është përballur me situata të vështira, tejkalimi i të cilave ka kërkuar ndërmarrjen e masave për t'i forcuar mekanizmat institucionalë, fuqizimin e sundimit të ligjit, demokracinë e shteti ligjor.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke kontribuar në këtë rrugëtim të vendit, ka krijuar historinë e vet tash e 23 vjet që nga ekzistenca e tij. Avokati i Popullit promovon, mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e njeriut nga shkeljet e autoriteteve publike, duke trajtuar ankesat e qytetarëve dhe të subjekteve të tjera duke i hetuar sipas detyrës zyrtare, si dhe duke adresuar rekomandime te autoritetet përgjegjëse, zbatimi i të cilave fuqizon demokracinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

I gjithë angazhimi ynë për një vit është i përmbledhur në Raportin Vjetor, i cili në mënyrë besnike pasqyron çështjet e trajtuara gjatë periudhës raportuese; konstatimet dhe rekomandimet që dalin nga hetimi i çështjeve të ngritura; paraqet nivelin e zbatimit të rekomandimit dhe çështjet e tjera që ngre Avokati i Popullit e që janë me rëndësi për të drejtat dhe për liritë e njeriut.

Me punën tonë, përmes ushtrimit të mandatit kushtetues e ligjor, synojmë përmirësimin e respektimit të të drejtave dhe të lirive të qytetarëve, që, e përkthyer në të mirën që përfitojnë qytetarët, është përmirësimi i mirëqenies së tyre.

Viti 2022 na ballafaqoi me krizës globale si pasojë e luftës në Ukrainë dhe efektet që la pas pandemia COVID-19; pastaj inflacioni; rritja e çmimeve dhe kriza energjetike; greva në sektorin publik; situata në 4 komunat në veri të vendit pas bojkotimit të institucioneve dhe vënies së barrikadave; vërshimet në disa zona të vendit ishin disa nga ngjarjet dhe situatat që kërkuar vëmendjen e veçantë, pasi, në një mënyrë, afektonin të drejtat dhe liritë e njeriut.

Nga vlerësimi i përgjithshëm i të drejtave dhe i lirive të njeriut për këtë vit, mund të them se, pavarësisht se ka përmirësime, progresi nuk është mjaftueshëm në përputhje me kërkesat dhe as me standardet për respektimin e drejtave të njeriut, të përcaktuara në Kushtetutë, si rezultat i masave të pamjaftueshme për zbatim të plotë të ligjit; mungesës së llogaridhënies dhe të përgjegjësisë; joefikasitetit në sistemin e drejtësisë, dhe aspekteve të tjera, kanë ndikuar që edhe në këtë vit te Avokati i Popullit të adresoheshin 1595 ankesa.

Pozita e vështirë e personave me aftësi të kufizuara është përcjellë me politika të pamjaftueshme për përmirësimin e respektimit të të drejtave të tyre në raport me detyrimet pozitive të shtetit për ndërmarrjen e masave që u garantojnë të drejtat dhe liritë që gëzojnë.

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Dhuna në familje dhe vrasja e grave vazhdon të jetë një nga problemet e vazhdueshme të shoqërisë sonë. Gjithashtu në këtë vit, tepër shqetësuese ishin rastet e dhunimeve seksuale të vajzave të mitura. Autoritetet kanë dështuar t'i ndërmerrnin të gjitha masat për mbrojtjen e jetës së grave - viktimat të dhunës në familje, edhe pse vazhdimisht ua kemi tërhequr vëmendjen për përgjegjësinë dhe detyrimin që kanë për t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e jetës, mbrojtjen nga dhuna në familje dhe nga dhuna në baza gjinore.

Një çështje tjetër, të cilën vazhdoj ta vë në vëmendje, është zvarritja e procedurave gjyqësore dhe mungesa e një mekanizmi ligjor për mbrojtjen e së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm kohor, i cili do t'ua mundësonte palëve kompensimin për shkak të dëmit të shkaktuar material.

E drejta për mosdiskriminim vazhdon t'u mohohet shumë kategorive të qytetarëve, sidomos atyre që janë me status më të rënduar social dhe ekonomik, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuar dhe shumë grupeve të tjera shoqërore. Qytetarët, të cilët nuk kanë një vend pune dhe nuk realizojnë të ardhura, vazhdojnë të jetojnë në kushte tejet të vështira dhe pa asnjë mbështetje nga shteti, pavarësisht faktit se në këtë gjendje janë për shkak të pamundësisë për të siguruar një vend pune.

Mospërbushja e detyrimit për respektimin e të drejtave të fëmijëve mbetet shqetësim, si: gjithëpërfshirja në arsim e fëmijëve me aftësi të kufizuar; mbrojtja e fëmijëve nga punësimi para moshës së lejuar; mbrojtja e fëmijëve nga kërkimi i lëmshës në rrugë; ruajtja e fëmijëve nga dhuna në familje; mungesa e integritetit të duhur social të tyre.

Përveç adresimit të çështjeve që i kemi hetuar, në këtë vit kemi pasur angazhim të shtuar edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kemi arritur të anëtarësohemi në Rrjetin Evropian të Ombudsmanëve për Fëmijë (ENOC), që është rrjet i institucioneve të pavarura për të drejtat e fëmijëve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës<sup>2</sup>. Gjithashtu në këtë vit jemi nikoqir të Asamblesë së Përgjithshme të Asociacionit të Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM), ku pritet të marrin pjesë ombudsmanë nga 40 vende të botës. Kjo ngjarje do të pasojë edhe me një Konferencë mbi "Integritetin dhe Pavarësinë e Institucioneve të Ombudsmanëve - Qëndrueshmëria në mes të Sfidave", që synon të krijojë një mundësi për ta identifikuar llojin e kërcënimeve ndaj pavarësisë së tyre që përjetojnë Institucionet e Ombudsmanëve, praktikatat më të mira dhe reagimet efektive ndaj tyre.

Është inkurajues fakti se Avokati i Popullit vazhdon të mbetet institucioni më i besueshëm në vend dhe në rajon. Në këtë vit, niveli i besueshmërisë së qytetarëve ka arritur në 68%.<sup>3</sup>

Ndërsa gjatë vitit 2023 vëmendje të veçantë do t'u kushtojmë të drejtave që lidhen me sigurinë dhe me shëndetin në punë; përmbushjes së detyrimeve që ka shteti në raport me krimet e luftës; qasjes në drejtësi për viktimat; së drejtës për të ditur dhe dokumentimit të së kaluarës; të drejtave në arsim; gjuhës së urrejtjes; pozitës së gruas në relacion me të drejtat pronësore dhe shumë çështjeve të tjera, me qëllim të avancimit të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.

2 Rrjeti Evropian i Ombudsmanëve për Fëmijë (ENOC), i qasshëm në: [https://enoc.eu/?page\\_id=2316](https://enoc.eu/?page_id=2316)

3 Balkan Barometer 2022/Public Opinion Survey faqe. 124, 125, 126, 127, i qasshëm në: <https://www.rcc.int/balkanbarometer/publications>

# Hyrje

Avokati i Popullit, në përputhje me nenin 135 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 29 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 31 mars 2023 ia paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, Raportin Vjetor për gjendjen e të drejtave të njeriut gjatë vitit 2022.

Raporti përmban një analizë dhe vlerësim të gjendjes së mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut në Republikën e Kosovës, si dhe një analizë dhe vlerësim të situatës në lidhje me forma të caktuara të shkeljes së të drejtave të individëve apo të grupeve të caktuara shoqërore.

Avokati i Popullit, me analizën dhe vlerësimin e situatës nëpërmjet rasteve të trajtuara dhe të hetuara, gjatë këtij viti u ka adresuar autoriteteve 646 rekomandime, të cilat kanë për qëllim eliminimin e mangësive dhe të parregullsive të vërejtura që çojnë në shkelje të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve, dhe në këtë mënyrë raporti synon të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Përgjatë vitit 2022, Avokati Popullit, në kuadër të mandatit të tij të paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për Avokatin e Popullit, me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Ligjin për Barazi Gjinore, me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe me shumë ligje të tjera, ka pranuar 1595 ankesa nga qytetarët dhe 42 raste ex officio ka hapur me vetiniciativë, ndërsa pas hetimeve janë mbyllur 604 raste.

Duke gjykuar nga numri i ankesave, arsyet më të shpeshta për të cilat qytetarët na janë drejtuar në vitin 2022 kanë qenë ankesat për organet e

drejtësisë, që është në nivel të ngjashëm si në vitet e mëparshme; ankesat për shkeljen e së drejtës për kujdes shëndetësor; për të drejtat e punës; për mbrojtje sociale; për të drejtën e pronës; dyshimet se janë diskriminuar etj.

Duhet theksuar se ndryshe nga raportet e shumë institucioneve të tjera të dorëzuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat janë raporte të punës, roli i këtij raporti është të japë një analizë dhe vlerësim të gjendjes së mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive në Republikën e Kosovës. Prandaj, potenciali i këtij raporti qëndron pikërisht në faktin se përmban një analizë të ankesave të qytetarëve, të gjendjes së të drejtave të njeriut pothuajse për secilën fushë, si dhe të dhëna të shumta nga institucionet e Republikës së Kosovës, të dhëna nga shoqëria civile, si dhe nga burime relevante ndërkombëtare, të gjitha këto në një vend.

Avokati i Popullit, si institucion që një pjesë të madhe të punës e bazon në ankesat e qytetarëve, Raportin Vjetor e ka edhe si një mundësi për t'i njoftuar përfaqësuesit e popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës me përvojat dhe me vështirësitë që përballen qytetarët. Informacioni nga këto ankesa dhe monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së të drejtave dhe të lirive themelore, së bashku me të dhënat e shumta zyrtare që analizojmë, na lejojnë të identifikojmë problemet sistematike, të japim një pamje të gjendjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe të rekomandojmë zgjidhje - të gjitha në shërbim të përmirësimit të të drejtave të qytetarëve në Republikën e Kosovës.



# Mandati i Avokatit të Popullit

## Mandati i mbrojtjes së të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit ushtron mandatin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nëpërmjet mekanizmit të hetimit të rasteve të paraqitura nga ankuesit; hetimit sipas detyrës zyrtare të shkeljeve të mundshme; kontestimit të një akti të administratës për mbrojtjen e interesit publik; dhënies së rekomandimeve të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor; dhënies së opinioneve në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curie); dhënies së rekomandimeve në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore; udhëheqjes së procedurës së ndërmjetësimit dhe të pajtimit; dhënies së asistencës viktimave të diskriminimit; dhënies së rekomandimeve për institucionet publike për zbatimin e detyrimeve në fushën e ndalimit të diskriminimit dhe të barazisë; referimit të çështjeve në Gjykatën Kushtetuese dhe në mekanizma të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.

## Mandati i mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit ushtron mandatin e mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut nëpërmjet mekanizmit të monitorimit të rasteve gjyqësore, ku palët kanë statusin e viktimës së pretenduar të shkeljes së të drejtave të njeriut, apo sipas detyrës zyrtare konsiderohet se mund të ketë shkelje sistematike të të drejtave të njeriut; nëpërmjet mekanizmit të detyrimit të autoriteteve publike

për t'u përgjigjur në kërkesat e Avokatit të Popullit; monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit; mbikëqyrjes së standardit të hartimit të legjislacionit për sa u përket përcaktimeve të të drejtave të njeriut dhe përputhshmërisë me Kushtetutën; monitorimit të zbatimit të ligjeve që kanë për fokus të drejtat e njeriut dhe mekanizmave të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.

## Mandati promovues i të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit ushtron mandatin e promovimit të të drejtave të njeriut nëpërmjet mekanizmit të ngritjes së ndërgjegjësimit të opinionit publik dhe të institucioneve publike për të drejtat e njeriut dhe të lirive themelore, nëpërmjet edukimit, trajnimeve dhe ligjëratave, publikimit të opinioneve dhe të broshurave që paraqesin qëndrimin e Avokatit të Popullit për çështje të caktuara, deklaratave për zbatim të masave të caktuara, organizimit të ditëve të hapura për të drejtat e njeriut, organizimit të konferencave, tryezave tematike, bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me partnerë socialë, shkëmbimit të vizitave me institucione homologe, paraqitjes në media të opinioneve të Avokatit të Popullit dhe të mekanizmave të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.



## **Mandati si mekanizëm kombëtar për parandalimin e torturës**

Avokati i Popullit ushtron mandatin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e torturës (MKP) dhe të trajtimeve e të ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, përmes vizitave të rregullta dhe pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigrantëve dhe çdo vend tjetër ku dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut. Në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit jep rekomandime për përputhshmërinë e ligjeve dhe të akteve të tjera me Kushtetutën dhe me standardet ndërkombëtare në parandalimin e torturës. MKP-ja bashkëpunon me mekanizmat ndërkombëtarë, vendorë dhe me mekanizmat e tjerë që përcaktohen me ligj të veçantë në fushën e parandalimit të torturës.

## **Mandati si mekanizëm i barazisë**

Avokati i Popullit ushtron mandatin e tij si mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit. Një mandat të tillë, Avokati i Popullit e ushtron përmes hetimit të rasteve të diskriminimit, të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, të promovimit të praktikave të mira në promovimin e barazisë, të informimit të publikut për rastet e diskriminimit, trajtimin e rasteve që lidhen me diskriminimin gjinor, dhe bashkëpunon me partnerë socialë, me organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare.

# Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve

Nga 1 janari 2022 deri më 31 dhjetor 2022, në Institucionin e Avokatit të Popullit, zyra qendrore në Prishtinë dhe zyrat rajonale: Prizren, Gjilan, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Graçanicë, janë parashtruar 1595 ankesa nga qytetarët e Republikës së Kosovës, me pohimet ankimore për shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut nga autoritetet publike në Republikën e Kosovës, por edhe me kërkesa për këshillë juridike.

Nga analiza e ankesave të paraqitura nga qytetarët, sipas kategorive kushtetuese të të drejtave dhe të lirive të njeriut, vërehet se numri më i madh i tyre kanë të bëjnë me: të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; të drejtën për mjete juridike; të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit; mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, mbrojtjen e pronës; barazia para ligjit; të drejtat e fëmijës; e drejta për arsimin etj.

Në paraqitjet e mëposhtme tabelore, në mënyrë më të detajuar janë paraqitur të dhënat e përgjithshme të ankesave të pranuar, të shqyrtuara dhe të vendosura për pranueshmëri apo papranueshmëri për hetim, rastet e hapura për hetim me vetiniciativë të Avokatit të Popullit, përkatësia etnike dhe gjinore e ankuesve, autoritetet përgjegjëse publike ndaj të cilave janë paraqitur ankesat, numrin e rasteve të vendosura si të përfunduara/mbyllura, numrin e raporteve dhe rekomandimeve të publikuara ndaj autoriteteve publike dhe zbatueshmërinë e tyre.

**Tabela 1: Ankesat e paraqitura te Avokati i Popullit në vitin 2022**

Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura	1595
Numri i personave të përfshirë në ankesa	2799
<b>Përkatësia etnike e ankuesve</b>	
Shqiptarë	1441
Serbë	77
Boshnjakë	29
Ashkali	13
Turq	11
Romë	10
Egjiptianë	2
Goranë	2
Të tjerë	10

Ankesat e paraqitura, të ndara sipas zyrave të Avokatit të Popullit	
Zyra Qendrore-Prishtinë	790
Zyra Rajonale-Gjilan	165
Zyra Rajonale-Prizren	144
Zyra Rajonale-Ferizaj	130
Zyra Rajonale-Pejë	130
Zyra Rajonale-Mitrovicë e Jugut	96
Zyra Rajonale-Gjakovë	94
Zyra Rajonale-Graçanicë	28
Zyra Rajonale-Mitrovicë e Veriut	18
Përkatësia gjinore e ankuesve	
Meshkuj	1123
Femra	472
Autoritetet publike përgjegjëse ndaj të cilave janë drejtuar ankesat (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)	
Ministritë	481
Gjykatat	475
Komunat	257
Policia	80
Prokuroritë shtetërore	63
Person privatë	54
Kompanitë private	54
Ndërmarrjet publike	29
Autoritetet e huaja	13
Agjencia Kosovare e Privatizimit	20
Të tjera	188

**Tabela 2: Ankesat e paraqitura, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë (një ankesë mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara)**

E drejta për mjete juridike	498
E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	472
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	310
E drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit	279
Mbrojtja e pronës	166
Të drejtat e të akuzuarit	96
Barazia para ligjit	88
Të drejtat e fëmijës	57
E drejta për arsimin	40
Liria e lëvizjes	32
E drejta e martesës dhe e familjes	30
Dinjiteti i njeriut	23
Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës	21
Përgjegjësia për mjedisin jetësor	15
E drejta e privatësisë	13
E drejta e qasjes në dokumente publike	13
E drejta për jetën	7
Raste për ndërmjetësim	7
Liria e asociimit	6
E drejta e lirisë dhe e sigurisë	5
Liria e shprehjes	5
Kufizimi i të drejtave dhe i lirive themelore	3
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	3
E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër	3
Konfesionet fetare	1
Liria e besimi, e ndërgjegjes dhe e fesë	1
E drejta e integritetit personal	1

**Tabela 3: Ankesat e vendosura si të papranueshme**

<b>Numri i ankesave të papranueshme</b>	<b>910</b>
<b>Ankesat e papranueshme, sipas neneve të Ligjit për Avokatin e Popullit</b>	
Mosshfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	256
S'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	221
Në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	221
Jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	142
Mosinteresim, dështim i palës për t'u përgjigjur - Neni 22, pika 1.2	56
Keqpërdorim i së drejtës së ankesës - Neni 21, pika 1.3.4	6
Raporti është publikuar - Neni 24, pika 3	3
Ankesë anonime - Neni 21, pika 1.3.3	3
E parashtruar pas afatit ligjor - Neni 21, pika 1.3.2	2

**Tabela 4: Ankesat në pritje për shqyrtim**

<b>Numri i ankesave në pritje për shqyrtim</b>	<b>16</b>
--	-----------

**Tabela 5: Ankesat e vendosura si të pranueshme për hetim**

<b>Numri i ankesave të vendosura si të pranueshme për hetim</b>	<b>676</b>
<b>Numri i rasteve hetimore me iniciativë të Avokatit të Popullit (Ex officio)</b>	<b>42</b>
<b>Përkatësia etnike e ankuesve bazuar në ankesat e hetuara</b>	
Shqiptarë	593
Serbë	56
Boshnjakë	14
Romë	4
Ashkali	3
Turq	2
Goran	1
Të tjerë	3
<b>Përkatësia gjinore e ankuesve, bazuar në ankesat e hetuara</b>	
Meshkuj	473
Femra	203
<b>Autoritetet publike përgjegjëse të ankesave të hetuara (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)</b>	
Gjykatat	237
Ministritë	220
Komunat	131

Policia	42
Prokuroritë shtetërore	24
Agjencia Kosovare e Privatizimit	14
Kompanitë private	11
Ndërmarrjet publike	9
Person privatë	4
Autoritetet e huaja	3
Të tjera	75

**Tabela 6: Ankesat e pranueshme për hetim, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë (një ankesë mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara)**

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	246
E drejta për mjete juridike	218
E drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit	129
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	112
Mbrojtja e pronës	79
Barazia para ligjit	75
Të drejtat e fëmijës	36
E drejta për arsimin	29
Të drejtat e të akuzuarit	26
Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës	15
Liria e lëvizjes	14
Dinjiteti i njeriut	13
E drejta e martesës dhe e familjes	9
Përgjegjësia për mjedisin jetësor	9
E drejta e privatësisë	7
E drejta për jetën	5
Raste për ndërmjetësim	5
Liria e asociimit	5
Kufizimi i të drejtave dhe i lirive themelore	3
E drejta e lirisë dhe e sigurisë	3
E drejta e qasjes në dokumente publike	3
Liria e shprehjes	2
E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër	2
Konfesionet fetare	1

**Tabela 7: Rastet ex officio bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë (një rast mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara)**

Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	10
Barazia para ligjit	9
E drejta për arsimin	8
E drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit	7
Të drejtat e fëmijës	6
Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës	4
E drejta për mjete juridike	3
Mbrojtja e pronës	3
Të drejtat e të akuzuarit	2
E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	2
E drejta për jetën	2
E drejta e privatësisë	2
Liria e lëvizjes	1
Dinjiteti i njeriut	1
E drejta e martesës dhe e familjes	1
Raste për ndërmjetësim	1
Kufizimi i të drejtave dhe i lirive themelore	1

**Tabela 8: Ankesat e pranueshme për hetim, të cilat janë mbyllur nga IAP-ja gjatë vitit 2022 (përfshijnë ankesat e pranueshme të vitit 2022 dhe të viteve paraprake)**

<b>Numri i përgjithshëm i ankesave të pranueshme për hetim e të cilat janë përfunduar/ mbyllur</b>	<b>604</b>
<b>Ankesat e përfunduara/mbyllura, sipas neneve të Ligjit për Avokatin e Popullit</b>	
I zgjidhur në pajtim me kërkesën e ankuesit - Neni 21, pika 1.5	257
I papranueshëm, s'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	122
I papranueshëm, në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	92
I mbyllur me raport - Neni 24, pika 3	77
I papranueshëm, mosshfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	28
I mbyllur për mosinteresim të ankuesit, dështim për t'u përgjigjur - Neni 22, pika 1.2	18
I papranueshëm, jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	10

**Tabela 9: Raportet me rekomandime, Letër rekomandimet, Avokati i Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae), Opinione dhe Kërkesat për masë të përkohshme**

Raporte për ankesat e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	13
Raporte për rastet hetimore me iniciativë të AP-së, Ex officio	7
Raportet e MKP-së	8
Letra me rekomandime për ankesat e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	4
<b>Rekomandime në raportet dhe në letrat me rekomandime</b>	<b>646</b>
Avokati i Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae)	2
Kërkesë për masë të përkohshme	1
Opinione	8

**Tabela 10: Zbatueshmëria e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, nga autoritetet publike përgjegjëse**

Autoriteti përgjegjës	Të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara	Në pritje për t'u zbatuar	Totali i rekomandimeve
Ministria e Drejtësisë	6	5	0	11	22
Ministria e Punëve të Brendshme	2	0	0	2	4
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	0	0	0	12	12
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	1	0	0	1	2
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave	0	0	0	1	1
Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Drejtësisë	0	0	0	3	3
Ministria e Shëndetësisë	0	0	0	2	2
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	0	0	0	3	3
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	0	0	0	6	6
Min. e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	0	0	1	1	2
Policia e Kosovës	3	0	0	0	3
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	0	0	0	2	2
Administrata Tatimore e Kosovës	0	0	0	1	1
Autoriteti i Aviacionit Civil	0	0	0	3	3
Senati dhe Rektorati	0	0	0	2	2
Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"	0	0	1	0	1
Këshilli Prokurorial i Kosovës	0	0	0	3	3
Gjykata e Apelit	1	0	0	0	1
Gjykata Themelore e Prishtinës	3	0	0	0	3



Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	0	0	0	1	1
Komuna e Prishtinës	0	0	1	1	2
Komuna e Skenderajt	0	0	0	1	1
Komuna e Graçanicës	1	0	0	0	1
Komuna e Gjakovës	2	0	0	0	2
Komuna e Ferizajt	0	0	0	1	1
Komuna e Mitrovicës së Veriut	0	0	0	1	1
Komuna e Deçanit	0	0	0	1	1
Komuna e Rahovecit	0	0	0	1	1
Komuna e Lipjanit	1	0	0	0	1
Komuna e Shtimes	1	0	0	0	1
Komuna e Kamenicës	0	0	0	1	1
Komuna e Klllokotit	0	0	0	1	1
Komuna e Shtërpçës	1	0	0	0	1
Komuna e Istogut	0	0	0	1	1
Komuna e Zveçanit	1	0	0	0	1
Komuna e Mamushës	0	0	0	1	1
Komuna e Zubin Potokut	1	0	0	0	1
Komuna e Leposaviqit	1	0	0	0	1
Komuna e Ranillugut	0	0	0	1	1
Komuna e Parteshit	0	0	0	1	1
Komunave të Kosovës	0	0	0	11	11
<b>Totali</b>	<b>25</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>77</b>	<b>110</b>
Rekomandimet e Raportit ex officio lidhur me shëndetin riprodhues, të cilat janë brenda afatit ligjor për zbatim, drejtuar 78 autoriteteve					536 <sup>4</sup>
Numri i përgjithshëm i rekomandimeve					646


4 Më 30 dhjetor 2022 është publikuar Raporti ex officio nr. 577/2021, të drejtat në shëndetin seksual dhe riprodhues në Republikën e Kosovës me anë të cilit autoriteteve iu janë adresuar 536 rekomandime. Këto rekomandime nuk mund të vlerësohen për zbatim në vitin 2022 sepse janë adresuar në ditën e fundit të vitit, prandaj, të njejtat do të monitorohen dhe vlerësohen për zbatim gjatë vitit 2023.

## Paraqitja grafike e statistikave të ankesave të paraqitura te Avokati i Popullit


1 janar 2022 - 31 dhjetor 2022



**FIGURA 1: ANKESAT E PARAQITURA TË QYTETARËVE DHE TË SHQYRTUARA NGA AVOKATI POPULLIT**




**FIGURA 2: ANKESAT E PARAQITURA SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE TË QYTETARËVE**







**FIGURA 3: NUMRI I ANKESAVE TË PARAQITURA SIPAS GJINISË SË QYTETARËVE**




**FIGURA 4: AUTORITETET PUBLIKE PËRGJEGJËSE, SIPAS ANKESAVE TË PARAQITURA TË QYTETARËVE**




**FIGURA 5: ANKESA E PARAQITURA, SIPAS KAPITULLIT II TË KUSHTETUTËS, TË DREJTAT DHE LIRIT THEMELORE**




**FIGURA 6: ANKESAT E PRANUESHME PËR HETIM, SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE TË QYTETARËVE**




**FIGURA 7: AUTORITETET PUBLIKE PËRGJEGJËSE, SIPAS ANKESAVE TË HETUARA**




**FIGURA 8: ANKESAT E HETUARA, SIPAS KAPITULLIT II TË KUSHTETUTËS, TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE**




**FIGURA 9: ANKESAT E HETUARA EX-OFFICIO, SIPAS KAPITULLIT II TË KUSHTETUTËS, TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE**




**FIGURA 10: ANKESAT E PRANUESHME PËR HETIM, TË CILAT JANË VENDOSUR ME PËRFUNDIM/MBYLLJE TË HETIMEVE**




**FIGURA 11: PËRQINDJA E ZBATUESHMËRISË SË REKOMANDIMEVE TË AVOKATIT TË POPULLIT, NGA AUTORITETET PUBLIKE PËRGJEGJËSE**



**FIGURA 12: PËRQINDJA E ZBATUESHMËRISË SË REKOMANDIMEVE TË AVOKATIT TË POPULLIT, TË PUBLIKUARA GJATË VITIT 2021, MË 31 DHJETOR 2021 DHE MË 31 DHJETOR 2022**



**FIGURA 13: PËRQINDJA E ANKESAVE TË PARAQITURA GJATË VITIT 2022, NË ZYRËN QENDRORE DHE ZYRAT RAJONALE TË AVOKATIT TË POPULLIT**





**Mbrojtja e të drejtave  
të njeriut nga  
Avokati i Popullit**

# Të drejtat fundamentale

## Dinjiteti i Njeriut

Kushtetuta, me Nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], përcakton: “Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.” Dinjiteti i njeriut është i lidhur me të gjitha të drejtat e tjera të njeriut dhe se duhet të merret parasysh nga shteti, me rastin e zbatimit të Kushtetutës dhe të ligjeve, si i tillë mund të trajtohet si vlerë e sistemit kushtetues.

Dinjiteti i njeriut është edhe pjesë e preambulës së Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila zbatohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Kjo deklaratë, në nenin 1 përcakton: “Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta.”

Në praktikën e saj, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut trajton dinjitetin njerëzor si një e drejtë, cenimi i së cilës prek thelbin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>5</sup>, respektivisht ndërlidhur me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në kuadër të zbatimit të masave të caktuara, shteti duhet të ketë kujdes që të mos cenojë dinjitetin njerëzor dhe në këtë rast rrjedhimisht të cenojë edhe thelbin e një të drejte që mbrohet në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>6</sup> Cenimi i dinjitetit të njeriut, në kuptim të

Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës së njohur nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është e lidhur gjithnjë me shkeljen e një të drejte tjetër që e përcakton Konventa.<sup>7</sup>

Avokati i Popullit në praktikën e tij në disa raste ka trajtuar cenimin e dinjitetit njerëzor në kuptim të cenimit të të drejtave të tjera që përcaktohen me Kapitullin II të Kushtetutës. Në Raportin ex-officio nr. 235/2018, Avokati i Popullit thekson se mohimi i së drejtës në pension kontributpagues të moshës për këtë kategori të qytetarëve, përveç që përbën cenim të barazisë para ligjit dhe diskriminim, cenon edhe dinjitetin e tyre.<sup>8</sup>

Edhe gjatë vitit 2022 Avokati i Popullit ka pranuar 23 ankesa për sa u përket pretendimeve për shkeljen e kësaj të drejte, ndërsa prej tyre, 14 ankesa janë proceduar për hetime të mëtejme.

Avokati i Popullit gjatë vizitës në Shtëpinë për të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (ShPMPF), ka pranuar ankesë nga rezidenti G. S., i cili është me aftësi të kufizuara në karrocë. Ai ankohej se nuk kishte pasur qasje në oborr që tri vjet, kjo për shkak të hapësirës së vogël të ashensorit. Avokati i Popullit, lidhur me këtë ankesë ka kërkuar nga organet kompetente që gjendja e krijuar të përmirësohet sa më shpejt, rezidentët të trajtohen

5 Guide on Article 3 of the European Convention on Human Rights, Prohibition of torture First edition – 31 August 2022, f.13.

6 Guide on Article 8 of the European Convention on Human Rights, Right to respect for private and family life, home and correspondence Updated on 31 August 2022, f.26.

7 Shih p.sh., po aty, f.46.

8 <https://oik-rks.org/2018/04/17/raport-me-rekomandime-exofficio-nr-235-2018/>.

me dinjitet, në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë diskriminim.<sup>9</sup>

Avokati i Popullit, gjithashtu pas vizitës që ka realizuar në Shtëpinë Rezidenciale për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore në Prizren, ka konstatuar se ka mungesë të kushteve elementare dhe mangësi në funksionimin e kësaj qendre, kushtet në këtë qendër nuk janë në përputhje me standardet e respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara mendore, rezidentë në këtë institucion.

Avokati i Popullit, gjatë kësaj vizite ka konstatuar se ka mungesë të furnizimit të rregullt të veshmbathjes, të ngrohjes, të medikamenteve për trajtim shëndetësor e të tjera dhe në bazë të të gjeturave ua ka tërhequr vëmendjen autoriteteve për detyrimin që kanë për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor dhe UA nr.11/2014 për Punën dhe Vendosjen e Rezidentëve, Personave me Aftësi të kufizuara Mendore-Ngecje në Zhvillimin Mendor në Institutin Special në Shtime dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet.

Avokati i Popullit, me Raportin Ex-officio nr. 577/2021 lidhur me të drejtat në shëndetin seksual dhe riprodhues, ndër të tjera ka konstatuar: *“Shumica e grave dhe vajzave nuk janë trajtuar në mënyrë të dinjitetshme në institucione shëndetësore publike në Kosovë, veçmas në rastet e abortit dhe kujdesit pas abortit.”* Një konstatim i tillë ka dalë si rezultat i të gjeturave nga hetimi që ka treguar për pritjet e gjata për trajtim, mungesa e terapive adekuate, mungesa e dedikimit të kohës për pacientë, trajtimi i padinjteshëm në mungesë të hapësirave të nevojshme, mungesa e privatësisë, e konfidencialiteti.

Avokati i Popullit në raport ka vlerësuar se trajtimi i padinjteshëm dhe cenimi i konfidencialitetit të grave, posaçërisht i atyre me aftësi të kufizuara, në institucione shëndetësore, paraqet shkelje të të drejtave të njeriut. Autoriteteve përgjegjëse ua ka rikujtuar detyrimin që të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar trajtim me dinjitet, mbrojtje të privatësisë dhe të konfidencialitetit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe shëndetësore, si të drejta të garantuara që duhet të respektohen në institucione shëndetësore, si publike ashtu edhe në ato private.

## E Drejta për Jetën

E drejta për jetën është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Neni 25 i Kushtetutës [E Drejta për Jetën] përcakton: *“Secili individ gëzon të drejtën për jetën.”*

Bazuar në të dhënat për rastet e raportuara të dhunës në familje dhe mbi bazë të raporteve që Avokati i Popullit ka publikuar për këto raste, del se cenimi më i shpeshtë i së drejtës për jetë si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve pozitive të shtetit vërehet te rastet e dhunës në familje.

Sipas Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, siç njihet si Konventa e Stambollit,<sup>10</sup> dhuna ndaj grave konsiderohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe formë e diskriminimit. Gjithashtu kjo konventë përcakton edhe detyrimet e përgjithshme pozitive të shtetit për ta mbrojtur të drejtën për jetë, duke përfshirë edhe detyrimin e shtetit për të ndërmarrë masa preventive për ta mbrojtur jetën dhe parandaluar dhunën. Dispozita mbi mbrojtjen nga dhuna në familje janë të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-

9 <https://oik-rks.org/2022/11/24/raporti-mkpt-se-per-viziten-ne-shtepine-per-personat-e-moshuar-dhe-pa-perkujdesje-familjare-ne-prishtine/>

10 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në Kodin Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (neni 248) dhe në dokumentin mbi Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë. Arritja e barazisë gjinore, luftimi dhe eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vdekjeve është objektiv që proklamohet edhe në Objektivin 5 të Agjendës 2030.<sup>11</sup>

Avokati i Popullit vazhdimisht vite me radhë, nga aspekte të ndryshme ka trajtuar cenimin e së drejtës për jetë, si rezultat i dhunës në familje dhe dështimit të shtetit në përmbushje të obligimeve pozitive. Si faktorë kryesorë që kanë ndikuar në cenimin e kësaj të drejte evidentohen: dështimi i hallkave institucionale në marrjen e masave adekuate dhe proporcionale ligjore për mbrojtje të së drejtës për jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje; vlerësimin e rrezikut dhe masave për mbrojtjen e viktimës; mungesë e koordinimit ndërinstytucional; mungesa e zbatimit të Ligjit për Mbikëqyrje të Personave të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës; si dhe mungesa e respektimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka pranuar 7 ankesa lidhur me cenimin e së drejtës për jetë, prej të cilave 5 raste janë iniciuar për hetim.

Shqetësuese mbetet vrasja e grave, gjatë vitit raportues janë vrarë 4 gra si pasojë e dhunës në familje, dhe lidhur me këto raste, Avokati i Popullit ka iniciuar hetime sipas detyrës zyrtare, që ndërliiden me cenimin e së drejtës për jetë dhe detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtje nga dhuna në familje.

Avokati i Popullit, me Raportin me rekomandime ex-officio nr.13/2022, përkritazi me detyrimet

pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën në jetë dhe për të siguruar mbrojtje nga dhuna në familje, ka konstatuar se autoritetet përgjegjëse kanë dështuar në përmbushjen e obligimeve pozitive për ta mbrojtur të drejtën në jetë, nuk janë respektuar Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ka munguar vëmendja e duhur për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, ka munguar koordinimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve përgjegjëse si edhe vërehet mungesa e theksuar e vlerësimit adekuat të rrezikut.

Avokati i Popullit rithekson se institucionet duhet të punojnë më shumë që garancitë kushtetuese, legjislacioni primar si edhe standardet e përcaktuara në instrumentet dhe konventat ndërkombëtare që garantojnë dhe mbrojnë të drejtën në jetë të gjejnë zbatim të plotë në praktikë. Në këtë drejtim Avokati i Popullit kërkon nga autoritetet përgjegjëse që të përmbushin detyrimet pozitive dhe përgjegjësinë që ka shteti për masat që duhet të ndërmarrë për mbrojtjen e jetës. Shteti duhet të marrë përgjegjësi kur dështon t'i përmbushë këto detyrime dhe të ndërmarrë masa në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

## E Drejta e Integritetit Personal

E drejta e integritetit personal është e drejtë e garantuar me Kushtetutë, ku në nenin 26 [E Drejta e Integritetit Personal] përcakton: “ *Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përfshin: (1) të drejtën që të marrë vendime lidhur me reprodukimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj;(2) të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin;(3) të drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj në pajtim me ligjin; (4) të drejtën që të*

<sup>11</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 25 janar 2018, kishte shprehur vullnetin politik nëpërmjet Rezolutës Nr. 06-R-001 për miratimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ), duke shprehur kështu gatishmërinë për t'u angazhuar në zbatimin e Agjendës 2030.

mos marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin paraprak të saj/tij.”<sup>12</sup>

Gjithashtu, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, integritetin fizik dhe psikologjik të një personi e interpreton nëpërmjet nenit 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare).

Në frymën e Kushtetutës, e drejta e integritetit personal në vendin tonë mbrohet edhe me një numër ligjesh.<sup>13</sup>

Avokati i Popullit gjatë periudhë raportuese nuk ka pranuar ndonjë ankesë nga qytetarët për shkeljen e së drejtës së integritetit personal. Mirëpo në Raportin ex officio nr. 577/2021<sup>14</sup>, përkitazi me të drejtat në Shëndetin Seksual dhe Riprodhues (ShSR) në Republikën e Kosovës, janë identifikuar një mori shkeljesh të të drejtave që ndërlidhen edhe me shkeljen e integritetit personal, e veçmas kjo është vërejtur te rastet e grave me aftësi të kufizuara. Raporti ka marrë për bazë rrëfimet e grave dhe të vajzave nga fokus-grupet, dëgjimet publike, intervistat sy më sy dhe intervistat me organizata joqeveritare. Përveç të tjerash, Avokati i Popullit ka konstatuar se grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nuk u janë ofruar informata të duhura për gjendjen e tyre shëndetësore, duke mos u ofruar shërbime në mënyrë të dinjitetshme dhe duke mos u krijuar kushte për marrjen e shërbimeve të dinjitetshme dhe të përshtatshme me nevojat e tyre, e me këtë, nëse e shikojmë në interpretim të gjerë të nenit 8 të KEDNj-së, atëherë mund të nxjerrim konkluzionin se është cenuar integriteti i tyre si në aspektin psikik, ashtu edhe në atë fizik.

## Liria e Lëvizjes

Liria e lëvizjes është e drejtë themelore e njeriut, e cila u lejon individëve të lëvizin lirshëm brenda vendit ku jetojnë ose të lëvizin lirshëm nga një vend në tjetrin.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 35 garanton lirinë e lëvizjes dhe shprehimisht përcakton se shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës dhe kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës gjithashtu të zgjedhin vendbanimin. Sipas Kushtetutës, secili person ka të drejtë të largohet nga vendi, po ashtu shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t'u ndalohet hyrja në vend dhe nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur me ligj dhe me marrëveshjet ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit. E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t'u vendosur në vend, rregullohet me ligj.

Liria e lëvizjes garantohej edhe me KEDNj-në, Protokollin 4, i cili në nenin 2 përcakton ushtrimin e të drejtave të qytetarëve për lëvizjen e lirë dhe për mënyrën e kufizimit të kësaj të drejte në përputhje me ligjin dhe të justifikuar nga interesi publik në një shoqëri demokratike.

Përkitazi me të drejtën e lëvizjes së lirë, gjatë vitit raportues IAP-ja ka pranuar 32 ankesa, prej tyre 14

12 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>, neni 26

13 Kodi Nr.08/L-032 i Procedurës Penale, i publikuar në Gazetën Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.24/17 gusht 2022 neni 142 <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/DC62FE67-D24D-4307-932F-38B0B2D4812B.pdf>; Ligji nr. 02 /L-76 për Shëndetin Riprodhues, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2506>; Ligji 03/L-110 për Ndërprerjen e Shtatzënisë <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2624>; Ligji nr. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Banorëve të Kosovës në Sistemin Shëndetësor <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2454>; Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12554>.

14 <https://oik-rks.org/2023/01/04/raport-ex-officio-nr-5772021-lidhur-me-te-drejtat-ne-shendetin-seksual-dhe-riprodhues-qasja-ne-informata-dhe-sherbime-kontracesioni-ne-abortion-dhe-kujdes-pas-abortit-si-dhe-kujdesi-per-shendetin-e/>

janë hapur për hetim. Ankesat të cilat janë adresuar në IAP lidhur me të drejtën e lirisë së lëvizjes, kryesisht kanë të bëjnë me refuzimin e kërkesës për pajisje me dokumente personale të Republikës së Kosovës, refuzimin e kërkesës për t'u pajisur me nënshtetësinë e Republikës së Kosovës edhe përkundër pretendimeve që ankuesit i plotësonin kriteret e caktuara, për shkak të refuzimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës me natyralizim e bashkëshortit, dhe për pamundësinë e pajisjes me pasaportën e Republikës së Kosovës për shkak të mungesës së materialeve për prodhimin e pasaportave.

Agjencia e Regjistrimit Civil, nga muaji tetor 2022, ka njoftuar opinionin publik se ka mungesë të materialeve për prodhimin e pasaportave dhe nuk ka lëshuar pasaporta për aplikuesit, përveç për rastet urgjente. Qytetarët janë njoftuar se për shkak të mungesës së materialit për prodhimin e pasaportave, të njëjtët nuk mund të pajisen me to deri në janar 2023. Avokati i Popullit ka ndjekur me shqetësim këtë situatë, për shkak se mospajisja me dokumente udhëtimi kufizon lirinë e lëvizjes. Avokati i Popullit u ka bërë thirrje institucioneve përgjegjëse që dështime të tilla institucionale të mos përsëriten, ngase të njëjtat krijojnë pasiguri tek qytetarët e vendit dhe shkelje të të drejtave elementare të tyre.

Avokati i Popullit i ka ndjekur me vëmendje ngjarjet në veri të vendit dhe ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me situatën e krijuar si pasojë e vendosjes së barrikadave. Avokati i Popullit nëpërmjet komunikatës për media ka theksuar se vendosja e barrikadave në veri e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe ka vlerësuar se duhet të rikthehet rendi dhe ligji në gjithë territorin e vendit, duke mundësuar realizimin e të drejtave civile si dhe mbrojtjen dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe të lirisë të njeriut të garantuara më Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit ka tërhequr vëmendjen e secilit autoritet që në kuadër të fushëveprimit të tij, me përgjegjësi kushtetuese

e ligjore, në mënyrë të kujdesshme të harmonizojnë të gjitha veprimet në respektimin e të drejtave dhe të lirisë të njeriut dhe vlerëson angazhimin e gjithë mekanizmave vendorë dhe ndërkombëtarë për të siguruar të drejtën elementare për siguri, lëvizje të lirë, të drejtën për punë dhe të drejtat e tjera të garantuara me instrumentet vendore dhe ndërkombëtare.

## Mbrojtja e Pronës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], përcakton: *“E drejta e pronës është e garantuar.”* Për më tepër, Kushtetuta definon edhe të drejtën e shfrytëzimit të pronës duke përcaktuar: *“Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik” dhe se “Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona.”*, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në pajtim me ligjin për interesat publike.

Po ashtu, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mbrojtjen e pronës e garanton me nenin 1, të Protokollit 1.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar 130 ankesa që në një formë apo në tjetrën prekin të drejtat pronësore të ankuesve. Numri më i madh i ankesave janë për shkak të zvarritjes të procedurave gjyqësore, kanë të bëjnë me kontestet pronësore, mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore etj. Avokati i Popullit gjatë ditëve të hapura ka pranuar ankesë nga një grup qytetarësh lidhur me kalimin e pronave private në pronësi të Republikës së Maqedonisë Veriore me rastin e demarkimit të kufirit në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë Veriore. Qytetarët janë ankuar se pjesë nga pronat e tyre nuk figurojnë në certifikatat e pronësisë në Republikën e Maqedonisë Veriore, e për të cilat ata pretendojnë se nuk janë shpronësuar dhe nuk janë kompensuar as nga Republika e Kosovës dhe as nga ajo e Maqedonisë Veriore, madje ata pohojnë se për një gjë të tillë ata janë njoftuar vetëm me rastin e nxjerrjes se



certifikatave të pronësisë. Avokati i Popullit i ka hapur rastet për hetim.

Gjatë vitit raportues, Avokati Popullit ka pranuar ankesa kundër Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), përkatësisht për pjesën e mandatit të trashëguar nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP), lidhur me ekzekutimin e vendimeve për dëbim. Ankesat kryesisht janë paraqitur lidhur me Kategorinë A të kërkesave që kanë të bëjnë me lirimin e pronave.

Avokati i Popullit ka pranuar një numër ankesash kundër KEDS-it e që kanë të bëjnë me pengim posedimi, përkatësisht vendosjen e shtyllave elektrike pranë pronave private, duke penguar kështu përdorimin e qetë dhe të papenguar të pronës. Gjithashtu ka edhe ankesa me pretendime se KEDS-i ka dështuar në shtrirjen e rrjetit nëpër disa zona rurale, me ç' rast, sipas ankuesve, në mungesë të energjisë elektrike u pamundësohet shfrytëzimi i pronave të tyre.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka publikuar një raport lidhur me ankesën e paraqitur nga disa qytetarë<sup>15</sup> lidhur me *Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale*. Çështja ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të pronarëve të paluajtshmërive në territorin e komunës së Prishtinës, të cilët detyrohen ta paguajnë tarifën e taksës për transaksionet në pronën e paluajtshme, të përcaktuar me këtë rregullore. Rregullorja ishte qartazi e pabazuar në ligj, ndaj së cilës nuk kishte reaguar as Ministria e Pushtetit Lokal, e cila ka për obligim vlerësimin e ligjshmërisë së akteve komunale. Avokati i Popullit ka konstatuar se obligimi për pagimin e tarifës së taksës për transaksion të pronës së paluajtshme përbën shkelje të së drejtës pronësore, për shkak

se një obligim i tillë nuk përcaktohet me ligj. Prandaj i ka rekomanduar Komunës së Prishtinës shfuqizimin e rregullores, ndërsa Ministrisë së Pushtetit Lokal që të ndërmarrë masa për fillimin e procedurave gjyqësore lidhur me kontestimin e akteve komunale, në rastet kur komunat refuzojnë kërkesën e ministrisë për rishqyrtimin e akteve komunale.

Për sa i përket pronës shoqërore dhe pretendimeve të individëve mbi pronat e ndërmarrjeve shoqërore të themeluara në të kaluarën nga marrja e pronave private, kompetente mbetet Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DhPGjS). Avokati i Popullit ka vazhduar të pranojë ankesa ndaj DhPGjS-së lidhur me zvarritjet procedurale. Nga ankesat e pranuar dhe të trajtuara vërehet se nuk ka ndonjë përmirësim të dukshëm në zgjidhjen e shpejtë të rasteve që paraqiten pranë kësaj gjykate e që është i vetmi autoritet për të vendosur lidhur me këto çështje.

## E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] përcakton: “*Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj [...]*”<sup>16</sup> Kjo e drejtë është në harmoni të plotë me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si KEDNJ-në<sup>17</sup> dhe Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike.<sup>18</sup>

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit, si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka realizuar një numër të konsiderueshëm të vizitave në qendra të ndalimit në stacione policore, në qendra të paraburgimit e në burgje. Gjatë këtyre

15 <https://oik-rks.org/2022/11/25/raport-i-avokatit-te-popullit-ankesa-nr-3532021-per-rregulloren-01-41304-025353117-e-dates-10-tetor-2017-per-ndryshimin-dhe-plotesimin-e-rregullores-01-nr-1102782-per-tarifa-ngarkesa-dhe-gjo/>

16 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 29.

17 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, neni 5.

18 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 9.

vizitave janë realizuar intervista me personat e privuar nga liria, në disa raste ka pasur pretendime për shkeljen e së drejtës së lirisë, duke iu referuar vendimeve për paraburgim dhe zvarritjes së jashtëligjshme të procedurave gjyqësore, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë.

Në dhjetor 2022, mediat kishin raportuar për arrestimin e z. Dejan Pantiçit, të cilit i ishte caktuar paraburgimi me vendim të gjykatës dhe po mbahej nga policia në lokacion që nuk bëhej publik, për shkak të sigurisë dhe të rrethanave që u krijuan nga situata në komunat e veriut të Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit, me qëllim që të sigurohej se z. Pantiçi po i respektoheshin të drejtat e garantuara, realizoi takim online me z. Pantiçin, ku gjatë takimit ai tha se nuk ka ndonjë ankesë për sa i përket trajtimit nga Policia e Kosovës, se ka avokat mbrojtës, familja është njoftuar për faktin se ai u arrestua dhe iu shqiptua masa e paraburgimit, i është mundësuar ta merrte terapinë adekuate të përshkruar nga mjeku, i është siguruar akomodimi, i është dorëzuar vendimi gjyqësor për caktimin e masës së paraburgimit dhe se nuk ka ndonjë ankesë lidhur me trajtimin.

Avokati i Popullit gjatë këtij viti raportues nuk ka marrë ndonjë ankesë për sa u përket pretendimeve për shkeljen e kësaj të drejte.

## E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është e drejtë themelore e njeriut e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], ku përcakton: “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë

*para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*

Kjo e drejte në vete përmban të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj dhe të drejtën në ndihma juridike falas, atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është e garantuar edhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [E drejta për një proces të rregullt].

Për sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut në fushën e gjyqësorit, përkatësisht së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Avokati i Popullit ka mandat të kufizuar. Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, duke mos ndërhyrë në raste dhe në procedura ligjore që janë duke u zhvilluar në gjykata, përveç ankesave që kanë të bëjnë me zvarritje të procedurave në gjykimin e lëndëve gjyqësore.<sup>19</sup>

Edhe në këtë vit, numri më i lartë i ankesave të pranuar nga Avokati i Popullit kanë të bëjnë me shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në kuptim të zvarritjeve procedurale, respektivisht të cenimit të kësaj të drejte të caktuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së.

Avokati i Popullit në të gjitha rastet e ankesave të shqyrtuara, pas konstatimit të cenimit të kësaj të drejte, përmes shkresave dhe raporteve me rekomandime ka kërkuar nga autoritetet gjyqësore ndërmarrjen e veprimeve për eliminimin e shkeljeve të konstatuara.

19 Ligji Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16.8.



Më 21 qershor 2022, Avokati i Popullit ka organizuar tryezë diskutimi lidhur me *Zgjidhjen efektive të zvarritjeve të procedurës gjyqësore – shkelja e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, nga e cila kanë dalë konkluzionet, që kanë të bëjnë me: nevojën e angazhimit të përbashkët të gjitha institucioneve kompetente për ndërmarrjen e veprimeve për krijimin e mekanizmit për zgjidhjen efektive lidhur me rastet e zvarritjeve të procedurës gjyqësore dhe kompensimin e viktimave të shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.<sup>20</sup>

Edhe përkundër faktit se zvarritjet e procedurave gjyqësore paraqesin një prej shqetësimeve që Avokati i Popullit ka ngritur vazhdimisht dhe i ka rekomanduar Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës krijimin e një mekanizmi ligjor për kompensimin e shkeljeve të kësaj natyre, ende nuk ka asnjë hap në drejtim të zbatimit të këtij rekomandimi. Prandaj qytetarët, pavarësisht faktit se u cenohet kjo e drejtë, mbesin pa mbrojtje ligjore në drejtim të kompensimit të shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

## Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe e prokurorëve

Avokatit të Popullit, me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve (LPDGjP)<sup>21</sup>, i janë caktuar kompetenca për pranimin e ankesave nga qytetarët, të paraqitura ndaj një gjyqtari ose prokurori, neni 9.3 i ligjit: *“Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari ose prokurori tek Avokati i Popullit.”*

Duke u bazuar në kompetencat e këtij ligji, Avokati i Popullit në këtë vit raportues i ka pranuar 9 ankesa nga qytetarët, prej të cilave 7 ankesa i ka proceduar për hetim, ndërsa 2 ankesa i ka refuzuar

si të papranueshme, meqenëse nuk i kanë plotësuar kriteret e pranueshmërisë në pajtim me Ligjin e Avokatit të Popullit dhe me LPDGjP-në.

Vlen të theksohet se Avokati i Popullit në të gjitha këto rastet e trajtuara i ka pranuar vendimet nga autoritetet kompetente brenda afatit të paraparë me ligj dhe i ka njoftuar ankuesit me vendimet që ka marrë.

## E Drejta për Mjete Juridike

E drejta për mjete juridike garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], ku përcakton: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”* Kjo e drejtë është e garantuar edhe me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në këtë vit, Avokati i Popullit ka pranuar nga qytetarët 498 ankesa me pretendimin se u është cenuar e drejta për mjete juridike, për shkak të mospërgjigjes brenda afatit në ankesat e parashtruara. Nga ankesat e pranuar, 218 ankesa janë hapur për hetim, ndërsa të tjerat janë vendosur si të papranueshme, sepse nuk kanë plotësuar kriteret e pranueshmërisë sipas Ligjit për Avokatin e Popullit.

Kundër autoriteteve të nivelit qendror janë paraqitur 155 ankesa, prej të cilave 75 ankesa janë hapur për hetim, ndërsa kundër autoriteteve përgjegjëse të nivelit lokal janë paraqitur 78 ankesa, prej të cilave 53 ankesa janë hapur për hetim. Nga ankesat e pranuar vërehet se shumica e pretendimeve ankimore kanë të bëjnë me mospërgjigje të autoriteteve në ankesat e parashtruara.

20 <https://oik-rks.org/2022/06/21/komunikate-per-media/>

21 Ligji nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve, neni 9.3.

Ndaj gjykatave të të gjitha niveleve janë paraqitur 76 ankesa, prej të cilave 32 ankesa janë hapur për hetim.

Avokati i Popullit, duke iu referuar artikullit në portalin “Nacionale”, me titull: “*Paguaj dënimin 50% më lirë, por s’ke të drejtë ankese - a po e shkel ATK-ja kushtetutën?*”<sup>22</sup>, ka hapur hetime sipas detyrës zyrtare ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, për shkak të privimit të qytetarëve në ushtrimin e së drejtës për mjete juridike ndaj dënimeve kundërvajtese të Administratës Tatimore të Kosovës. Avokati i Popullit, pas hetimit të rastit, ka nxjerrë raportin me rekomandime, me konstatimin se neni 12 i Rregullores së Administratës Tatimore të Kosovës, që përcakton: “Nëse i pandehuri e paguan gjobën para se të marrë formën e prerë vendimi për kundërvajtjen, do të konsiderohet se në këtë mënyrë ka hequr dorë nga e drejta për paraqitjen e ankesës.”, shkel të drejtën për mjet juridik, nenin 32, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në nenin 13, të drejtën për mjet juridik, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rekomandimi është zbatuar brenda afatit nga Administrata Tatimore e Kosovës.

## E Drejta e Privatësisë

E drejta për jetën private, jetën familjare, banesa dhe korrespondenca janë të drejta që përfshihen në të drejtën e privatësisë, të cilat mbrohen me nenin 8 të KEDNj-së dhe me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Çdokush ka të drejtë që t’i respektohet jeta private e familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij. Megjithatë, në praktikë janë identifikuar shkelje të së drejtës së privatësisë në Kosovë.

Avokati i Popullit gjatë këtij viti ka pranuar trembëdhjetë ankesa për shkelje të kësaj të drejte, prej të cilave shtatë janë hapur për hetime të mëtejme, ku AP-ja ka ndërmarrë veprime të nevojshme hetimore, duke u drejtuar autoriteteve kompetente rekomandime konkrete.

Midis objekteve të cilave duhet t’u kushtohet respekt i veçantë, sipas nenit 8, është shtëpia, që është vendi ku personi jeton në mënyrë të përhershme apo me të cilin personi ka lidhje të mjaftueshme e të vazhdueshme. Avokati i Popullit ka trajtuar ankesat për sa i përket cenimit të së drejtës së privatësisë nga shqetësimet që u shkaktohen qytetarëve në shtëpitë e tyre, nga fqinjët e tyre, nga bizneset në afërsi, nga kafenetë e restorantet, nga makinat e parkuara para shtëpive të tyre etj. Në të gjitha këto raste Avokati i Popullit ka ndërmarrë veprime dhe do të vazhdojë t’i trajtojë deri në zgjidhjen e tyre.

Në linjë të mbrojtjes së kësaj të drejte, Avokati i Popullit ka analizuar edhe çështjen e instalimit të kamerave të sigurisë në disa qeli të të burgosurave në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, me ç’ rast ka tërhequr vëmendjen e autoriteteve kompetente për shkeljen e të drejtave të personave të privuar nga liria, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me legjislacionin relevant në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit, pas analizimit të rastit dhe grumbullimit të informatave nga terreni, është njoftuar se qëllimi i vendosjes së kamerave ka qenë për sigurinë e disa të burgosurave me probleme të shëndetit mendor, si dhe ato mbulonin vetëm shtretërit dhe dritaret e qelisë. Edhe përkundër qëllimit të mirë që kishte vendosja e këtyre kamerave, megjithatë Avokati i Popullit ka vlerësuar se ky veprim ishte ndërhyrje arbitrare në privatësi, si dhe në anën tjetër nuk kishte një akt

22 Gazeta “Nacionale”, linku: <https://nacionale.com/sociale/paguaj-denimin-50-me-lire-por-ske-te-drejte-ankese-a-po-e-shkele-atk-ja-kushtetuten>

nënligjor konkret që do ta rregullonte një veprim të tillë. Avokati i Popullit i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me rekomandim që vendosja e kamerave të këtë bazë ligjore të arsyetuar mirë, të cilin rekomandim Ministria e Drejtësisë e ka marrë shumë seriozisht dhe ka zbatuar rekomandimin e dhënë.<sup>23</sup>

## E Drejta e Martesës dhe Familjes

Kushtetuta definon të drejtën e martesës dhe të familjes duke përcaktuar: “Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush ka të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin.”<sup>24</sup> Më tej Kushtetuta përcakton: “Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe Ligji bazohen në barazinë e bashkëshortëve.” Ligji për Familjen, në nenin 14 përcakton: “Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes.” Ligji rregullon një fushë mjaft të gjerë të marrëdhënieve shoqërore, me fokus marrëdhëniet që lindin në familje, në martesë ose të lidhura me familjen dhe me martesën.

Bazë për rregullimin e marrëdhënieve familjare në Kosovë janë edhe standardet ndërkombëtare, që janë të zbatueshme drejtpërdrejt në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.<sup>25</sup> Sipas nenit 8, paragrafi 1, të KEDNJ-së: “Çdo njeri ka të drejtën për respekt për jetën familjare, vendbanimin dhe korrespondencën e tij.” Në bazë të këtij neni, jeta e familjes është pozicionuar drejtpërdrejt në sferën e jetës private, pa ndërhyrjen arbitrare të shtetit.

Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në gëzimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut.<sup>26</sup>

Avokati i Popullit, në Opinionin për projektin e Kodit Civil<sup>27</sup>, ka konstatuar: “Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke mos përcaktuar shprehimisht se e drejta e martesës është e drejtë e “burrit dhe gruas”, nuk paraqet asnjë pengesë për të konstatuar se privimi i personave me sekse të njëjta nga e drejta e martesës, paraqet shkelje të së drejtës për të mos u diskriminuar në bazë të orientimit seksual.”

Avokati i Popullit gjatë këtij viti ka pranuar 30 ankesa, 9 prej tyre janë proceduar për hetime të mëtejme. Bazuar në analizën e rasteve të paraqitura në IAP, ankesat më të shumta në këtë fushë kanë të bëjnë me zvarritjet procedurale në gjykata, mospagimin e alimentacionit, mosnxjerrje e urdhër-mbrojtjes, besimin e fëmijëve kur prindërit jetojnë ndaras, realizimi i kontaktit me fëmijët kur prindërit jetojnë ndaras etj.

Çështja e pengimit të kontakteve të fëmijëve nën përkujdesjen e njërit prind, me prindin i cili është ndarë nga bashkësia familjare, në Kosovë vazhdon të jetë një problem shumë i rëndë. Në të shumtën e rasteve, për shkak të prishjes dhe të acarimit të skajshëm të raporteve ndërnjerëzore midis ish-bashkëshortëve, ku në të shumtën e rasteve janë të përfshira edhe familjet e tyre, njërit prind i mohohet kontakti me fëmijët nga prindi tjetër.

23 <https://oik-rks.org/2022/03/16/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-952022-perkitazi-me-instalimin-e-kamerave-te-sigurise-ne-disa-qeli-te-te-burgosurave-ne-qendren-korrektuese-per-femra-ne-lipjan/>

24 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 37, paragrafi 1

25 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22

26 KEDNJ, neni 8 paragrafi 2

27 <https://oik-rks.org/2022/05/27/opinion-i-avokatit-te-popullit-lidhur-me-njohjen-e-marredhenieve-familjare-te-personave-me-sekse-te-njejta-me-projektin-civil/>

## Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë

Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë në Kosovë është e rregulluar me nenin 38 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 9 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kushtetuta, në nenin 38 [Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë], përcakton: “*Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, është e garantuar.*” Ndërsa Ligji Nr. 02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë është një tregues i synimit për forcimin ligjor të këtyre të drejtave dhe lirive, por me këtë ligj, i cili është ende në fuqi, të drejtat fetare, e mbi të gjitha pozita juridike e komuniteteve fetare, nuk janë të rregulluara në mënyrë adekuate. Në raportet e mëparshme vjetore (2012-2015), Avokati i Popullit raportoi për shqetësimet e komuniteteve fetare për shkak të mungesës së rregulloreve ligjore që do të rregullonin pozicionin e tyre ligjor, si dhe për nevojën për një zgjidhje ligjore të pozicionit ligjor të bashkësive fetare.

Përpjekjet për ndryshimin e ligjit ekzistues dhe rregullimin e këtyre çështjeve kanë ekzistuar për gati një dekadë: Projektligji nr. 06/L-001 për ndryshimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë, i cili është dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në shtator 2017, si dhe Projektligji nr. 07/L-037 për ndryshimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë, i cili është dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në shtator 2020. Avokati i Popullit thekson rëndësinë që ka procedimi i këtij ligji, pa vonesë, me qëllim të miratimit në Kuvend.

Miratimi i këtij ligji do të rregullojë pozitën juridike të bashkësive fetare dhe është një parakusht i domosdoshëm për respektimin e të drejtave të tjera që kanë të bëjnë me lirinë e besimit dhe të fesë. Në anën tjetër zvarritja e miratimit të këtij ligji mund

të konsiderohet si dështim i autoriteteve shtetërore për t’i mbrojtur këto të drejta. Kjo çështje është shqetësuese për të gjitha bashkësitë tradicionale fetare në Kosovë dhe mund të jetë me rëndësi edhe për komunitetet e vogla fetare që mund të shprehin synimin për regjistrimin e aktiviteteve të tyre në Kosovë.

Gjatë këtij viti është zhvilluar një debat i gjerë publik që shkas ka marrë Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 06/2014 Kodi i Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore për Nxënës të Shkollave të Mesme të Larta. Edhe pse udhëzimi administrativ nuk përcakton kufizim të bartjes së shamisë, debati kryesisht është zhvilluar për atë se a është e lejuar apo jo bartja e shamisë nëpër shkolla. Avokati i Popullit, duke e analizuar debatin e zhvilluar në opinionin publik dhe raportet e mëhershme që Avokati i Popullit i ka nxjerrë për këtë çështje, konsideron se udhëzimi administrativ nuk e rregullon këtë çështje. Në raportet e publikuara në vitet e mëhershme, Avokati i Popullit kishte konsideruar se udhëzimi administrativ nuk paraqet bazë të mjaftueshme ligjore për kufizimin e kësaj të drejte, duke u nisur nga parimi se kufizimi i të drejtave dhe i lirive mund të bëhet vetëm përmes një ligji të miratuar në Kuvend, kur ka një qëllim legjitim dhe përmbushen kriteret e përcaktuara me nenin 55 të Kushtetutës.

## Liria e Shprehjes

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 40 [Liria e Shprehjes], përcakton: “*Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.*” Liria e shprehjes nuk hyn në grupin e të drejtave absolute, “mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe

provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare”.<sup>28</sup>

Liria e shprehjes, si e drejtë themelore, është një e drejtë në vetvete si dhe një komponent i të drejtave të tjera të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar 5 ankesa me pretendimin për shkeljen e së drejtës së lirisë së shprehjes, 2 prej të cilave janë hapur për hetim.

Avokati i Popullit ka vazhduar të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të tij drejtuar autoriteteve publike gjatë viteve paraprake për respektimin dhe përmbushjen e të drejtës së lirisë së shprehjes në vend. Më 10 dhjetor 2021, Avokati i Popullit, nëpërmjet raportit lidhur me ndikimin e pandemisë në të drejtat e njeriut<sup>29</sup>, përfshirë ndikimin e pandemisë në lirinë e shprehjes, u kishte adresuar autoriteteve publike rekomandime lidhur me ofrimin e informacionit në gjuhën e përshtatshme apo në gjuhën amtare për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, si në vijim: “Qeveria e Republikës së Kosovës, ministritë dhe institucionet e tjera të sigurojnë qasje dhe përkthim adekuat të informacionit në lidhje me COVID-19 në kohën e duhur, në gjuhët zyrtare dhe Ministria e Shëndetësisë të sigurojë qasje në të gjitha informatat që i publikon në lidhje me situatën e pandemisë COVID-19 për personat me aftësi të kufizuara, në gjuhën e kuptueshme të tyre.” Në këtë kontekst është vlerësuar gatishmëria e autoriteteve relevante dhe ndërmarrja e veprimeve nga ana e tyre për t’i zbatuar rekomandimet e Avokatit të Popullit në fushën përkatëse.

Me këtë drejtim Avokati i Popullit ka bërë thirrje të rregullohet infrastrukturë e duhur ligjore dhe efektive mbi përdorimin në rrjeteve sociale në vend me qëllim të luftimit të keqinformimit dhe shpërndarjes së lajmeve të paverifikuara si dhe ndërtimi i një standardi që në mënyrë të balancuar garantohet liria e shprehjes, duke vendosur kufijtë e domosdoshëm për mbrojtjen e lirisë dhe të të drejtave të tjera të njeriut.

Duke qenë se rritja e gjuhës së urrejtjes dhe e krimeve të urrejtjes është theksuar si një nga fenomenet më alarmante në Bashkimin Evropian<sup>30</sup>, është kërkuar punë e pandërprerë në monitorimin, parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes në të gjitha format e saj, në internet dhe jashtë tij.

Avokati i Popullit ka ndjekur me shqetësim debatin i cili është zhvilluar në Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë seancës së datës 16 mars 2022, ku deputetëve të Kuvendit u është kërkuar të votonin pro/kundër dokumentit të plotësuar të Kodit Civil që trajton, ndër të tjera, bashkësitë civile të të njëjtit seks (neni. 1138, para. 2: “*Bashkësitë e regjistruara ndërmjet personave me sekse të njëjta janë të lejuara. Kushtet dhe procedurat rregullohen me ligj të veçantë*”). Ky nen i këtij kodi, nga sa është vërejtur nga mediet dhe platformat sociale, hasi në kundërshtim nga një numër i madh qytetarësh si dhe nga disa deputetë dhe në fund u refuzua. Një nga arsyetimet kryesore që deputetët ngritën për të kundërshtuar projekt-kodin e propozuar ishte se bashkësitë civile të të njëjtit seks përbënin një kërcënim për ruajtjen e institucionit të familjes. Në këtë seancë parlamentare disa nga deputetët, në diskutimet e tyre kanë përdorur gjuhë të papërshtatshme ndaj personave LGBTI+. Avokati i Popullit deklaroi se gjuha e përdorur në seancën e lartpërmendur është në kundërshtim me vlerat

28 Neni 40, paragrafi 2, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

29 <https://oik-rks.org/2021/12/10/raport-i-vecante-emergjenca-shendetesore-dhe-ndikimi-i-pandemise-covid-19-ne-te-drejtat-e-njeriut-ne-republiken-e-kosoves/>

30 KERI, Raporti vjetor mbi aktivitetet e KERI-t për vitin 2017, <https://rm.coe.int/annual-report-on-ecri-s-activities-covering-the-period-from-1-january-16808c168b>.



themelore të një shoqërie demokratike, që i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë, dhe se këto vlera janë bazë themelore për funksionimin e shtetit të së drejtës.

Në këtë kontekst Avokati i Popullit është në proces të hartimit të raportit mbi gjuhën e urrejtjes në diskursin publik në Kosovë. Përmes këtij raporti ka për qëllim që të argumentojë se gjuha e urrejtjes paraqet problem serioz për të drejtat e njeriut dhe barazinë, duke shkaktuar tensione të panevojshme ndërmjet grupeve të ndryshme sociale, por gjithashtu duke çrregulluar rendin dhe qetësinë publike, e cila është e nevojshme të adresohet nga institucionet përgjegjëse. Raporti gjithashtu synon të ndërtojë publikun dhe institucionet lidhur me standardet ndërkombëtare dhe vendore se çka konsiderohet gjuhë e urrejtjes dhe kur tejkaloheft kufiri i lirisë së shprehjes dhe të japë shembuj të mbledhur nga hulumtimi lidhur me gjuhën e përdorur në debatet parlamentare si dhe atë të përdorur në diskursin mediatil, me fokus të veçantë në mediat sociale, duke argumentuar atë edhe përmes praktikës gjyqësore ndërkombëtare dhe vendore.

## E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike

E drejta e qasjes në dokumente publike i garanton secilit person të drejtën e qasjes në dokumente publike, me përjashtim të informacioneve të kufizuara me ligj (neni 41 i Kushtetutës dhe Ligji për Qasje në Dokumente Publike). Kjo e drejtë nuk është e drejtë absolute, por është e drejtë e cila duhet të balancohet me të drejtat e tjera, pa i dëmtuar interesat e tjera.

E drejta e qasjes në dokumente publike, përveç me legjislacion vendor, garantohet edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 19) dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (nenet 8 dhe 10).

Institucioni i Avokatit të Popullit, si institucion i pavarur kushtetues, i ndihmon qytetarët në realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet publike në bazë të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit ka pranuar 14 ankesa që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike, 11 nga këto janë shpallur të papranueshme, ndërsa 3 të tjerat janë hapur për hetim. Nga ankesat e hapura për hetim, një ankesë është pranuar nga mediat dhe dy janë ankesa individuale. Ankesat individuale kanë të bëjnë kufizimin e qasjes në dokumentet e kërkuara e që ndërlidhen me procedurën e rekrutimit në dy institucione të ndryshme.

Në rastin e ankesës së ushtruar kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), nga Gazeta Online Insajderi, për refuzim të kërkesës për qasje në dokumente publike, lidhur me shpenzimet e të një diplomati, Avokati i Popullit, me raportin me rekomandim, ka konstatuar se MPJD-ja ka dështuar të përmbushte detyrimet lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo e garantuar. Për më tepër, Avokati i Popullit konstaton se mosveprimi i MPJD-së, edhe përkundër vendimeve që ka nxjerrë lidhur me çështjen Agjencia për Informim dhe Privatësi, tregon për qasje mospërfillëse të MPJD-së, duke mos i kushtuar vëmendje dhe rëndësi interesit të publikut për mënyrën e shfrytëzimit të parasë publike.

## Liria e Medieve

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 42 [Liria e Medieve] ofron garanci për lirinë dhe pluralizmin e mediave dhe ndalon censurën. Burimet e gazetarëve mbrohen me Ligjin nr. 04/L-147 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë. Ekzistojnë edhe ligjet e tjera që përmbajnë dispozita të

hollësisht për zbatimin e garancive kushtetuese, si dhe vetërregullimi i medieve përmes kodeve të etikës që mëtojnë përgjegjësinë më të madhe në gazetari.

Sipas Komisionit të Pavarur të Mediave, në Kosovë ekzistojnë 19 televizione<sup>31</sup> (një televizion publik, 13 TV stacione në gjuhën shqipe, dhe 5 TV stacione në gjuhën serbe), dhe të licencuara janë 89 radiostacione. Ndërsa nuk ekziston një numër i saktë i gazetave online dhe i portaleve. Megjithatë Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) ka 57 anëtarë të regjistruar në këtë këshill.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka raportuar për më shumë se 30 raste të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, fotoreporterëve dhe kameramanëve dhe shtëpive mediale.<sup>32</sup> Që nga prilli i vitit 2022, AGK-ja, së bashku me Qendrën Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe të Medias (ECPMF), kanë mirëpritur 13 gazetarë nga Ukraina dhe së fundmi edhe katër gazetarë nga Afganistani, si pjesë e programit “Gazetarët në Rezidencë - Kosovë”, që financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe e cila ka për qëllim t’i ofrojë strehim gazetarëve të kërcënuar.

Avokati i Popullit konsideron se liria e shprehjes dhe liria e mediave përbëjnë gurëthemet e një shoqërie demokratike. Mediat duhen të jenë të lira të raportojnë për çdo temë që konsiderohen në interes të publikut. Sulmet, kërcënimet dhe presionet ndaj gazetarëve duhet të marrin një përgjigje të shpejtë për të garantuar siguri dhe mbrojtje për ta, që të jenë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre. Avokati i Popullit po ashtu rithekson se gazetarët dhe shtëpitë mediale në përgjithësi duhen të punojnë më shumë së bashku për t’i luftuar lajmet e rreme dhe parandalimin e dezinformatave, si dhe gjuhën që përhap urrejtje, në mënyrë që misioni i tyre të ruhet nga shpërdorimi dhe keqpërdorimi.

## Liria e Tubimit

Liria e tubimit shprehimisht garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Konventën e të Drejtave të Fëmijëve.

Më qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për organizimin e tubimeve publike dhe respektimin e fjalës së lirë, e drejta për tubimet publike rregullohet me Ligjin nr. 03/L-118 për Tubimet Publike, i cili përcakton të drejtën e fjalës së lirë në tubime publike, të protestave, të manifestimeve publike, kohën dhe mënyrën e lajmërimit, detyrat dhe përgjegjësitë e organizatorëve.

Gjatë vitit raportues, IAP-ja nuk ka marrë asnjë ankesë përkitazi me të drejtën e lirisë së tubimit, gjithashtu nuk ka gjetur shkas për hapjen e ndonjë rasti për hetime me vetiniciativë.

## Liria e Asociimit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 44, përcakton: “*Liria e asociimit është e garantuar.*” Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 11, Liria e tubimit dhe e organizimit, ka përcaktuar: “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për *mbrojtjen e interesave të tij.*”

Republika e Kosovës ka miratuar edhe një sërë dispozitash ligjore ku qytetarëve dhe kategorive

31 <https://bit.ly/3DbLLlA>

32 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, postimi në Facebook më 31 dhjetor 2022, linku: <https://bit.ly/3Db5iSW>

të caktuara të të punësuarve u njihet e drejta e asociimit në mekanizma të ndryshëm.<sup>33</sup>

Avokati i Popullit në vitin 2022 ka pranuar 5 ankesa me pohimet ankimore se janë cenuar të drejtat lidhur me Lirinë e Asociimit, nga autoritete publike. Ankesat kanë qenë të drejtuara ndaj institucioneve, si: Ministria e Punëve të Brendshme, Banka Qendrore e Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe Radiotelevizioni i Kosovës.

Duke hetuar ankesat e pranuar, Avokati i Popullit ka nxjerrë raport me rekomandime<sup>34</sup> lidhur me cenimin e të drejtave për Lirinë e Asociimit, lidhur me pohimet ankimore për diskriminim në bazë të lirisë së asociimit, të ankuesve, respektivisht të Shoqatës Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Avokati i Popullit pas hetimit ka konstatuar shkelje të së drejtës së lirisë së asociimit, gjithashtu ka konstatuar se ka munguar vullneti i shprehur nga Autoriteti i Aviacionit Civil për bashkëpunim me Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Avokati i Popullit i ka rekomanduar Autoritetit të Aviacionit Civil që të ndër marrë të gjitha masat në respektimin e së drejtës së asociimit dhe të organizmit sindikal.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka nxjerrë Raportin me rekomandime<sup>35</sup> lidhur me cenimin e të drejtave për Lirinë e Asociimit, të ankuesit: Institutit për Kontabilitet, Auditim dhe Financa, lidhur me pohimet ankimore për diskriminim në bazë të lirisë së asociimit, nga Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Avokati i Popullit pas hetimit ka konstatuar se dispozitat e nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33, pika 3, të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk janë në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe të sigurisë juridike, sepse janë në kundërshtim me parimet kushtetuese të sundimit të ligjit dhe të mosdiskriminimit, të përcaktuara me nenin 7 të Kushtetutës, me lirinë e asociimit, sipas nenit 44 të Kushtetutës, me të drejtën për ushtrimin e profesionit, sipas nenit 49 të Kushtetutës, si dhe me parimet e Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Financave, Punës dhe Tranfereve (MFPT) ta bëjë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, përkatësisht fshirjen e nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33, paragrafi 3.

Më 27 maj 2022, MFPT-ja ia ka dërguar Avokatit të Popullit përgjigjen lidhur me raportin në fjalë, përmes së cilës e ka njoftuar se në koordinim me Departamentin Ligjor të ministrisë, do të bëjë kërkesë për plotësimin e Programit Legjislativ për vitin 2022, në mënyrë që ta përfshijë edhe ndryshimplotësimin e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, për ndryshimin e nenit 3, paragrafi 1.13, dhe të nenit 33, paragrafi 3, dhe harmonizimit të këtyre kriterëve me parimet kushtetuese dhe me dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Në vitin raportues, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) kishte marrë vendim për fillimin e grevës me kërkesë adresuar Qeverisë

33 Ligji nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare përkatësisht neni 4 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5; Ligji nr.04/L-011 për Organizmin Sindikal në Kosovë neni 2 paragrafi 1.4; Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht neni 20; Ligji nr.03/L-212 i Punës përkatësisht Neni 88.

34 <https://oik-rks.org/2022/06/09/raport-i-avokatit-te-popullit-ankesa-nr-4742021-arianit-dobrosi-dhe-te-tjeret-perkitazi-me-pretendimet-e-ankuesve-per-diskriminim-ne-baze-te-lirise-se-asociimit-si-anetare-ne-shoqaten-sindikale/>

35 <https://oik-rks.org/2022/04/29/raport-i-avokatit-te-popullit-nr-4442021-ne-lidhje-me-ndryshimet-dhe-plotesimet-e-ligjit-nr-06-L-032-per-kontabilitet-raportim-financiar-dhe-auditim/>



së Kosovës për: rritjen e pagës për 100 euro më shumë; nxjerrjen e ligjit për pagat në sektorin publik; plotësimin e ligjeve për zyrtarët publikë, për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe për sigurimin shëndetësor.

Duke pasur parasysh situatën e krijuar me grevën, me ç' rast, përveç të tjerash, fëmijëve u cenohej e drejta për arsim, Avokati i Popullit, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, më 15 shtator 2022 ka mbajtur takime të ndara me përfaqësues të sindikatave dhe të Qeverisë, në përpjekje që nëpërmjet ndërmjetësimit të ndihmonte në zgjidhjen e situatës që ishte krijuar me grevën.

Më 18 shtator 2022, Avokati i Popullit iu ka dërguar palëve letër për diskutimet dhe çështjet e ngritura në mes palëve gjatë takimeve, përmes së cilës u ka kërkuar të jepnin përgjigje. Nëpërmjet së njëjtës, palëve u është rikujtuar se çdo qëndrim apo veprim, në qendër të çdo prioriteti duhet ta ketë interesin më të mirë të fëmijës dhe të drejtën e fëmijëve për edukim dhe arsimim, si e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Parimi i interesit më të mirë për fëmijët duhet ta udhëheqë secilin prej nesh në kuadër të përmbushjes së detyrimeve dhe të përgjegjësive që kemi. Gjithashtu ua ka rikujtuar përgjegjësinë kushtetuese e ligjore të qeverisë dhe detyrimin pozitiv që ka shteti për respektimin e së drejtës për arsimim dhe respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut, siç janë të përcaktuara në Kushtetutë.

Në anën tjetër, Avokati i Popullit ka theksuar rëndësinë që ka respektimi i së drejtës për organizim sindikal dhe i së drejtës për veprime sindikale. Mirëpo ka ngritur shqetësimin dhe palëve ua ka rikujtuar se situata e krijuar me grevën në arsim ishte në dëm të fëmijëve dhe për çdo orë të humbur të mësimi, pasojat do të jenë të parikuperueshme për ta.

Për më shumë, më 18 shtator 2022, Avokati i Popullit doli edhe me komunikatë për publikun, nëpërmjet së cilës u bëri thirrje publike palëve që të reflektonin, të gjenin një zgjidhje për të dalë nga situata që ishte krijuar, ashtu që fëmijëve t'u mundësohej gëzimi i së drejtës për arsimim. Me këtë, Avokati i Popullit ka konstatuar se në situatën e krijuar, e drejta për arsim, si e drejtë kushtetuese, nuk ishte duke u respektuar, se fëmijëve po u cenohej kjo e drejtë dhe ishin duke u privuar nga e drejta për edukim dhe arsimim, e kjo do të ketë pasoja të rënda për fëmijët dhe për vendin.

Në po të njëjtën ditë, më 18 shtator 2022, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) me qëndrimin se ishin të gatshëm të bisedonin për çështjet e prekura nga Avokati i Popullit, ndërsa ishin në pritje të përgjigjes nga sindikatat.

Më 3 tetor 2022, greva e arsimit është ndërprerë njëanshëm nga ana e Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK), pa asnjë marrëveshje mes palëve.

## Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], paragrafi 1, përcakton: "Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor."

Gjithashtu edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 3, të Protokollit 1, përcakton të drejtën për zgjedhje të lira, si në vijim: "*Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e*

*lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.”*

Gjatë vitit raportues, në Republikën e Kosovës nuk ka pasur zgjedhje, ndërsa ka pasur përpjekje për organizimin e zgjedhjeve në nivel lokal në komunat veriore të vendit, të cilat janë pezulluar.

Avokati i Popullit vëren se gjatë vitit raportues nuk ka pasur veprime për harmonizimin e ligjeve për zgjedhjet me Ligjin për Barazi Gjinore. Avokati i Popullit vazhdimisht e ka ngritur çështjen e mospërfaqësimit të barabartë në listat e kandidatëve, të cilët garojnë në zgjedhje, për shkak se këto lista janë në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe me Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, ligje këto që kërkojnë trajtim të barabartë në të gjitha sferat. Më 27 shtator 2019, Avokati i Popullit ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (GjThP), gjegjësisht Departamentit të Përgjithshëm, me kërkesë për masë të përkohshme përkitazi me shkeljen nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të së drejtës për trajtim të barabartë të grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes. Padi është ngritur për shkak se KQZ-ja i ka certifikuar listat me emrat e kandidatëve për deputetë të propozuara nga subjektet politike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, pa përfillur garancitë kushtetuese e ligjore për sa i përket barazisë gjinore, në mënyrë specifike trajtimin e barabartë të grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes.

Për sa u përket të drejtave zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, Avokati i Popullit viteve të fundit ka publikuar disa raporte me rekomandime dhe një *Opinion Amicus Curie* lidhur me emërimin e nënkryetarëve në komuna.

Avokati i Popullit, lidhur me ankesën A.nr.274/2022, përkitazi me Padinë A.nr.1046/22, të parashtruar më 29 prill 2022 nga Avokatura Shtetërore, në emër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit

Lokal, në çështjen e emërimit të nënkryetarit të komunës për komunitete në Fushë Kosovë, është paraqitur si mik i gjykatës ku ka shprehur qëndrimet e tij nga raportet e sipërpërmendura se as Udhëzimi Administrativ (i asokohshëm) nr. 2014/01 dhe as Udhëzimi Administrativ (që është në fuqi) nr. 02/2020 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna nuk e përçojnë frymën e Kushtetutës dhe të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Nuk është e qëndrueshme juridikisht që të vlejë qëndrimi se nënkryetari për komunitete duhet të jetë pjesëtar i komunitetit më të madh joshumicë në një komunë të caktuar. Në këtë drejtim, çfarëdo kufizimi në Udhëzimin Administrativ, sipas të cilit do t'i jepej përparësi ndonjërit nga komunitetet joshumicë për propozimin e nënkryetarit për komunitete i komunës, e cenon të drejtën e komuniteteve të tjera joshumicë, që nuk janë komuniteti më i madh joshumicë, që ta propozojnë nënkryetarin për komunitete të komunës.

**Institucioni i Avokatit të  
Popullit si mekanizëm  
i barazisë**

# Institucioni i Avokatit të Popullit si mekanizëm i barazisë

Avokati i Popullit është institucion i pavarur kushtetues që mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.

Ligji për Avokatin e Popullit e përcakton Avokatin e Popullit edhe si mekanizëm të barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi e përcakton Avokatin e Popullit si institucion i shtetit, i cili bën promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe i cili trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin. Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, për më tepër, e autorizon Avokatin e Popullit t'u ofrojë asistencë viktimave të diskriminimit në bërjen e ankesave kundër diskriminimit dhe u ofron informatat e domosdoshme personave që kanë paraqitur një ankesë për diskriminim në lidhje me të drejtat e tyre, për detyrimet dhe mundësitë e gjykatës, si dhe për mjetet e tjera mbrojtëse; u drejtohet organeve të prokurorisë dhe të hetimit direkt me një kërkesë për fillimin e hetimit të kundërvajtjeve dhe të veprave penale dhe kërkon fillimin e procedimit disiplinor të zbatueshëm; të përcjell zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe të iniciojë ndryshimin e dispozitave për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes

nga diskriminimi; ofron këshilla, udhëzime dhe mbështetje subjekteve të sektorit publik dhe privat mbi praktikën e mira në promovimin e barazisë, në përshtatjen ndaj diversitetit dhe parandalimin e diskriminimit mbi bazat e mbuluara nga Ligji përkatës për Barazi Gjinore dhe nga ky ligj, si dhe jep rekomandime për marrjen e masave për promovimin e barazisë, përshtatjen ndaj diversitetit dhe/ose luftimin e diskriminimit.

Ligji për Barazi Gjinore e përcakton Avokatin e Popullit si institucion i barazisë që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Duhet pasur parasysh se në vazhden e zhvillimit dhe të mbrojtjes efikase të të drejtave, e në veçanti mbrojtjes nga diskriminimi, obligimi i autoriteteve shtetërore nuk kufizohet vetëm në ato të drejta të cilat shprehimisht mbrohen me dispozitat kushtetuese dhe të ligjeve fushëveprimi i të cilave ka për objekt barazinë para ligjit, por edhe me dispozitat e cilitdo ligj në fuqi me të cilat garantohet ndonjë e drejtë apo përfitim për qytetarët e vendit, duke marrë për obligim mbrojtjen përgjithshme nga diskriminimi.

Lidhur me organet e barazisë, Komisioni Evropian miratoi dy propozime për Direktiva<sup>36</sup> të reja obliguese, që do të fuqizojë ndjeshëm organet e barazisë dhe punën e tyre.

Përderisa shumë nga këto kritere (direktiva) për funksionimin e organeve të barazisë janë të përfshira në legjislacionin vendor, akoma mbeten disa çështje sfiduese që Avokati i Popullit i ka identifikuar në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në Ligjin për Barazi Gjinore, që do të pasqyrohen më poshtë.

## Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Avokati i Popullit gjatë ushtrimit të mandatit tij lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi ka hasur në një numër sfidash. Nga pikëpamja e Avokatit të Popullit, sfidat në zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi janë si në vijim:

- Ofrimi i asistencës ligjore viktimave të diskriminimit në hartimin e ankesave, ngase kjo bie ndesh me parimet dhe dispozitat e Ligjit për Avokatin e Popullit, me të cilat kërkohet që Avokati i Popullit duhet të ruajë paanësinë dhe që Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në çështjet gjyqësore, përveç në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore;
- Mungesa e kompetencave të plota të Avokatit të Popullit në sektorin privat, përkatësisht mungesa e autorizimit të Avokatit të Popullit që në mënyrë të drejtpërdrejtë të hetojë ankesat ndaj subjekteve të sektorit privat;
- Mungesa e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, por edhe të Ligjit për Barazi Gjinore;
- Paqartësia rreth autoritetit i cili nxjerr sanksione administrative sipas dispozitave kundërvajtëse që i përmban ligji;
- Mosharmonizimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi me Ligjin për Procedurën Kontestimore/mungesa e njohjes se faktit se Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi është *lex specialis* për çështje që kanë të bëjnë me diskriminimin.

Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, Avokati i Popullit prej 21 – 23 janar 2022 ka mbajtur një punëtori me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione, me ç’ rast i ka njoftuar anëtarët e Komisionit, që morën pjesë në punëtori, me çështjen në fjalë.

Avokati i Popullit konsideron se, me gjithë sfidat, ka arritur që me mjaft sukses ta ushtrojë mandatin e tij si organ i barazisë. Megjithatë, Avokati i Popullit ka nevojë për përkrahjen e autoriteteve në fuqizimin e mëtejshëm dhe në ngritjen e kapaciteteve të Departamentit për Mbrojtje nga Diskriminimi si dhe ndryshimin e disa nga dispozitat e pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, në mënyrë që ushtrimi i mandatit të Avokatit të Popullit të fuqizohet në mënyrë që viktimave të diskriminimit t’u ofrohet mbrojtja maksimale.

## Gjetjet e Avokatit të Popullit lidhur me diskriminimin në Kosovë

Avokati i Popullit, gjatë vitit raportues i janë adresuar 75 ankesa me pretendime për diskriminim, ndërsa 6 raste janë hapur nga Avokati i Popullit me vetiniciativë.

Rastet e hapura nga ankesat e qytetarëve kryesisht kanë të bëjnë me pretendime për diskriminim lidhur me çështjet sociale, shëndetësore, çështjet nga marrëdhënia e punës, arsimit etj., e që pak a shumë janë të ngjashme me ankesat e tjera që i pranon Avokati i Popullit, por që ankesat e regjistruara (Departamenti për Mbrojtje nga Diskriminimi) përmbajnë pretendime se ka pasur diskriminim kryesisht mbi bazën e etnisë, moshës, gjinisë, mendimit politik apo mbi ndonjë bazë tjetër të mbrojtur me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Ndërsa rastet e hapura me vetiniciativë kanë të bëjnë me situata në lidhje me vlerësimin e aftësisë

së kufizuar nga Komisioni për vlerësimin dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, mungesa e punësimit në institucionet publike të personave me aftësi të kufizuara, qasja e Personave me Aftësi të Kufizuar në komunat e Kosovës dhe programi i bursave për nxënësit e shkollave të mesme nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka publikuar pesë raporte me rekomandime<sup>37</sup>, me të cilat kishte identifikuar dispozita të ligjeve dhe të akteve të tjera normative të cilat janë diskriminuese dhe po ashtu ka identifikuar praktika diskriminuese.

Përveç raporteve të publikuara, Avokati i Popullit ka publikuar Opinionin lidhur me njohjen e marrëdhënieve familjare të personave me seks të njëjta me Projektkodin Civil.<sup>38</sup>

Nëpërmjet këtij opinionit, Avokati i Popullit ka vënë në pah garantitë kushtetuese që i ofron Kushtetuta e Republikës së Kosovës për respektimin e jetës private dhe familjare, e po ashtu mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual për secilin qytetar të Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit ka shprehur qëndrimin e tij se marrëdhëniet familjare të personave me seks të njëjta, të njihen dhe të definojnë me Kodin Civil, ashtu sikur që e garanton Kushtetuta dhe në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pa asnjë dallim dhe në të njëjtën mënyrë sikur për personat me seks të kundërta.

Më tej Avokati i Popullit ka vlerësuar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke mos përcaktuar shprehimisht se e drejta e martesës është e drejtë e “burrit dhe gruas”, nuk paraqet asnjë pengesë

për të konstatuar se privimi i personave me seks të njëjta nga e drejta e martesës paraqet shkelje të së drejtës për të mos u diskriminuar në bazë të orientimit seksual. Për më tepër, formulimi i Projektkodit Civil për lejimin e bashkësive të regjistruara civile ndërmjet personave me seks të njëjta, pa e definuar qartë se çfarë paraqet një bashkësi e regjistruar civile dhe duke përcaktuar se kushtet dhe procedura për njohjen e këtyre bashkësive do të rregullohen me ligj të veçantë, nuk paraqet zgjidhje dhe nuk i reflekton të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Avokati i Popullit vazhdimisht, qoftë nëpërmjet raporteve vjetore dhe takimeve, ka njoftuar Kuvendin lidhur me procesin gjyqësor të iniciuar nga Avokati i Popullit kundër Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRR-E). Gjykata e Apelit, më 4 dhjetor 2022, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ZRR-E-së, ndërsa ka vërtetuar Aktgjykimin A.nr.1373/17 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 15 shtator 2021, me të cilin konstatohet se ka pasur trajtim të pabarabartë me rastin e faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore.

ZRR-E-ja më 13 dhjetor 2021 kishte hapur shqyrtimin e jashtëzakonshëm tarifor. ZRR-E-ja argumentonte se shtrenjtimi i çmimeve në tregjet ndërkombëtare kombinuar me rritjen e kërkesës së brendshme të energjisë e bënte të domosdoshme një rishikim të tarifave. Avokati i Popullit ka hapur hetime lidhur me Vendimin e ZRR-E-së për vendosjen e strukturës tarifore dhe rregullimin e çmimeve përmes bllok-tarifave. Lidhur me çështjen, Avokati i Popullit ka nxjerrë Opinionin ex officio nr. 39/2022, për vlerësimin e strukturës së re tarifore në Kosovë kundërt të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit ka vlerësuar se Vendimi i ZRR-E-së për shtrenjtim seleksionues (deri në 800 kw dhe mbi 800 kw) të

37 <https://oik-rks.org/raportet/raportet-mbi-rastet/>

38 <https://oik-rks.org/2022/05/27/opinion-i-avokatit-te-popullit-lidhur-me-njohjen-e-marredhenieve-familjare-te-personave-me-sekse-te-njejta-me-projektkodin-civil/>

çmimit të energjisë për vendosje të bllok-tarifave dhe vendimi për subvencionim gjithashtu seleksionues bien në kundërshtim me parimet e vendosjes së tarifave të përshkruara në legjislacionin vendor dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit. Masat afirmative të vendosura në vendimin e ZRrE-së nuk i gëzojnë njëjtë të gjithë konsumatorët me çmime të rregulluara dhe nga shtrenjtimi nuk preken njëjtë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

## Aktet normative në raport me parimin e mosdiskriminimit

Gjatë vitit raportues Avokati i Popullit ka publikuar katër raporte me rekomandime, ku ka identifikuar dispozita të akteve normative që bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit.

Avokati i Popullit, në Raportin 444/2021<sup>39</sup>, ka konstatuar se Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim përmban dispozita që janë në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit.

Avokati i Popullit në këtë raport ka vlerësuar se kushtet për licencimin dhe ushtrimin e profesionit të kontabilistëve dhe të auditorëve duhet të jenë objektive dhe të barabarta për të gjithë dhe nuk duhet të lidhen me natyrën e anëtarësimit të detyrueshëm në një organizatë ndërkombëtare. Licencimi dhe ushtrimi i profesionit të kontabilistëve dhe të auditorëve duhet të jenë të qasshme për të gjithë qytetarët e kualifikuar në kushte të barabarta. Prandaj, Avokati i Popullit kishte kërkuar ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Avokati i Popullit, në Raportin me rekomandime 176/2020<sup>40</sup>, ka gjetur se Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr. 10/2014 për punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpitë me bazë në komunitet përmban dispozita diskriminuese. Dispozita e nenit 5, pika 1.3; pika 1.4 dhe pika 1.8 paraqesin akt të diskriminimit të drejtpërdrejtë, ngase vendos kushte në bazë të statusit familjar të parashtruesve të kërkesës për vendosje në shtëpinë e personave të moshuar, mbi bazën e gjinisë dhe statusit martesor të pasardhësve të tyre apo lidhur me faktin nëse parashtruesit e kërkesës kanë bijë, bija të pamartuara apo të martuara. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit ka kërkuar ndryshimin e këtyre dispozitave.

Avokati i Popullit, në Raportin me rekomandime 125/2021, ka hasur në praktika që bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit në Universitetin e Prishtinës (UP), lidhur me ndryshimin e rregulloreve të UP-së, që janë në kundërshtim edhe me Statutin e UP-së. Avokati i Popullit ka vlerësuar se Rregullorja për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" (nr. prot.886, datë 27.4.2022); dhe Rregullorja për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" (nr. prot.887, datë 27.4.2022) përmbajnë kriteret diskriminuese. Sipas këtyre rregulloreve, kandidatët që kanë përfunduar studimet e doktoratës në UP dhe të cilët i plotësojnë kriteret e Statutit të UP-së, kanë përparësi ndaj kandidatëve që studimet e doktoratës i kanë përfunduar në institucione të tjera të Arsimit të Lartë të Kosovës dhe vendeve fqinje të Kosovës, pavarësisht pikëve të grumbulluara në kategoritë përkatëse. Kjo

39 <https://oik-rks.org/2022/04/29/raport-i-avokatit-te-popullit-nr-4442021-ne-lidhje-me-ndryshimet-dhe-plotesimet-e-ligjit-nr-06-032-per-kontabilitet-raportim-financiar-dhe-auditim/>

40 <https://oik-rks.org/2022/03/30/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-1762020-lidhur-me-ndryshimet-e-udhezimit-administrativ-mpms-nr-102014-per-punen-dhe-kriteret-e-vendosjes-se-rezidenteve-ne-shtepine-e-personave-te-moshuar-pa/>



përparësi nuk aplikohet në raport me kandidatët të cilët tashmë janë në marrëdhënie të rregullt të punës në UP; dhe kandidatët që kanë përfunduar studimet Master në UP (për fusha të caktuara me Statut - studimet e integruara 5, 6-vjeçare) dhe të cilët i plotësojnë kriteret e Statutit të UP-së, kanë përparësi ndaj kandidatëve që studimet i kanë përfunduar në institucione të tjera të Arsimit të Lartë të Kosovës dhe vendeve fqinje të Kosovës, pavarësisht pikëve të grumbulluara në kategoritë përkatëse.

Avokati i Popullit ka konstatuar se kriteret e tilla përbëjnë kufizime që nuk janë të autorizuara me ligjet përkatëse që rregullojnë fushën e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe këto përbëjnë diskriminim mbi bazën e vendit apo institucionit të arsimit të lartë publik dhe privat ku janë përfunduar studimet, në kuptim të Protokollit 12, neni 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## Praktikat e përgjithshme të cilat bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit

Përveç rasteve kur Avokati i Popullit identifikon dispozita të akteve normative që mund të bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit, ekzistojnë edhe praktika në kundërshtim me këtë parim, ku kryesisht viktimat të diskriminimit janë pjesëtarët e grupeve të cenueshme, si: të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, pjesëtarët e komuniteteve, në veçanti komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Praktika diskriminuese hasen në masë të madhe edhe në sektorin privat të punësimit, në veçanti kur bëhet fjalë për gratë dhe vajzat.

Për Avokatin e Popullit mbetet shqetësues fakti se raportimi i rasteve të diskriminimit mbetet akoma i vogël. Shumica e ankesave për diskriminim që paraqiten te Avokati i Popullit nuk rezultojnë me diskriminim, ndërsa rastet e vërteta të diskriminimit vazhdojnë të mos paraqiten apo denoncohen - sa

nga mosnjohja e konceptit të diskriminimit, sa nga frika e viktimizimit, por edhe nga mungesa e besimit të qytetarëve te gjykatat.

Për sa u përket rasteve të diskriminimit që trajtohen nga gjykatat, vërehet se përveç numrit të vogël të rasteve, procedura që zhvillohet dhe vendimet që i nxjerrin gjykatat përmbajnë mangësi të dukshme. Aktgjykimi C.nr.3663/18 i Gjykatës Themelore të Prishtinës, i datës 18.10.2022, me paditës z. Faruk Kukaj, dhe të të paditurën Komunën e Prishtinës, rast ky në të cilin Avokati i Popullit është paraqitur si mik i gjykatës, edhe pse pjesërisht e ka miratuar padinë e z. Kukajt, është i rëndësishëm për faktin se vërtetohet diskriminim. Megjithatë procedura e zhvilluar në këtë rast nuk ishte në pajtim me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, në kuptimin e barrës së provës, ku gjykata ka kërkuar nga paditësi, njëherësh viktimë e diskriminimit, të ofronte prova me të cilat mbështeste pretendimet për diskriminim, ndërsa ligji përcakton se barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë. Po ashtu aktgjykimi është i mangët për shkak se gjykata ka refuzuar si të pabazuar, në mes të tjerash, kërkesëpadinë e paditësit që t'i ndalohej së paditurës kryerja e veprimeve diskriminuese. Refuzimi i kërkesës për ndalimin e veprimeve diskriminuese është praktikë e papranueshme dhe nuk arrin të mbrojë viktimën nga diskriminimi.

Diskriminimi shfaqet në forma të ndryshme dhe përveç në rastet kur diskriminimi është i drejtpërdrejtë, formë kjo më lehtë e identifikueshme, format e tjera të diskriminimit kërkojnë analizë, hulumtim dhe trajtim të situatave prej rastit në rast. Fakti se kemi një numër të vogël të rasteve që paraqiten në gjykatë dhe numër të vogël të vendimeve gjyqësore që trajtojnë rastet e diskriminimit, mungesa e vendimeve gjyqësore ku vërtetohet diskriminimi dhe kompensohen viktimat e shkeljes, ndikon negativisht në parandalimin e diskriminimit.



Në anën tjetër, është me rëndësi të theksohet se sipas Protokollit 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit vlen për situatat që bien në fushën e veprimit të një të drejte substanciale të garantuar nga ligji brendshëm. Në këtë drejtim, mungesa e zbatimit të ligjit të brendshëm që në vete përmban të drejta substanciale po ashtu ndikon negativisht në parandalimin e diskriminimit.

# Të Drejtat e Fëmijës

Fëmijët përveç që janë bartës të të drejtave, janë edhe pjesëmarrës aktivë në realizimin e të drejtave të tyre. Ata gëzojnë të drejta të përgjithshme si të rriturit, por edhe të drejta specifike që u përshtaten nevojave të tyre të veçanta si fëmijë. Meqenëse fëmijët fillojnë jetën të varur nga të rriturit, respektimi dhe realizimi i të drejtave është thelbësor që ata të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë, t'u njihet dinjiteti njerëzor dhe urgjenca që shteti të sigurojë mirëqenien e tyre. Rrjedhimisht, zhvillimi i shëndetshëm i fëmijëve është thelbësor për mirëqenien e ardhshme të çdo vendi, sepse kontributi i tyre në shoqëri varet nga po ky zhvillim.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron shprehimisht të drejtat e fëmijëve dhe imponon detyrime ligjore për t'i respektuar, mbrojtur dhe përmbushur ato, përmes nenit 50 - *Të Drejtat e Fëmijës* - dhe zbatimit të drejtpërdrejtë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Për më tepër, në vitin 2019 Kosova shënoi një hap të rëndësishëm drejt realizimit të këtyre të drejtave përmes plotësimit të kornizës ligjore me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF), si ligji i parë i cili adreson në tërësi dhe mënyrë specifike nevojat e fëmijëve. Mirëpo, ligji mbetet vetëm një hap simbolik nëse nuk përcillet me hapa konkretë dhe zbatim të suksesshëm. LMF-ja obligon Qeverinë, Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Këshillin Gjyqësor që, një vit nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrin 18 akte nënligjore sipas fushave të tyre përgjegjëse. Deri më sot, gati tri vjet pas, janë miratuar vetëm gjashtë akte nënligjore: 1. Udhëzim

administrativ (QRK) nr. 08/2022 për këshillin për të drejtat e fëmijës; 2. Udhëzim administrativ (QRK) nr. 07/2022 për autoritetet për të drejtat e fëmijës; 3. Udhëzim administrativ (QRK) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës; 4. Udhëzim Administrativ (QRK) nr. 04/2022 për masat për mbrojtjen e fëmijës kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe të atyre që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës; 5. Udhëzim administrativ (QRK) nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative; dhe 6. Rregullore (IAP) nr. 01/2019 për procedurat e veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave të paraqitura nga fëmijët apo ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve.<sup>41</sup>

Siç është theksuar edhe në Raportin me rekomandim *ex-officio* nr. 381/2020<sup>42</sup>, raport ky që ka pasur për qëllim identifikimin e akteve nënligjore të përcaktuara me LMF, është konstatuar se këto akte nënligjore janë të një rëndësie të veçantë, sepse mundësojnë zbatimin praktik të ligjit.

## Ankesat e parashtruara lidhur me të drejtat e fëmijëve

Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 ka pranuar 77 ankesa nga qytetarët, kryesisht të parashtruara nga prindër të fëmijëve. Ndërsa sipas detyrës zyrtare ka hapur 9 raste për hetim, ku në pesë nga

41 Për më shumë detaje shih Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844> [e qasur së fundmi me datën 17.01.2023].

42 <https://oik-rks.org/2021/08/18/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-3812020/>

ato janë gjetur dhe adresuar shkelje sistematike të të drejtave të fëmijëve. Nga ky numër, 23 ankesa janë shpallur të papranueshme, ngase çështjet me të cilat kanë pasur të bëjnë kanë qenë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, nuk kanë pasur shkelje të të drejtave të njeriut, apo ankuesit kanë pasur mundësi t'i shfrytëzojnë ose kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike. Nga ankesat e pranuar prej qytetarëve, 54 ankesa janë hapur për hetim dhe shtjellohen më detajisht përgjatë raportit.

Gjatë këtij viti, IAP-ja u ka adresuar 41 rekomandime autoriteteve përkatëse publike dhe u ka dërguar 18 letra rikujtuese këtyre autoriteteve lidhur me moszbatimin e rekomandimeve.

Ankesat e paraqitura nga individët	<b>77</b>
Rastet e hapura për hetim sipas ankesave të paraqitura nga individët	54
Ankesat e papranuara	23
Rastet e hapura për hetim sipas detyrës zyrtare	<b>9</b>
Gjithsej	<b>86</b>

## E drejta e fëmijëve për arsim

Rastet lidhur me të drejtën për arsim, të cilat janë hetuar nga Avokati i Popullit, duke përfshirë edhe ato të iniciuara sipas detyrës zyrtare, kanë trajtuar: dhunën në shkollë, vijushmërinë në shkollë si dhe kushtet e mësimit për nxënësit egjiptianë, romë dhe ashkali, grevat në arsim, diskriminimin e fëmijës me aftësi të kufizuar, mungesën e transportit për fëmijë me aftësi të kufizuar, dhe ndërprerjen e mësimit.

Lidhur me të drejtën e fëmijëve në arsim, IAP-ja ka publikuar dy raporte me rekomandime: Raport *ex-officio* nr.331/2022<sup>43</sup> lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar të Kosovës me të drejtat e fëmijëve në arsim dhe Raportin me rekomandime *ex officio* nr.411/2021<sup>44</sup> në lidhje me themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara (*shih pjesën për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara*). Në raportin e parë, IAP-ja vlerësoi nivelin e zbatimit të dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve në sektorin e arsimit nga autoritetet dhe institucionet e arsimit në Kosovë. Ky raport ka gjetur se në dekadën e fundit Kosova ka shënuar progres në arsim, mirëpo ky progres ka qenë jo i barabartë në nënsektorë të ndryshëm për sa i përket pjesëmarrjes, përfshirjes dhe zhvillimit të fëmijëve sipas nevojave dhe aftësive të tyre (*shih pjesën e përgjithshme për të drejtën në arsim*).

IAP-ja gjatë vitit 2022 po ashtu zhvilloi takimet me fëmijët në shkollë dhe përgjatë bashkëbisedimeve me ta u vërejtën shqetësime të ndryshme.

43 <https://oik-rks.org/2022/11/10/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-3312022-lidhur-me-perafrimin-e-dispozitave-te-sistemit-te-arsimit-te-pergjithshem-parauniversitar-te-kosoves-me-te-drejtat-e-femijeve-ne-arsim/>

44 <https://oik-rks.org/2022/04/27/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-4112021-ne-lidhje-me-themelimin-e-ekipit-profesional-vleresues-dhe-perkrahes-per-nevojat-e-posacme-arsimore-per-femijet-me-aftesi-te-kufizuara/>

## Të drejtat e fëmijëve në procedurat pranë gjykatave

Gjatë këtij viti, IAP-ja ka pranuar 14 ankesa kundër gjykatave të cilat kryesisht kishin të bënin me besimin e kujdestarisë së fëmijëve dhe caktimin e alimentacionit, zvarritjen e procedurave gjyqësore për kompensim material për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, pëlqimin për dhënien e pasaportës për fëmijë, caktimin e paraburgimit, lirim nga paraburgimi, mos(realizimin) e kontaktit me fëmijët, të drejtën për gjykim të drejtë dhe mosekzekutim të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, me kërkesë të palëve, IAP-ja ka monitoruar seancat gjyqësore lidhur me besimin e fëmijëve, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe lidhur me shmangien nga sigurimi i mjeteve të jetesës. Lidhur me rastet në fjalë, IAP-ja u është drejtuar gjykatave përkatëse me shkresa për t'u informuar për veprimet e ndërmarra në drejtim të respektimit të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe të së drejtës për mjete juridike.

Në dy nga këto raste IAP-ja u ka dërguar gjykatave themelore letra specifike me rekomandime për të trajtuar rastet me prioritet për shkak të natyrës së tyre dhendikimit që kanë tek fëmijët. Në rastin e parë, prindi ushtroi ankesë në IAP lidhur me zvarritjen e lëndës në Gjykatën Themelore për kompensim dëmi për njohjen e së drejtës së fëmijës së tij me aftësi të kufizuara për përfshirje në çerdhe. Një situatë e tillë e kishte vështirësuar gjendjen materiale dhe emocionale të tij dhe të fëmijës duke ua cenuar edhe mirëqenien. Në rastin e dytë, ngjashëm prindi kishte ushtuar ankesë në krah të fëmijës së tij për zvarritjen e lëndës në gjykatë për kompensim dëmi për lëndimet të cilat i kishte pësuar fëmija. Në anën tjetër, gjykata kishte informuar përfaqësuesin e IAP-së se lëndët nuk ishin në agjendën e gjykatës, sepse gjykata ishte ende duke shqyrtuar lëndët e pranuar gjashtë vjetëve më parë si dhe vetëm lëndët me prioritet ligjor shqyrtohen jashtë planit të agjendës. Duke marrë parasysh rrethanat e

rastit, IAP-ja ia rikujtoi gjykatës se është obligim kushtetues i shtetit që qytetarëve t'u garantojë që çështjet e tyre të dëgjoen në mënyrë të drejtë nga gjykata dhe brenda një afati të arsyeshëm, si dhe t'u garantojë mjete juridike efektive. Për më tepër, këto të drejta janë të garantuara me nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta gjithashtu obligon që të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve. Ky parim i mishëruar edhe në KDF dhe LMF, sipas Komitetit për të Drejtat e Fëmijës është koncept i trefishtë që përfshin: një të drejtë substanciale, parim ligjor interpretues dhe rregull të procedurës. Si rregull i procedurës, sa herë që të merret një vendim që do të ndikojë në një fëmijë të caktuar, një grup të identifikuar fëmijësh ose fëmijëve në përgjithësi, procesi i vendimmarrjes duhet të përfshijë një vlerësim të ndikimit të mundshëm (pozitiv ose negativ) të vendimit mbi fëmijën ose fëmijët në fjalë. Për më tepër, neni 46 i LMF-së shprehimisht parasheh mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në këto raste, vendimi i gjykatës është tejet i rëndësishëm për të siguruar që fëmijët e ankuesve do të kenë mundësi që me anë të këtij kompensimi të kenë qasje në shërbime arsimore dhe shëndetësore kualitative. Zvarritja e mëtutjeshme e lëndëve do të kishte pasoja negative në mirëqenien e fëmijëve dhe si e tillë nuk është në interesin më të mirë të tyre.

Pas rekomandimit të IAP-së, gjykata i është drejtuar Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) me kërkesë për të dhënë Opinion këshillëdhënës duke kërkuar udhëzime se si duhet të veprohet kur ka rekomandime të IAP-së që një lëndë të procedohet shpejt dhe pa vonesa, ndërsa çështja juridike nuk përcaktohet si lëndë me prioritet në bazë të strategjisë së KGJK-së. Ky Komitet ka vendosur një standard të rëndësishëm përmes lëshimit të Opinionit Nr. 04/2022, ku i referohet

rekomandimeve dhe argumenteve ligjore të prezantuara nga IAP-ja. Ky Opinion këshillon gjyqtarët e tri niveleve të gjykatave të Republikës së Kosovës që në rastet e tilla ku në lëndët në pritje janë të përfshirë palë me status ligjor të fëmijës (përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara), duhet pa hezitim të merren me prioritet në trajtim edhe nëse në pritje ka lëndë më të vjetra, pasi vetë ligji në këto raste ka përcaktuar prioritet të trajtimit të tyre.<sup>45</sup> Ky opinion është rezultat i drejtpërdrejtë i punës dhe i avokimit të IAP-së dhe ka implikime të gjera për të gjitha vendimet e reja që prekin fëmijët në gjithë territorin e Kosovës, duke krijuar një precedent të rëndësishëm për gëzimin e së drejtës për mbrojtje gjyqësore dhe qasjes efektive në mjete juridike për rastet që kanë të bëjnë me fëmijët.

## Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla

Dhuna vazhdon të mbetet e pranishme në jetën e fëmijëve siç është pohuar në vazhdimësi gjatë diskutimeve me nxënës, ku si shqetësime janë ngritur përdorimi i ndëshkimit trupor fizik si mjet disiplinimi nga mësuesit dhe ngacmimi në mes të bashkëmoshatarëve (bullizmi). Përdorimi i dhunës cenon realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe ka pasoja afatgjata të dëmshme në shëndetin dhe vetëvlerësimin e tyre. Fëmijët janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj dhunës për shkak të moshës së tyre dhe se shpesh dhuna ndaj tyre kryhet në duart e të rriturve, përfshirë personat të cilëve fëmijët duhet t'u besojnë dhe varen nga ta. Fëmijët e vegjël kanë mungesë sidomos të njohurive për të drejtat e tyre dhe nuk mund të flasin për të mbrojtur veten. LMF-ja jep një përkufizim të detajuar dhe gjithëpërfshirës të dhunës dhe përcakton obligimet institucionale për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijëve.<sup>46</sup>

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime për 5 raste, prej të cilave 3 raste janë iniciuar sipas ankesave dhe 2 sipas detyrës zyrtare. Rastet kishin të bënin me trajtimin nga policia të rastit të bullizimit të një nxënësi nga një grup moshatarësh, mostrajtimin e rastit të bullizimit të një nxënësi nga drejtorja e shkollës dhe prokuroria, dhunë në shkollë nga mësuesi dhe dhunë seksuale.

Rasti i parë i hetuar sipas detyrës zyrtare kishte të bënte me pohimet e "Gazetës Express", në shkrimin me titull: "Mësuesi në Dragash i rrah me rrip nxënësit". Në këtë shkrim, nxënësit ishin ankuar se mësuesi vazhdimisht ushtron dhunë fizike ndaj tyre duke i rrahur me rrip. Më pas, njëri nga prindërit kishte raportuar në polici dhunën dhe doli që akuza të njëjta kishte pasur edhe më herët nga nxënës të tjerë. Mësuesi është pezulluar nga puna si dhe rasti është duke u hetuar nga Prokuroria. Ndërsa rasti i dytë është nisur në bazë të shkrimit në portalin "Telegrafi", me titull: "Rasti i dhunimit të 11 vjeçare në Prishtinë, Prokuroria thotë se e njëjta në qershor të këtij viti ishte raportuar si e zhdukur", ku veprimet e ndërmarra nga institucionet shtetërore janë duke u hetuar nga IAP-ja nëse përmbushnin detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna seksuale dhe trafikimi. Pas hetimeve, Avokati i Popullit ka hartuar Draft-raportin me rekomandime Ex-officio nr.468/2022, ku konstaton se në rastin konkret ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të fëmijëve, përkatësisht shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e fëmijës nga keqtrajtimi dhe trajtimi jonjerëzor sipas nenit 3 - Ndalimi i torturës - të KEDNj-së, neneve 19 dhe 34 të KDF-së, nenit 56 të Konventës së Stambollit dhe neneve 5, 11.2, 15 (1.2) dhe 24 të LMF-së, meqë autoritetet ishin në dijeni për rrezikun që i kanosej fëmijës dhe dështuan të ndërmerren të

45 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, Opinioni KKEGj Nr. 04/2022, në: <https://www.gjyqesori-rks.org/komiteti-keshilledhenes-per-etike-gjyqesore/?r=M&tabl=1> [i qasur së fundmi më datën 16.1.2023].

46 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, 2019.

gjitha masat e arsyeshme për ta mbrojtur atë. Duke u thirrur në KDF, në Konventën e Stambollit dhe në statistikën në dispozicion, Avokati i Popullit ka shqyrtuar dimensionin gjinor të dhunës ku dhuna seksuale dhe trafikimi me qenie njerëzore paraqiten si forma të dhunës në bazë gjinore dhe rrjedhimisht paraqesin rrezik më të madh për vajzat dhe gratë. Më tutje, detyrimet e shtetit për mbrojtjen e fëmijës shihen si të dyfishta duke qenë se bëhet fjalë për një grup të cenueshëm ndaj dhunës, pra fëmijën vajzë. Po ashtu, Avokati i Popullit ka konstatuar se autoritetet nuk kanë vepruar në interesin më të mirë të fëmijës. Në rastin konkret autoritetet përgjegjëse kanë dështuar në zbatimin e nenit 5 të LMF-së, përkatësisht në sigurimin e interesit më të mirë të fëmijës, i cili obligon për kujdes të shtuar ndaj historisë së fëmijës, duke pasur parasysh situatat e veçanta të abuzimit si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen. IAP-ja do të vazhdojë të monitorojë rrjedhën e këtyre proceseve gjatë vitit të ardhshëm për të siguruar se mirëqenia e fëmijës dhe interesi i tij/saj kanë konsideratë primare.

## Fëmijët me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë ende duke përjetuar vështirësi serioze dhe përballen me pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të përcaktuara me ligj. Vajzat dhe djemtë me aftësi të kufizuara i përkasin njërës prej grupeve më të rrezikuara të fëmijëve duke qenë se janë më të ndjeshëm ndaj përjashtimit shoqëror, diskriminimit dhe mungesës së informacionit dhe/ose burimeve financiare, transportit dhe qasjes fizike në objektet arsimore dhe në ato të kujdesit shëndetësor.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, lidhur me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime për gjashtë raste, ku

pesë janë iniciuar pas ankesave të prindërve dhe një sipas detyrës zyrtare. Këto ankesa kishin të bënin me realizimin e së drejtës për arsim, më konkretisht me mungesën e mësuesve mbështetës, mungesën e transportit shkollë-shtëpi, mosangazhimin e asistentit personal dhe diskriminim për qasje në arsim.

Në rastin e parë, ankesa është parashtruar nga një grup prindëresh dhe ka të bëjë me sigurimin e transportit për shkollimin e obligueshëm për të cilin Ligji për Arsimin Parauniversitar (LAP) parasheh në mënyrë të qartë obligimin e komunës si dhe mungesën e mësuesve mbështetës.<sup>47</sup> Ndërsa tri rastet e tjera ishin ankesa individuale dhe kërkohej siguri i transportit deri tek institucioni parafillor për të cilin LAP-i nuk parasheh qartazi detyrim, mirëpo parasheh mundësinë që të përfshihet si shkollim obligativ me krijimin e kushteve financiare.<sup>48</sup>

Megjithatë, duke marrë parasysh rritjen e rëndësisë së edukimit parafillor në vitet e fundit, rëndësinë e gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit, parimin e interesit më të mirë të fëmijës si dhe dispozitat e LMF-së, IAP-ja konsideron se komunat duhet të planifikojnë dhe ndajnë buxhet edhe për sigurimin e këtij transporti.

Rasti i pestë ka të bëjë me mosangazhimin e asistentit personal nga komuna, ku prindërit detyrohen që vetë të mbulojnë shpenzimet financiare, përndryshe fëmija e ka të pamundur që të vijojë mësimin dhe integrohet në klasë njëjtë si bashkëmohatarët e tij. Ndërsa rasti i fundit është iniciuar sipas detyrës zyrtare bazuar në informatat e postuara nga televizioni “Klan Kosova”, me titull “Gjimnazi Hivzi Sylejmani Në Fushë Kosovë nuk e pranon nxënësin, veç pse është në karrocë”. Për fund, nxënësi është akomoduar dhe vijon mësimin me rregull në gjimnaz.

47 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, 2011, neni 15.

48 Po aty, neni 49.

Këto probleme janë dokumentuar edhe në Raportin lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar me të drejtat e fëmijëve në arsim. Fillimisht, raporti vëren se pjesëmarrja në sistemin arsimor e fëmijëve me aftësi të kufizuara është e ulët dhe se arsyet kryesore janë niveli i vetëdijesimit/qëndrimit shoqëror ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe kapaciteti i kufizuar i sistemit për të ofruar shërbime arsimore dhe rehabilituese për ta.<sup>49</sup> Më tutje, pengesë për përfshirje janë: mungesa e fondeve, e ekspertizës dhe e shërbimeve të specializuara mbështetëse, në veçanti mungesa e asistentëve personalë, e pajisjeve lehtësuese, e transportit për në shkollë dhe e fizioterapisë. Sfidë konsiderohet edhe mungesa e të dhënave të sakta për fëmijët brenda sistemit arsimor, duke e vështirësuar planifikimin e shërbimeve nga drejtoritë komunale dhe nga vetë shkollat. Nga ana tjetër, shkollat po ashtu kanë kapacitete shumë të kufizuara për ta promovuar përfshirjen duke qenë se mësimdhënësit në shkollat e rregullta kanë kualifikim mësimor, por jo domosdo edhe trajnim adekuat për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe kjo e vështirëson punën në arritjen e rezultateve të duhura. Avokati i Popullit u ka rekomanduar komunave dhe shkollave që të hartojnë dhe zbatojnë fushata ndërgjegjësuëse me qëllim të gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë për komunitetet dhe prindërit si dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për hartimin e planeve individuale të arsimit në pajtim me Udhëzimin administrativ nr. 18/2013 për përdorimin e planit individual arsimor.

Në muajin prill, IAP-ja publikoi Raport me rekomandime ex officio nr.411/2021 në lidhje me themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara.<sup>50</sup> Avokati i Popullit

kishte filluar hetimet qysh në vitin e kaluar pas pranimit të pesë ankesave dhe një të hapur sipas detyrës zyrtare, ku ishte informuar se disa komuna nuk i kishin themeluar ende ekipet profesionale vlerësuese dhe përkrahëse për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, ndonëse LAP-i i obligonte ato. Sipas nenit 41 të LAP-it, ky ekip duhet të përbëhet nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe të rehabilitimit, si mbështetje e jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese, për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. LAP-i obligon institucionet e përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për ta avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social. Moszbatimi i duhur i këtyre dispozitave ndikon që fëmijët me aftësi të kufizuara të përjetojnë vështirësi serioze dhe pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të përcaktuara me ligj, përfshirë këtu edhe të drejtën për arsimim gjithëpërfshirës. IAP-ja ka konstatuar se komunat: Mamushë, Lipjan, Istog, Deçan, Skenderaj, Kamenicë, Shtime, Rahovec, Zveçan, Zubin Potok, Shtërpçë, Leposaviq, Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Klllokot, Graçanicë nuk i kanë themeluar ekipet profesionale vlerësuese në pajtim me LAP-in dhe me Udhëzimin Administrativ nr. 16/2017 mbi vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Andaj, Avokati i Popullit ka konstatuar se në rastin konkret, mosthemelimi i ekipeve vlerësuese përbën shkelje të të drejtave të fëmijëve, pasi këto 17 komuna nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore e as standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

49 <https://oik-rks.org/2022/11/10/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-3312022-lidhur-me-perafrimin-e-dispozitave-te-sistemit-te-arsimit-te-pergjithshem-parauniversitar-te-kosoves-me-te-drejtat-e-femijeve-ne-arsim/>

50 <https://oik-rks.org/2022/04/27/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-4112021-ne-lidhje-me-themelimin-e-ekipit-profesional-vleresues-dhe-perkrahes-per-nevojat-e-posacme-arsimore-per-femijet-me-aftesi-te-kufizuara/>



## Mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve

Kuvendi ende nuk e ka miratuar Ligjin për Shërbime Sociale dhe as Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, pavarësisht rekomandimeve të Avokatit të Popullit në tri vitet e fundit në raportet vjetore, si dhe në Raportin lidhur me vlerësimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale në Kosovë.<sup>51</sup> Miratimi i këtyre ligjeve është shumë me rëndësi për mirëqenien e fëmijëve, veçanërisht i Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, përmes të cilit do të rregullohej në tërësi mandati, roli, kompetencat, përgjegjësitë dhe struktura e qendrave për punë sociale, siç është theksuar edhe në deklaratën e përbashkët me shoqërinë civile drejtuar autoriteteve qeveritare.<sup>52</sup>

Për sa i përket mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, këtë vit janë paraqitur 11 ankesa, kryesisht për shkak të mospagimit të shtesës për fëmijë, shëndetin e fëmijës në institucion psikiatrik, shëndetin e fëmijës në Qendrën Edukative-Korrektuese, sigurimin e banimit nga komuna dhe punën e Qendrës për Punë Sociale

51 <https://oik-rks.org/2019/12/23/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-592019-lidhur-me-vleresimin-e-sistemit-te-ofrimit-te-sherbimeve-sociale-ne-kosove/>

52 IAP, IAP, KOMF dhe LQPSK kërkuar nga qeveria që t'i miratojë dy projektligje për shërbime sociale më të mira për fëmijët dhe familjet, 09.08.2022, në: <https://oik-rks.org/2022/08/09/iap-komf-dhe-lqps-kerkuan-nga-qeveria-qe-ti-miratojne-dy-projektligjet-per-sherbime-sociale-me-te-mira-per-femijet-dhe-familjet/>.



# E Drejta për Arsimin

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton dhe rregullon të drejtën për arsimim me nenin 47, si e drejtë e cila ngërthen tri obligime kryesore: (i) ofrimin e arsimit themelor të detyrueshëm dhe papagesë; (ii) krijimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, i cili ofron mundësi të barabarta; dhe (iii) krijimin e një sistemi arsimor i cili përmbush nevojat dhe aftësitë themelore e specifike të çdo fëmije.<sup>53</sup> Kjo e drejtë përcaktohet edhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNJ) dhe me Konventën për Mbrojtjen e Fëmijës (KDF).<sup>54</sup> Për më tepër, Kushtetuta garanton edhe lirinë e krijimtarisë artistike dhe shkencore si dhe lirinë akademike.<sup>55</sup>

Gjatë vitit 2022, korniza e politikave në fushën e arsimit është plotësuar me miratimin e Strategjisë për Arsim 2022-2026<sup>56</sup> dhe me Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2022-2026.<sup>57</sup> Strategjia si dokumenti kryesor për zhvillimin e sektorit të arsimit ka paraparë pesë objektiva strategjike për adresimin e problemeve kyçe në këtë fushë: edukimin në fëmijërinë e hershme;

arsimin parauniversitar; arsimin, aftësimin profesional dhe arsimin për të rritur; arsimin e lartë dhe digjitalizimin e arsimit. Ndërsa PKZMSA-ja ka paraparë si një ndër prioritetet kyçe edhe arritjen e standardeve adekuate të cilësisë së institucioneve dhe programeve në përputhje me objektivat e procesit të Bolonjës dhe Deklaratën e saj. Me anë të këtij prioriteti synohet që përmes zbatimit të procesit të akreditimit, ndër të tjera, të mundësohet rikthimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim në Asociacionin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Ndërsa, për sa i përket plotësimit të kornizës ligjore, Avokati i Popullit mbështet rekomandimin e Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën për 2022 për miratimin e Ligjit të ri për Arsimin e Lartë me qëllim të përforcimit të autonomisë dhe integritetit akademik të institucioneve të arsimit të lartë dhe përmirësimit të cilësisë.<sup>58</sup> Më tutje, edhe këtë vit, lidhur me integrimin e sistemit arsimor në tërë Kosovën, problematike mbetet çështja e sistemit paralel të shkollave fillore, të mesme dhe Universitetit të Mitrovicës së Veriut, që vazhdojnë

53 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 47.

54 Protokoll nr. 1 i KEDNJ, neni 2 dhe Konventa për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 28.

55 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 48.

56 MASHTI, Strategjia e Arsimit 2022-2026, 2022, në: <https://masht.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit2022-2026/> [e qasur së fundmi me datën 25.01.2023].

57 Qeveria e Republikës së Kosovës, Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2022-2026, 2022, në: [http://mei-ks.net/repository/docs/1%20PKZMSA%202022-2026\\_shq.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/1%20PKZMSA%202022-2026_shq.pdf) [e qasur së fundmi me datën 25.01.2023].

58 Çështja e Universitetit të Mitrovicës së Veriut është ngritur edhe nga Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën për 2022, 2022, në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf> [e qasur së fundmi me datën 25.01.2023].

të zhvillojë veprimtarinë në kuadër të sistemit arsimor të Serbisë.<sup>59</sup>

Lidhur me të drejtën në arsim, IAP-ja ka publikuar dy raporte me rekomandime: Raport *ex-officio* nr.331/2022<sup>60</sup> lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar të Kosovës me të drejtat e fëmijëve në arsim dhe Raportin me rekomandime *ex officio* nr.411/2021<sup>61</sup>, i adresuar në këtë vit, në lidhje me themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara (shih pjesën për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara). Në raportin e parë, IAP-ja vlerësoi nivelin e zbatimit të dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve në sektorin e arsimit nga autoritetet dhe institucionet e arsimit në Kosovë. Ky raport ka gjetur se në dekadën e fundit Kosova ka shënuar progres në arsim, mirëpo ky progres ka qenë jo i barabartë në nënsektorë të ndryshëm për sa i përket pjesëmarrjes, përfshirjes dhe zhvillimit të fëmijëve sipas nevojave dhe aftësive të tyre. Rezultatet në testin PISA (Programi për vlerësimin ndërkombëtar të studentëve) kanë treguar se cilësia e arsimit nuk është në nivelin e duhur për të përgatitur nxënësit për jetën. Për më tepër, pandemia COVID-19 i ka dhënë një goditje të rëndë procesit të përmirësimeve të vazhdueshme në zbatimin e të drejtave të njeriut në sistemin arsimor. Të gjitha trendet dhe proceset pozitive ose kanë ngecur, në rastin më të keq si ai për fëmijët me aftësi të kufizuara, ose janë kthyer mbrapa gjatë pandemisë. Ky raport gjeti se për sa i përket pjesëmarrjes, Kosova në përgjithësi ka arritur pjesëmarrje pothuajse universale në arsimin e përgjithshëm parauniversitar, me përjashtim të

arsimit parashkollor, ku pjesëmarrja është e vogël, përkundër disa përmirësimeve. Mirëpo, situata nuk është e mirë kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në arsim të fëmijëve egjiptianë, romë dhe ashkalinj si dhe për pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Në përgjithësi raporti vlerësoi se sistemi arsimor në Kosovë nuk u mundëson nxënësve zhvillimin e potencialit sipas nevojave dhe aftësive të tyre, në pajtim me dispozitat kushtetuese.

Përveç të tjerash, Avokati i Popullit, përmes Raportit nr.331/2022, i rekomandoi Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) që të hartojë dhe zbatojë politika për të përmirësuar cilësinë e arsimit, veçanërisht në fushën e matematikës, shkencës, dhe leximit; të hartojë dhe zbatojë një strategji për të përmirësuar pjesëmarrjen, cilësinë dhe njohjen e hershme të aftësisë së kufizuar në të paktën dy vjet të arsimit parashkollor (moshat 3 dhe 4), përfshirë përdorimin e ambienteve të shkollës për të hapur shërbime/grupe të edukimit parashkollor; si dhe të angazhohet drejtpërdrejt dhe t'i koordinojë politikat dhe praktikat me komunat dhe me shkollat për ta përmirësuar pjesëmarrjen në nivel të arsimit parashkollor. Gjithashtu, raporti i rekomandoi ministrisë që të rishikojë formulën ekzistuese për shpërndarjen dhe menaxhimin e fondeve në arsim, për ta lejuar delegimin e pushtetit në shkolla dhe më shumë investime në materialet mësimore, në teknologji të reja dhe në kushte të punës, që lidhen drejtpërdrejt me mësimdhënien dhe me mësimnxënien. Ndërsa komunave, si bartëse të kompetencave në arsim, u rekomandoi që: të funksionalizojnë ekipet e parandalimit dhe të reagojnë në nivel të shkollës dhe të komunës; të

59 Për vitin akademik 2022/23, 21 institucione të akredituara të arsimit të lartë, prej të cilave 9 institucione publike dhe 12 institucione private, ishin pjesë e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë. Për më shumë shih: <https://akreditimi.rks-gov.net/vendime-per-institucione-publike/> dhe [https://akreditimi.rks-gov.net/vendime-per-institucione-private\\_v1/](https://akreditimi.rks-gov.net/vendime-per-institucione-private_v1/).

60 <https://oik-rks.org/2022/11/10/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-3312022-lidhur-me-perafrimin-e-dispozitave-te-sistemit-te-arsimit-te-pergjithshem-parauniversitar-te-kosoves-me-te-drejtat-e-femijeve-ne-arsim/>

61 <https://oik-rks.org/2022/04/27/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-4112021-ne-lidhje-me-themelimin-e-ekipit-profesional-vleresues-dhe-perkrahes-per-nevojat-e-posacme-arsimore-per-femijet-me-aftesi-te-kufizuara/>

rrisin bashkëpunimin dhe koordinimin në mes të të gjitha palëve të interesuara (përfshirë qendrat mësimore) për ta adresuar çështjen e braktisjes së shkollës dhe dhunën në shkollë, veçanërisht në arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë; ta rrisin financimin për ofrimin e edukimit dhe të arsimit parashkollor dhe parafillor në komunë, për t'i shtrirë shërbimet parashkollore edhe në zonat rurale dhe të delegojnë planifikimin dhe menaxhimin e plotë financiar në shkolla. Më tutje, rekomandimi tjetër iu referua shkollave të cilat duhet të planifikojnë dhe të zbatojnë aktivitete që i angazhojnë nxënësit në aktivitete plotësuese shkollore dhe jashtëshkollore, ta përmirësojnë bashkëpunimin me prindërit dhe me komunitetet për ta përmirësuar cilësinë e arsimit si dhe ta transformojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien e orientuar drejt nxënësit duke u larguar nga mbajtja e thjeshtë e mësimin dhe bartja mekanike e njohurive.

Në këtë drejtim, për sa i përket gjithpërfshirjes në arsimin parauniversitar, si parakusht për përfshirje edhe në arsimin e lartë, Avokati i Popullit e vlerëson si pozitive mbështetjen financiare të ofruar për studentët egjiptianë, romë dhe ashkalinj me qëllim të përmirësimit të kushteve materiale dhe qasjes në arsim<sup>62</sup>, si dhe mbështetjen financiare për studentet vajza/gra në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës, ku veçanërisht janë inkurajuar të aplikojnë studentet nga komunitetet joshumicë, ato me aftësi të kufizuara si dhe nga zonat rurale.<sup>63</sup>

Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 ka pranuar një numër të konsiderueshëm ankesash lidhur me të drejtën në arsim, ku 7 raste janë iniciuar sipas detyrës zyrtare. Këto raste, duke përfshirë edhe

rastet e iniciuara sipas detyrës zyrtare, kanë trajtuar: dhunën në shkolla, kriteret për fitimin e gradave dhe titujve në universitete, vijushmërinë në shkollë si dhe kushtet e mësimin për nxënësit egjiptianë, romë dhe ashkalinj, grevat në arsim, diskriminimin e fëmijës me aftësi të kufizuara, mungesën e transportit për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe ndërprerjen e mësimin. Në një nga këto raste, pas shqetësimeve të ngritura nga takimet me studentë, Avokati i Popullit kishte hapur hetimet *ex-officio* kundër MASHTI-t, lidhur me mosrespektimin e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe statutet e universiteteve publike, të cilat përcaktojnë kriteret për fitimin e titujve dhe gradave të ndryshme. Pas hetimeve është konstatuar se këto probleme janë duke u adresuar dhe se ka pasur përmirësime në këtë drejtim pas hyrjes në fuqi të Rregullores për procedurat vlerësuese për zgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik.

Më 2 dhjetor 2021, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me rekomandime<sup>64</sup> kundër MASHTI-t për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në lidhje me mosnjohjen/verifikimin e diplomave të lëshuara nga Bartësit e Arsimit të Lartë (BAL). Ky raport i ka rekomanduar MASHTI-t: 1) që të formojë një komision për trajtimin e çështjes, pas përfundimit të punës së komisionit, të vendoset në mënyrë meritore për kërkesat e parashtruara nga palët për njohjen/validimin e diplomave; 2) që të sigurojë që Inspektorati i Arsimit, si organ ekzekutiv qendror, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm në të gjitha institucionet edukativo-arsimore. Gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit ka monitoruar zbatimin e këtyre rekomandimeve, ku është njoftuar se është formuar komisioni i ekspertëve dhe janë verifikuar/vulosur

62 Për më shumë shih: <https://masht.rks-gov.net/thirrje-per-mbeshtetje-financiare-per-studentet-e-komuniteteve-rom-ashkali-dhe-egjiptian/> [e qasur së fundmi me datën 25.01.2023].

63 Për më shumë shih: <https://masht.rks-gov.net/thirrje-per-mbeshtetje-financiare-te-studenteve-ne-fushat-e-shkences-teknologjise-inxhinierise-dhe-matematikes-apo-stem-te-arsimit-te-larte-ne-kosove/> [e qasur së fundmi me datën 25.01.2023].

64 <https://oik-rks.org/2021/12/23/raport-me-rekomandime-a-nr-242018-k-dhe-te-tjeret-kunder-ministrise-se-arsimit-shkences-teknologjise-dhe-inovacionit/>

3874 diploma dhe dokumente të tjera të lëshuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë, prej tyre 1828 ishin të Arsimit Universitar Publik si dhe 2046 të Arsimit të Lartë Privat.<sup>65</sup> Po ashtu është shpallur konkursi për angazhimin e 20 inspektorëve të arsimit, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në të gjitha institucionet edukativo-arsimore.<sup>66</sup> IAP-ja do të vazhdojë monitorimin e këtyre rekomandimeve për të siguruar zbatimin e tyre dhe respektimin e plotë të së drejtës për arsimim.

Një pengesë për ushtrimin e së drejtës në arsim gjatë këtij viti ishte greva e organizuar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), e cila vonoi fillimin e vitit të ri shkollor për një muaj. Me gjithë rëndësinë e respektimit të së drejtës për organizim sindikal dhe të së drejtës për veprime sindikale, kjo e drejtë bie ndesh me të drejtën e fëmijëve në arsim, duke qenë se mosvijimi i shkollimit ka pasoja të dëmshme për zhvillimin intelektual dhe emocional të fëmijës.

---

65 Informata e pranuar nëpërmjet adresës elektronike nga Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC), më datën 8.2.2023.

66 Sinjali, MASHTI shpall konkurs për 20 inspektorë të arsimit, 26 nëntor 2022, në: <https://sinjali.com/mashti-shpall-konkurs-per-20-inspektore-te-arsimit/> [e qasur së fundmi me datën 25.01.2023].

# Liria e Artit dhe e Shkencës

Liria e artit dhe e shkencës bën pjesë në kuadër të të drejtave kushtetuese dhe ligjore. Në këtë drejtim, Kushtetuta [neni 48] garanton liri artistike, shkencore dhe akademike. Kjo e drejtë është pjesë edhe e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut [neni 27], që këtë të drejtë e garanton si të drejtë kolektive ashtu edhe të drejtë individuale.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk përmban një të drejtë të tillë specifike. Por, varësisht kontekstit, kjo e drejtë trajtohet në kuadër të të drejtave të tjera. Duke trajtuar lirinë e shprehjes, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut thekson: *“Neni 10 përfshin gjithashtu lirinë artistike, e cila jep mundësinë për të marrë pjesë në shkëmbimin publik të informacioneve dhe ideve kulturore, politike dhe sociale të të gjitha llojeve. Si pasojë, ata që krijojnë, përforcojnë, shpërndajnë ose ekspozojnë vepra arti kontribuojnë në shkëmbimin e ideve dhe opinioneve që janë thelbësore për një shoqëri demokratike.”*<sup>67</sup> Kështu, fakti se nuk ka një të drejtë specifike në KEDNJ, nuk nënkupton se liria e artit dhe e shkencës është jashtë sferës së KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GjEDNJ-së.

Përkundër faktit se në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në disa dokumente të tjera ndërkombëtare kjo e drejtë përcaktohet si e drejtë e veçantë, ajo nuk mund të funksionojë si e ndarë nga të drejtat e tjera, siç janë: liria e shprehjes, e drejta në pronë etj. Neni 46.5 i Kushtetutës, që mbron pronën intelektuale, është në ndërlidhje edhe me

këtë të drejtë në kuptim të së drejtës së krijuesit artistik në gjenerimin e të drejtave pronësore nga krijimtaria e tij artistike dhe shkencore.

Po ashtu kjo e drejtë garantohet edhe nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (PNDEShK)<sup>68</sup> dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.<sup>69</sup> Mbrojtja sipas PNDEShK-së konsiderohet si mbrojtja më specifike e kësaj të drejte sipas akteve ndërkombëtare.<sup>70</sup> Ndër të tjera, ky pakt përcakton: *“Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e domosdoshme për kërkimin shkencor dhe për veprimtarinë krijuese.”*<sup>71</sup> Kështu, krahas garantimit të lirisë individuale edhe kolektive, ky nen përcakton edhe një lloj obligimi për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme institucionale për jetësimin dhe zhvillimin e kësaj të drejte. Liria e artit dhe e shkencës, në Kushtetutën e Kosovës ndërthet në vete edhe lirinë akademike, e cila është e garantuar me Ligjin në fuqi për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, respektivisht nenin 27.

Kështu, liria akademike duhet ndërlidhur ngushtë me autonominë institucionale (si p.sh. asaj universitare) për realizimin e kësaj të drejte, për shkak se secili statut i universiteteve në Republikën e Kosovës përcakton lirinë akademike si një e drejtë themelore e personelit akademik universitar.

Në këtë vit raportues, Avokati i Popullit nuk ka marrë asnjë ankesë në lidhje me këtë të drejtë.

67 Müller dhe të tjerët kundër Zvicrës, par 27; Lindon, Otchakovsky-Laurens dhe July kundër Francës, par, 47

68 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore, neni 15.

69 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 19.

70 “Report of the Special Rapporteur in the field of cultural rights”. United Nations, General Assembly, 2013, p.4.

71 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore, neni 15.3.

## E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit

E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>72</sup> dhe është në harmoni me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.<sup>73</sup> Gjithashtu kjo e drejtë është e rregulluar dhe mbrohet edhe me ligje bazike, të cilat përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.<sup>74</sup>

Avokati i Popullit vëren se realizimi i të drejtave të qytetarëve nga fusha e marrëdhënies së punës ka një rëndësi të posaçme për statusin e çdo qytetari dhe njëkohësisht është një indikator se si shteti i realizon obligimet ndaj qytetarëve. Garancitë kushtetuese për të drejtën e punës dhe për të drejtën për zgjedhjen e lirë të profesionit krijojnë obligim për institucionet që t'i mbrojnë këto të drejta në mënyrë të barabartë ndaj të gjithëve dhe të sigurojnë respektimin dhe zbatimin e plotë të legjislacionit përkatës.

Për sa i përket së drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit, gjatë vitit 2022 Avokati i Popullit ka pranuar gjithsej 54 ankesa. Disa nga këto raste, të cilat janë hetuar nga Avokati i Popullit, duke përfshirë edhe rastin e iniciuar sipas detyrës zyrtare, kanë trajtuar: ndërprerjen e marrëdhënies së punës, manifestimin e fesë në vendin e punës, mosrealizimin e së drejtës në pagë etj.

Avokati i Popullit konstaton se edhe gjatë kësaj periudhe raportuese vazhdon shkelja e së drejtës

së punës dhe ushtrimit të profesionit. Sikurse në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, ka shkelje të së drejtës nga marrëdhënia e punës – shkelje të procedurave të punësimit, të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë joligjore, kohëzgjatjen dhe moskompensimin jashtë orarit, mosshfrytëzim të së drejtës për pushim vjetor, mosrealizimin e së drejtës në pagë, punëtor pa kontrata të punës, diskriminimi në moshë etj.

Avokati i Popullit sjell në vëmendje se marrëveshjet kolektive të punës janë instrument për rregullimin e kushteve të punës dhe të punësimit, burim i së drejtës së punës, por edhe çdo marrëveshje ndërlidhur me kushtet e punës e të punësimit. Dispozitat e kontratës kolektive kanë efekt të përgjithshëm juridik dhe ato i plotësojnë apo i zëvendësojnë normat ligjore. Në parim ato nuk aplikohen direkt, por shërbejnë si akte të përgjithshme në bazë të të cilave lidhen kontratat individuale mbi punën.

Mungesa e vullnetit për të arritur marrëveshjen e përgjithshme kolektive, e cila kishte skaduar në vitin 2018, ka ndikuar në mosrealizimin e disa të drejtave nga marrëdhënia e punës në sektorin publik dhe në atë privat. Mbështetje dhe zbatueshmëri më të madhe ka gjetur dispozita e nenit 48, e cila njihje të drejtën për shtesë mbi pagën bazë për përvojë pune në shumën 0.5% për çdo vit të plotë të përvojës së punës. Megjithatë, edhe në zbatim të kësaj dispozite ka pasur pengesa, qoftë në sektorin

72 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 49.

73 Po aty, neni 22.

74 Ligji nr. 03/L-212 i Punës; Ligji nr.03/L-145 për Shërbimin Civil; Ligji nr.03/L- 147 për Pagat e Nëpunësve Civilë; Ligji nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social.

privat, apo edhe në konfuzitetet se cila përvojë llogaritet - ajo e përgjithshme apo te punëdhënësi aktual. Rrjedhimisht, si e tillë kjo dispozitë ka gjetur zbatim të mirë vetëm në sektorin publik.

### Mbrojtja dhe siguria në punë

Sipas statistikave të Inspektoratit të Punës (IP), numri i aksidenteve në vendet e punës që përfundojnë me fatalitet mbetet i lartë dhe mjaft shqetësues. Që nga viti 2004 deri në vitin 2021, sipas IP-së<sup>75</sup>, kanë humbur jetën 232 persona në vendin e punës ose lidhur me punën. Vetëm gjatë vitit 2022, sipas të dhënave zyrtare në Kosovë, 14 persona kanë humbur jetën në vendin e punës. 169 aksidente kanë përfunduar me lëndime të lehta, ndërsa 61 aksidente kanë përfunduar me lëndime të rënda.<sup>76</sup> Këto raste kanë ndodhur, siç vijon: 9 raste të vdekjes kanë ndodhur në sektorin e ndërtimit, 2 raste në sektorin e prodhimit, 1 rast nga kontakti me energjinë elektrike, 1 rast në shërbime si dhe 1 rast ka ndodhur nga goditja nga rrufeja.

### Numri i aksidenteve me pasojë lëndimet dhe vdekjet në nivel viti 2004-2022:

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Lëndime	54	15	15	47	21	29	21	31	45	37	63	47	62	50	125	90	160	130	169
Vdekje	17	7	7	4	11	9	10	10	17	17	9	9	9	19	22	11	16	9	14

Avokati i Popullit thekson se mbetet problematik fakti i mospërputhjes së evidencave dhe statistikave në lidhje me aksidentet në vendet e punës, për shkak të të dhënave të ndryshme nga një institucion tek tjetri, sepse ende nuk ka një bazë të të dhënave në të cilën do të gjendeshin statistikat përkatëse dhe përshkruese të aksidenteve në vendet e punës në të gjithë sektorët. Andaj, edhe besueshmëria e këtyre të dhënave mbetet sfiduese dhe e diskutueshme.

Ligji në fuqi për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë obligon punëdhënësin që menjëherë, posa të ndodhë aksidenti në vendin e punës, të njoftojë IP-në. Njëra ndër problemet që mbetet evidente, është mosraportimi i aksidenteve në vendet e punës, sidomos i aksidenteve që si pasojë kanë lëndimin.

Shqetësuese mbetet mungesa e raportimeve mbi sëmundjet profesionale dhe ato që lidhen me vendet e punës, shkaku i mungesës së rregullimeve specifike ligjore dhe tërë sistemit që lidhet me Shëndetin në Punë.

Avokati i Popullit është duke zhvilluar një hulumtim lidhur me çështjen e sigurisë dhe shëndetin në punë, si dhe informalitetin e punësimit në sektorin privat dhe, pas hetimeve dhe të gjeturat, do të përmbledhen në një raport që do t'u dërgohet institucioneve relevante.

75 Këto të dhëna janë marrë nga ueb-faqja zyrtare e Inspektoratit të Punës si dhe nga Drafti fillestar i koncept-dokument për avancimin e legjisllacionit nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, i hartuar nga ish-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në kuadër të së cilës ka qenë edhe Inspektorati i Punës.

76 Intervistë e z. Hekuran Nikqit, Kryeinspektor në MPMS të Republikës së Kosovës, më 31 dhjetor 2022, (<https://kosovapress.com/rritet-numri-i-punëtorëve-që-humben-jetën-në-vendin-e-punës/>).



Derisa legjislacioni aktual rregullon vetëm çështjen e kompensimit të shpenzimeve të kurimit për të punësuarit që pësojnë aksident në vendet e punës, nuk ka rregullimi juridik për përfitime të tjera. Rrjedhimisht, në rastet më të rënda, kur i punësuarit nuk ka arritur të mbijetojë shkaku i aksidentit në vendin e punës, familja e tij/saj nuk gëzojnë ndonjë kompensim të domosdoshëm, i cili është i përcaktuar me legjislacionin në fuqi nga fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. E vetmja rrugë për realizimin e përfitimeve financiare në këto raste mbetet procedura gjyqësore civile, e cila familjarëve të viktimave u merr shumë kohë, mund dhe kosto financiare.

Gjatë kësaj periudhe, Avokati i Popullit konstaton se si në sektorin publik, e sidomos në sektorin privat, ka shkelje të ndryshme të së drejtës nga marrëdhënia e punës, përfshirë edhe diskriminimin, si: shkelje të procedurave të punësimit, të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë joligjore, si dhe shkelje lidhur me kohëzgjatjen e orarit të punës, kompensimin për punë jashtë orarit, mohimin e së drejtës për pushim vjetor dhe pushim të lehonisë dhe mosrealizimin e së drejtës në pagë.

### **Mbrojtja e së drejtës për mosdiskriminim në punë**

Gjatë vitit 2022, IAP-ja ka pranuar disa ankesa nga qytetarët që kishin të bënin me pretendime ankimore për diskriminim. Ndër to është një ankesë për të cilën janë duke u zhvilluar hetime përkitazi me pretendime për diskriminim për shkak të përkatësisë etnike, ku një person pohon që një institucion publik nuk e kishte përzgjedhur në pozitë pune, duke pohuar që ekziston bazë ligjore e mjaftueshme që garanton punësimin e personave nga komunitetet joshumicë në institucione publike. Po ashtu, çështjet e tjera që janë adresuar në formë ankesë në IAP përfshijnë edhe mungesën e trajtimit

të duhur të një pjese të stafit në institucione publike nga menaxhmenti, pretendime për trajtim jo të barabartë si dhe mohim të së drejtës për ngritje në detyrë dhe në zhvillim të karrierës etj.

Më 9 qershor 2022, Avokati i Popullit publikoi Raportin me Rekomandime A.nr.474/2021 përkitazi me pretendimet e ankuesve për diskriminim në bazë të lirisë së asociimit si anëtarë në Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.<sup>77</sup>

Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Autoritetit të Aviacionit Civil lidhur me nevojën e krijimit të hapësirës së mjaftueshme të veprimit për Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, respektimin e lirisë së asociimit dhe gjetjes së gjuhës së përbashkët duke krijuar mundësi të përfshirjes së kësaj sindikate edhe në ndërtimin e politikave të institucionit pa i anashkalluar dhe diskriminuar ata.

<sup>77</sup> <https://oik-rks.org/2022/06/09/raport-i-avokatit-te-popullit-ankesa-nr-4742021-arianit-dobroshi-dhe-te-tjeret-perkitazi-me-pretendimet-e-ankuesve-per-diskriminim-ne-baze-te-lirise-se-asociimit-si-anetare-ne-shoqaten-sindikale/>



# Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale

E drejta e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale hyn në grupin e të drejtave sociale-ekonomike, të cilat Kushtetuta e Republikës së Kosovës i garanton me dispozitën e nenit 51, duke e garantuar mbrojtjen shëndetësore (si dhe mbrojtjen sociale). Avokati i Popullit në këtë vit ka pranuar 310 ankesa përkitazi me mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, ndërsa janë hapur 112 raste për hetim.

Natyra e ankesave të trajtuara kryesisht kishte të bënte me pretendimet për cenimin e së drejtës nga marrëdhënia e punës, me cenimin e së drejtës për mjete juridike, me pretendime për cenimin e lirisë së shprehjes, me pretendime për cenimin e së drejtës për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike, me ankesa ndaj plotësim-ndryshimit të Statutit të Qendrës Klinike Universitare, me ankesa të punëtorëve shëndetësorë lidhur me organizimin sindikal etj.

Në bazë të ankesave dhe të rasteve të hetuara është konstatuar se edhe në vitin 2022 në Sektorin Publik të Shëndetësisë ka pasur mungesa të furnizimeve të rregullta me barna esenciale, produkte e pajisje medicinale si dhe materiale shpenzuese. Ka vazhduar të ketë pritje të gjata të pacientëve për të kryer disa lloje intervenimesh. Gjithashtu shqetësuese ka vazhduar të jetë largimi i profesionistëve shëndetësorë nga<sup>78</sup> vendi - nga institucionet publike dhe nga ato private.

Avokati i Popullit ripërsërit edhe në këtë vit se Ligji nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor nuk po gjen

zbatim, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore vazhdon të mos jetë pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kujdesi Paliativ në Republikën e Kosovës akoma nuk është funksionalizuar dhe Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh), i filluar në vitin 2002, akoma nuk është ngritur dhe si rrjedhojë kemi një SISh jo të plotë dhe jofunksional.

Përveç kësaj, Avokati i Popullit ka shprehur shqetësim edhe lidhur me rrezikun që ka ekzistuar për dështimin e furnizimit me barna në burgje, për shkak të dështimit të procedurave të prokurimit për furnizim me këto barna.

Avokati i Popullit, më 18 mars 2022, organizoi tryezë diskutimi përkitazi me mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në sektorin shëndetësor. Përfundimet që dolën nga kjo tryezë shpërfaqën problemet e vazhdueshme përkitazi me mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në sektorin shëndetësor. Të dhënat në fjalë nuk janë të plota, janë të pamjaftueshme, herë-herë gjysmake apo edhe të paqarta, si dhe një pjesë e tyre nuk janë kompatible me metodologjinë dhe kriteret që përdorë Agjencia e Statistikave të Kosovës, që janë të nevojshme për t'u konsideruar valide, të besueshme dhe të krahasueshme. Duke pasur parasysh të dhënat e mbledhura dhe informacionet e pranuar nga ky takim, Avokati i Popullit filloi hetime sipas detyrës zyrtare dhe të gjeturat e këtij hetimit do të publikohen në një raport që do të publikohet pas përfundimit të hetimeve.

Në fund të dhjetorit 2022, Avokati i Popullit adresoi tek autoritetet përgjegjëse raportin e iniciuar sipas detyrës zyrtare përkitazi me të drejtat në Shëndetin Seksual dhe Riprodhues (ShSR) në Republikën e Kosovës, me fokus qasjen në informata, në shërbime në kontracëpsion, qasjen në abort dhe në kujdesin pas abortit, si dhe kujdesin për shëndetin e nënës. Raporti përfshin të dhëna për periudhën nga viti 2019 dhe paraqet vijimësi të vlerësimit në nivel vendi të të drejtave në ShSR-së, adresuar tek autoritetet nga Avokati i Popullit në vitin 2016. Hetimi u bazua në metodologjinë e kontekstualizuar dhe për bazë kishte Udhëzuesin në mbështetje të Institucioneve Kombëtare për të Drejta të Njeriut (©UNFPA, 2015) dhe me mbështetjen e Zyrës së UNFPA-së.

Gjatë hetimit janë evidentuar probleme që ka sistemi shëndetësor, si: stafi i pamjaftueshëm mjekësor dhe jo mjaft i përgatitur për t'iu përgjigjur standardeve më të mira për shërbime të dinjitetshme dhe cilësore; mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për shëndetësi, përfshirë mungesën e sigurimeve shëndetësore, si dhe infrastrukturën jo të mjaftueshme dhe jo në pajtim me nevojat e kërkesat, veçmas nevojat e popullatës me karakteristika që kërkojnë ndjeshmëri e vëmendje të veçantë, rezulton me pamundësi për përmbushjen e detyrimeve që ka shteti për qasje universale shëndetësore. Po ashtu hetimi nxori në pah se sado që ekziston baza ligjore dhe struktura e mekanizmat në pajtim me këtë bazë ligjore, anomalitë në funksionim dhe mungesa e koordinimit dhe planifikimit janë të shumta. Për më tepër, mungesa e informimit dhe e edukimit të mirëfilltë për ShSR-në, qasja joproaktive e personelit shëndetësor, mungesa e profesionalizmit dhe etikës, joefektiviteti dhe joefikasiteti i mekanizmave të ankesës, janë barriera që pengojnë realizimin e të drejtave të garantuara dhe qasje gjithëpërfshirëse e pa diskriminim.

Megjithatë, përkundër gjithë çrregullimeve dhe vështirësive në funksionimin e sistemit, gatishmëria e personelit mjekësor për të përmbushur detyrimet

dhe thirrjen e profesionit që kanë, janë përgjegjësi që bien drejtpërdrejt në ndërgjegjen, etikën dhe profesionalizmin individual të punonjësve shëndetësorë, të të gjitha kategorive, dhe nuk janë të lidhura domosdo me mungesën e buxhetit, infrastrukturën e mangët apo çështje të tjera objektive, pa e minimizuar rëndësinë e tyre.

## Pensionet

Shumica e pensionistëve në Kosovë jetojnë me pensione bazike, që janë të pamjaftueshme për jetesë, madje me to nuk mbulohen as shpenzimet elementare të jetës. Në përgjithësi, gjendja e pensionistëve vazhdon të jetë e njëjtë sikurse viteve të kaluara.

Qeveria ka ndërmarrë hapa të caktuar në reformimin e fushës së sistemit të pensioneve dhe beneficioneve. Në planin e saj ka hartimin e një ligji të vetëm për pensionet, i cili në një vend do të përfshijë dhe trajtojë të gjitha të drejtat në pensione si dhe krijimin e Fondit për Sigurime Sociale. Me këtë ligj synohet të përcaktohet struktura organizative, forma e menaxhimit, shkalla e kontributeve dhe pensioni invalidor, e gjithë kjo me qëllim të harmonizimit me praktikën evropiane. Mbetet e paqartë se kur kjo reformë do të zbatohet në tërësi.

Në janar të këtij viti Qeveria mori vendim me të cilin rriti shumën e përfitimeve të skemava pensionale të financuara nga shteti, nga 70 euro në shumën prej 100 euro. Me këtë rritje janë përfshirë pensionet bazike-sociale, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensioni familjar dhe pensioni invalidor i punës.

Avokati i Popullit edhe në këtë vit ka pranuar ankesa përkitazi me çështjen e pensioneve.

Bazuar në ankesat e pranuar, edhe më tej mbetet shqetësuese ndërprerja e pensionit të moshës për shkak të mosparaqitjes fizike çdo gjashtë muaj në zyrën e pensioneve, përmes të të cilit fakt vërtetohet se personi është gjallë. Sipas Ministrisë

së Financave, Punës dhe Transfereve, ndërprerja e pensioneve ndodh për shkak se pensionistët që nuk lajmërohen brenda afatit të përcaktuar, në mënyrë automatike dalin nga sistemi i përfituesve të pensioneve. Gjithashtu, ata kanë pohuar se pas tre muajsh ndërpritet në tërësi pensioni, pasi programi në fjalë në mënyrë automatike i ndërprejnë rastet e tilla kur personat nuk lajmërohen me kohë sipas Udhëzimit Administrativ nr.05/2015.

Një praktikë e tillë, sipas Avokatit të Popullit, është e papranueshme dhe paraqet shkelje të të drejtave të personave që përfitojnë nga skemat pensionale. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit ka rekomanduar që një praktikë e tillë të ndërpritet.

Duke ritheksuar shqetësimin e tij që detyrimi i paraqitjes së pensionistëve në zyrat për pensione sipas kriterëve të Udhëzimit Administrativ nr.05/2015, cenon dinjitetin e pensionistëve, duke marrë parasysh moshën dhe gjendjen shëndetësore, që në shumicën e rasteve u vështirësohet dukshëm prezenca fizike në zyrat e pensioneve.

Gjithashtu, IAP-ja është duke hetuar edhe raste të tjera që kanë të bëjnë me pretendime ankimore për shkelje të të drejtave të njeriut në shfrytëzim të së drejtës në pensione, përfshirë ndërprerjen e pensionit të personave me aftësi të kufizuar, refuzimin e kërkesave për pension kontributpagues, që ndërliiden me kriterin diskriminues prej pesëmbëdhjetë vjetësh stazh kontributpagues etj.

Për këtë çështje Avokati i Popullit ka shprehur qëndrimin e tij në Raportin me rekomandime *ex officio nr.235/2018*, rekomandimet e adresuara kanë të bëjnë me ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me pensionet kontributpaguese. Me këtë rast Avokati i Popullit kishte konstatuar diskriminim të dyfishtë për shkak të mosnjohjes së kontributeve për periudhën e largimit nga puna si pasojë e masave të dhunshme.

## Çështjet sociale

Avokati i Popullit, duke iu referuar ankesave të pranuar, hetimeve të zhvilluara në kuadër të çështjeve që ka trajtuar këtë vit, konstaton se gjendja ekonomike dhe sociale e një pjese dërmuese të familjeve në Kosovë vazhdon të përkeqësohet. Papunësia dhe moszbatimi i ligjeve janë faktorët kryesorë që ndikojnë në krijimin e një situate të tillë. Personat që nuk kanë një vend pune, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët që detyrohen të punojnë dhe janë në kushte rruge, janë disa nga grupet më të cenueshëm, që në mungesë të masave sociale dhe të shërbimeve për trajtim shpesh ballafaqohen me kushte të pa dinjitetshme për jetë.

Vazhdon të jetë shqetësim neglizhimi i fuqizimit të Qendrave për Punë Sociale, në mungesë të politikave të mirëfillta, mungesës së shërbimeve përkatëse, kapaciteteve të pamjaftueshme dhe shumë probleme të tjera që janë evidentuar për sa i përket këtyre qendrave.

Avokati i Popullit vëren se gjatë këtij viti Qeveria ka ndërmarrë disa masa për përmirësimin e situatës sociale, siç është Vendimi (nr.24/2022) mbi caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e pjesshëm të Masës 3.4 - pako ushqimore për familjet në nevojë në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Me gjithë përpjekjet e Qeverisë në ndërmarrjen e masave për zbutjen e krizës ekonomike që ka përfshirë vendin, por edhe globin, si dhe ndikimi negativ që ka shkaktuar pandemia COVID-19, gjendja në terren nuk është aspak e mirë për familjet me të ardhura të ulëta si dhe për ata pa ndonjë të ardhur. Zakonisht masat e ndërmarra nga ana e ekzekutivit kanë pasur ndikim afatshkurtër në përmirësimin e gjendjes sociale-ekonomike për familjet dhe individët përfitues.

# Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor

Kushtetuta në neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] përcakton: “*Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.*”

Avokati i Popullit vëren se institucionet përgjegjëse edhe gjatë vitit raportues nuk kanë arritur që përmes politikave multisektoriale të nivelit qendror dhe lokal të bëjnë kthesa të dukshme, të qëndrueshme, të cilat do të ndikonin në parandalimin e ndotjes dhe rehabilitimin e dëmeve mjedisore në vend. Edhe përkundër rëndësisë që ka mbrojtja e mjedisit, si e drejtë e njeriut, autoritetet nuk arritën të përmbushnin detyrimet e tyre kushtetuese.

Avokati i Popullit, gjatë vitit raportues ka pranuar 15 ankesa që kanë të bëjnë me të drejtën për mjedisit të sigurt dhe të shëndetshëm. Nëntë ankesa të pranueshme kanë të bëjnë me çështjen e shkarkimit në lumenj të ujërave të patrajtuara, bezdinë nga zhurma dhe kundërmimi, të drejtën e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje lidhur me vendimet institucionale për çështje mjedisore, infrastrukturën rrugore etj. Përkitazi me rastet, ende janë duke vazhduar hetimet.

Me qëllim të promovimit të së drejtës në fjalë, Avokati i Popullit, nëpërmjet aktiviteteve të

ndryshme, shënoi ditët ndërkombëtare që lidhen me mjedisin.

Edhe pse gjatë vitit raportues është miratuar Ligji i ri për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, shqetësues ka vazhduar të mbetet kualiteti i ajrit dhe ndikimi në të drejtën e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Janë regjistruar tejkalime të përqendrimit të PM10 dhe PM2.5 në periudhën nëntor – mars, dhe tejkalimet me Ozon (O3) gjatë sezonit veror. Fakti se 32.2% e kohës gjatë vitit 2022, kualiteti i ajrit ishte i nivelit të moderuar, të pashëndetshëm dhe shumë të pashëndetshëm<sup>79</sup>, është tregues i mjaftueshëm për kërcënimin serioz në shëndetin e qytetarëve<sup>80</sup>. Ndotja më e madhe me PM10 dhe PM2.5 vjen nga djegiet e vogla, industria dhe transporti.<sup>81</sup> Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e ajrit vazhdojnë me mospërmbushje të kërkesave ligjore dhe ndërmarrjen e masave adekuate në uljen e ndotjes së ajrit.

Edhe pse Kosova është ndër vendet më të varfra me burime ujore, nuk janë ndërmarrë veprime konkrete të cilat do ta ndalnin degradimin e vazhdueshëm të lumenjve në aspektin tredimensional: uji, shtretërit dhe brigjet e lumenjve.<sup>82</sup> Mbrojtja e ujërave sipas parimeve të menaxhimit të qëndrueshëm vazhdon të jetë një sfidë serioze në raportin autoritet publik-mjedis. Ndërhyrjet e pakontrolluara, pa kriter, të

79 <https://airqualitykosova.rks-gov.net/>, Gjatë vitit 2022, niveli i cilësisë së ajrit ishte 69.8% të kohës në nivelin e ajrit shumë të mirë dhe të mirë, 12.7% të kohës të moderuar dhe 19.5% në nivelin e cilësisë së ajrit të pashëndetshëm dhe shumë të pashëndetshëm.

80 MCC, Raport, 2021: “Ndotja e ajrit dhe ndikimi në shëndet në Kosovë”, 12.1% të vdekshmërisë totale, nga të gjitha shkaqet e vdekjeve natyrore në Kosovë i atribuohen nivelit aktual të PM2.5.

81 AMMK, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2021, fq. 5

82 AMMK, Raporti: Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve, 2022, “Sipërfaqet e degraduar nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit deri në vitin 2018 është vlerësuar se është 1421.06 ha.”

operatorëve për eksploatin e rërës dhe zhavorrit në segmentet e ndryshme të shtretërve të lumenjve dhe të brigjeve të tyre kanë vazhduar duke shkaktuar mjedis të pasigurt për jetën e qytetarëve, si dhe mungesë të ujërave. Mosrespektimi i kritereve gjatë realizimit të projekteve ujore, shpyllëzimi i brigjeve të lumenjve tanimë janë duke shkaktuar ulje të lartësisë dhe zgjerim të shtretërve të lumenjve, ndryshim në rrjedhën e ujërave, dëmtim të substratit të florës përgjatë brigjeve të lumenjve, hapje të gropave të mëdha si rezultat i eksploatimit të inerteve,<sup>83</sup> si dhe përmbytje.<sup>84</sup> Dëmet më të mëdha të evidentuara të kësaj natyre janë shkaktuar në lumin “Drini i Bardhë”. Theks i veçantë duhet t’i jepet mosmarrjes së veprimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen nga degradimi të peizazhit dhe vegetacionit të lumit dhe ujëvarës “Mirusha”, si monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë.<sup>85</sup>

Problemet kryesore janë ndërtimi shtigjeve në drejtim të ujëvarave nga aksi rrugor Klinë – Gjakovë, si dhe shfrytëzimi i ujërave. Rehabilitimi i ndërhyrjeve në lumenj sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi nuk ka shënuar përmirësim.

Paqartësitë me operimin e hidrocentraleve kanë vazhduar. Përkundër konstatimeve për dështimin e shtetit për të respektuar parimet e së drejtës mjedisore, mangësive të theksuara në zbatimin e kritereve, të evidentuara në procesin e licencimit të hidrocentraleve, të cilat nuk sigurojnë shfrytëzim, menaxhim dhe mbrojtje efikase të ujërave dhe të mjedisit,<sup>86</sup> si dhe mundësisë që dëmet të jenë të riparueshme, gjykatat e rregullta dhe Gjykata

Kushtetuese e Republikës së Kosovës ende nuk kanë arritur të marrin vendime përfundimtare duke shpërfaqur mungesën e ekspertizës në fushën mjedisore.<sup>87</sup> Me qëllim të sensibilizimit të publikut lidhur me rëndësinë e ujërave, Avokati i Popullit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit, më 27 qershor 2022, organizuan tryezën: “Ujërat, e drejtë e njeriut – mbikëqyrja dhe llogaridhënia”.

Degradimi, ndotja, betonimi dhe ndryshimi pa kriter i tokave ka vazhduar me ritëm të njëjtë. Praktika e mosrespektimit të kritereve të caktuara me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe me Ligjin e Ndërtimit tashmë është çështje që kërkon trajtim të shpejtë dhe politika të qarta institucionale për ndryshim.

Theks i veçantë duhet t’i vihet mosvënies nën kontroll të përputhshmërisë së objekteve ndërtimore në ndërtim dhe të atyre të përfunduara, me lejen e ndërtimit, dhe mosdhënia e lejeve/certifikatës së përdorimit, është dëshmi e mosarritjes së përbushjes së obligimeve pozitive të organeve kompetente për zbatimin e legjislacionit të ndërtimit. Mungesa e mbikëqyrjes dhe e certifikimit final të përdorimit të objekteve paraqet nevojën imediate për ndërmarrjen e masave nga institucionet kompetente për vlerësimin e sigurisë së objekteve për përputhshmërinë me rregullat e përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, e mbi të gjitha me rregullat e sigurisë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe me ato kundër ndotjes dhe degradimit të mjedisit.

83 Po aty.

84 <https://kallxo.com/lajm/ihmk-reshjet-do-te-vazhdojne-diteve-ne-vijim-ne-disa-zona-mund-te-kete-vershime/>

85 Koalicioni 27, Raport Hije mbi Kapitullin 27 Mjedis dhe Ndryshimet Klimatike, shtator 2022: “Në lumin “Mirusha” derdhen 11 rrjedha të ujërave të zeza nga fshatrat Bellanicë, Temeqinë, Bubël, Panorc, Rud, Turjakë, Mirushë, Lubizhdë, Banjë, Damaneq dhe Llapqevë.”

86 Zyra Kombëtare e Auditimit, 27 qershor 2022, Raporti i auditimit të performancës: “Sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i tyre mbi ndikimin në mjedis dhe ujëra.”

87 Gjykata Kushtetuese, KI143/22, Aktgjykim, KI143/22, i 15 dhjetorit 2022: “Gjykata konstatoi se, Aktgjykimi [AR]. UZVP. nr. 51/2022] i 19 korrikut 2022 i Gjykatës Supreme, Aktvendimi [AA. nr. 386/2022] i 26 majit 2022 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [A. nr. 3129/2021] i 12 prillit 2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, janë nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe interpretimit dhe zbatimit arbitrar të ligjit, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në Gjykatën Themelore.”

Avokati i Popullit vlerëson që mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr. 01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme kanë ndikim serioz në kufizimin e lëvizjes së lirë dhe të papenguar, të privatësisë, së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, trajtimin të barabartë nga mospërfshirja e interesave të të gjithë qytetarëve, në veçanti të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

Për më tepër, mospërmirësimi i infrastrukturës për qasje në objekte të banimit kolektiv, sidomos në objekte të institucioneve publike, ashtu sikurse është paraparë me Udhëzimin Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas Avokatit të Popullit përbën kufizim serioz së lëvizjes së lirë dhe të drejtës për mjedis të sigurt e të shëndetshëm të personave me aftësi të kufizuara.

Çështja e ndërhyrjes dhe e ndërtimeve pa kriter në zonat e mbrojtura duhet të shikohet me kujdes. Avokati i Popullit vlerëson se veprimet e fundit të organeve të ndjekjes lidhur me ndërtimet në Brezovicë në zonën e mbrojtur janë të vonuara.<sup>88</sup> Situata e ngjashme është duke vazhduar në komunën e Novobërdës. Proporcioni i sipërfaqeve të pyllëzuara mbetet shumë i ulët në krahasim me pyjet e djegura.<sup>89</sup>

Kërcënim serioz mjedisor vazhdojnë të mbeten 763 depo ilegale, 8 depo sanitare, të cilat nuk menaxhohen sipas standardeve dhe kriterëve, 17 lokacione me kimikate dhe mbeturina të rrezikshme, hedhja e mbetjeve industriale pa kriterë dhe standarde, rrjedha e materieve të dëmshme nga

minierat dhe nga depot e mbetjeve minerare, vajrat e përdorura, pesticidet dhe mbetjet e makinave.<sup>90</sup>

Edhe në këtë vit institucionet nuk kanë arritur të vënë nën kontroll mbrojtjen e privatësisë së qytetarëve nga zhurma dhe bezdia e krijuar nga zhurma. Ligji i ri për Mbrojtje nga Zhurma ende nuk është arritur të miratohet edhe në këtë vit. Avokati i Popullit edhe gjatë vitit raportues ka pranuar ankesa lidhur me cenimin e privatësisë nga zhurma.

Duhet theksuar si shqetësuese mungesa e një hulumtimi shkencor, i cili do të ishte tregues i ndikimit të gjendjes së mjedisit në shëndetin e qytetarëve. Treguesi kryesor i cili do ta evidentonte ndikimin e faktorëve mjedisorë në shëndetin e qytetarëve, Sistemi i Informimit Shëndetësor (SISh), i cili do të nxirrte të dhëna lidhur me problemet shëndetësore, ende nuk është funksionalizuar.

Avokati i Popullit vlerëson se mediat si dhe OShC-ja duhet të fuqizojnë veprimet në drejtim të sensibilizimit të publikut për problemet mjedisore, ndikimin në të drejtat e njeriut si dhe format e realizimit të drejtave mjedisore janë kurrikulat planprogramet arsimore.

Avokati i Popullit, bazuar në gjetjet e listuara më lart, në vazhdim do të intensifikojë aktivitetet në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm.

88 <https://www.koha.net/arberi/351838/gjykata-aprovon-kerkesen-e-prokurorit-urdheron-sekuestrimin-e-erkohshem-te-villave-ne-brezovice/>

89 AMMK, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2021: "Në vitin 2021 janë djegur 2653 ha pyje, janë pyllëzuar rreth 309 ha sipërfaqe me pyje."

90 Po aty, fq. 26.



# Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të torturës (më tej: MKP) i Avokatit të Popullit, në bazë të nenit 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, realizon vizita të rregullta në çdo kohë, pa kufizim dhe pa paralajmërim, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, në spitale psikiatrike, në azile, në pika kufitare, në ndalimin në qendrat e emigracionit dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe e vlerëson se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe të lirive të njeriut.<sup>91</sup>

MKP-ja këtë viti ka realizuar gjashtëdhjetë e dy (62) vizita. Prej tyre njëzetë (20) janë vizita të përgjithshme, nëntëmbëdhjetë (19) janë vizita ad-hoc, njëzet e një (21) janë vizita përcjellëse, një (1) vizitë tematike dhe një (1) vizitë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, në kuadër të monitorimit të operacioneve të kthimit me forcë nga Zvicra, në kuadër të bashkëpunimit me Komisionin Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës.

Gjatë këtij viti Avokati i Popullit ka pranuar dyqind e tridhjetë e katër (234) thirrje telefonike, si dhe në linjën pa pagesë nëntë (9) telefonata, nga personat e privuar nga liria. Ndërsa ka realizuar dyqind e dyzet e katër (244) intervista individuale, duke mos i llogaritur intervistat grupore. Kërkesat/ankesat e pranuar janë drejtuar menjëherë tek menaxhmenti i institucionit ku është realizuar inspektimi, në fund

të vizitës ose janë proceduar për hetim të mëtejme. Sipas pretendimeve nga ankesat e pranuar, nëntëdhjetë e gjashtë (96) ankesa janë regjistruar nën kategorinë “të drejtat e të akuzuarit”, ndërsa prej tyre njëzet e gjashtë (26) janë proceduar për hetime të mëtejme. Me kategorinë “ndalimi i torturës” janë regjistruar njëzet e një (21) ankesa, prej tyre pesëmbëdhjetë (15) janë hapur për hetim të mëtejme.

Edhe gjatë këtij viti, ankesat kryesisht kanë qenë të drejtuara kundër vendimeve gjyqësore, beneficioneve të ndryshme, lirimit me kusht, faljes së presidentit, trajtimit shëndetësor etj. Të gjitha kërkesat/ankesat janë trajtuar nga MKP-ja dhe janë siguruar informatat nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Drejtoria Shëndetësore e Burgjeve dhe nga Paneli për Lirim me Kusht, për çka edhe janë njoftuar palët.

Nga të dhënat e siguruar nga Paneli për Lirim me Kusht, gjatë këtij viti janë shqyrtuar shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë (795) kërkesa për lirim me kusht, nga të cilat, treqind e dymbëdhjetë (312) janë vendosur për lirim me kusht, katërqind e tridhjetë e dy (432) janë refuzuar, ndaj dyzet e shtatë (47) kërkesave ka pushur procedura e shqyrtimit për shkak të lirimit të parakohshëm të parashtruesve nga ana e gjykatave dhe katër (4) kërkesa janë hedhur poshtë.

91 Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 2.

Ashtu siç u tha më lart, gjatë këtij viti janë realizuar gjashtëdhjetë e dy (62) vizita, si dhe janë publikuar tetë (8) raporte me rekomandime dhe atë për: Qendrën Korrektuese në Dubravë; Qendrën Edukuese-Korrektuese për të Mitur (QEKM) dhe Qendrën Korrektuese për të Mitur (QKM) në Lipjan; Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan; Qendrën e Paraburgimit në Pejë; Qendrën e Mbjajtjes për të Huaj në Vranidoll; Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë; Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë dhe Raportin Ex-oficio nr.95/2022 për Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur dhe Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Përmes këtyre raporteve, MKP-ja u ka adresuar autoriteteve kompetente tridhjetë e tetë (38) rekomandime me qëllim të avancimit të të drejtave themelore të personave të privuar lirie.<sup>92</sup>

Autoritetet kompetente zbatuan tetë (8) rekomandime, pesë (5) prej tyre u zbatuan pjesërisht, ndërsa njëzet e pesë (25) janë në pritje për implementim. Avokati i Popullit do të ndjekë për së afërmi implementimin e tyre, por njëkohësisht do të ofrojë ndihmën e tij të pakushtëzuar që bashkërisht të punojnë për realizimin e tyre.

MKP-ja është anëtare në Rrjetin e Evropës Juglindore të Mekanizmave kundër Torturës, në këtë cilësi gjatë këtij viti ka marrë pjesë dy herë në takimet e përbashkëta të Rrjetit, të mbajtura në Vjenë (Austri), ku edhe ka prezantuar: “*Nevojat e veçanta të të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara fizike në vendet e ndalimit*” si dhe “*Akomodimi dhe trajtimi i fëmijëve dhe adoleshentëve me probleme të shëndetit mendor dhe aftësi të kufizuara mendore dhe fizike*” në Republikën e Kosovës.

## Monitorimi i qendrave të mbajtjes dhe i stacioneve policore

Në këtë vit janë vizituar disa stacione policore, si: Qendrën Rajonale të Mbjajtjes në Prishtinë; Stacionin Policor Veri dhe Jug në Prishtinë; Stacionin Policor në Fushë Kosovë; Stacionin Policor në Mitrovicë – Jug; stacionet policore në Gjilan, në Prizren, në Drenas, në Han të Elezit si dhe Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Kufirit-Vija e Gjellbër. Këto vizita janë realizuar me qëllim të vlerësimit të përgjithshëm të respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjatë vizitave, në qendrat e mbajtjes në Policinë e Kosovës nuk kemi marrë ankesa nga personat e arrestuar të cilët ishin në mbajtje në kohën e vizitës, për keqtrajtim fizik apo për mosrespektim të të drejtave themelore të garantuara me akte ligjore vendore dhe ndërkombëtare.

Në këtë vit rëndësi të veçantë u është kushtuar të miturve të arrestuar dhe nga vizitat e realizuara nuk kemi hasur në të mitur të arrestuar. Mirëpo, për të kuptuar më shumë lidhur me trajtimin e të miturve nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe për respektimin e të drejtave të tyre themelore, që nga momenti i arrestimit, kemi vizituar Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, ku janë intervistuar të paraburgosurit e akomoduar në këtë qendër. Të gjithë të paraburgosurit e mitur të intervistuar kanë pohuar se janë trajtuar në mënyrë korrekte dhe profesionale nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe se janë respektuar të drejtat e tyre

92 <https://oik-rks.org/mekanizmi-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-mkpt/raporte-mkpt/>



themelore.<sup>93</sup> Po ashtu, të miturit e intervistuar kanë pohuar se nuk janë mbajtur në Ndalim Policor më shume se 24 orë.

Avokati i Popullit, në vitin 2022, ka pranuar 6 ankesa kundër Policisë së Kosovës, bazuar në pretendimet e qytetarëve se janë keqtrajtuar fizikisht. Prej këtyre 6 ankesave, 3 janë hapur për hetim, ndërsa 3 ankesa janë shpallur të papranueshme. Lidhur me rastet ndaj zyrtarëve policorë, kemi monitoruar procedurën e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK). Sipas IPK-së, rastet janë referuar tek Drejtoria për Hetim të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës në Policinë e Kosovës për trajtim disiplinor, pasi hetimet nuk kanë rezultuar me elemente të veprës penale.

Për sa u përket kushteve të stacioneve policore, është konstatuar se kushtet në përgjithësi janë në gjendje të pranueshme për sa i përket hapësirës, ndriçimit natyral, artificial dhe higjienës dhe i plotësojnë kushtet e domosdoshme për akomodim të personave të ndaluar.

Megjithatë, për Qendrën Rajonale të Mbjtjes në Prishtinë (ashtu si në vizitat paraprake të realizuara në këtë qendër), kemi konstatuar se kushtet e punës për zyrtarët policorë nuk janë të mira, pasi ndërtesa është shumë vjetër dhe ka mungesë të dritës natyrale, ndërsa gjatë dimrit është shumë ftohtë dhe ka lagështi. Në këtë qendër edhe kushtet e të ndaluarve nuk janë në harmoni me aktet ligjore dhe as me standardet ndërkombëtare.

Gjithashtu Stacioni Policor “VERI” në Prishtinë vazhdon punën në kontejnerë me kushte minimale për punë.

Stacioni Policor në Fushë Kosovë përballet me kushte të rënda infrastrukurore dhe me kushte minimale për punë për zyrtarët policorë.

Sipas të dhënave nga Policia e Kosovës, ka përfunduar renovimi dhe janë funksionalizuar qendrat e mbajtjes në këto objekte policore: në Deçan, në Gjakovë, në Rahovec, në Lipjan, në Drenas, në Gjilan, në Pejë, në Mitrovicë të Jugut dhe në Mitrovicë të Veriut.

Për sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë lidhur me trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës, të arrestuarit kanë të drejtë të parashtrorjnë ankesë në stacionin policor ku mbahen, si dhe në IPK. Përveç kësaj, të arrestuarit mund t'i drejtojnë ankesë edhe Avokatit të Popullit. Për t'u ofruar qasje më të lehtë në shërbimet e këtij institucioni dhe për t'ua mundësuar të arrestuarve dhe të ndaluarve parashtrimin e ankesës në mënyrë konfidenciale, Avokati i Popullit ka vendosur kuti të ankesave në ato stacione policore ku ka qendra të mbajtjes.

## Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e torturës (MKP) realizon vizita në vendet ku mbahen persona të privuar nga liria, me qëllim të vlerësimit të përgjithshme të trajtimit të personave të privuar nga liria, duke përfshirë shërbimet e ofruara, regjimet, kategorizimin, trajtimin shëndetësor, konfliktet ndërmjet të burgosurve, rastet eventuale të keqtrajtimit, si dhe aspektet e tjera të përgjithshme të trajtimit.

Trajtimi – në këtë vit, gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimi, nuk kemi marrë ankesa për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Është konstatuar se ka komunikim të mirë ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues. Shqetësuese mbetet trajtimi i personave me probleme të shëndetit mendor, i personave të

93 <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-edukuese-korrektuese-per-te-mitur-dhe-ne-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>

moshuar, i personave me probleme shëndetësore kronike, me nevoja të veçanta, varësisë etj. Sipas informatave zyrtare, në këtë viti, në qendrat korrektuese dhe në ato të paraburgimit janë trajtuar 218 raste me çrregullime mendore dhe të personalitetit si dhe me terapi psikiatrike, me sëmundje kronike janë trajtuar 226 persona, 50 persona kanë qenë mbi moshën 65-vjeç, e 4 persona me nevoja të veçanta etj.

Regjimi - me qëllim të socializmit dhe rehabilitimit të të dënuarve parashihet implementimi i katër llojeve të tretmanëve: tretmani i pranimit, tretmani themelore, standard dhe i avancuar.<sup>94</sup>

Në Qendrën Korrektuese në Dubravë funksionojnë tri punëtori, të cilat në fakt janë edhe qendra për trajnime profesionale, ku organizohen trajnime për saldim, për ndërtimtari, për axhustator, për zdrukthëtari, për mirëmbajtje teknike, për instalim të ujit dhe për instalim të rrymës. Po ashtu, në kuadër të Qendrës Korrektuese në Dubravë funksionon edhe shkolla e mesme, në të cilën mësimin e vijnë 37 të burgosur. Mirëpo, gjatë vizitës në këtë qendër, të dënuarit na kanë informuar se disa të dënuar nuk dinë shkrim-lexim. Një fakt të tillë e ka pohuar edhe udhëheqësi për programe dhe arsim. Lidhur me këtë i kemi rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë: *“Të organizohen kurse të veçanta për të burgosurit që nuk dinë shkrim-lexim.”*<sup>95</sup> Në Burgun e Sigurisë së Lartë shumica e të burgosurve janë të angazhuar në punë të ndryshme, siç janë: mirëmbajtja, pastrimi i pavijoneve, puna në kuzhinë, në punëtorinë për prodhim të letrës higjienike dhe të qeseve, nga ku furnizohen edhe institucionet e tjera të ShKK-së. Në Qendrën Korrektuese për Femra, të dënuarat, shumica prej tyre, janë të angazhuara në punë: në furrë, në kuzhinë, në rrobaqepësi dhe në pastrim,

ndërsa gjatë stinës së verës angazhohen në kopshte dhe në serrën e qendrës. Kurse të paraburgosurat janë shumë pak të angazhuara në punë dhe në aktivitete të tjera, pasi angazhimi i tyre është subjekt i lejes së gjykatës kompetente. Mirëpo, të dënuarat kanë pasur ankesa, sidomos nga ato me burgim afatgjatë, të cilat pohuan se numri i aktiviteteve dhe i angazhimeve në Qendrën Korrektuese për Femra nuk është i mjaftueshëm. Avokati i Popullit i ka potencuar ankesat e njëjta edhe në Raportin me rekomandime për Qendrën Korrektuese për Femra dhe për Qendrën Korrektuese për të Mitur<sup>96</sup>, i cili ishte publikuar më 23 dhjetor 2021, ku ishte rekomanduar: *“Të shtohen aktivitetet jashtë qelisë për të burgosurat (përshirë të paraburgosurat), kur një gjë e tillë është e mundur. Vëmendje e veçantë duhet t’u kushtohet të burgosurve të dënuar me dënime afatgjata.”* Andaj në raportin e publikuar më 25 nëntor 2022, janë ripërsëritur këto rekomandime për Ministrinë e Drejtësisë.<sup>97</sup>

## Regjimi për të paraburgosurit

Gjatë vizitave të këtij viti kemi konstatuar një regjim të varfër për të paraburgosurit shumica e të paraburgosurve, shumicën e kohës e kalojnë të mbyllur në qelitë e tyre, për shkak të infrastrukturës (Qendra e Paraburgimit në Prizren dhe ajo në Pejë dhe pjesërisht ajo në Mitrovicë) dhe për shkak se angazhimi i tyre në aktivitetet jashtë qelisë është subjekt i lejes së gjykatës kompetente.

Vlen të theksohet se një ndër aspektet më të rëndësishme që ndikon në rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve është mundësia që të angazhohen në punë, e që do të ndihmonte shumë edhe në jetën pas vuajtjes së dënimit. Andaj,

94 Rregullorja e brendshme për tretmanë neni 10, Llojet e Tretmanëve. <https://shkk.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Rregullorja%20e%20brendshme%20per%20tretman.pdf>

95 <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

96 <https://oik-rks.org/2021/12/24/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-per-femra-dhe-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>

97 <https://oik-rks.org/2022/11/25/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-per-femra-ne-lipjan/>

Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues duhet ta trajtojë me seriozitet themelimin e Njesisë Ekonomike.

## Kujdesi shëndetësor në qendrat korrektuese dhe në qendra të paraburgimit

Hapësirat në të cilat ofrohen shërbimet mjekësore në qendra korrektuese dhe në të paraburgimit, në përgjithësi janë në nivel të kënaqshëm, përpos në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, në atë në Prizren dhe në Mitrovicë. Këto 3 qendra nuk janë adekuate dhe nuk mbrojnë konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore.

Kontrollet mjekësore për të sapo pranuarit, sipas Praktikave Standarde e Veprimit<sup>98</sup> të Drejtorisë Shëndetësore të Burgjeve (DShB) dhe të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale<sup>99</sup> përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshtrohet kontrollimit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit. Gjatë vizitave të realizuara, shikimit të dosjeve mjekësore, si dhe në raportet e dërguara nga DShB-ja, është vërejtur se të gjithë të burgosurve të sapopranuar u bëhen kontrollet mjekësore brenda 24 orëve nga momenti i pranimit. Lidhur me këtë, këtë vit nuk kemi marrë ankesa nga të dënuarit dhe të paraburgosurit e pranuar. Këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në rastet kur prania e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor. Për sa i përket trajtimit mjekësor, kemi pranuar ankesa nga të burgosurit gjatë vizitave, nga telefonatat e pranuar, nga familjarët, punëtori social, kutitë e ankesave etj.

Disa nga këto ankesa janë regjistruar për hetim të mëtejshëm dhe janë duke u proceduar. Për të gjitha këto raste janë siguruar informatat nga shikimi i dosjeve në terren si dhe nga informatat shtesë të siguruar nga DShB-ja.

Prania e të burgosurve me probleme mendore në qendrat korrektuese dhe në qendra të paraburgimit vazhdon të mbetet një ndër sfidat më të mëdha për Shërbimin Korrektues. Zgjidhja provohet të jetë hapja e Pavijonit D në Qendrën Korrektuese në Dubravë, projekt i cili është në fazën finale dhe pritet të fillojë punën në vitin tjetër.

MKP-ja do të vazhdojë me vizita të rregullta gjatë vitit 2023, ku do të përcjellë për së afërmi veprimet e autoriteteve dhe implementimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me trajtimin e personave me probleme mendore.

## Kushtet e akomodimit në qendrat korrektuese dhe në qendra të paraburgimit

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese në Dubravë,<sup>100</sup> është konstatuar se kushtet e akomodimit në përgjithësi mund të konsiderohen se janë në pajtim me LESP-në dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

Të burgosurit janë ankuar se mungonte uji i ngrohtë si dhe shtypja e ujit gjatë verës është e vogël (pavijonet 1, 3, 4 dhe 5). Sipas tyre, uji i ngrohtë nuk është i mjaftueshëm për pastrim dhe për mirëmbajtje të higjienës. Si pasojë e kësaj, gjatë vizitave është vërejtur se të burgosurit përdornin pajisje elektrike të improvizuara për ngrohje të ujit, të cilat mund t'i rrezikonin seriozisht jetët e tyre. Lidhur me këtë,

98 Praktika Standarde e Veprimit, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

99 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867bn>

100 <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

menjëherë kemi shprehur shqetësimin tek zyrtarët kompetentë, të cilët e njoftuan ekipin monitorues se janë duke bërë përpjekje të vazhdueshme që këto pajisjes të mos lejohen.

Për sa u përket kushteve të akomodimit në Spitalin e Qendrës Korrektuese në Dubravë, kemi konstatuar se objekti në përgjithësi nuk i plotëson kushtet as për të hospitalizuarit dhe as për stafin shëndetësor edhe përkundër renovimeve që janë bërë. Po ashtu duhet cekur se spitali në këtë qendër ka dy kate dhe posedon vetëm shkallë dhe kjo paraqet vështirësi për mungesë të qasjes për pacientët e sidomos për personat me aftësi të kufizuar.

Avokati i Popullit, në raportin me rekomandim për Qendrën Korrektuese në Dubravë, i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë: *“Të krijohen kushte adekuate për të hospitalizuarit në spitalin e burgut.”*<sup>101</sup>

Në vizitën e realizuar në Qendrën Korrektuese për Femra,<sup>102</sup> kemi konstatuar se qelitë ku akomodohen të burgosurat kanë ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, si dhe nuk kanë lagështi. Për sa i përket hapësirës për banim për të burgosurat, hapësira në dispozicion është në pajtim me dispozitat e LESP-së dhe me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT).<sup>103</sup> Po ashtu nuk ka mbipopullim dhe shumica e të burgosurave qenë të vendosura vetëm në dhoma, sipas kërkesave të tyre.

Të burgosurat u ankuan se dushet dhe makineritë në lavanderi, si pasojë e gjendjes teknike, nuk janë funksionale.

Avokati i Popullit, në raportin me rekomandime drejtuar Ministrisë së Drejtësisë,<sup>104</sup> ka ripërsëritur rekomandimet që të bëhen rregullimet teknike të dusheve dhe të makinerive në lavanderi.

MKP-ja gjatë këtij viti i kushtojë rendësi të veçantë funksionimit të Shtëpisë së Nënave në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan.<sup>105</sup>

Shtëpia e Nënave nuk i plotëson kushtet elementare për akomodim në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe as me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurave me fëmijë. Për arsye të dëmtimit të objektit për shkak të vjetërsisë dhe mungesës së renovimit, gjendja në këtë objekt është tejet e rëndë.

Në raportin për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë<sup>106</sup> kemi konstatuar se kushtet e akomodimit në këtë qendër, në kuptim të ndriçimit dhe ventilimit, nuk janë në pajtim me LESP-në<sup>107</sup> dhe as me standardet e përcaktuara nga KPT-ja. Në vizitën e realizuar në këtë qendër kemi marrë ankesa të shumta nga të paraburgosurit dhe nga të dënuarit, lidhur me kushtet e akomodimit, në të cilat pohojnë se në dhomat ku janë të akomoduar ka shumë lagështi.

Përmes raportit, pas vizitës në këtë qendër, kemi ripërsëritur rekomandimin që të investohet në

101 <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

102 <https://oik-rks.org/2022/11/25/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-per-femra-ne-lipjan/>

103 Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449/>

104 <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/Raport-i-AP-MKPT-lidhur-me-viziten-ne-Qendren-Korrektuese-per-Femra-ne-Lipjan-1-1.pdf>

105 <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/Raport-i-AP-MKPT-lidhur-me-viziten-ne-Qendren-Korrektuese-per-Femra-ne-Lipjan-1-1.pdf>

106 <https://oik-rks.org/2022/11/17/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-peje/>

107 Ligji nr.08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 35, paragrafi 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

kushtet e akomodimit që të jenë në pajtim me standardet e përcaktuara në LESP; me standardet e KPT-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.<sup>108</sup>

Gjatë vizitës në Burgun e Sigurisë së Lartë, kemi konstatuar se në përgjithësi kushtet e akomodimit janë në nivel të kënaqshëm në kuptim të hapësirës, pastërtisë, si dhe qasjes në dritë natyrale dhe artificiale.

Për sa u përket kushteve të akomodimit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, theksojmë se qelitë ku akomodohen të burgosurit kanë dritë të mjaftueshme natyrore, hapësirë banimi, e cila shkon përtej standardit të përcaktuar me LESP-në dhe me standardet e përcaktuara nga KPT-ja. Po ashtu, MKP-ja vërejtë se ka qeli adekuate në dispozicion të të burgosurve me aftësi të kufizuara.

Lidhur me Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë dhe Qendrën e Paraburgimit në Prizren, kushtet e akomodimit në përgjithësi ishin të pranueshme, përveç në raste të caktuara, në kuptim të hapësirës për banim për një të burgosur, ku kushtet e akomodimit nuk janë në pajtim me LESP-në, as me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe as me standardet e KPT-së.

Ndërsa gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, edhe në këtë vit është vërejtur se qelitë ku akomodohen të burgosurit janë në pajtim me LESP-në dhe me standardet e KPT-së, kanë ndriçim të mjaftueshëm, nuk kanë lagështi dhe po ashtu kanë ngrohje adekuate dhe pastërti.

Në Raportin për Qendrën e Edukuese për të Mitur në Lipjan, MKP-ja ka vërejtur se kushtet ku

mbaheshin djem të miturit ishin shumë të mira, dhomat ishin të pastra dhe të ndriçuara, shtretërit e të miturve kishin çarçafë, batanije, përveç dyshekëve të cilët ishin të vjetruar dhe jocolësorë. Dhomat ku qëndronin të miturit ishin të mëdha dhe kishin ndriçim të mjaftueshëm, posedonin TV, dollapë personalë. Secila dhomë kishte tualete të cilat ishin në gjendje të rregullt, të përshtatshme dhe kishin ujë të ngrohtë pandërprerë. Po ashtu, dhomat dhe tualetet, të cilat ishin të dedikuara për personat me nevoja të veçanta, i plotësonin kushtet për këtë kategori. Kjo qendër i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të të miturve.<sup>109</sup>

Ndërsa për sa u përket kushteve të akomodimit, në Raportin për Qendrën Korrektuese për të Mitur<sup>110</sup> është konstatuar se në dhoma kishte dritë të mjaftueshme natyrale dhe artificiale, në përgjithësi kjo qendër plotëson kushtet adekuate për akomodimin e të miturve të burgosur.

## Personeli i qendrave korrektuese dhe i qendrave të paraburgimit

Në vitin raportues, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa të shumta nga personeli korrektues lidhur me kushtet e punës si dhe me numrin e vogël të zyrtarëve korrektues në raport me të burgosurit. Një nga ankesat e shumta është edhe mosfurnizimi me uniforma dhe me pajisje të tjera të domosdoshme për ta kryer punën e tyre.

Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë rritjen e numrit të punëtorëve socialë dhe të zyrtarëve ligjorë sipas vlerësimit dhe nevojës, situatë që vazhdon të mbetet e njëjtë.

108 <https://oik-rks.org/2022/11/17/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-peje/>

109 <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-edukuese-korrektuese-per-te-mitur-dhe-ne-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>

110 <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-edukuese-korrektuese-per-te-mitur-dhe-ne-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>

## Institucionet e shëndetit mendor dhe ato të kujdesit social

MKP-ja ka vizituar Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (tani e tutje: IPFK), Repartin e Urgjencës dhe të Kujdesit Intensiv Psikiatrik të Klinikës Psikiatrike (tani e tutje: UKIP), Qendrën për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP), Shtëpinë Integruese në Bashkësi në Bresje dhe Ferizaj, Institutin Special në Shtime, Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime, Shtëpitë me Bazë në Komunitet: në Shtime, në Ferizaj dhe në Prizren.

Gjatë vizitave në institucionet e shëndetit mendor nuk kemi marrë ankesa për keqtrajtim të pacientëve nga personeli i institucioneve në fjalë.

Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës ka kapacitet prej 36 shtretërish, nga 12 shtretër në secilin repart. Gjatë vizitës (shtator 2022), në secilin repart kapaciteti ishte i plotësuar, ndërsa në listë të pritjes për këto reparte janë edhe disa raste të tjera.

Trajtimi dhe aktivitetet - nuk ka pasur ankesa për keqtrajtim fizik, gjithashtu nuk janë vërejtur as shenja të dhunës fizike tek pacientët. Ekipi intervistoi pacientët e pranishëm, të cilët pohuan për një trajtim të duhur nga stafi mjekësor. Në IPFK, përveç vlerësimit, trajtimit me medikamente, ofrohen edhe aktivitete psiko-sociale. Trajtimi psiko-social konsiston në aktivitete, si: lojëra, shikim televizori, vizatime, daljet ditore brenda institucionit (në shëtitore të IPFK-së), seanca individuale dhe grupe me psikologun etj.

Kushtet e akomodimit - inventari është demoluar, sidomos në pjesën e qëndrimit ditor, dy dhomat e izolimit, për shkak të kushteve jo të mira, janë jashtë funksionit, kamerat nuk punojnë, xhami i derës së dhomës ishte i thyer. Kushtet higjienike

janë në rregull, pacientët kanë qasje në dritë natyrale, ventilim si dhe privatësia në duze dhe në tualete ishte në nivelin e duhur. Qendra nuk ka një repart të veçantë për pacientet femra dhe për të mitur dhe kur ka raste të gjinisë femërore, pacientët e gjinisë mashkullore dhe femërore rrinë në hapësira të përbashkëta.

Kontakti me botën e jashtme - vizitat familjare realizohen dy herë në javë nga 30 minuta. Përpos vizitave, pacientët kanë të drejtë edhe për telefonata. Qendra praktikon edhe vikendet terapeutike, gjë e cila deri më tani është treguar e suksesshme.

Parandalimi i vetëvrasjeve - viteve të fundit nuk kanë pasur raste të vdekjeve apo vetëvrasjeve në IPFK. Gjatë vizitës së fundit u konstatua se është zbatuar rekomandimi për sa u përket protokolleve. IPFK-ja së fundmi kishte përpiluar: Protokollin e vlerësimit dhe trajtimit të pacientëve që shfaqin rrezik potencial për vetëvrasje; Protokollin e parandalimit dhe menaxhimit të sjelljes së çrregulluar/violente dhe Protokollin e vlerësimit dhe trajtimit të pacientëve që shfaqin sjellje vetëlënduese.

Mjetet e kufizimit - gjatë vizitës kemi konstatuar se nuk përdoret kufizim mekanik, në repart është një këmishë për fiksime mekanik, por nuk ishte përdorur asnjëherë, dhoma e izolimit është mjete kryesor dhe i vetmi mjet i kufizimit.

Rishikimi i vendimeve nga gjykatat kompetente - për sa u përket vendimeve të gjykatës, sikurse edhe në vitet e kaluara, edhe gjatë vitit 2022 është konstatuar se po vazhdon problemi i mosndryshimit të masës nga gjykatat kompetente, pavarësisht arritjes së objektivave për trajtim të atyre rasteve. Sipas drejtorit të IPFK-së, ata kanë bërë kërkesë për disa persona që t'u ndërrohet masa, por nuk kanë marrë përgjigje nga gjykatat.



## Klinika e Psikiatrisë në Prishtinë - Reparti i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik

Klinika Psikiatrike është njësi organizative e ShSKUK-së, e cila, sipas ligjit në fuqi, ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (e vetmja klinikë në Kosovë), por është e detyruar të ofrojë edhe shërbime të nivelit sekondar për regjionin e Prishtinës, në mungesë të një spitali të përgjithshëm.

Reparti i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP) - është njësi e mbyllur dhe funksionon në kuadër të Klinikës Psikiatrike. Në këtë repart trajtohen rastet e çrregullimeve të ndryshme psikotike, të çrregullimeve bipolare dhe të çrregullimeve të personalitetit që nuk mund të trajtohen në repartet e tjera të hapura. Ky repart është i vetmi në tërë territorin e Kosovës. MKP-ja u njoftua se pacientët në përgjithësi sillen në repartin UKIP nga familjarët ose nga policia dhe janë pacientë të cilët akomodohen pa vullnetin e tyre.

Avokati i Popullit ndër vite e ka përmendur në raportet me rekomandime<sup>111</sup> mungesën e akteve nënligjore të Ligjit për Shëndetin Mendor dhe të cilat janë paraparë që të miratohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria e Kosovës. Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që të nxirren aktet nënligjore të Ligjit për Shëndet Mendor, në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm dhe funksional.

Trajtimi dhe aktivitetet në repartin UKIP – gjatë vizitës (gusht 2022), MKP-ja kontrolloi regjistrin e pranimit të rasteve në UKIP dhe nuk ka vërejtur mbipopullim asnjëherë në këtë repart, më së shumti ishin prezentë 10-12 pacientë. Gjatë kohë së vizitës ishin prezentë katër pacientë, të cilët u intervistuan

dhe nuk kishin asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për sjellje jo të mirë të personelit.

Gjatë vizitave në këtë repart është konstatuar se trajtimi kryesor është me medikamente, ndërsa aktivitetet psiko-sociale nuk ishin të mjaftueshme.

Mungon ekipi shumëdisiplinor, si: psikologu, punëtori social, terapisti okupacional dhe mungon plani individual i trajtimit.

Edhe në këtë vit është konstatuar se nuk ka evidenca që vërtetojnë se pacientëve u është ofruar shpjegim me shkrim për arsyet e trajtimit të pavullnetshëm, ashtu siç parashihet në nenin 21, paragrafi 1.4, të Ligjit për Shëndetin Mendor, i cili shprehimisht përcakton se pacientit të trajtuar pa vullnetin e tij/saj, ndër të tjera, duhet t'i shpjegohen me shkrim, brenda 48 orësh, arsyet e trajtimit të pavullnetshëm.

Mjetet e Kufizimit në UKIP - nuk përdoret kufizimi mekanik, por vetëm masa e izolimit dhe kufizimi kimik. Gjatë vizitës, MKP-ja ka vërejtur se dosjet e pacientëve përmbanin vlerësimin e tre mjekëve, anamnezën, historinë e sëmundjes, formularin për vendosjen në dhoma të izolimit, kërkesën për pranim në spital, por nuk ka pëlqim për trajtim dhe nuk ka miratim të informuar. Vazhdon të mos ketë regjistër të veçantë për personat të cilët vendosen në izolim, edhe pse është rekomandimi Avokatit të Popullit me raportin me rekomandime, i publikuar më 26 tetor 2018.<sup>112</sup>

## Qendrat e shëndetit mendor dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi

Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, në nenin 10 i përcakton shërbime kujdesi për shëndetin mendor, kujdesi shëndetësor parësor, dytësor

111 <https://oik-rks.org/2018/10/26/-1raport-me-rekomandime-i-mkpt-lidhur-me-viziten-ne-shtime/>.

112 <https://www.oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-kliniken-psikiatrike-ne-qkuk/>.

dhe tretësor. Në shërbimet e shëndetit mendor të nivelit dytësor (pjesë e ShSKUK-së) bëjnë pjesë: departamentet e psikiatrisë në kuadër të spitaleve të përgjithshme; Qendrat e Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi; Qendra për Integrimin, Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (në tekstin e mëtejme QIRSKP).

Shërbimi komunitar dhe rezidencial ofrohet përmes shërbimit profesional të shëndetit mendor dhe gjithsej janë nëntë (9) Qendra të Shëndetit Mendor [QShM], me nëntë [9] Shtëpi për Integrim në Bashkësi [ShB], që ofrojnë shërbime të shëndetit mendor në të gjitha regjionet e Kosovës. Gjatë vitit 2022, MKP-ja ka vizituar Qendrën e Shëndetit Mendor në Prishtinë dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi në Bresje dhe në Ferizaj. Shtëpitë Integruese në Bashkësi në Bresje dhe Ferizaj i plotësojnë të gjitha kushtet e nevojshme për jetesë. MKP-ja ka intervistuar rezidentët pa prezencën e stafit të shtëpive dhe nuk ka marrë ankesa për keqtrajtim fizik. Ekipi ka vërejtur një atmosferë relaksuese mes rezidentëve dhe stafit shëndetësor.

### **Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP)**

QIRSKP-ja funksionon në kuadër të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) dhe ofron shërbime 24 orë në ditë. QIRSKP-ja është institucion i tipit të hapur, rezidentët në këtë qendër janë kryesisht të diagnostikuar me çrregullime psikotike, si schizofrenia. Kapaciteti zyrtar për akomodim në këtë institucion është 60 rezidentë dhe gjatë kohës së vizitës nuk u vërejt mbipopullim, gjithsej ishin prezentë 60 rezidentë.

Stafi i kësaj qendre ofron bashkëpunim të plotë dhe qasje të papenguar në çdo hapësirë që mundëson realizimin e intervistave me rezidentë pa prezencë të stafit shëndetësor. Rezidentët trajtohen në

mënyrë humane, ka komunikim dhe klimë pozitive ndërmjet rezidentëve dhe personelit. Në përgjithësi, kushtet e akomodimit në këtë institucion janë të një standardi të lartë.

Si sfidë e kësaj qendre mbetet referimi i rasteve për trajtim të detyrueshëm psikiatrik nga gjykata si dhe heqja e zotësisë së veprimit të përhershëm të disa pacientëve, një nga çështjet që Avokati i Popullit do trajtojë me kujdes gjatë vitit në vazhdim.

## **Institucionet e kujdesit social**

### **Instituti Special në Shtime (ISSh), Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime, Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK)**

Trajtimi për personat me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor ofrohet gjatë 24 orëve në Institutin Special në Shtime dhe në nëntë [9] Shtëpi me Bazë në Komunitet.

Instituti Special në Shtime dhe Shtëpia e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta në Shtime deri në fund të vitit 2022 janë menaxhuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejme MFPT), ndërsa pritet që nga janari 2023 këto institucione të kalojnë nën menaxhim të Ministrisë së Shëndetësisë. Ndërsa Shtëpitë me Bazë në Komunitet, nga janari i vitit 2016, menaxhohen nga drejtoritë komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

Kushtet e banimit - në Institutin Special në Shtime, në përgjithësi kushtet janë shumë të mira, hapësirat e banimit kanë ndriçim natyral të mjaftueshëm, ngrohje, ajrim si dhe pastërtia është në nivel të kënaqshëm. Dhomat ku akomodoheshin rezidentët, kryesisht janë me nga 2 deri 3 shtretër në një dhomë, ka komodina për vendosjen e rrobave dhe gjërave personale, gjithashtu ka edhe stolisje për stimulim pamor, p.sh. piktura të ndryshme, të cilat



janë punuar nga disa rezidentë në bashkëpunim me instruktorët. Gjatë vizitës në ISSh, ekipi i MKP-së ka vizituar edhe kuzhinën, ku përgatitet dhe shërbehet ushqimi. Kuzhina kishte ndriçim dhe ventilim të duhur, pastërtia ishte në nivel, si dhe ushqimi ishte adekuat.

Trajtimi, stafi dhe aktivitetet në ISSh - kanë qasje të afërt me rezidentët. Rezidentët dukeshin mirë për nga veshja dhe higjiena, raporti me stafin ishte miqësor. MKP-ja nuk ka hasur në rezidentë me shenja të lëndimeve.

Për sa u përket mjeteve të kufizimit - sipas stafit, qendra nuk ka dhoma të izolimit dhe nuk përdoren forma të kufizimit fizik.

### **Vizita në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime**

Në këtë qendër janë të vendosur 10 persona (aq sa është kapaciteti), të moshave të ndryshme, ku vetëm një rezidente është nën moshën 18 vjeçe, të tjerët e kanë arritur moshën madhore. Andaj, Avokati i Popullit u ka rekomanduar autoriteteve që të gjendet një zgjidhje për personat që vazhdojnë të qëndrojnë në shtëpi e që kanë arritur moshën madhore ashtu që të lirohen hapësirat për fëmijët në nevojë. Stafi i qendrës ka një qasje të afërt miqësore me rezidentët, ndërsa kushte e akomodimit në përgjithësi janë të mira, dhomat e rezidentëve kanë hapësirë të mjaftueshme.

Shërbimi shëndetësor dhe psikiatrik është i përbashkët me Institutin Special në Shtime. Psikiatri i viziton një herë në javë, rastet ndonjëherë dërgohen edhe në ambulancën e Institutit Special në Shtime. Në rast nevojë, shërbimet e tjera shëndetësore dhe specialistike u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Shtime dhe Qendra Klinike Universitare në Prishtinë. Analizat laboratorike u bëhen në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Shtime çdo 6 muaj, në mënyrë të rregullt, të cilat edhe MKP-ja i ka verifikuar gjatë

vizitës së fundit. Në Shtëpinë e Fëmijëve nuk ka dhoma të izolimit dhe nuk përdoren forma të kufizimit mekanik.

### **Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK)**

Gjithsej janë 10 shtëpi me bazë në komunitet, në komunat si në vijim: Kamenicë, Deçan, Ferizaj, Vushtrri, Lipjan, Graçanicë, Shtime dhe Prizren si dhe Shtëpia e Fëmijëve në Shtime. Secila Shtëpi ka kapacitet për 10 rezidentë, përveç ShBK-së në Shtime me kapacitet 12 shtretër.

Gjatë vitit 2022, MKP-ja ka vizituar Shtëpitë me Bazë në Komunitet në Shtime, në Ferizaj dhe në Prizren, të cilat në përgjithësi i plotësojnë kushtet e nevojshme për jetesë, përveç në Prizren, ku janë evidentuar mangësi në funksionimin e kësaj qendre, si: mungesa e ngrohjes dhe e kushteve të tjera.

Shërbimet shëndetësore realizohen në qendrat e mjekësisë familjare, në Qendrat e Shëndetit Mendor të komunave përkatëse dhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Këto qendra nuk kanë dhoma të izolimit dhe nuk përdoren forma të kufizimit fizik.

# Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve joshumicë

Gjatë vitit 2022 IAP-ja ka pranuar 144 ankesa nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, prej të cilave 80 ankesa janë shpallur të pranueshme. Ankesat e pranuar kanë të bëjnë me integrimin e të kthyerve, të drejtat pronësore, arsimin, me moszbatimin e plotë të rregulloreve për përdorimin e gjuhëve, si dhe probleme që lidhen me marrjen e dokumentacionit personal për personat që kanë jetuar në Kosovë deri në vitin 1999, për bashkëshortët dhe fëmijët e tyre.

## Kthimi dhe siguria

Bazuar në të dhënat e Komisionarit të Lartë për Refugjatë (UNHCR), gjatë vitit 2022 në Kosovë janë kthyer vetëm 204 persona nga komunitetet joshumicë.<sup>113</sup> Shumica e qendrave kolektive deri në vitin 2021 janë mbyllur, kështu që ka mbetur që të sigurohet strehimi edhe për 139 persona të tjerë, të cilët ende jetojnë në banesa kolektive në veri të Kosovës.<sup>114</sup> Në bazë të informatave, të cilat IAP-ja i ka marrë nga organizatat e shoqërisë civile që merren me çështjet e personave të zhvendosur dhe strehimin e tyre në partneritetet me UNHCR-në,<sup>115</sup> ishte planifikuar që gjatë vitit 2022, qendrat e mbetura kolektive të mbyllen dhe për personat e zhvendosur të bëhet strehimi i përhershëm në bazë të planit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim

(MKK) dhe komunave në veri të Kosovës, por deri në fund të vitit 2022 kjo nuk u realizua.

Sfidat me të cilat përballen personat e zhvendosur dhe të kthyerit janë: uzurpimi i pronës dhe privimin nga e drejta e posedimit; moszbatimi i vendimeve gjyqësore, që më së shpeshti kanë të bëjnë me pronat e paluajtshme; mungesën e qasjes në institucionet arsimore; gjendjen ekonomike; papunësinë; problemet infrastrukturore; gjendja e keqe sociale; kthimi i qëndrueshëm; problemet me zbatimin e të drejtave gjuhësore etj.

Në këtë vit është vërejtur një angazhim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), e cila edhe në këtë vit ka ndihmuar dhe ka ofruar përkrahje për të gjithë të kthyerit në Kosovë, janë realizuar 106 projekte për komunitete, nga të cilat 79 janë individuale dhe 23 për komunitete dhe 4 për shoqata/kooperativa (39 prodhuese, 45 të shërbimeve dhe 22 bujqësore - përpunuese). Përveç asaj që u tha më sipër, janë realizuar 11 projekte në fushën e arsimit, kulturës, sportit, shëndetësisë, manifestimeve fetare, si dhe ndihmës për komunitetet e cënueshme në formë të mobilimit. Gjatë vitit 2022, për të siguruar kthim të qëndrueshëm, MKK-ja ka ndërtuar 19 shtëpi dhe është ofruar ndihmë për 11 familje nga komunitete të ndryshme në komunat: Pejë, Klinë, Istog, Obiliq,

113 Sipas të dhënave statistikore të UNHCR-së, nga janari deri në dhjetor të vitit 2022, janë kthyer 155 serbë, 25 ashkalinj dhe egjiptianë, 1 boshnjak dhe 17 romë.

114 Sipas të dhënave statistikore të UNHCR-së, deri në fund të dhjetorit 2022, në qendrat kolektive në veri të Kosovës ende jetojnë 139 persona: në Mitrovicën veriore 21, Leposaviq 71, Zubin Potok 20 dhe Zveçan 27.

115 OJQ „FDMC“ nga Graçanica.

Fushë Kosovë, Graçanicë, Novobërdë, Shtërpcë, Prizren dhe Gjakovë. Përveç asaj që u tha më sipër, në kuadër të projektit të BE-së dhe MKK-së, të quajtur RRRK, në fazën e pestë për shfrytëzuesit janë ndërtuar 35 shtëpi, të cilat janë të pajisura me mobilie dhe pajisje elektrike. MKK-ja raportoi se është në fazën e përgatitjes së një Strategjie të re për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, në lidhje me të cilën janë planifikuar konsultime publike me komunitetet.<sup>116</sup>

Në raportin vjetor për vitin 2021, Avokati i Popullit raportoi për krijimin e një sistemi të menaxhimit të të dhënave në lidhje me personat e zhvendosur dhe të kthyerit, me qëllim të ofrimit të ndihmës për personat e interesuar për t'u kthyer, personat e zhvendosur që jetojnë në qendra kolektive dhe në shtëpi private. Lidhur me këtë, duhet theksuar se sistemi në fjalë ende nuk është funksional dhe, në bazë të informacioneve që i ka marrë IAP-ja nga MKK-ja, i njëjti do të vihet në funksion në fillim të vitit 2023.

Avokati i Popullit ka vazhduar angazhimin në kuadër të Iniciativës Ndërinstitucionale për Personat e Zhvendosur dhe Refugjatët nga Kosova, e cila njihet më mirë si "Inicijativa e Shkupit"<sup>117</sup>, ka marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit dhe këmbimit të përvojave me përfaqësues të institucioneve, në grupet punuese që merren me dokumentet personale dhe çështjet pronësore. Gjatë vitit 2022 grupet punuese nuk janë mbledhur në kapacitetin e tyre të plotë, kjo për shkak se ka pasur ndërrime të kryesuesve të grupeve, kështu që takimet kanë qenë të natyrës konsultative. Rrjedhimisht, gjatë vitit 2022 nuk ka pasur zhvillime konkrete dhe progres thelbësor në

çështje të caktuara që kanë të bëjnë me dokumentet personale dhe çështjet pronësore. Është mbajtur një takim me kryesuesit e 5 grupeve punuese, ku tema e takimit ka qenë: planifikimi i aktiviteteve në përputhje me temat nga Plani i Veprimit, njohja me aktivitetet e arritura dhe gjendjen aktuale të punës së 5 nëngrupeve. Gjithashtu, në fund të vitit 2022 është mbajtur një takim me përfaqësues të institucioneve të Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës lidhur me çështjen e marrjes së dokumenteve për personat e zhvendosur në Maqedoninë e Veriut, me qëllim të rregullimit të statusit dhe kthimit eventual të tyre.<sup>118</sup> IAP-ja do të vazhdojë edhe me tutje ta monitorojë punën e grupeve të lartpërmendura, në mënyrë që të kontribuojë në monitorimin e situatës lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut të personave të zhvendosur, të refugjatëve dhe të të kthyerve në Republikën e Kosovës.<sup>119</sup>

Në këtë kontekst duhet përmendur sërish problemin e vazhdueshëm të sigurimit të dokumenteve personale, me të cilin ballafaqohen edhe personat e zhvendosur edhe refugjatët nga Kosova, si dhe qytetarët e katër komunave veriore, për çka IAP-ja ka raportuar në raportet e mëparshme vjetore, dhe herën e fundit në Raportin Vjetor të IAP-së për vitin 2021.<sup>120</sup>

## Të drejtat pronësore

Avokati i Popullit, në përputhje me mandatin e vet, ka monitoruar situatën dhe ka raportuar për të drejtat e komuniteteve joshumicë dhe problemet që lidhen me të drejtat pronësore në përgjithësi.<sup>121</sup> E drejta në pronë është një nga të drejtat themelore të njeriut të garantuar me Kushtetutë dhe ligjet në fuqi, si dhe

116 Informatat e marra nga MKK-ja më 22.12.2022.

117 "Inicijativa e Shkupit" funksionon në 5 grupe punuese për zbatimin e: 1. Çështjeve pronësore, 2. Sigurinë, dialogun dhe integritimin, 3. Dokumentet personale 4. Menaxhimin e të dhënave dhe 5. Planifikimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.

118 Informatat të marra nga OSBE-ja - misioni në Kosovë, dhe nga MKK-ja, në fund të dhjetorit të vitit 2022.

119 Takimi i Grupit Punues për dokumente personale, i cili u mbajt më 13.6.2022, ku morën pjesë edhe përfaqësuesit e IAP-së.

120 <https://oik-rks.org/2022/03/31/raporti-vjetor-2021/>, faqe 76.

121 Shih raportet e mëhershme vjetore të IAP-së lidhur me këtë temë.

me instrumente të shumta juridike ndërkombëtare në fuqi në Kosovë. Është fakt i padiskutueshëm se në vitet e fundit ka pasur një progres në zgjidhjen e çështjeve të pronësisë, uzurpimit dhe riuzurpimit të pronës, kontratave të falsifikuara të shitjes, si dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe të ekzekutueshme lidhur me dëbimin nga banesat e uzurpuara në mënyrë të paligjshme. Përkundër kësaj, është ende e nevojshme që shteti të merret me këtë çështje në vazhdimësi, në mënyrë që të gjithë personat, pronat e të cilëve janë të uzurpuara, të mundë t'i posedojnë pronat e tyre në përputhje të plotë me të drejtat që gëzojnë sipas ligjeve në Kosovë.

Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës vazhdon të ketë vështirësi në ekzekutimin e vendimeve për dëbimin e personave të cilët në mënyrë të paligjshme kanë uzurpuar pronën e personave të tjerë. Numri më i madh i këtyre rasteve janë prona të uzurpuara që janë në pronësi të qytetarëve të komuniteteve joshumicë në Republikën e Kosovës.

Edhe në vitin 2022, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa lidhur me zvarritjen e procedurave gjyqësore në kontestet pronësore, uzurpimi dhe riuzurpimi i pronës, si dhe mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe të plotfuqishme, në lidhje me të drejtat pronësore. Ankesat e sipërpërmendura janë në fazën e hetimit në përputhje me mandatin e IAP-së.

## Arsimi

Avokati i Popullit vlerëson se, sikur edhe gjatë gjithë viteve të kaluara, dallimet në shtrirjen e sistemit arsimor ende janë të pranishme në Kosovë. Sistemi arsimor menaxhohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe atë në gjuhën shqipe, turke dhe

boshnjake, ndërsa jashtë sistemit arsimor ende zhvillohet arsimi në gjuhën serbe për komunitetin serb, si dhe për disa qytetarë të komunitetit malazez, pjesërisht për pjesëtarët e komunitetit boshnjak (në veri të Kosovës), për një pjesë të caktuar të pjesëtarëve të komunitetit goran dhe kryesisht pjesëtarë të komunitetit rom.

Avokati i Popullit edhe këtë vit rithekson se, si pasojë e kësaj, nxënësit që përfundojnë shkollimin në sistemin paralel nuk mund të vazhdojnë shkollimin sipas sistemit arsimor të Republikës së Kosovës, për shkak se këto diploma nuk njihen. Në vitin akademik 2021/22 janë regjistruar 14 studentë, ndërsa regjistrimi u është lejuar vetëm atyre studentëve të cilët e kanë përfunduar shkollën e mesme sipas planprogramit të Republikës së Serbisë në Kosovë deri në vitin 2008, ndërsa të gjithë ata që arsimin e mesëm e kanë marrë pas vitit 2008 në Kosovë, sipas sistemit arsimor të përmendur, nuk kanë mundur të regjistroheshin për shkak të mosnjohjes së diplomave të shkollës së mesme.<sup>122</sup>

Gjatë vitit 2022, procesi i verifikimit të diplomave të marra në Universitetin e Mitrovicës së Veriut është ndërprerë për shkak të skadimit të mandatit të komisionit,<sup>123</sup> prandaj një numri të madh të studentëve të këtij universiteti nuk u është mundësuar të kërkonin punësim në tregun e punës në Republikën e Kosovës në vitin paraprak. Gjatë vitit 2022 është nisur një iniciativë për formimin e një komisioni verifikues me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe misionit të OSBE-së në Kosovë, kështu që pritet që së shpejti Komisioni të formohet dhe të funksionojë në gjysmën e parë të vitit 2023 dhe se pas një pauze njëvjeçare, procesi i verifikimit të vazhdojë pa pengesa.

122 Informacione të marra në takimin me përfaqësuesit e OSBE-së në Kosovë, më 5.12.2022.

123 Komisionit i skadoi mandati më 31.1.2022 dhe nga ajo ditë nuk ka mbajtur takim.

IAP-ja ka raportuar më herët për problemin që i ka prekur prej vitesh komunitetet turk dhe boshnjak dhe i referohet përmirësimit të cilësisë së teksteve shkollore dhe manualeve ndihmëse për arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhët e këtyre komuniteteve. Në gjysmën e dytë të vitit 2022, problemi i përmendur u zgjidh përfundimisht. Në fakt, tekstet e librave në gjuhën boshnjake dhe turke janë përzgjedhur dhe librat janë miratuar nga MASHTI për shtyp. Një grup autorësh (12) parashtruan në IAP ankesë që ka të bëjë me trajtimin e pabarabartë të autorëve dhe recensentëve të teksteve shkollore në gjuhën shqipe për sa i përket pagesës së tarifave për punën e tyre. IAP-ja e regjistroi rastin dhe në gjysmën e dytë të vitit 2022 rasti u zgjidh pozitivisht në përputhje me kërkesat e ankuesve. Në vitin shkollor 2021/2022, nxënësit që e vijnë arsimin në gjuhën boshnjake dhe turke, pas dy dekadash, morën tekste të reja dhe më moderne në gjuhën e tyre amtare.

## Përdorimi i gjuhës

Të drejtat gjuhësore janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ashtu që gjuha shqipe dhe ajo serbe janë gjuhë zyrtare,<sup>124</sup> ndërsa gjuhët e komuniteteve të tjera joshumicë në komuna të caktuara njihen si gjuhë në përdorim zyrtar,<sup>125</sup> gjë që është e rregulluar më tej me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.<sup>126</sup>

Avokati i Popullit konstaton se në mungesë të kapaciteteve, vazhdon të ketë problem të zbatimit të plotë të kësaj të drejte. Këto probleme janë si në institucionet e nivelit lokal ashtu edhe në ato qendrore. Në lidhje me të drejtat gjuhësore,

Avokati i Popullit në raportin me rekomandime<sup>127</sup> ka konstatuar se Komuna e Gjakovës ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve pasi që ankueses në komunikim zyrtar i është drejtuar vetëm në gjuhën shqipe.

Vazhdon praktika që disa faqe zyrtare të Qeverisë vetëm pjesërisht ofrojnë informacione bazë në gjuhën serbe dhe vetëm pjesërisht janë të qasshme dhe të përditësuara. Mosrespektimin e të drejtave gjuhësore të komuniteteve joshumicë, si: të gjuhës serbe dhe të gjuhëve në përdorim zyrtar në nivel komunal, e kanë theksuar edhe pjesëtarët e komunitetit boshnjak dhe turk.<sup>128</sup> Të njëjtin problem e konstatojnë edhe qytetarët nga komuniteti goran në komunën e Dragashit.

Lidhur me përmirësimin e të drejtave gjuhësore, është formuar Njësia e Përkthimit, me qëllim që të përmirësohet përkthimi i dokumenteve zyrtare në të dyja gjuhët zyrtare. Detyrë e Njesisë është analiza e përkthimeve të projektligjeve, si dhe harmonizimi i ligjeve në gjuhët zyrtare.

Avokati i Popullit në këtë vit, duke shqyrtuar ankesën e D. G. kundër Komunës së Gjakovës, me Raportin ex officio 700/2021,<sup>129</sup> ka konstatuar: *“Komunikimi zyrtar i organeve të administratës me ankuesen është në kundërshtim me nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.”*

Në lidhje me monitorimin e situatës lidhur me respektimin e të drejtave gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit në këtë vit ka filluar bashkëpunimin me Zyrën e Komisionarit për Gjuhët, me qëllim

124 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 5 dhe 59.

125 Gjuhët në përdorim zyrtar janë gjuha turke, në komunën e Mamushës dhe të Prizrenit dhe gjuha rome në komunën e Graçanicës dhe të Prizrenit.

126 Ligji nr.02/L-037 për Përdorimin e Gjuhëve.

127 <https://oik-rks.org/2022/09/13/raport-i-avokatit-te-popullit-ankesa-nr-7002021-dragica-gashiq-kunder-komunes-se-gjakoves/>

128 Informacionet e marra nga përfaqësuesit e komunitetit boshnjak në Prizren dhe nga përfaqësuesit e misionit të OSBE-së në Kosovë.

129 <https://oik-rks.org/2022/09/13/raport-i-avokatit-te-popullit-ankesa-nr-7002021-dragica-gashiq-kunder-komunes-se-gjakoves/>

të koordinimit dhe promovimit më të mirë të të drejtave gjuhësore si dhe të zgjidhjes më të shpejtë të ankesave të paraqitura. Në dhjetor të këtij viti është mbajtur një punëtori e përbashkët e IAP-së dhe Zyrës së Komisionarit për Gjuhët, me mbështetjen e IOM-it, me qëllim të identifikimit të fushave të bashkëpunimit strategjik që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave gjuhësore në Republikën e Kosovës. Në vitin 2023 do të kryhet një hulumtim i përbashkët lidhur me respektimin e të drejtave gjuhësore në Republikën e Kosovës.

## Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Avokati i Popullit ka vazhduar komunikimet me përfaqësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të shoqërisë civile si dhe me vetë ankuesit nga këto komunitete, përmes takimeve fizike në zyrat e IAP-së në seli në Prishtinë, po ashtu edhe në zyrat rajonale. Gjithashtu, IAP-ja ka vazhduar me kontaktet ditore përmes linjave të telefonit dhe u ka ofruar këshilla dhe informata komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me mandatin dhe kompetencat e IAP-së, mundësinë e parashtrimit të ankesave në IAP dhe ankesa ndaj institucioneve të tjera publike.

Avokati i Popullit rithekson se të kthyerit nga këto komunitete nuk janë në dijeni për mekanizmat dhe procedurat ankimore në rast të diskriminimit të tyre në ofrimin e shërbimeve publike. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, gjatë punës në terren, në disa raste kanë informuar familjet e kthyerat lidhur me mundësitë e parashtrimit të ankesave të tilla, sikurse në Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Mitrovicë të Jugut etj.

Nga çështjet e ngritura në takimet e realizuara është konstatuar se mekanizmat kompetentë që kanë të bëjnë me kthimin në nivel lokal duket se

nuk i përfillin siç duhet politikat e kthimit dhe ka mungesë të buxhetit të mjaftueshëm lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme të strehimit për të kthyerit. Gjithashtu personat e kthyer në Kosovë ballafaqohen edhe me probleme të tjera, përfshirë shkallën e lartë të papunësisë, mungesën e arsimimit dhe mungesën e aftësive profesionale që ua pamundëson atyre punësimin e rregullt.

Çështja e shtetësisë, regjistrimit civil dhe e pajisjes me dokumente personale paraqet sfidë për personat e zhvendosur dhe refugjatët nga Kosova, si dhe pjesëtarët e komunitetit rom, por edhe qytetarët e katër komunave veriore. Edhe pse në kuadër të "Iniciativës së Shkupit" është krijuar mundësia për qasje më të lehtë në procedurat administrative dhe marrjen e dokumenteve personale, personat e zhvendosur vazhdojnë të përballen me këtë problem në komuna të caktuara të Kosovës.

Mbi bazën e ankesave të pranuara gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit vëren se vazhdon të mbetet shqetësim edhe për këto komunitete zvarritja e procedurave gjyqësore për vërtetimin e të drejtave pronësore. Sfidë tjetër mbetet mosekzekutimi i aktgjyqimeve të formës së prerë të gjykatave dhe i vendimeve të Komisionit për Zgjidhjen e Kërkesave Pronësore Banësore.

Gjatë këtij viti kemi vazhduar takimet me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare përkitazi me disa ankesa që kanë të bëjnë me bursat për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Sikurse në vitin e kaluar, edhe në këtë vit, të drejtë aplikimi dhe mbështetje me bursa kanë pasur nxënësit që vijojnë mësimet në shkollimin e obligueshëm sipas sistemit arsimor të Republikës së Kosovës, duke ua pamundësuar mbështetjen nxënësve romë që ndjekin mësimet në shkolla sipas sistemit arsimor të Serbisë.



Në Raportin me rekomandime ex officio nr. 331/2022<sup>130</sup> lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar të Kosovës me të drejtat e fëmijëve në arsim, Avokati i Popullit ka vërejtur se gjithpërfshirja e nxënësve romë, egjiptianë dhe ashkalinj mbetet dukshëm prapa komuniteteve të tjera, veçanërisht në arsimin parashkollor dhe në atë të mesëm të lartë. Ndonëse në vitet e fundit është shënuar progres në edukimin dhe në arsimimin e fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë në nivel të shkollës fillore, pjesëmarrja e tyre në nivelet e tjera arsimore mbetet e ulët dhe në veçanti vërehet se pjesëmarrja e vajzave është më e ulët sesa e djemve në shkollën e mesme të lartë. Gjithashtu është vërejtur një ndarje e fushave të përzgjedhura në shkollën e mesme të lartë ku nxënësit romë, ashkalinj dhe egjiptianë detyrohen të përzgjedhin shkollat profesionale për shkak të kriterëve të rrepta të gjimnazeve. Gjithpërfshirja e nxënësve në nivel vertikal (nivelet arsimore), por edhe në nivel horizontal (fushat e ndryshme të studimit), kërkon një qasje në të drejtat e njeriut ku analizohen jo vetëm numrat, por edhe problemet strukturore dhe diskriminimi me të cilën përballen nxënësit ashkalinj, romë dhe egjiptianë për realizimin e së drejtës për arsim. Sipas zyrtarëve të intervistuar të MASHTI-t dhe aktivistëve nga komunitetet, rastet e raportuara tregojnë se fëmijët e braktisin shkollën për shkak të varfërisë dhe të problemeve të mirëqenies. Avokati i Popullit i ka rekomanduar MASHTI-it të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar përfshirjen, por edhe përmirësimin e rezultateve arsimore të fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë, në të gjitha nivelet e arsimit.

130 <https://oik-rks.org/2022/11/10/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-3312022-lidhur-me-perafrimin-e-dispozitave-te-sistemit-te-arsimit-te-pergjithshem-parauniversitar-te-kosoves-me-te-drejtat-e-femijeve-ne-arsim/>, fq. 33-37.

# Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara

Avokati i Popullit konstaton se gjendja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në këtë periudhë raportuese në Kosovë pothuajse është e njëjtë sikurse edhe në vitin e kaluar.

Legjislacioni vendor në Kosovë në mënyrë të qartë e ndalon diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar.<sup>131</sup> Përveç ligjeve të veçanta, të cilat i rregullojnë çështjet e personave me aftësi të kufizuar, Kosova ende nuk e ka një ligj të harmonizuar gjithëpërfshirës, i cili do t'i adresonte të gjitha grupet e personave me aftësi të kufizuar. Edhe pse ministria e linjës para disa vitesh ka filluar me hartimin e një dokumenti gjithëpërfshirës të ligjit për këtë fushë, nuk ka progres të dukshëm në këtë drejtim.

Në mars të vitit 2022, Avokati i Popullit filloi fushatën “Barazi për të gjithë”. Kjo fushatë u mbajt në 11 komuna në Kosovë. Qëllimi i këtyre tryezave ka qenë promovimi i mandatit të Avokatit të Popullit si dhe fuqizimi i bashkëpunimit me institucione publike, me shoqërinë civile, me media dhe me aktivistë të të drejtave të njeriut.

Për sa i përket mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, nga të dhënat e mbledhura në terren vërehet se akoma si çështje sfiduese mbeten moszbatimi i Ligjit për

Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, rastet e dhunës ndaj fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara, mospunësimi i personave me aftësi të kufizuara, mungesa e qasjes në infrastrukturë, veçanërisht theksohen objektet e gjykatave dhe të prokurorive si dhe qendrave për punë sociale nëpër komuna të ndryshme, vendimet shabllone të komisioneve mjekësore për refuzim të njohjes të së drejtës për pension apo ndërprerje të pensioneve për këtë grup, përkrahja e pamjaftueshme për personat me autizëm dhe e personave me zhvillim të vonshëm mendor, personat shtatshkurtër nuk janë përfitues të pensioneve, mungesa e qendrave për studentë, për studentë me aftësi të kufizuara, mungesa e materialeve informuese në alfabetin brailit, mungesa e sinjalizimeve në semaforë për personat e verbër, numri i vogël i asistentëve, i psikologëve dhe i pedagogëve, moszbatimi i Ligjit për Personat Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, si për shembull: lirimi nga tatimi në pronë, si dhe nga pagesat e tjera etj. Po ashtu, në takimet e mbajtura të IAP-së me përfaqësues të shoqërisë civile është pohuar se ka nevojë për ngritje të bashkëpunimit me nivelin qendror, përkatësisht me ministrinë e linjës, si ajo e Punës dhe e Financave. OJQ-të theksojnë se kanë shumë vështirësi që t'i takojnë udhëheqësit e ministrive për të diskutuar çështje me interes për personat me aftësi të kufizuara. Një çështje tjetër

<sup>131</sup> Shih nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, në mënyrë të qartë ndalon diskriminimin e bërë nga punëdhënësit dhe thekson nevojën për mundësi të barabarta dhe trajtimin e personave me aftësi të kufizuara në punësim, trajnim dhe rikualifikim dhe garanton mbrojtjen e tyre ligjore.



shqetësuese, e cila ka qenë evidente edhe në të kaluarën, janë zvarritjet procedurale në gjykata për rastet që ndërlidhen me njohjen e së drejtës për pension të personave me aftësi të kufizuara. Në shumë raste një problematikë e tillë nuk është aspak inkurajuese që personat me aftësi të kufizuara, që ndihen të diskriminuar apo u shkelet ndonjë e drejtë e tyre e garantuar, t'u drejtohen organeve gjyqësore.

Gjatë muajve qershor dhe korrik 2022 janë mbajtur takime të ndara me përfaqësuesit e HANDIKOS-it; Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar; Shoqatës së të Verbërve të Kosovës; OJQ Feniks; Down Syndrome Kosova dhe të OJQ-së "Autizmi".

Sipas OJQ-së HANDIKOS, personat me aftësi të kufizuar, në veçanti paraplegjikët dhe tetraplegjikët, ballafaqohen me shumë sfida dhe probleme, për shkak që krahas aftësisë së kufizuar të cilët ata e kanë, gjithashtu një pjesë e konsiderueshme kanë edhe sëmundje të tjera që akoma më shumë ndikojnë në gjendjen e tyre shëndetësore. Gjithashtu u theksua mungesa e qasjes fizike në hapësira publike dhe private për personat me aftësi të kufizuar, përfshirë trotualet, rrugët, ndërtesat dhe objektet e tjera publike dhe private, moszbatimi Udhëzimi Administrativ-Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe trajtimi i personave me aftësi të kufizuar gjatë vlerësimit dhe rivlerësimit të aftësisë së kufizuar, nga komisionet mjekësore.

Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar; Shoqata e të Verbërve të Kosovës dhe përfaqësues nga OJQ Feniks, ndër problemet më shqetësues e shohin moszbatimin e obligimeve ligjore nga institucionet në punësimin e personave të verbër.

Përfaqësuesit e OJQ-së Down Syndrome Kosova theksuan mungesën e asistentëve për fëmijët me Down Syndrome në shkollimin e obligueshëm.

Edhe personat me autizëm ballafaqohen me shumë sfida dhe probleme. Një konstatim i tillë u bë nga një takim me përfaqësuesin e OJQ-së "Autizmi",

ku u tha se shteti nuk ofron asnjë përkujdesje për personat autikë pas moshës 18 vjeçe dhe se për shërbimet e ofruara duhet paguar vetë prindërit e fëmijëve për çdo muaj dhe që është një barrë shtesë për familjen, krahas vështirësive të shumta me të cilat ata ballafaqohen me këta fëmijë.

Avokati i Popullit gjatë kësaj periudhe raportuese ka pranuar ankesa të parashtruara nga personat me aftësi të kufizuar, por edhe të vetë organizatave joqeveritare, të cilat merren me aktivitete që kanë të bëjnë më këta persona. Gjithashtu ka hapur edhe raste sipas detyrës zyrtare (ex officio), sikurse janë hetimet që janë duke u zhvilluar lidhur me çështjen e arsimimit gjithëpërfshirës të personave me aftësi të kufizuar që ua mundëson atyre të konkurrojnë në tregun e punës, ku planifikohet të bëhet një analizë e situatës së arsimimit të personave me aftësi të kufizuar, duke u fokusuar në barrierat dhe vështirësitë që hasin ata. Po ashtu do të vlerësohet se sa është sistemi arsimor në gjendje të përgatisë personat me aftësi të kufizuara që të jenë të pavarur dhe të gatshëm të konkurrojnë në tregun e punës.

Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae), më 2 dhjetor 2021, i dërgoi një mendim juridik (amicus curiae) Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me një ankesë individuale të ankuesit z. Faruk Kukaj, lidhur me pretendimet për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, d.m.th. mosrespektimin e dispozitave ligjore lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme fizike për personat me aftësi të kufizuara në hapësirat publike dhe private në Komunën e Prishtinës.

Në mendimin e tij, Avokati i Popullit ka nxjerrë konkluzionin se mosofrimi i akomodimit të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tyre specifike, përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në nenin 1 të Ligjit nr. 05/L021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe është në kundërshtim me praktikën ndërkombëtare, duke përfshirë vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Më 18 tetor 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë mori Aktgjykimin C.nr.3663/18, sipas të cilit aprovet pjesërisht si e bazuar padia e paditësit z. Faruk Kukaj dhe detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës që paditësit, për shkak të diskriminimit nga mosveprimi-mungesa e ofrimit të kushteve fizike në hapësirat publike dhe qasjes në objektet publike për personat me aftësi të kufizuara, t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar jomaterial në emër të cenimit të dinjitetit.

Ky është rasti i parë gjyqësor në Kosovë që është bërë në bazë të pretendimeve për diskriminim të personave me aftësi të kufizuara, përkitazi me qasje dhe lëvizje të lirë në infrastrukturën publike.

Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime ex officio Nr. 331/2022<sup>132</sup> lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar të Kosovës me të drejtat e fëmijëve në arsim. Raporti ka për qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve në sektorin e arsimit nga autoritetet dhe institucionet e arsimit të Kosovës. Avokati i Popullit konsideron se cilësia e arsimit nuk është në nivelin e duhur për të përgatitur nxënësit për jetën dhe rikujton se Komentari i nenit 29 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës nënvizon të drejtën individuale dhe subjektive për një cilësi specifike të arsimit. Avokati i Popullit vlerëson se sistemi arsimor në Kosovë nuk ua mundëson nxënësve zhvillimin e potencialit sipas nevojave dhe aftësive të tyre, në pajtim me dispozitat kushtetuese.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe raportuese është publikuar Raporti me rekomandime nr.262/2018<sup>133</sup> lidhur me pengesën për qasje fizike të personave me aftësi të kufizuara në hapësirat e Administratës

Pensionale të Kosovës, Zyra Regjionale e Pensioneve në Prishtinë. Dështimi i autoritetit publik për të siguruar qasjen në një pjesë të këtij objekti, sjell pasojën se një grupi të caktuar personash, të cilët nuk mund t'i tejkalojnë barrierat fizike, u pengohet përdorimi i shërbimeve të Degës së Administratës Pensionale në Prishtinë, në kushte të barabarta dhe në baza të barabarta me qytetarët e tjerë. Avokati i Popullit vëren se sigurimi i qasjes në objekte dhe shërbime është një parakusht themelor për jetën e pavarur të personave me aftësi të kufizuara, pasi u mundëson atyre të marrin pjesë aktive në të gjitha fushat e jetës në baza të barabarta. Nëse vetëm një nga elementet e qasjes nuk është adekuate, një person me aftësi të kufizuara do të gjendet në situatën e të ashtuquajturit "ndërprerje e zinxhirit të lëvizjes", pra do të silltet në një situatë ku nuk ka mundësi të funksionojë në mënyrë të pavarur. Si rezultat i asaj që u tha më sipër, Avokati i Popullit nxjerr konkluzionin se dështimi i autoriteteve publike për të ofruar përshtatje/akomodim të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tyre të veçanta, përbën një akt të diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të aftësisë së kufizuar, i cili përcaktohet në përputhje me nenin 1 dhe me nenin 4, paragrafi 1, pika 1 dhe pika 8, të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Prandaj Avokati i Popullit nxori një rekomandim përkatës për autoritetet përgjegjës që të sigurojë qasje të papenguar për personat me aftësi të kufizuara.

132 <https://oik-rks.org/2022/11/10/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-3312022-lidhur-me-perafrimin-e-dispozitave-te-sistemit-te-arsimit-te-pergjithshem-parauniversitar-te-kosoves-me-te-drejtat-e-femijeve-ne-arsim/>

133 <https://oik-rks.org/2022/12/02/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-26220148-lidhur-me-pengesen-ne-qashe-fizike-te-personave-me-aftesi-te-kufizuar-ne-hapesirat-e-administrates-pensionale-te-kosoves-zyra-regjionale-e-pensi/>

# Mbikëqyrja e të drejtave të njeriut në Forcën e Sigurisë së Kosovës

Mbrojtja e të drejtave të njeriut që u jepet pjesëtarëve të forcave të armatosura ekziston brenda një konteksti më të gjerë të pozicionit të ushtrisë në një shtet demokratik. Kushtetuta e vendit tonë rregullon rendin shtetëror për sa i përket strukturës ligjore, mekanizmave llogaridhënës, rishikimit apo mbikëqyrjes së pavarur dhe të drejtave individuale. Në Kapitullin XI [Sektori i Sigurisë], Neni 125, paragrafi 4, saktësohet: “*Kontrolli civil dhe demokratik mbi institucionet e sigurisë garantohej.*”

Respektimi i të drejtave të njeriut dhe liritë themelore për të gjithë, duke përfshirë personelin e forcave të armatosura, paraqet koncept gjithëpërfshirës të sigurisë, i cili e lidh ruajtjen e paqes me respektimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore.<sup>134</sup> Personeli i forcave të armatosura ka të drejta të njëjta dhe mbrojtje po të njëjtojtë si të gjithë personat e tjerë, me përjashtim të disa kufizimeve të vendosura nga shërbimi ushtarak.<sup>135</sup>

Në funksion të bashkëpunimit dhe mbikëqyrjes së të drejtave të njeriut, në maj 2022 është realizuar një takim me ministrin e Ministrisë së Mbrojtjes (MM). Më tej, në koordinim me njësitë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në MM dhe FSK, në tetor të këtij viti raportues është realizuar një prezantim për oficerë dhe zyrtarë të Ministrisë

së Mbrojtjes, përkitazi me të drejtat e njeriut në forcat e armatosura dhe rolin e Avokatit të Popullit në kontekst të kësaj e të zinxhirit të kontrollit demokratik të sektorit të sigurisë. Planifikohet që ky format prezantimi të shtrihet përgjatë vitit 2023 në vetë FSK-në, përshtatshëmrisht në strukturën organizative.

Gjatë vitit raportues ka pasur disa raste publike që kanë tërhequr vëmendjen për sa i përket funksionimit dhe ndjekjes së procedurave për rekrutim në FSK, trajtim brenda FSK-së, si dhe (pa)mundësive për avancim. Megjithatë në IAP janë pranuar vetëm tri ankesa: një ankesë ndaj Ministrisë së Mbrojtjes dhe dy ankesa ndaj FSK-së.

Transformimi legjislativ për sa i përket Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së ka vazhduar. Në vitin 2022 kanë hyrë në fuqi: Ligji Nr. 08/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes;<sup>136</sup> Ligji Nr. 08/L-157 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;<sup>137</sup> Ligji Nr. 08/L-156 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës<sup>138</sup>; Ligji Nr. 08/L-133 për Komisionarin Parlamentar për Forcën e Sigurisë.<sup>139</sup>

134 Për më tepër, shih Kodin e Sjelljes mbi Aspektet Politiko-Ushtarake të Sigurisë, dokument i Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSCE) <https://www.osce.org/files/f/documents/6/a/119812.pdf>

135 Për më tepër, shih Përmbledhjen e standardeve, praktikave të mira dhe rekomandimeve mbi të Drejtat e Njeriut dhe Personelin në Forcat e Armatosura [https://www.osce.org/files/f/documents/6/5/480143\\_1.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/6/5/480143_1.pdf)

136 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=66946>

137 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=66945>

138 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=66944>

139 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61417>

Në funksion të mandatit mbikëqyrës edhe për FSK-në, IAP-ja gjatë vitit 2022 është ftuar dhe ka marrë pjesë në punimet e Konferencës së 14-të Ndërkombëtare të Institucioneve të Ombudsve për Forcat e Armatosura (14th ICOAF). Konferenca është bashkë organizuar nga DCAF<sup>140</sup> dhe Komiteti i Ombudsit Parlamentar të Forcave të Armatosura të Norvegjisë, nga data 2 deri më 4 tetor 2022, në Oslo të Norvegjisë. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të institucioneve të Ombudsve që mbikëqyrin forcat e armatosura në vendet përkatëse, nga afro 50 shtete gjithandej globit. Tema e Konferencës, për këtë vit ishte: *“Të drejtat dhe detyrimet e personelit të forcave të armatosura në kohë paqjeje dhe lufte: ndërmjet politikës dhe praktikës.”*

---

140 DCAF - Geneva Centre for Security Sector Governance është Fondacion zviceran që përfshin 57 anëtarë dhe Kantonin e Gjenevës. Me programet e veta që prekin më shumë se 80 vende, DCAF-ja njihet ndërkombëtarisht si lidere për Qeverisjen në Sektorin e Sigurisë (SSG) dhe Reformën në Sektorin e Sigurisë (SSR).

# Të Drejtat e të Huajve

Gjatë këtij viti Avokati i Popullit ka vizituar Qendrën e Azilit në Magure, Qendrën e Mbjajtjes për të Huajt në Vranidoll, Qendrën e pritjes për Azilkërkues dhe Migrantë në Vranidoll.

Në bashkëpunim me përfaqësuesit e Komisionerit të Lartë për Refugjatë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësuesve të Civil Rights Program Kosova, janë realizuar vizita në Qendrën e Azilkërkuesve në Magure dhe në Vranidoll.

Gjatë kohës së vizitave në Qendrën për Azilkërkues në Magure ishin të vendosur 27 azilkërkues, ndërsa në banim privat ishin 30-40 persona. Ndërsa në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll nuk kishte persona të akomoduar. Në vitin 2021, Avokati i Popullit kishte rekomanduar që të evitoheshin mangësitë në funksionimin e sistemit të kanalizimit në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll. Grupi monitorues, gjatë vizitës së fundit, ka vërejtur se në këtë qendër ishin kryer renovimet dhe rekomandimi ishte zbatuar.

Bazuar në statistikat e Qendrës, numri i azilkërkuesve krahasuar me vitet paraprake, ishte në rënie. Gjatë vitit 2022 numri i azilkërkuesve ishte rreth 518 persona, kryesisht nga Maroku, Siria, Afganistani, Algjeria.

Për sa u përket fëmijëve azilkërkues, në Qendrën për Azilkërkues në Magure (maj 2022) u njoftuam se kishte familje me fëmijë, por nuk kishte fëmijë të pashoqëruar. Ndërsa sipas njoftimit të mëvonshme, të datë 30 nëntor 2022, janë regjistruar 22 të mitur të pashoqëruar.

Njoftimi i azilkërkuesve për të drejtat themelore - azilkërkuesit informohen për të drejtat e tyre dhe për procedurat e azilit përmes broshurave dhe dokumenteve të shkruara në gjuhën arabe, angleze, frënge, turke, serbe etj.

Kushtet e akomodimit në Qendrat për Azilkërkues - kushtet e akomodimit janë të një standardi shumë të mirë në kuptim të hapësirës për banim, ndriçimit, pastërtisë dhe ngrohjes. Për sa u përket aktiviteteve sociale dhe të edukimit, grupi monitorues konsideron se Qendra për Azilkërkues në Magure i plotëson të gjitha kushtet për aktivitete sociale dhe edukative.

Kujdesi shëndetësor - shërbimet mjekësore për të huajt në Qendrën e Azilit u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare më e afërt dhe nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Përveç kësaj, Jezuit Refugee Service (JRS) ka angazhuar një mjek dhe furnizon qendrat me barna dhe me materiale të tjera të nevojshme. MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga azilkërkuesit shërbimet mjekësore, përkundrazi, azilkërkuesit kanë pohuar se shërbimet e nevojshme u jepen me kohë.

Shërbimet psikologjike ofrohen nga organizata Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT). Psikologu gati çdo ditë është i pranishëm në Qendër dhe u ofron trajtime individuale dhe grupore.

Kontaktet me botën e jashtme - sipas Rregullores, azilkërkuesve u lejohet të pranojnë vizita në Qendër, të pranojnë pako dhe korrespondencë, ta përdorin telefonin e Qendrës për të komunikuar sipas orarit të caktuar, si dhe të dalin nga Qendra nga ora

7:00 deri në orën 22:00.<sup>141</sup> Po ashtu, Rregullorja përcakton se Komisionerit të Lartë i OKB-së për Refugjatë (UNHCR), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), si dhe organizatat e ndryshme joqeveritare kanë qasje në Qendër. Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë qasje dhe komunikim të pakufizuar me aplikuesit e Qendrës.<sup>142</sup>

Procedura e parashtrimit të ankesave - çështja e parashtrimit të ankesave është e rregulluar me nenin 43 të Rregullores, ku përcaktohet se azilkërkuesi ka të drejtë t'i parashtrojë ankesë udhëheqësit lidhur me kushtet e pranimit dhe të trajtimit nga zyrtarët e Qendrës. Ankesa më pas dërgohet në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim, në kuadër të MPB-së, në afat prej 7 ditësh. MKP-ja ka vërejtur se në dispozicion të azilkërkuesve në Qendër është një kuti e ankesave e vendosur nga Qendra.

## Qendra e Mbajtjes për të Huajt

Bazuar në mandatin kushtetues e ligjor që ka Avokati i Popullit, si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim, gjatë vitit raportues ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt, në muajt maj dhe qershor. Në këtë qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe të huajt për të cilët konsiderohet se e cenojnë sigurinë publike, me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre dhe për arsye të tjera. Kapaciteti i kësaj qendre është 70 persona, ndërsa gjatë vizitës së bërë ishin të pranishëm 3 të huajt.

Gjatë intervistave të zhvilluara me personat e vendosur në qendër, nuk është paraqitur asnjë ankesë për trajtim në qendër dhe është konstatuar se kushtet e akomodimit në këtë qendër janë në nivel shumë të mirë. Të huajve që mbahen në këtë

qendër, shërbimet mjekësore u jepen nga Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, sipas nevojës, dërgohen edhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Qendra ende nuk ka personel mjekësor, edhe pse përmes raporteve të mëhershme u është rekomanduar që qendra ta ketë në dispozicion së paku një infermier/e.

Të huajve u mundësohet të bëjnë telefonata sipas nevojës në kohëzgjatje prej 5 minutash, gjithashtu u mundësohen edhe thirrjet nga jashtë. Gjatë vizitës, Grupi monitorues ka vërejtur se të huajt mund t'u telefononin familjeve të tyre si dhe të komunikoin përmes komunikimit *online* përmes SKYPE apo edhe përmes sistemeve të tjera të komunikimit.

Në këtë qendër është e vendosur kutia e ankesave, e cila administrohet nga vetë qendra. Po ashtu të huajt në mbajtje mund t'i drejtojnë ankesat e tyre tek Avokati i Popullit. Gjatë vizitës, rezidentëve u janë shpërndarë broshura në gjuhën angleze, serbe, turke dhe arabe, të cilat përmbajnë hollësi se si ata mund të kontaktojnë me Avokatin e Popullit dhe t'i parashtrojnë ankesat e tyre.

Avokati i Popullit, më datë 25 korrik 2022, ka publikuar raport me rekomandime për vizitën e realizuar në këtë qendër.

141 Rregullorja (MPB) nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil, nenet 38, 39, 42 dhe 54.

142 Rregullorja (MPB) nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil, neni 54.

# Të drejtat e personave në kuptim të “drejtësisë tranzicionale”

Si në çdo vend tjetër që ka dalë nga lufta e ku janë shkaktuar shumë viktima dhe dëme materiale, edhe në Republikën e Kosovës, mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale janë të domosdoshëm në mënyrë që të adresohen nevojat e viktimave për drejtësi, njohje dhe pranim, zhdëmtim për humbjet e tyre jomateriale dhe materiale si dhe ndërmarrje të veprimeve ligjore dhe të natyrave të tjera, në mënyrë që të garantohet mospërsëritja.

Ekzistojnë katër mekanizma kryesorë, të cilët mundësojnë arritjen e këtyre objektivave të Drejtësisë Tranzicionale:

- E drejta në drejtësi,
- E drejta për të ditur,
- E drejta në reparacion,
- Garantimi i mospërsëritjes.

Në dy dekadat e fundit, përpjekjet për ballafaqim me të kaluarën dhe Drejtësia Tranzicionale në Republikën e Kosovës janë zhvilluar pa një strategji gjithëpërfshirëse. Ballafaqimi kryesisht është bërë në sektorë specifikë përmes iniciativave dhe rrugëve institucionale dhe ligjore për t'u trajtuar veçmas çështje të ndryshme që lidhen me konfliktin.

## E drejta në drejtësi

Një nga instrumentet kryesore të Drejtësisë Tranzicionale është “e drejta në drejtësi”, e cila ka të

bëjë me ndjekjet dhe gjykimet penale të përgjegjësve për shkeljet e rënda të ligjit ndërkombëtar, e që janë krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, tortura, zhdukjet e dhunshme dhe gjenocidi.

E drejta për drejtësi përfshin të drejtën e viktimave për të marrë drejtësi përmes një mjeti juridik të drejtë dhe efektiv. E drejta për drejtësi gjithashtu i detyron shtetet të hetojnë shkeljet dhe të ndjekë penalisht personat përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të ndërmarrë veprimet ndëshkuese nëse vërtetohet fajësia. Rrjedhimisht kjo nënkupton se e njëjta duhet të pasohet me dëmshpërblim. Përgjegjësia kryesore për të ushtruar juridiksionin bie mbi gjykatat kombëtare/vendore, megjithatë, edhe gjykatat penale ndërkombëtare ose hibride mund të ushtrojnë njëkohësisht juridiksionin, siç janë: Tribunalet Ndërkombëtare, Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Në Republikën e Kosovës, performanca e dobët edhe nga misionet ndërkombëtare, por edhe nga gjyqësori vendor në ndjekjen penale të përgjegjësve për krime lufte dhe dështimi i tyre në sjelljen e drejtësisë për viktimat e krimeve të luftës dhe familjet e tyre më së miri pasqyrohen në të dhënat statistikore të bëra publike nga Organizatat e Shoqërisë Civile.<sup>143</sup> Nga këto statistika,<sup>144</sup> në Kosovë nga viti 1999 e deri në vitin 2022 janë akuzuar për

143 Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë.

144 <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Buletini%20per%20Drejtesi%20Tranzicionale%202022/Buletini%20per%20Drejtesi%20Tranzicionale.pdf>



krime lufte gjithsej 117 persona dhe vetëm 45 prej tyre (35 shqiptarë, 9 serbë dhe 1 rom) janë dënuar me aktgjykime të plotfuqishme.

Edhe pse “Strategjia e Krimeve të Luftës”<sup>145</sup> e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe e Prokurorit të Shtetit ka hyrë në fuqi në vitin 2019, ajo ende nuk ka dhënë rezultatet e pritura. Ndoshta i vetmi element i kësaj strategjie që është realizuar është rritja e numrit të prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në Departamentin për Krime Lufte, në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, kjo strategji nuk është zbatuar në pjesën që parasheh vendosjen e bashkëpunimit me Mekanizmin Rezidual për Tribunalet Ndërkombëtare dhe Prokuroritë në vendet e rajonit. Bashkëpunimi me Mekanizmin Rezidual do të ishte tejet i rëndësishëm, sepse ky institucion e menaxhon bazën e të dhënave të Tribunalit Penal për ish-Jugosllavi ku ka dokumentacione të shumta të mbledhura nga Prokuroria e këtij Tribunali për krimet e kryera në Kosovë. Nga ana tjetër, bashkëpunimi eventual me Prokuroritë për krime të luftës nga rajoni, me theks të veçantë me atë të Serbisë, do hapte mundësinë për ndjekjen penale të atyre që kane kryer krime lufte në Kosovë dhe që jetojnë në Serbi. Viteve të fundit vërehet se të gjitha proceset gjyqësore për krime lufte në Kosovë zhvillohen ndaj kryerësve të krimeve të profilit të ulët, të cilët nuk kanë qenë përgjegjës kryesorë për ato krime. Kjo ndodh sepse organet e ndjekjes nuk mund të vijnë deri te përgjegjës kryesorë, shumica e të cilëve jetojnë në Serbi. Ideja që të tejkalohen këto probleme përmes gjykimeve në mungesë nuk duket të jetë zgjidhje ideale, për shkak të vështirësive dhe sfidave që përmban në vetvete gjykimi në mungesë.

## E drejta për të ditur

E drejta për të ditur përfshin të drejtat e viktimave dhe familjeve të tyre për të mësuar të vërtetën mbi atë çfarë u ka ndodhur atyre personalisht apo familjarëve dhe njerëzve të tyre të dashur. Kjo e drejtë bazohet në të drejtën e patjetërsueshme të shoqërisë për të ditur se cilat rrethana rezultuan në kryerjen e krimeve dhe shkeljeve, ashtu që të parandalohet përsëritja e tyre në të ardhmen. Përtej kësaj, kjo e drejtë ofron një detyrim të shtetit për të ndërmarrë masa, si: sigurimi i arkivave dhe i dëshmimeve të tjera, duke ruajtur dhe mirëmbajtur kujtesën kolektive.

Rëndësia e së vërtetës në një shoqëri pas konfliktit është e lidhur ngushtë me demokratizimin dhe transparencën. Pas përfundimit të mizorive ekziston një konsensus i përgjithshëm që shoqëria demokratike, e posaçërisht komuniteti i viktimave, meriton të mësojë krejt të vërtetën se çka ka ndodhur gjatë periudhës së luftës apo regjimit diktatorial. Në veçanti, e drejta e familjeve të personave të zhdukur për të ditur të vërtetën është e garantuar me Protokollin shtesë të Konventave të Gjenevës<sup>146</sup>, në nenet 32, 33 dhe 34. Gjithashtu, të drejtën për të ditur fatin e personave të zhdukur me forcë e garanton edhe Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Dhunshme, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën 47/133.<sup>147</sup>

Përveç mekanizmave institucionalë, në realizmin e Së Drejtës për të Ditur, mund të kontribuojnë edhe aktorë të tjerë, siç janë: shoqëria civile, akademja, media, komuniteti i artistëve, por edhe individë të tjerë.

145 [https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Dokumente%20Strategjike/2019\\_03\\_29\\_125750\\_STRATEGJIA\\_E\\_KRIMEVE\\_TE\\_LUFTE.pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Dokumente%20Strategjike/2019_03_29_125750_STRATEGJIA_E_KRIMEVE_TE_LUFTE.pdf)

146 <https://ckrm.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/ZENEVSKI%20KONVENCII%20%20NA%20ALBANSKI%20%2019%2011%202019%20vnatresni%20strani.pdf>

147 <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-convention-protection-all-persons-enforced>



***Institucionet e shtetit kanë ndërmarrë nisma në drejtim të realizimit të së drejtës së viktimave dhe të qytetarëve për të ditur të vërtetën mbi të kaluarën, mirëpo asnjëra nga këto nisma nuk ka dhënë rezultatet e pritura. Ende është shumë larg hartimit të një narrativi zyrtar të saktë dhe gjithëpërfshirës mbi krimet dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut të ndodhura gjatë luftës në Kosovë.***

Për dallim nga nismat zyrtare të institucioneve të vendit, shoqëria civile ka shkuar më larg në dokumentimin e krimeve të luftës, sidomos të viktimave të këtyre krimeve. Shumë organizata të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe mediat dhe individë, kanë ndërmarrë nisma të ndryshme në drejtim të hulumtimit të fakteve dhe nxjerrjes të së vërtetës mbi krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë.

Njëra ndër çështjet më të ndjeshme në fushën e së drejtës për të ditur janë personat e zhdukur. Sot, në Republikën e Kosovës, ende nuk dihet fati i mbi 1600 personave të zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë. Sigurisht, procesi i gjurmimit për lokacionet e varrezave masive është tejet i ndërlikuar, por së paku institucionet e shtetit të Kosovës do duhej të ishin më efikase dhe së paku të zbardhnin identitetin e rreth 300 mbetjeve mortore që gjenden në morgun e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë. Po të trajtohej kjo çështje me kujdes dhe të identifikoheshin këta trupa, atëherë numri i përgjithshëm i personave të zhdukur do të bie për gati 20%.

Edhe në mbledhjen e fakteve për krimet e kryera gjatë luftës, shteti i Kosovës nuk ka pasur sukses. Janë krijuar mekanizma të cilët nuk kanë zbatuar misionin e tyre, siç është rasti me Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës dhe Departamentin për Drejtësi Tranzicionale. Mekanizmi i parë është shuar, ndërsa ai i dyti ende nuk ka dhënë ndonjë rezultat dhe nuk ka informata të ketë filluar zbatimin e disa nga detyrat e tij, siç është themelimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për dokumentimin e krimeve dhe dëmeve të luftës

dhe mbledhja e të dhënave për dëmet e luftës nga institucionet publike dhe qytetarët.

## E drejta në reparacion

E drejta për dëmshpërblim përfshin masat të cilat shteti obligohet t'i aplikojë për viktimat, familjet e tyre dhe komunitetet, ashtu që t'i kontribuojnë një forme të njohjes simbolike të ndjenjës së humbjes së tyre, e cila është e nevojshme si pjesë e shërimit nga traumat e luftës dhe të ofrojë drejtësi dhe kompensim për humbjet që janë shkaktuar.

Në Kosovë, menjëherë pas përfundimit të luftës, ka pasur përpjekje që të siguroheshin reparacionet për komunitetet e goditura nga lufta. Edhe pse është e vështirë që të bëhet një hartë e reparacioneve materiale që janë siguruar për rindërtimin e shtëpive, mund të thuhet se një numër shumë i madh i organizatave, institucioneve dhe fondacioneve ndërkombëtare kanë kontribuar që të rindërtohen shtëpitë e shumta dhe t'u sigurohet kulm mbi kokë qytetarëve të Kosovës. Meqenëse, në përputhje me standardet ligjore ndërkombëtare, të afërmit e viktimave, si personat e zhdukur, ashtu edhe ata të vrarë nga konflikti i armatosur në Kosovë, kanë të drejtë në reparacione adekuate dhe efektive, autoritetet e Kosovës kanë filluar të hartojnë korniza ligjore për të rregulluar këtë çështje. Në fushën e së drejtës në reparacione, autoritetet në Kosovë, përmes aprovimit të ligjeve për ofrimin e reparacioneve materiale për shumicën e kategorive të viktimave të krimeve të luftës, kanë bërë përpjekje solide që të krijojnë mekanizma dhe të ndërmarrin masa që viktimat e luftës të marrin kompensime materiale për vuajtjet dhe humbjet që i kanë pësuar gjatë luftës dhe kjo pa dyshim se ndikon edhe në njohjen dhe pranimin simbolik të vuajtjeve të tyre.

Rregullimi me ligje dhe rregullore i fushës së reparacioneve simbolike dhe memorialëve lë shumë për të dëshiruar. Ngritja e memorialëve që u kushtohen viktimave të luftës së viteve 1998-1999

duhet të rregullohet me një ligj të posaçëm, por në të njëjtën kohë duhet të fuqizohet edhe agjencia për memorialët. Nga ana tjetër, duhet të punohet edhe në shënjimin e hapësirave publike dhe jopublike ku ka pasur shkelje masive të të drejtave të njeriut dhe krime të luftës. Edhe pse ka pasur nisma shumë të mira nga ana e shoqërisë civile, pak nga ato nisma janë përkrahur dhe institucionalizuar. Është e papranueshme që shteti i Kosovës ende nuk e ka krijuar në muze i cili i kushtohet luftës dhe viktimave civile të saj.

## Garantimi i mospërsëritjes

E drejta për garanci për mospërsëritje nënkupton obligimin e shtetit për të siguruar qeverisje të mirë dhe sundim të ligjit ashtu që të sigurojë që krimet që kanë ndodhur në të kaluarën të mos përsëriten.

Reformat institucionale paraqesin procesin e rishikimit dhe të ristrukturimit të institucioneve shtetërore, në mënyrë që ato të respektojnë të drejtat e njeriut, të ruajnë shtetin e së drejtës dhe të jenë të përgjegjshëm ndaj publikut.

Në rastin e Kosovës, ndërmarra dhe zbatim i reformave institucionale në mënyrë që të garantohet mospërsëritja ka qenë shumë më e lehtë dhe e thjeshtë sesa në vendet e tjera që kanë dalë nga lufta apo regjimi diktatorial/autoritar. Kjo për arsye se administrata shtetërore, e cila ishte abuzive dhe diskriminuese ndaj qytetarëve, si dhe institucionet e sigurisë që kishin kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, me marrëveshjen e paqes janë detyruar të largoheshin nga Kosova. Të gjitha institucionet shtetërore janë krijuar nga fillimi, prandaj edhe nuk ka pasur nevojë të ndërmerreshin reformat strukturore ose verifikimi. Gjithashtu, menjëherë me përfundimin e luftës në Kosovë prezenca e institucioneve ndërkombëtare ka qenë shumë e madhe dhe për një kohë Kosova është administruar nga UNMIK-u dhe misioni i tij,

si dhe organizatat e tjera ndërkombëtare kanë asistuar në themelimin e institucioneve vendore.

Transformimi i kornizave ligjore, si element i reformave institucionale, që garantojnë mospërsëritjen, është bërë në mënyrë të duhur në Kosovë. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) miraton zbatimin automatik të instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Në anën tjetër, në shtyllën e reformave institucionale në Kosovë ka ngecje të theksuara në zhvillimin e programeve të trajnimit të zyrtarëve civilë, sidomos të atyre në nivel lokal dhe të cilët janë të autorizuar t'u ofrojnë shërbime të ndryshme qytetarëve dhe të cilët nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në bazë të hulumtimeve të ndërmarra mund të arrihet në përfundimin se shteti i Kosovës ka ndërmarrë nisma ligjore dhe institucionale për të zbatuar mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale, por këto nisma nuk kanë qenë gjithmonë në harmoni dhe në bashkërenditje me njëra-tjetrën dhe si të tilla nuk kanë mundur të japin rezultate të dëshiruara. Prandaj, një ndër dështimet kryesore të shtetit të Kosovës në fushën e zbatimit të mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale është fakti se nuk kanë qenë në gjendje që deri më tani të hartonin një strategji nacionale për Drejtësinë Tranzicionale, e cila do të harmonizonte të gjitha nismat ligjore dhe institucionale që të realizojë të drejtën e viktimave në drejtësi dhe reparacione si dhe të drejtën e shoqërisë për të ditur mbi të kaluarën. Nga ana tjetër, për shkak të kompetencave të kufizuara dhe për shkak të rrethanave politike, autoritetet kosovare shpesh nuk kanë qenë në pozitë të zbatonin masat nga fusha e Drejtësisë Tranzicionale.

Duke pasur parasysh të gjeturat e lartpërmendura dhe në mënyrë që shteti i Kosovës të zbatojë në

tërësi dhe me efikasitet mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale, Avokati i Popullit, gjatë vitit 2023 do të publikojë një Raport me rekomandime konkrete për autoritetet përgjegjëse lidhur me gjetjet e tij për sa i përket zbatimit të mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale në Republikën e Kosovës.

# Kufizimi dhe shmangia nga të drejtat e njeriut

Për sa i përket shmangies, sipas nenit 56 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna.”*

Në anën tjetër, kufizimi i të drejtave të njeriut nuk është i kushtëzuar me gjendjen e jashtëzakonshme. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës [neni 55, paragrafët 1 dhe 2], të drejtat e njeriut dhe liritë themelore mund të kufizohen vetëm me ligj dhe deri në atë masë sa është e domosdoshme që në një shoqëri të hapur dhe demokratike të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi. Kufizimi i të drejtave të njeriut nuk mund të bëhet për qëllime të tjera, përpos atyre për çfarë janë përcaktuar kufizimet. Po ashtu, Kushtetuta përcakton se me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës të së drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2022, nxori Vendimin nr. 01/55 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës. Me këtë rast

u miratuan masa të cilat në aspektin e politikave kufitare e kufizonin/pamundësonin hyrjen e një kategorie personash në territorin e Kosovës, gjegjësisht ata persona të cilët nuk kanë dëshmi për tri doza të vaksinës kundër COVID-19, ose së paku nuk kanë dy doza dhe test PCR negativ jo më të vjetër se 48 orë para nisjes.

Avokati i Popullit ka ndërmarrë një mori veprimesh hetimore dhe në bazë të të gjeturave, të fakteve të mbledhura, si dhe pas analizimit të ligjeve relevante si dhe nga praktikat e vendeve të rajonit, konstatoi se shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, kufizimet e vendosura deri në këtë masë duket sikur ishin të ashpra, joproporcionale dhe si të tilla padyshim që ndikonin në të drejtat e njeriut.

Si rrjedhojë, më 31 janar 2022, Avokati i Popullit ka publikuar Opinionin Juridik Ex Officio nr.40/2022, me të cilin konstatoi se masat e aplikuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës ishin më të ashpra krahasuar me masat që kishin aplikuar vendet e tjera në rajon e që për nga shkalla e infektiveve me virus nuk qëndronin më mirë sesa vendi ynë. Aty thuhej se asnjëri prej shteteve të rajonit, në hyrje të pikave kufitare nuk kërkonte nga qytetarët tri doza të vaksinës, prandaj si rrjedhojë e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës kishte edhe kundërshtime, reagime e protesta në disa pika kufitare, prandaj këto shqetësime do të duhej t'i merrte parasysh Qeveria e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të rishikoheshin këto masa.

Opinioni solli përfundime se Qeveria duhet ta rishqyrtonte edhe masën e kufizimit për ndalim të qarkullimit nga ora 22:00 deri në orën 5:00, duke precizuar se në vend të kësaj do të ishte më e dobishme që të hiqej ora policore dhe të fuqizoheshin mekanizmat e kontrollit për zbatimin e masave të përgjithshme tanimë të ditura. Për më shumë, Opinioni precizonte se me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, Qeveria e Republikës së Kosovës do të duhej t'i kushtonte kujdes esencës së të drejtës që kufizoheshin, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohej të arrihej, si dhe ta shqyrtonin mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim sa më të vogël apo deri në atë masë sa ishte e domosdoshme për arritjen e qëllimit legjitim, masa këto që do të konsideroheshin si të nevojshme në një shoqëri të hapur dhe demokratike.

Më 4 shkurt 2022, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, i cili ndër të tjera kishte precizuar se opinioni në fjalë do të shqyrtohej në takimin e radhës ku pritej propozimi për masat e reja për vendimin e radhës të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e reja antiCOVID-19.

Në të njëjtën ditë mediat raportuan se Qeveria e Republikës së Kosovës nxori Vendimin nr.01/59 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, datë 4 shkurt 2022. Me këtë rast u vendos për zbutje të masave për sa i përket hyrjes në Republikën e Kosovës, u vendos të hiqej obligimi i bartjet së maskës në hapësira të hapura, ora policore pësoi ndryshime duke filluar prej orës 24:00 deri në orën 5:00, aktiviteti gastronomik u lejua të zhvillohej deri në orën 23:00, u lejuan të punonin edhe disa sektorë, si: kinematë, sallat e fitnesit etj.

Më 1 mars 2022, Qeveria, me Vendimin nr.01/66 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin,

parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, duke vendosur për zbutje të tjera të masave, hoqi orën policore si dhe u vendos për lehtësime të tjera.

# Barazia Gjinore

Arritja e barazisë gjinore është një nga objektivat kryesore dhe prioritetet për zhvillimin e çdo shoqërie moderne demokratike, në të cilën të gjithë anëtarët e saj trajtohen në mënyrë të barabartë, në të gjitha situatat, pa diskriminim.

Kushtetuta në neni 7 [Vlerat] përcakton: *“Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”*

Republika e Kosovës nuk është nënshkruese e Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) dhe Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), megjithatë, bazuar në Kushtetutë, këto konventa janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë.<sup>148</sup> Mbrojtja nga diskriminimi në Kosovë, sidomos nga ai në baza gjinore, është i rregulluar me Ligjin Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe me Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore. Avokati i Popullit është mekanizmi i barazisë<sup>149</sup> për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë e pa diskriminim në bazat e mbrojtura në të dy këto ligje.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të

zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipat gjinorë, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj.<sup>150</sup> Pra, barazia ndërmjet grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore, e cila nuk mund të quhet e përmbyshur nëse mbetet thjesht e shkruar në letër.

Barazia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa u përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave.<sup>151</sup>

Nëse gratë dhe burrat nuk trajtohen në mënyrë të barabartë apo në përputhje me masat afirmative të parashikuara në kornizën ligjore të Kosovës, në një situatë të krahasueshme, mund të nënkuptohet se ato/ata janë duke u diskriminuar. Në këtë rast, është me rëndësi të analizohet nëse ky diskriminim është

148 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

149 Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, neni 1.

150 UN Women, 2011.

151 UN Women, 2011.

vetëm në bazë të gjinisë, apo edhe për shkaqe të tjera të lidhura me diskriminimin e shumëfishtë, që prek në mënyrë disproporcionale gratë, pikërisht për shkak të gjinisë dhe karakteristikave të tjera personale të tyre. Shembuj të diskriminimit të shumëfishtë që pësojnë gratë nënkuptojnë një trajtim më pak të favorshëm të tyre, për shkak të shtatzënisë dhe amësisë, statusit martesor, kombësisë, racës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit social, besimit fetar ose besimit, moshës apo ndonjë arsye tjetër të përshkruar me ligj ose me marrëveshje dhe me instrumente ndërkombëtare në fuqi.

Avokati i Popullit konsideron se në shoqërinë tonë ende ekziston pabarazia gjinore në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, në jetën politike dhe vendimmarrje, në pronë dhe trashëgimi, në fushën e arsimit, shëndetësisë, në ndarjen e përgjegjësisë në familje etj.

Shumë fakte tregojnë se gratë janë në një pozitive më pak të favorshme sesa burrat në fushën e punësimit, përparimit në karrierë dhe në veçanti kjo vlen sidomos për gratë me aftësi të kufizuara, gratë e një moshe të caktuar, gratë nga komunitetet pakicë, gratë e zonave rurale, gratë shtatzëna dhe nënat e fëmijëve të mitur.

## Barazia gjinore në të drejtën në punë

Niveli i lartë i papunësisë, rolet tradicionale gjinore dhe faktorët ekonomikë janë elementet kyçe që vështirësojnë pozitën e grave në tregun e punës. Stereotipat gjinorë dhe mentaliteti patriarkal ende mbesin sfidat më të mëdha që ndikojnë që gratë ende janë të nënperfaqësuara në fushën e punësimit.

Edhe në vitin 2022 është përsëritur përvoja shumëvjeçare, e cila tregon se një numër i grave

ankohen për problemet që lidhen me të drejtën në punë dhe çështjet ekonomike, mbrojtjen sociale, apo lidhur me shkeljen e të drejtave të tyre gjatë shtatzënisë.

Shumica e grave të punësuar gjithashtu kanë edhe përgjegjësinë për përkujdesjen për anëtarë të familjes së tyre dhe për mbarëvajtjen e jetës familjare, përgjegjësi këto që shpesh konsiderohen detyrim vetëm i grave, pikërisht për shkak të stereotipave e roleve gjinore dhe mentalitetit patriarkal që ende i ushqen modele të tilla. Përgjegjësia për t'u kujdesur për anëtarët e tjerë të familjes dhe mungesa e shërbimeve sociale dhe e shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve dhe të moshuarave të familjes reflektohen në pabarazinë që evidentohet në tregun e punës. Mosbalancimi i detyrimeve dhe i përgjegjësisë brenda familjes ndërmjet grave dhe burrave, duke ua lënë më shumë grave këto detyrime, sjell zvogëlim të dukshëm të kohës në dispozicion të grave për të investuar dhe avancuar në karrierën profesionale. Kjo, e shoqëruar edhe me mundësi më të pakta në dispozicion të grave për t'u mbështetur për punësim apo vetëpunësim, si dhe për t'u zgjedhur në pozicionet drejtuese e menaxhuese në sektorë të ndryshëm, reflektohen në pabarazitë e dukshme gjinore në tregun e punës.

Në Kapitullin III të Ligjit për Barazi Gjinore përcaktohen një sërë masash dhe veprimesh që duhet të ndërmerren për mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë në bazë të përkatësisë gjinore në marrëdhëniet e punës. Zbatimi i tyre, gërshetuar edhe me nenin 6, pika 8, ku është parashikuar kuota minimale e përfaqësimit 50% për secilën gjini, në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe në institucionet e tjera publike, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse, do të zvogëlonte dukshëm pabarazitë që vërehen sot në tregun e punës. Kuota e përfaqësimit, si masë afirmative, mund të zbatohet për një periudhë të caktuar veçanërisht për të nxitur qasjen, pjesëmarrjen dhe punësimin e grave në ata sektorë



ku ka dallime të ndjeshme gjinore, e sidomos në nivelet e drejtimit dhe të vendimmarrjes brenda këtyre sektorëve.

Avokati i Popullit, në këtë periudhë raportuese, ka pranuar 9 ankesa me pretendim se ka diskriminim gjinor dhe të drejtën për punë, nga të cilat 5 kanë qenë të pranueshme për hetim. Natyra e ankesave sipas pretendimeve të ankuueseve ka të bëjë me diskriminimin në vendin e punës për shkak të gjinisë, ngacmimin në vendin e punës, shkeljet e së drejtës në lidhje me shfrytëzimin e pushimit mjekësor dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës.

## Barazia gjinore në të drejtën në pronë dhe në trashëgimi

Edhe pse Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgiminë i Kosovës, në neni 12 përcakton: *“Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij.”*, gratë dhe vajzat në të shumtën e rasteve heqin dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve burra. Kjo praktikë bazohet kryesisht në normat zakonore, paragjykimet që u bëhet grave dhe vajzave kur trashëgojnë dhe mentalitetit i cili i konsideron burrat si trashëgimtarë të vetëm të pasurisë së familjes së tij në shoqërinë kosovare.

Edhe pse Ligji Nr.2004/32 për Familjen, në nenin 47, përcakton: *“Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë.”*; gjithashtu në paragrafin 4 përcakton: *“Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh.”*, të dhënat që prezantohen nga organizatat që hulumtojnë pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në ndarjen e pasurisë, tregojnë për në një shkallë të ulët. E njëjta situatë është edhe te ndarja e pasurisë së përbashkët familjare.

Kjo gjendje nuk ka arritur të ketë përmirësim as gjatë këtij viti raportues, edhe pse duhet theksuar përpjekjet që me Udhëzimin Administrativ (UA) 04/2021, të aplikohen masa afirmative për lehtësira me rastin regjistrimit të pronës së përbashkët të bashkëshortëve. Qëllimi i UA 04/2021 është që të ndikojë direkt në sjelljen e bashkëshortëve në lidhje me pronën e fituar gjatë martesës, e cila nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve.

UA 04/2021 është i rëndësishëm për inkurajimin e çifteve të reja që nga fillimi i krijimit të pronës ta gëzojnë të drejtën e regjistrimit të asaj prone në emër të të dy bashkëshortëve, e drejtë që është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet në fuqi dhe që ka ndikim pozitiv për përparimin drejt barazisë gjinore mes burrave dhe grave në të drejtën pronësore.

Pavarësisht kësaj, Avokati i Popullit rithekson se korniza aktuale legjislative për trashëgimi është e pamjaftueshme që të përballet me praktikat tradicionale siç është edhe heqja dorë nga trashëgimia, të cilën gratë e bëjnë për arsye të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe dëshirën që t'i ruajnë lidhjet e tyre me familjen e origjinës. Përveç nevojës për legjislacion më të qartë, Avokati i Popullit thekson gjithashtu se duhet të punohet më shumë në ngritjen e vetëdijes për të drejtat e grave në trashëgimi, si dhe luftimin e traditave patriarkale duke punuar në ngritjen e vetëdijes edhe te burrat që të mos pranojnë të vazhdojnë praktika të tilla diskriminuese. Këtë konstatim e bazojmë në numrin e vogël të ankesave që janë paraqitur nga gratë te Avokati i Popullit, në lidhje me çështjet e trashëgimisë, numër që nuk pasqyron realitetin në terren.

## Përgjegjësia e autoriteteve publike për mbrojtje nga dhuna në familje

Dhuna në familje paraqet një problem shqetësues në shoqërinë tonë. Përmasat me të cilat po shpërfaqet tregon më së miri se duhet mobilizim i përgjithshëm për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, e cila po vazhdon të marrë jetë viktimash të pafajshme. E në shumë raste po konstatohet se kjo po ndodh për shkak të dështimit të shtetit për t'i ndërmarrë të gjitha masat e përshtatshme dhe për t'i përmbushur detyrimet pozitive për mbrojtjen e së drejtës për jetë.

Republika e Kosovës ka një kornizë ligjore solide për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në baza gjinore dhe dhunës në familje, megjithatë mangësitë në zbatim, kapacitetet e pamjaftueshme, moszbatimi i masave ligjore, moskoordinimi institucional dhe i autoriteteve që kanë detyrim t'i ndërmarrin këto masa, vlerësimi joadekuat i masave të sigurisë dhe rrezikut, si dhe mangësi të tjera që janë konstatuar edhe në raportet e Avokatit të popullit, janë tregues i gjendjes tepër të rëndë, e cila gjendje duhet të ndryshohet.

Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin të kornizës ligjore, duhet theksuar masat për përafrimin e legjislacionit me Konventën e Stambollit, e cila prej shtatorit të vitit 2020 është pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Konventa dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave e konsideron si shkelje të të drejtave të njeriut dhe formë diskriminimi.<sup>152</sup> Qëllimet e Konventës të paraqitura edhe përmes katër shtyllave kryesore të saj, fokusohen te: mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës; parandalimi; ndjekja penale dhe vendosja e kryerësve të këtyre formave të

dhunës përpara përgjegjësive; si dhe të vepruarit përmes politikave të integruara, të cilat synojnë bashkërendimin e veprimeve për fuqizimin e grave, zvogëlimin e stereotipave gjinorë dhe praktikave të dëmshme, përparimin drejt barazisë gjinore e ndërtimin e një shoqërie pa dhunë.

Avokati i Popullit konsideron se harmonizimi i legjislacionit shtetëror me Konventën e Stambollit, si një standard ndërkombëtar i avancuar për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe nga të gjitha format e dhunës ndaj grave, mbetet shumë i ngadalshëm.

Një gjë të tillë e vërteton fakti se ende nuk është finalizuar ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, edhe pse procedura për ndryshim ka filluar qysh në vitin 2016.

Rastet e raportuara të dhunës në familje për vitin 2022, sipas Policisë së Kosovës, janë 2757 raste të dhunës në familje, ose 301 raste (12%) më shumë sesa në vitin 2021. Ky numër i rasteve është tregues i prezencës në përmasa shqetësuese të dhunës në shoqërinë tonë. Është tregues edhe i vetëdijesimit për raportim të dhunës dhe besimit të popullsisë tek autoritetet përgjegjëse për mbrojtje nga dhuna në familje. Avokati i Popullit vëren me shqetësim se dinamika e rasteve të dhunës, recidivizmi, e sidomos numri i rasteve të dhunës të cilat përfundojnë me fatalitet, është rritur. Kështu, nëse gjatë vitit 2020 u evidentuan 13 raste të vrasjes si pasojë e dhunës në familje, gjatë vitit 2022, të dhënat nga Policia e Kosovës tregojnë për një rritje të këtyre rasteve me gati 62%, duke shkuar në 21 raste të vrasjeve në familje, 4 viktima janë gra që u vranë nga familjarët e tyre.

Më 22 korrik 2022, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin Ex officio nr. 13/2022<sup>153</sup>, të cilin ua ka

152 Neni 3/a i Konventës së Stambollit. Shiko: <https://rm.coe.int/168046246b>

153 <https://oik-rks.org/2022/07/22/raport-ex-officio-132022-perkitazi-me-detyrimet-pozitive-te-shtetit-pe-te-mbrojtur-te-drejte-ne-jete-dhe-per-te-siguarar-mbrojtje-nga-dhuna-ne-familje/>

përcjellë autoriteteve përgjegjëse. Raporti është iniciuar sipas detyrës zyrtare, bazuar në raportimet e mediave se më 5 janar 2022, në fshatin Llaushë në Skenderaj, ishte gjetur e vrarë me armë zjarri një grua. Raportohej se bëhej fjalë për vrasje, duke theksuar se viktima dhe dorasi ishin bashkëshortë. Më tej ishte raportuar se viktima më 1 janar 2022 e kishte raportuar rastin e dhunës në familje, por dyshohej se autoritetet nuk i kishin ndërmarrë masat e nevojshme dhe për pasojë rasti kishte përfunduar tragjikisht. Raporti konstaton mospërbushjen e detyrimeve pozitive nga ana e autoriteteve përgjegjëse për të mbrojtur të drejtën për jetë; gjithashtu ka analizuar veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve përkitazi me mbrojtjen e së drejtës për jetë, zbatimin e dispozitave kushtetuese, të instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, praktikën e Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, konventat, ligjet, politikat dhe strategjitë kundër dhunës në familje. Raporti gjithashtu konstaton se autoritetet nuk kanë respektuar Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë; nuk e trajtuan me vëmendjen e duhur rastin dhe nuk i ofruan mbrojtje adekuate viktimës; ka munguar koordinimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve, prokurori i rastit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, edhe përkundër faktit se është vënë në dijeni për rastin, nuk ka ndërmarrë veprimet ligjore për vlerësimin e rrezikut dhe masave të sigurisë për viktimën.

Avokati i Popullit ka ritheksuar në vazhdimësi shqetësimin për moszbatimin e Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të Cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, përkundër rekomandimeve që ka dhënë në raportin<sup>154</sup>, të cilat rekomandime ende nuk janë zbatuar. Në fund të këtij viti, Qeveria e Republikës

së Kosovës është zotuar se do të ndajë buxhet për zbatimin e këtij ligji.

Qeveria, me Vendimin nr.11/109, datë 23.11.2022, ka miratuar "Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale."<sup>155</sup> Qëllimi kryesor i këtij Protokollit është standardizimi i veprimeve të nevojshme për një reagim të vazhdueshëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri, për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin, dokumentimin, referimin, fuqizimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin e viktimave/të të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës seksuale, përmes ndërhyrjeve të menjëhershme dhe profesionale të institucioneve përgjegjëse. Protokollin do të zbatohet pavarësisht nëse dhuna seksuale ndodh në kontekstin e dhunës në familje ose jashtë saj (si p.sh. në vendet e punës, shkollat, parqet etj.). Përgjegjësia institucionale do të realizohet në përputhje me detyrimet dhe rolin e secilit institucion, të përshkruar në legjislationin në fuqi mbi krimet seksuale, si dhe në të gjithë dokumentet e miratuara në funksion të zbatimit të këtij legjislationi.

Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale konsiderohet një mjet praktik që udhëzon të gjitha institucionet përgjegjëse për hapat që duhet të ndërmarrin gjatë menaxhimit të këtyre rasteve, duke ruajtur parimet bazë të "Viktimës/të të mbijetuarës/mbijetuarit në qendër të shërbimeve", "Mos lëndo!" dhe "Mos shkakto dëm!", si edhe shumë parimeve të tjera të të punuarit me rastet e dhunës seksuale, si dhe thekson rëndësinë e koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve. Avokati i Popullit do të ketë në vëmendje zbatimin e këtij Protokollit gjatë vitit 2023, duke monitoruar burimet njerëzore, financiare e infrastrukturore që pritet të vihen në dispozicion nga Qeveria e Republikës së Kosovës për këtë qëllim.

154 <https://oik-rks.org/2021/03/09/raport-me-rekomandime-ex-officion-rasti-nr-6212018-ne-lidhje-me-masat-operative-parandaluese-per-mbrojtjen-e-viktimave-te-dhunes-ne-familje-sipas-ligjit-nr-05l-003-per-mbikëqyrjen-elektronike-t/>

155 Shiko: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/04F016B5-48F2-4DB3-A595-D320114AC25D.pdf>

Nga hetimet preliminare që ka nisur Avokati i Popullit, sipas detyrës zyrtare, për detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna seksuale, është duke bërë vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga institucionet shtetërore në rastin e dhunimit të së miturës që u raportua në media në muajin gusht të këtij viti.<sup>156</sup> Avokati i Popullit rikujton se dhuna seksuale dhe trafikimi me qenie njerëzore paraqiten si forma të dhunës në bazë gjinore dhe rrjedhimisht vajzat janë në rrezik më të madh nga kjo formë e dhunës. Më tutje, detyrimet e shtetit për mbrojtjen e fëmijës shihen si të dyfishta duke qenë se bëhet fjalë për një kategori të cenueshme ndaj dhunës, pra fëmijën vajzë. Në rastin konkret, po vlerësohen veprimet e autoriteteve në dritën e detyrimeve që dalin nga KEDNj-ja, KDF-ja dhe LMF-ja, të neneve 26 dhe 56 të Konventës së Stambollit, meqë autoritetet ishin në dijeni për rrezikun që i kanosej fëmijës dhe dështuan të ndërmerrnin të gjitha masat e arsyeshme për ta mbrojtur atë.

## Gratë viktimat/të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës

Edhe pse kanë kaluar shumë vite nga përfundimi i luftës në Kosovë, është hartuar korniza ligjore, shumë raste të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës vazhdojnë të hezitojnë për t'i raportuar këto raste dhe për të aplikuar në Komisionin për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimës së Dhunës Seksuale gjatë Luftës.

Në anën tjetër, gratë dhe viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës ende presin vendimet lidhur me rastet e tyre, të pakryera nga ana e organeve kompetente.

Grave viktimat/të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë duhet t'u sigurohet përkrahja institucionale dhe financiare e

nevojshme, paralelisht me rritjen e vetëdijesimit të shoqërisë për heqjen e paragjykimeve mbi këtë grup. Shoqëria kosovare duhet të angazhohet më shumë në financimin, emancipimin dhe mbrojtjen sa më të mirë të tyre me qëllim që t'u jepet më shumë mundësi për dinjitet dhe prosperitet. Gjithashtu, duhet t'i jepet rëndësi trajtimit të këtyre rasteve nga ana e gjyqtareve/gjyqtarëve dhe prokurorëve/prokurorëve të specializuar në këto krime. Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu duhet të vazhdojnë me ofrimin e ndihmës ligjore, shëndetësore dhe psikologjike gjatë procedurave gjyqësore me të cilat ballafaqohen gratë viktimat/të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës.

Avokati i Popullit ka takuar organizatat e shoqërisë civile, të cilat janë të licencuara për trajtimin e rasteve të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, dhe është informuar lidhur me shqetësimet dhe problemet me të cilat ballafaqohen viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare në Kosovë, gjatë zhvillimit të procedurave të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimës. Nga informatat e siguruar del se problemet më të shpeshta me të cilat janë ballafaquar dhe vazhdojnë të ballafaqohen viktimat e dhunës seksuale, janë: zvarritja dhe tejkalimi i afateve të përcaktuara për shqyrtim të aplikacioneve dhe marrjen e vendimit; rishqyrtimi i kërkesave dhe trajtimi i ankesave nga po i njëjti komision; vendimet shpeshherë jopërmbytësore dhe të paqarta, arsyetime të ngjashme për raste të ndryshme; vështirësitë që kanë gjatë intervistimit për shkak të gjendjes së tyre emocionale; zvarritja e procesit në gjykatë dhe mosshqyrtimi meritor i rasteve. Së fundmi rrethanë shqetësuese për viktimat e dhunës seksuale si dhe për organizatat joqeveritare të autorizuara për mbështetje të tyre në proces të aplikimit, evidentohet kufizimi i afatit kohor për aplikim dhe përmbyllje të procesit. Sipas organizatave joqeveritare, ky proces nuk duhet të jetë i kufizuar në kohë.

156 <https://insajderi.org/dosja-e-rastit-rrefimi-trondites-i-vajzes-se-dhunuar/>

# Të drejtat e personave LGBTI+

Përkundër faktit se ekziston një kornizë ligjore, e cila mbron të drejtat e komunitetit LGBTI+, si pjesë e shoqërisë në Kosovë, ky komunitet konsiderohet të jetë kategori e marginalizuar. Edhe në raportet vjetore paraprake, Avokati i Popullit ka konstatuar se respektimi i të drejtave të njeriut në përgjithësi mund të merret si tregues i zhvillimit demokratik të vendit, qoftë në nivelin legjislativ, qoftë në nivelin praktik.

Për sa i përket legjislacionit ekzistues, i cili rregullon të drejtat e personave LGBTI+, është evidente që kërkon plotësim lidhur me mbrojtjen e mëtejshme të të drejtave të njeriut në bazë të orientimit seksual dhe shprehjes së identitetit gjinor. Kodi i ri Civil, i dërguar në Qeveri nga Ministria e Drejtësisë, ka paraparë disa ndryshime ligjore lidhur me mbrojtjen e mëtejshme të të drejtave të njeriut në bazë të orientimit seksual dhe të identitetit gjinor.

Më 27 maj 2022, lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit publikoi Opinionin<sup>157</sup> dhe qëndrimet e tij lidhur me njohjen e marrëdhënieve familjare të personave me gjini të njëjtë.

Nëpërmjet këtij opinioni, Avokati i Popullit vë në pah garancitë kushtetuese që ofron Kushtetuta e Republikës së Kosovës për respektimin e jetës private dhe familjare, e po ashtu mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual për secilën qytetare dhe për secilin qytetar të Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit shpreh qëndrimin e tij se marrëdhëniet familjare të personave me gjini të njëjta, të njihen dhe të definojnë me Kodin Civil, ashtu sikur që e garanton Kushtetuta dhe në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pa asnjë dallim dhe në të njëjtën mënyrë sikur për personat me sekse të kundërta.

Avokati i Popullit vlerëson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke mos e përcaktuar shprehimisht se e drejta e martesës është e drejtë e “burrit dhe gruas”, nuk paraqet asnjë pengesë për të konstatuar se privimi i personave me gjini të njëjta nga e drejta e martesës paraqet shkelje të së drejtës për të mos u diskriminuar në bazë të orientimit seksual.

157 <https://oik-rks.org/2022/05/27/opinion-i-avokatit-te-popullit-lidhur-me-njohjen-e-marredhenieve-familjare-te-personave-me-sekse-te-njejta-me-projektkodin-civil/>

# Çështjet e iniciuara në Gjykatën Kushtetuese

Avokati i Popullit, përveç kompetencës për iniciimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese, mund të dërgojë opinione ose komente lidhur me çështjet që janë në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, dhe për të cilat çështje Gjykata i njofton palët e interesuara për dhënien e komenteve.

Përkitazi me këtë çështje, gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese opinione apo komente për rastet si në vijim:

Rasti KI 10/22 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ nr. 115/2021 të Gjykatës Supreme, që ka të bëjë me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores MD - Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Rasti KO 100/22 dhe KO 101/22 lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

KO147/22 lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të nenit 17, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, që ndërlidhet me nenin 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Gjatë vitit raportues, përkatësisht më 4 mars 2022, Avokati i Popullit ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese opinion lidhur me Kërkesën KI 10/22 të Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ nr. 115/2021 të Gjykatës Supreme, që ka të bëjë me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores MD -

Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Në këtë rast Avokati i Popullit ka vlerësuar se është shumë me rëndësi të sqarohet përgjegjësia e institucionit kompetent për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve nënligjore. Kjo do të mundësonte vlerësimin e pajtueshmërisë së akteve nënligjore me ligjin, por edhe realizimin e së drejtës kushtetuese, përkatësisht nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

Më tej Avokati i Popullit ka vlerësuar se situatat e tilla do të duhej të përcaktoheshin qartë në dispozitat e ligjeve (Ligji për Aktet Normative, i cili aktualisht është në shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe Ligji për Konfliktet Administrative, i cili është shpërndarë tek deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës). Kjo do të krijonte pasqyrë të qartë se cilat janë akte të përgjithshme normative, cilat nga këto akte i nënshtrohen kontrollit gjyqësor e cilat jo dhe të përcaktohej kompetenca e organit kompetent për vlerësimin e ligjshmërisë/kushtetutshmërisë së akteve të tilla.

Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, më 15 gusht 2022, ka nxjerrë Aktgjykim KI 10/22, me të cilin ka konstatuar: “Gjykatat e rregullta të sistemit juridik të Kosovës duke mos bërë kontrollin e ligjshmërisë së Rregullores së IML-së me nenin 15 të Ligjit të Mjekësisë Ligjore, parashtruesit të kërkesës ia mohuan të drejtën e “qasjes në gjykatë” në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, dhe për pasojë pamundësuan



që rasti i parashtruesve të kërkesës të shqyrtohet në meritat e kërkesës.” (paragrafi 80).

Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe rrjedhimisht ka shpallur të pavlefshme Aktgjykimin [AR]. nr. 115/2021] e 18 nëntorit 2021, të Gjykatës Supreme të Kosovës, Aktvendimin [AA.nr 651/2021] 6 gushtit 2021, të Gjykatës së Apelit, si dhe Aktvendimin [A.nr 1430/21] e 5 korrikut 2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe ka kthyer në rishqyrtim Aktvendimin [A.nr 1430/21] e 5 korrikut 2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me pajtim me Aktgjykimin KI 10/22 të Gjykatës Kushtetuese.

Më 29 korrik 2022, Avokati i Popullit ka dërguar në Gjykatë Kushtetuese komente lidhur me Ligjin nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KO 100/22 dhe KO 101/22.

Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit ka shprehur qëndrim se është me rëndësi që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë risitë që janë shfaqur si rezultat i miratimit të Ligjit të ri për KPK-në, në drejtim të përputhshmërisë së tyre me dispozitat kushtetuese, sepse në parim shfaqin dilemën nëse ndryshimet e tilla i cenojnë dispozitat kushtetuese, konkretisht nëse cenohet pavarësia e Avokatit të Popullit sipas nenit 132 të Kushtetutës, e po ashtu nëse cenohet ndarja e pushteteve, siç parashihet me nenin 4 të Kushtetutës, dhe funksionimi i pavarur i KPK-së, siç garantohet me nenin 110 të Kushtetutës.

Përkatësisht, Avokati i Popullit ka vlerësuar se është e rëndësishme që Gjykata Kushtetuese:

- Të vlerësojë nëse kompetenca e Avokatit të Popullit për caktimin e një anëtari joprokuror

të KPK-së bie në kundërshtim me dispozitat që garantojnë pavarësinë e Avokatit të Popullit dhe me dispozitat që garantojnë funksionimin e pavarur të KPK-së, si institucion i pavarur.

- Të vlerësojë nëse struktura e propozuar e Këshillit Prokurorial të Kosovës është në pajtim me ndarjen e pushteteve të përcaktuar me parimet kushtetuese.
- Të vlerësojë nëse votimi me shumicë të kualifikuar për çështjet e caktuara shprehimisht, e cenon funksionimin e pavarur të KPK-së, në frymën e nenit 110, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese, brenda periudhës raportuese, nuk ka marrë vendim lidhur me rastet e bashkuara KO 100/22 dhe KO 101/22, përkitazi me përbërjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Më 11 nëntor 2022, Avokati i Popullit ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese opinion përkitazi me kërkesën e Gjykatës Supreme dërguar në Gjykatën Kushtetuese lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të nenit 17, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, që ndërlidhet me nenin 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Përmes opinionit, Avokati i Popullit ka vlerësuar se dispozita e nenit 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, e cila parasheh kushtet për zgjedhjen në pozitën *profesor asistent* është diskriminuese dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi. Kjo për arsyen se dispozita në fjalë kufizon moshën për punësim në pozitën *profesor asistent* në Universitetin e Prishtinës në 50 vjeç, edhe pse Ligji nr.03/L-212 i Punës parashikon që moshë e punësimit në Republikën e Kosovës është 18 deri në 65 vjeç.



# Mbikëqyrja e politikave legjislative në përputhje me të drejtat e njeriut dhe me standardet ndërkombëtare

Avokati i Popullit, sikurse vitet e kaluara, edhe në vitin raportues ka ndjekur zhvillimet e politikave legjislative nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit ka vërejtur se Qeveria e Republikës së Kosovës përmes programit legjislativ për vitin 2022, ka përcaktuar planin dhe afatet e miratimit të projektligjeve dhe përcjelljen e tyre për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim Avokati i Popullit ka vërejtur se Qeveria e Republikës së Kosovës në programin legjislativ 2022 ka paraparë hartimin dhe miratimin e 150 projektligjeve.<sup>158</sup>

Lidhur me aktivitetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit ka vërejtur se Kuvendi ka zhvilluar normalisht punën dhe gjatë vitit raportues ka miratuar 110 ligje.<sup>159</sup>

Në këtë drejtim, në kuadër të aktivitetit legjislativ të Kuvendit, Avokati i Popullit ka vërejtur se Kuvendi i Republikës së Kosovës ndër të tjera ka miratuar Ligjin nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 3 dhjetor 2022. Përmes këtij ligji është rregulluar organizimi dhe

mënyra e funksionimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (Ligji nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 1).

Avokati i Popullit ka vërejtur se gjatë vitit raportues, përkatësisht më 22 dhjetor 2022, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 08/L-197 për Zyratë Publike dhe Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Më tej, Avokati i Popullit ka vërejtur se disa subjekte politike, në kuadër të kompetencave të tyre kushtetuese, e kanë iniciuar procedurën në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të disa neneve të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyratë Publike.

Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit ka dërguar komente në Gjykatën Kushtetuese dhe ka dhënë mendim lidhur me përmbajtjen e disa neneve të këtij ligji.

Për sa i përket Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Avokati i Popullit vlerëson se procedura e zhvilluar deri në miratimin e këtij ligji është treguese e një praktike jo të mirë të

158 Programi Legjislativ për vitin 2022 është miratuar në mbledhjen e 56-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 01/56, datë 26 janar 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr. 01/63, datë 24 shkurt 2022, me Vendimin nr. 01/69, datë 13 prill 2022, me Vendimin nr. 06/78, datë 16 maj 2022 dhe me Vendimin nr. 01/84, datë 22 qershor 2022.

159 Kuvendi i Republikës së Kosovës - Ligjet - <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet-dhe-ligjet/>

hartimit dhe miratimit të ligjeve. Kjo për faktin se mospublikimi i vlerës së koeficientit në periudhën gjatë hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të ligjit në fjalë ka shkaktuar paqartësi tek subjektet që janë prekur nga fushëveprimi i këtij ligji.

Për më tepër, Avokati i Popullit ka vërejtur se Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 14 korrik 2022, ka miratuar në parim Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.

Lidhur me këtë projektligj, Avokati i Popullit ka kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të merren parasysh opinionet e Komisionit të Venecias, i cili e ka vlerësuar përmbajtjen e projektligjit në fjalë, e po ashtu ka kërkuar t'i kushtohet vëmendje e shtuar mbrojtjes të së drejtës së pronës, mbrojtjes gjyqësore të të drejtave si dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Për më tepër, Avokati i Popullit ka vërejtur se projektligji në fjalë ka përcaktuar që në përbërjen e Komisionit për Mbikëqyrjen e Byrosë të jetë anëtar një zëvendës i Avokatit të Popullit, i caktuar nga Avokati i Popullit.

Avokati i Popullit ka vërejtur se gjatë vitit raportues Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, e cila ishte në zbatim që nga viti 2010. Me miratimin e kësaj rregullore Kuvendi ka avancuar në nivelin normues të brendshëm, duke reflektuar në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve, si dhe çështjet e tjera të brendshme të Kuvendit.

Lidhur me paraqitjen e raportit vjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit kishte kërkuar nga Kuvendi që raporti vjetor i Avokatit të Popullit të diskutohet por jo të votohet. Përkundër kërkesës, Kuvendi, lidhur me raportimin e Avokatit të Popullit për vitin 2021, kishte diskutuar dhe

në fund kishte votuar për raportin në fjalë, duke mos e marrë parasysh kërkesën e vazhdueshme të Avokatit të Popullit që raportet vjetore vetëm të diskutohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit raportues, në kuadër të aktiviteteve legjislative, Avokati i Popullit ka vërejtur një praktikë të miratimit të ligjeve kur me një ligj ndryshohen dhe plotësohen dy apo me tepër ligje ekzistuese. Në këtë drejtim, pa u lëshuar në vlerësimin e kësaj praktike, Avokati i Popullit ka vërejtur se në momentin e publikimit të ligjit të theksuar më sipër, në Gazetën Zyrtare, ai ligj nuk publikohet në rubrikën e secilit ligj që e ndryshon dhe plotëson, por publikohet vetëm në një faqe, duke e bërë kështu shumë të vështirë identifikimin e ndryshimeve ligjore.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka vërejtur se Ligji nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive të Pavarura,<sup>160</sup> është publikuar në gazetën zyrtare, mirëpo publikimi i tij është bërë vetëm në një rubrikë dhe nuk figuron në rubrikat e asnjërit ligj që janë ndryshuar dhe plotësuar me ligjin në fjalë.

Mospublikimi i këtij ligji në secilën rubrikë të ligjeve të cilat ndryshohen i vë në vështirësi përdoruesit e ligjit që t'i identifikojnë ndryshimet e miratuara. Një praktikë e tillë rezulton me paqartësi dhe njëkohësisht pasiguri tek përdoruesit e ligjit.

Përkritazi me këtë çështje, Avokati i Popullit kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që në rastet kur dërgohet për publikim një ligj i cili ka ndryshuar dhe plotësuar dy apo me tepër ligje të tjera, të njoftohet Gazeta Zyrtare që publikimi i atij ligji të bëhet në rubrikën e secilit ligj i cili është ndryshuar dhe plotësuar me ligjin në fjalë.

160 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62599>

Gjatë vitit raportues, në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë miratuar në parim Projektligji nr. 08/L-107 për Aktet Juridike dhe Projektligji nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative. Lidhur me këto projektligje, Avokati i Popullit konsideron se është e rëndësishme të përfshihen institucionet kompetente për vlerësimin e akteve nënligjore (udhëzime administrative, rregullore etj.), duke pasur parasysh edhe Aktgjykimin KI 10/22 të Gjykatës Kushtetuese parashtruar nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ nr. 115/2021 të Gjykatës Supreme, që ka të bëjë me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores MD - Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.



**Qëndrimet e Avokatit  
të Popullit të shprehura  
nëpërmjet raporteve për  
rastet e hetuara gjatë  
vitit 2022**

## Dinjteti i Njeriut, Barazia para Ligjit dhe Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale

### Raport për rastin ex officio nr. 176/2020, ndryshimi i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 10/2014 për punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet

Qëllimi i këtij raporti është që t'i rekomandojë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 10/2014 për punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet, me qëllim që procedurat dhe kriteret për pranimin e të moshuarve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet të harmonizohen me parimet themelore dhe me kompetencat që dalin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe të harmonizohet Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr. 10/2014 me dispozitat e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe të Ligjit nr. 06/L-084 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, të Ligjit nr. 2004/32 për Familjen, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës dhe të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Dispozitat e Udhëzimit Administrativ (të MPMS) nr. 10/2014 për punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet zbatohen për të moshuarit dhe pa përkujdesje familjare që kërkojnë mbrojtje nga institucionet shtetërore që ofrojnë ndihmë për personat në nevojë.<sup>161</sup> Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr. 10/2014 është akt nënligjor që e rregullon shprehimisht dhe në detaje këtë çështje.

Neni 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 10/2014 përcakton kriteret që duhet t'i plotësojnë parashtruesit e kërkesave për ta fituar të drejtën e akomodimit në Shtëpinë e të Moshuarve dhe pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet. Ndër të tjera, neni 5.1.3 parashikon që parashtruesi i kërkesës të mos ketë fëmijë biologjik ose të birësuar, ndërsa neni 5.1.4, (me të cilin lidhet neni 6.1.8) përcakton se akomodimi nuk pengohet nëse klienti në nevojë të ketë një vajzë të martuar. Ky raport shqyrton përputhshmërinë e këtyre kriterëve me legjislacionin në fuqi në përputhje me parimet e mbrojtjes nga diskriminimi.

Siç është theksuar, kriteri që parashtruesi i kërkesës të mos ketë pasardhës – fëmijë biologjik për t'i plotësuar kushtet për akomodim në një shtëpi për të moshuarit pa përkujdesje familjare dhe në shtëpi me bazë në komunitet është përcaktuar si një nga kriteret bazë për akomodim, në nenin 5, pika 1.3, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 14/2014, është e nevojshme që me qëllim të sigurimit të interesit më të mirë të të moshuarve që kërkojnë strehim në shtëpi pleqsh dhe në shtëpi me bazë komunitet, ky kriter të rishqyrtohet.

<sup>161</sup> Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr.14/2014, neni 2.

Nëse e rishqyrtojmë kriterin e dhënë në nenin 5, pika 1.3, të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2014, në raport me parimin e ligjshmërisë, i cili sipas nenit 4, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative kërkon që organet publike të veprojnë në përputhje me Kushtetutën, me ligjet në fuqi, si dhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme në kuadër të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca, nuk mund të konsiderohet se kriteri në fjalë e plotëson parimin e ligjshmërisë, as parimin e shtetit të së drejtës, sipas të cilit të gjithë janë të barabartë para ligjit, për arsye si në vijim:

Kushtetuta në nenin 21, paragrafi 1, e definon se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe përbëjnë bazën e rendit juridik të Republikës së Kosovës; ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni parashihet që Republika e Kosovës t'i mbrojë dhe t'i garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.

Sipas Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 1, si bazë diskriminuese dhe karakteristikë e mbrojtur është paraparë statusi personal dhe statusi familjar. Padyshim se ekzistenca e pasardhësve mund të paraqitet si nën karakteristikë e statusit personal dhe të gjendjes familjare dhe çdo shkelje e kësaj dispozite përbën diskriminim.

Kriteri që parashtruesi i kërkesës të mos ketë pasardhës - fëmijë biologjik ose të adoptuar përbën diskriminim, siç parashikohet në nenin 4, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sepse personat pa pasardhës biologjikë ose të adoptuar trajtohen në mënyrë më të favorshme, në raport me personat që kanë pasardhës biologjikë ose të birësuar. Mund të konstatohet që ky kriter është kriter kufizues dhe paraqet shkelje të parimit të trajtimit të barabartë. Prandaj nuk mund të konsiderohet që ky kriter e përmbush garancinë kushtetuese të barazisë, respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut, sundimin e ligjit dhe mosdiskriminimin si vlerë themelore e shoqërisë (neni 7, paragrafi 1, i Kushtetutës) as të dispozitës kushtetuese, sipas së cilës të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe secili e ka të drejtën e mbrojtjes së barabartë juridike dhe gëzimin e të drejtave të përcaktuara me ligj pa diskriminim mbi cilëndo baze, përfshirë cilindo status tjetër (neni 24 i Kushtetutës).

Kriteri që parashtruesi i kërkesës të mos ketë pasardhës - fëmijë biologjik apo të birësuar është në kundërshtim me Ligjin e Kosovës nr. 2004/32 për Familje, konkretisht me nenin 4 të Ligjit, i cili e parasheh që të gjithë personat gëzojnë trajtim të barabartë dhe se nuk do të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj asnjë personi apo personave për asnjë bazë. Nuk mund të konsiderohet trajtim i barabartë i personave që kanë pasardhës dhe i personave pa pasardhës në qoftë se vetëm personat pa pasardhës kanë të drejtë të akomodohen në një shtëpi për të moshuarit pa përkujdesje familjare dhe në një shtëpi me bazë në komunitet.

Duhet theksuar se prindërimi është një opsion, jo një detyrim dhe se është një çështje e zgjedhjes së lirë të individëve. Fakti i të qenit prindër si kusht duhet të shqyrtohet në përputhje me trajtimin e individëve ligjërisht beqarë, por megjithatë të lidhur shoqërisht, sepse e thekson privilegjin e vazhdueshëm të të qenit prindër dhe stereotipat negativë, të cilëve u nënshtrohen beqarët. Dhënia e përparësisë personave me pasardhës mund të krijojë supozime për shkallën e nevojave të një individi, shkallën e përgjegjësisë sociale dhe përkushtimit ndaj familjes, si dhe të drejtën për përfitime publike dhe mbrojtje ligjore. Kjo është në kundërshtim me nenin 1.2 të Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, i cili parasheh obligimin e shtetit për t'u ofruar shërbime sociale dhe familjare personave të cilëve u garantohet respektimi



i dinjitetit të tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat themelore të përcaktuara me legjislacionin e Kosovës dhe me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Dinjiteti personal, i mbrojtur me dispozitën kushtetuese të nenit 23, është themelor për të drejtat e njeriut dhe është i lidhur në mënyrë të pandarë me parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit. Si rezultat, respekti për dinjitetin e qenësishëm të të gjithëve duhet të jetë bazë e të gjitha politikave dhe procedurave publike të qeverisjes së shtetit. Mohimi i së drejtës të personave me pasardhës për t'u akomoduar në një shtëpi pleqsh dhe në një shtëpi me bazë në komunitet paraqet cenimin e dinjitetit të tyre, përjashtimin dhe stigmatizimin e tyre dhe i pengon këta persona t'i plotësojnë kushtet e vendosura nga programi për personat në nevojë.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet fushëveprimit të përcaktuar me nenin 2 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 10/2014. I njëjti zbatohet për të moshuarit dhe pa përkujdesje familjare dhe që kërkojnë mbrojtje nga institucionet shtetërore, të cilat ofrojnë ndihmë për personat në nevojë. Edhe personat me pasardhës, edhe personat pa pasardhës janë persona në nevojë, prandaj nuk është justifikuar në mënyrë të arsyeshme trajtimi i pabarabartë i tyre. Në mënyrë të arsyeshme mund të supozohet se edhe personat pa pasardhës kanë të njëjtat nevoja si personat që kanë pasardhës, sepse pasardhësit e tyre nuk mund ose nuk duan, për arsye të ndryshme, të kujdesen për ta.

Karakteristika nëse personat kanë ose jo pasardhës mund të nënkuptohet si një nën status tjetër që është përshkruar si bazë diskriminuese në nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në nenin 1 të Protokollit të saj 12. Prandaj është e nevojshme të shqyrtohet praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kur bëhet fjalë për ndalimin e diskriminimit.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka konstatuar në praktikën e saj gjyqësore se dallimet në trajtim bazuar në karakteristikat e njohura ose në "statusin" mund të barazohen me diskriminimin brenda kuptimit të nenit 14. Për më tepër, për të ardhur deri te çështja sipas nenit 14, duhet të ekzistojë dallimi në trajtimin e personave në situata analoge ose situata relevante të ngjashme. Një dallim i tillë në trajtim është diskriminues nëse nuk ka arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm; me fjalë të tjera, nëse nuk ekziston një qëllim legjitim ose nëse nuk ka raporte të arsyeshme proporcionale ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshiron të realizohet. Në rastin konkret, nuk ekziston asnjë justifikim objektiv dhe i arsyeshëm, as ndonjë qëllim legjitim apo raport proporcional për vendosjen e kriterit në fjalë.

Protokolli 12 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e definojnë ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit dhe e parasheh që fusha e mbrojtjes së nenit 1 ka të bëjë me katër kategori rastesh, veçanërisht, kur një person diskriminohet në gëzimin e çdo të drejte të dhënë shprehimisht një individ sipas ligjit kombëtar; gëzimin e së drejtës që mund të përcaktohet nga detyrimi i qartë i një autoriteti publik sipas ligjit kombëtar, përkatësisht kur një autoritet publik është i detyruar sipas ligjit kombëtar të veprojë në një mënyrë të veçantë; nga një autoritet publik në ushtrimin e kompetencave diskrecionale (për shembull, miratimi i subvencioneve të caktuara); me cilindo veprim ose mosveprim tjetër të një autoriteti publik.

Në rastin konkret, bëhet fjalë për detyrimin e autoritetit publik sipas së drejtës kombëtare, përkatësisht detyrimin për t'u ofruar shërbime sociale dhe familjare personave, për të cilët Qendra për Punë Sociale dhe komisioni përkatës (i themeluar në bazë të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2014) e vërteton se i plotësojnë kushtet për akomodim në shtëpitë e të moshuarve pa përkujdesje familjare dhe në shtëpitë

me bazë në komunitet. Nuk mund të konsiderohet se komisioni ka marrë një vendim meritor në qoftë se refuzon të pranojë një person me pasardhës, sepse bëhet fjalë për zbatimin e një kriteri diskriminues në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kriteri që parashtruesi i kërkesës ta ketë një vajzë, e cila është e martuar, po ashtu është dhënë si një nga kriteret bazë për akomodimin e parashtruesit të kërkesës në shtëpinë e të moshuarve dhe në shtëpitë me bazë komunitet, sipas nenit 5, pika 1.4, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 10/2014 (me të cilin lidhet neni 6, pika 1.8) dhe thotë: *“Strehimi nuk pengohet nëse klienti në gjendje të nevojës ka një vajzë, e cila është e martuar.”* Është e nevojshme të shqyrtohet ky kriter nga dy aspekte: në raport me personat që kanë vajza të martuara dhe në raport me personat që kanë vajza të pamartuara dhe djem, pavarësisht nga statusi i tyre martesor.

Në rastin konkret bëhet fjalë për një dallim të pajustificuar dhe të paligjshëm në bazë të gjinisë dhe të statusit martesor të pasardhësve të parashtruesit të kërkesës, që është në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila sipas nenit 7, paragrafi 1, thotë se barazia, respektimi i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut, sundimi i ligjit dhe mosdiskriminimi janë ndër vlerat themelore të shoqërisë kosovare.

Kriteri i dhënë në nenin 5, pika 1.4, me të cilin ndërlidhet neni 6, pika 1.8, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 10/2014, nuk është në përputhje me parimin e ligjshmërisë, me të cilin përcaktohen detyrimet e organeve të administratës publike që gjatë kryerjes së veprimtarisë administrative të punojnë dhe të vendosin në përputhje me ligjin (neni 4, paragrafi 1, i Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative).

Të gjitha kategoritë e pasardhësve janë të barabarta në të drejta dhe në detyrime në lidhje me prindërit e tyre, ndërkohë që statusi i personave që parashtrojnë kërkesa për strehim rezidencial në një shtëpi për të moshuarit është i njëjtë, qoftë nëse të njëjtët kanë vajza të martuara apo të pamartuara, apo djem, apo janë pa pasardhës. Prandaj mund të konstatohet se theksimi i dallimit ndërmjet pasardhësve të gjinisë mashkullore dhe femërore, pastaj vajzave që janë të martuara në raport me ato që nuk janë të martuara, paraqet trajtim të pabarabartë të pasardhësve, prandaj kriteri i dhënë në nenin 5, pika 1.4, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 10/2014 është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka hartuar një jurisprudencë të gjerë mbi mbrojtjen nga diskriminimi. Kur bëhet fjalë për diskriminimin në bazë të gjinisë, Gjykata ka deklaruar shumë herë se promovimi i barazisë gjinore është sot synimi kryesor në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Stereotipat gjinore, si: perceptimi i grave si kujdestare parësore dhe i burrave si kujdestarë parësorë nuk mund të konsiderohen një justifikim i mjaftueshëm për dallimet në trajtim. Në rastin konkret, vajzat e pamartuara konsiderohen si persona që kanë obligim dhe janë në pozitë më të përshtatshme që të kujdesen për prindërit e tyre, gjë që cenon parimin e trajtimit të barabartë.

Avokati i Popullit thekson se institucionet shtetërore për akomodimin e të moshuarve si dhe procedura për akomodimin dhe qëndrimin e tyre në to janë çështje sociale e ndjeshme dhe e rëndësishme. Shërbimi i mbrojtjes sociale me strehim për të moshuarit është shpesh e vetmja zgjidhje. Prandaj është e nevojshme që shteti, në përputhje me nevojat e këtyre përdoruesve, të krijojë kushte që shërbimi i akomodimit

rezidencial dhe i kujdesit për të moshuarit të mundësohet dhe të jetë i qasshëm për të gjithë qytetarët që janë në statusin e nevojës sociale, pa bërë dallime mbi cilëndo bazë të mbrojtur ligjërisht.

Avokati i Popullit mendon se kriteri i dhënë në nenin 5, pika 1.3, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 10/2014, që e definojnë se parashtruesi i kërkesës, për ta përfituar të drejtën e akomodimit, duhet të mos ketë pasardhës – fëmijë biologjik apo të adoptuar, është në kundërshtim me Kushtetutën, me legjisllacionin në fuqi (me Ligjin nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, me Ligjin nr.2004/32 të Kosovës për Familjen, me Ligjin nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative), me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe parimin e ligjshmërisë dhe sundimi të ligjit.

Avokati i Popullit vlerëson se kriteri i dhënë në nenin 5, pika 1.4 ( me të cilin lidhet nenit 6, pika 1.8), të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 10/2014, me të cilin parashtruesit të kërkesës për akomodim në shtëpinë për të moshuar dhe në shtëpitë me bazë në komunitet nuk pengohet akomodimi nëse klienti në nevojë ka një vajzë të martuar, është në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjet në fuqi (me Ligjin nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, me Ligjin nr. 2004/32 të Kosovës për Familjen, me Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative), me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parimin e ligjshmërisë dhe sundimit të ligjit.

Avokati i Popullit konstaton se kriteri për akomodimin në shtëpi për të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpi me bazë në komunitet, i paraparë me nenin 5, pika 1.3, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 14/2014, është kriter diskriminues, që bën dallime sipas statusit familjar të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht në bazë të faktit se a kanë personat apo jo pasardhës biologjik apo të birësuar, paraqet akt të diskriminimit të drejtpërdrejtë.

Avokati i Popullit konstaton se kriteri për akomodim në shtëpi për të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpi me bazë në komunitet, i paraparë me nenin 5, pika 1.4, (që ndërlidhet edhe me nenit 6, pikën 1.8) të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 10/2014, është kriter diskriminues, që bën dallime midis parashtruesve të kërkesës në bazë të gjinisë dhe të statusit martesor të pasardhësve të tyre, apo fakti nëse parashtruesit e kërkesës kanë djem, vajza të pamartuara apo të martuara, paraqet akt të diskriminimit të drejtpërdrejtë.

Për këtë Avokati i Popullit rekomandon që Ministria e Financave, Punës dhe Tranfereve ta ndryshojë Udhëzimin Administrativ (MPMS) nr. 10/2014 për punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, duke i shfuqizuar dispozitat e nenit 5, pikat 1.3, 1.4, dhe të nenit 6, pika 1.8, të Udhëzimit në fjalë.

## **Raport për rastin ex officio nr. 577/2021, të drejtat në Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në Republikën e Kosovës, me fokus qasjen në informata dhe në shërbime në kontracepsion, qasjen në abort dhe në kujdesin pas abortit, si dhe kujdesin për shëndetin e nënës**

Në fund të dhjetorit 2022, Avokati i Popullit, me përkrahjen e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsi (UNFPA) publikoi Raportin ex officio nr. 577/2021 përkitazi me të drejtat në Shëndetin Seksual

dhe Riprodhues (ShSR) në Republikën e Kosovës, me fokus qasjen në informata dhe në shërbime në kontracepsion, qasjen në abort dhe në kujdesin pas abortit, si dhe kujdesin për shëndetin e nënës.<sup>162</sup>

Raporti përfshin të dhëna për periudhën 2019, 2020, 2021 dhe paraqet vijimësi të vlerësimit në nivel vendi të të drejtave në ShSR, adresuar tek autoritetet nga ana e IAP-së në vitin 2016. Realizimi i këtij Hetimi është bazuar në metodologjinë e kontekstualizuar, që ka pasur për bazë Udhëzuesin në mbështetje të Institucioneve Kombëtare për të Drejta të Njeriut (©UNFPA, 2015) dhe me mbështetjen e Zyrës së UNFPA-së në Kosovë, që sikur edhe tek Vlerësimi i adresuar në vitin 2016, ka pasur rol mbështetës buxhetor dhe profesional.

Hetimi ka konsideruar informatat dhe dëshmitë e grave dhe vajzave si burim primar të pohimeve dhe të të gjeturave, për të skanuar gjendjen për sa i përket respektimit të të drejtave në ShSR. Po ashtu, ka vlerësuar edhe pohimet e kontributin e organizatave të shoqërisë civile të profilit, të cilat shtrijnë aktivitetin e tyre në komunitet dhe janë afër *grave e vajzave* dhe vështirësive me të cilat ato ballafaqohen, si dhe ka adresuar pyetje edhe tek autoritetet relevante, që hartojnë e zbatojnë politikat shëndetësore dhe tek ato që ofrojnë shërbime shëndetësore, në nivelin qendror dhe në nivelin lokal.

Institucionet nuk u kanë dhënë vëmendjen e duhur dhe as përkushtimin e nevojshëm për t'u adresuar rekomandimet dhe për t'i hequr barrierat praktike që ekzistojnë, në mënyrë që gratë dhe vajzat t'i gëzojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse, plotësisht dhe pa diskriminim, të drejtat në ShSR. Sikurse tek Vlerësimi i vitit 2016, ky Hetim ripohon se të drejtat në ShSR në Kosovë (gëzimi apo cenimi i tyre) nuk mund të shihen, as të kuptohen, si të shkëputura prej kompleksitetit socio-ekonomik e kulturor-historik në vend. Pasojat e dekadave të tëra të dëmtimit dhe lënies pas dore të shëndetësisë dhe infrastrukturës përcjellëse, përgjatë një periudhe shumë të gjatë para luftës së viteve 1998/1999 në Kosovë, kanë përcjellë pasoja edhe në dinamikën e rimëkëmbjes pas luftës, por edhe pas shtetësisë. Nga perspektiva e përgjithshme, është e evidente se Kosova ka rindërtuar një sistem shëndetësor dhe ka një kornizë relativisht të mirë ligjore në fushën e të drejtave të ShSR-së, e cila mbart të integruara brenda vetes frymën e një varg instrumentesh e marrëveshjesh ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e të cilat janë të zbatueshme drejtpërdrejt në vendin tonë. Megjithatë, dinamikat e ndryshimeve të përgjithshme dhe evoluimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në konceptet e vendosura, e kanë të nevojshme mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së kornizës normative me të njëjtat dhe e bëjnë të domosdoshme mbikëqyrjen e zbatimit dhe respektimit të të drejtave të garantuara, përtej germës së legjislacionit. Përderisa boshti i Vlerësimit të adresuar në vitin 2016 ishte rishikimi i garancive normative dhe standardeve të vendosura me to, Hetimi i tanishëm ka pasur për synim të lëshohet në thellësi të problemit, duke i konsideruar informatat dhe dëshmitë e grave dhe vajzave si burim primar të pohimeve dhe të të gjeturave, për të skanuar gjendjen për sa i përket respektimit të të drejtave në ShSR. Krahas zërit të grave dhe të vajzave, Hetimi ka vlerësuar edhe pohimet e kontributin e organizatave të shoqërisë civile të profilit, të cilat shtrijnë aktivitetin e tyre në komunitet dhe janë afër *grave e vajzave* dhe vështirësive me të cilat ato ballafaqohen. Përgjatë këtij Hetimi janë adresuar pyetje edhe tek autoritetet relevante, që hartojnë e zbatojnë politikat shëndetësore dhe tek ato që ofrojnë shërbime shëndetësore,

162 Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), rezervon të gjitha të drejtat lidhur me këtë Raport, i cili është përkrahur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi (UNFPA), Zyra në Kosovë. Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të Avokatit të Popullit dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e UNFPA-së të Kombeve të Bashkuara apo ndonjëres nga organizatat respektive.

në nivelin qendror dhe në nivelin lokal, në mënyrë që pasqyrimi i gjendjes të jetë sa më i plotë dhe duke pasur parasysh të gjitha palët. Përqendrimi tek qasja në informata dhe në shërbime në kontracëpsion, në qasje në abort dhe kujdes pas abortit dhe në kujdesin për shëndetin e nënës ka pasur parasysh ndërlihdjen dhe ndërvarësinë që kanë këto çështje, në kuadër të të drejtave të ShSR-së, por edhe pandashmërinë, mostjetërsimin dhe universalitetin, në kontekst të përgjithshëm të të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Të gjeturat e këtij Hetimi kanë sjellë në vëmendje përvojat e grave dhe të vajzave jo vetëm brenda periudhës të cilën e ka vënë në fokus, por pohime të tyre edhe para 2019-ës. Megjithatë, ka qenë shumë e dukshme që rrëfimet e dëshmitë që kanë dhënë nuk kanë dalluar ndër vite për sa i përket cenimit të të drejtave në ShSR dhe qasjes në kujdes dhe shërbime cilësore shëndetësore. Kjo gjë ka nxjerrë në pah disavantazhet e vazhdueshme socio-kulturore dhe ekonomike të grave dhe të vajzave dhe ka vërtetuar se shteti nuk ua ka dhënë vëmendjen e duhur dhe as përkushtimin e nevojshëm heqjes së barrierave praktike ekzistuese, në mënyrë që gratë dhe vajzat t'i gëzojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse, plotësisht dhe pa diskriminim të drejtat në ShSR.

Për sa i përket të drejtave për ShSR, gratë dhe vajzat në Kosovë, veçmas ato me aftësi të kufizuara; me status ekonomik të rënduar; që jetojnë në ambiente me norma kulturore konservative; me status social të marginalizuar; në zona më të thella rurale, e ndërlidhur me këto çështje, gra dhe vajza të komuniteteve ashkali, egjiptian dhe rom, mbeten më të cenueshme dhe ende nuk gëzojnë qasje të plotë, gjithëpërfshirëse dhe pa diskriminim në informata dhe shërbime shëndetësore cilësore.

Gjatë hetimit janë evidentuar edhe probleme që ka në vetvete sistemi shëndetësor. Staf i pamjaftueshëm mjekësor dhe jo mjaft i përgatitur, për t'iu përgjigjur standardeve më të mira për shërbime të dinjitetshme dhe cilësore; mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për shëndetësi, përfshirë mungesën e sigurimeve shëndetësore, si dhe infrastrukturën jo të mjaftueshme dhe jo në pajtim me nevojat e kërkesat, veçmas nevojat e popullatës me karakteristika që kërkojnë ndjeshmëri e vëmendje të veçantë, rezultojnë me pamundësi për përmbushjen e detyrimeve që ka shteti për qasje universale shëndetësore.

Sado që ekziston baza ligjore dhe struktura e mekanizmat në pajtim me këtë bazë ligjore, anomalitë në funksionim dhe mungesa e koordinimit dhe planifikimit janë të shumta. Për më tepër, mungesa e informimit dhe edukimit të mirëfilltë për ShSR, qasja joproaktive e personelit shëndetësor, mungesa e profesionalizmit dhe etikës, joefektiviteti dhe joefikasiteti i mekanizmave të ankesës janë barriera që pengojnë realizmin e të drejtave të garantuara dhe qasje gjithëpërfshirëse e pa diskriminim.

Megjithatë, Raporti thekson se përkundër gjithë çrregullimeve dhe vështirësive në funksionimin e sistemit, sjellja mjekësore, ashtu edhe gatishmëria e personelit mjekësor për të përmbushur detyrimet dhe thirrjen e profesionit që kanë, janë përgjegjësi që bien drejtpërdrejt në ndërgjegjen, etikën dhe profesionalizmin individual të punonjësve shëndetësorë, të të gjitha kategorive dhe nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me mungesën e buxhetit, infrastrukturën e mangët apo çështje të tjera objektive, pa e minimizuar rëndësinë e tyre.

Raporti ua ka adresuar rekomandimet përkatëse institucioneve përgjegjëse, si më poshtë:

Kuvendit të Republikës së Kosovës	(4 rekomandime)
Qeverisë së Republikës së Kosovës	(2 rekomandime)
Agjencisë së Statistikave të Kosovës	(1 rekomandim)
Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	(1 rekomandim)
Inspektoratit të Arsimit	(1 rekomandim)
Ministrisë së Shëndetësisë	(26 rekomandime)
Inspektoratit Shëndetësor	(6 rekomandime)
Inspektoratit Farmaceutik	(2 rekomandime)
Inspektoratit Sanitar	(2 rekomandime)
Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë	(6 rekomandime)
Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës	(15 rekomandime)
Drejtorive Komunale përkatëse për Shëndetësi	(38 x 1 rekomandim)
Drejtorive Komunale përkatëse për Shëndetësi (me maternitete)	(14 x 1 rekomandim)
QKMF (ku nuk ka QKMF, drejtorive përkatëse për Shëndetësi)	(38x11 rekomandime)

## **Raport për rastin ex officio nr. 262/2018 lidhur me pengesën për qasje fizike të personave me aftësi të kufizuara në hapësirat e Administratës Pensionale të Kosovës, Zyra Regjionale e Pensioneve në Prishtinë**

Ky raport ka dy qëllime kryesore: të tregojë nevojën që personave pensionistë me aftësi të kufizuara t'u mundësohet qasja e papenguar në objektin dhe në ambientet e Zyrës Regjionale të Administratës Pensionale në Prishtinë; dhe që autoriteteve përkatëse publike t'ua vë në dukje problemet lidhur me qasjen në objektet publike të personave me aftësi të kufizuara dhe nevojën që ata t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre pa asnjë diskriminim dhe pa asnjë barrierë, por edhe që të njëjtëve t'u ofrohet mundësia e qasjes së pavarur fizike për t'i shfrytëzuar të gjitha shërbimet publike të cilat ua mundësojnë atyre ta kenë një standard të përshtatshëm jetese dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në jetën publike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Zyra Regjionale e Administratës Pensionale në Prishtinë, më 12 shkurt 2018, ishte zhvendosur në hapësirën e re, gjegjësisht në pjesën e ndërtesës së ish-Bankës së Lubjanës (ish-OSBE-së) në rrugën "Fehmi Agani" në Prishtinë. Kjo ndërtesë është ndërtuar më shumë se 30 vjet më parë dhe në të cilën nuk është bërë ndonjë intervenim tjetër në strukturën e saj në mënyrë që personave me aftësi të kufizuara të mund t'u sigurohej qasja e papenguar në këtë pjesë të objektit.

Qasja e pavarur në ambientet e zyrave regjionale të Administratës Pensionale në Prishtinë për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht të atyre që janë përdorues të karrocave, është praktikisht e pamundur, sepse për ta ekziston një pengesë arkitekturore e pakapërcyeshme. Ndodhet në një lartësi të caktuar, për kapërcimin e së cilës përdoren shkallët (gjashtë shkallë të larta të pjerrëta), që është e vetmja rrugë deri

te hyrja në hapësirat e punës. Kjo paraqet gjithashtu një pengesë për të moshuarit, të cilët kanë vështirësi në lëvizje.

Në të drejtën ndërkombëtare, diskriminimi paraqet çdo dallim, refuzim ose kufizim mbi çfarëdo baze të mbrojtur ligjërisht, duke përfshirë edhe bazën e aftësisë së kufizuar, që ka për qëllim ose efekt shkeljen ose anulimin e pranimet, të gëzimit ose të ushtrimit në baza të barabarta të të gjitha të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në jetën politike, në fushën ekonomike, sociale, kulturore, në atë civile dhe në fusha të tjera.

E drejta ndërkombëtare e thotë qartë se nuk duhet të ketë një shkallë të të drejtave dhe të dinjitetit të njeriut, por barazi për të gjithë. Në përputhje me këtë: *“Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në cilëndo bazë”*<sup>163</sup>, në mënyrë të tillë që autoritetet publike të mos e diskriminojnë askënd në kuptim të kufizimit të gëzimit të të drejtave të dhëna ligjërisht.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj parashohin që gëzimi i të drejtave dhe i lirive të parapara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim. Neni 14 imponon detyrime pozitive ndaj shteteve që të ndërmarrin masa për ta parandaluar dhe eliminuar diskriminimin dhe kjo e përfshin edhe nevojën që autoritetet publike t'i marrin parasysh nevojat e grupeve të veçanta, në këtë rast të personave me aftësi të kufizuara.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përcakton se për t'ua mundësuar personave me aftësi të kufizuara që të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet t'i ndërmarrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar të kenë qasje në mjedisin fizik, njësoj si të tjerët. Parimet bazë të kësaj Konvente janë përfshirë në Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, një dokument që është udhërrëfyes për avancimin, fuqizimin dhe mbrojtjen e këtij grupi njerëzish, si qytetarë me të drejta të barabarta.

Është e pakontestueshme që personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht aftësive të tyre, kanë të drejta dhe nevoja, të cilat shteti e ka për detyrë t'i përmbushë në bazë të konventave dhe të standardeve ndërkombëtare por edhe në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Institucionet qendrore si synim kryesor të të gjitha politikave duhet ta kenë përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve, përfshirë këtu edhe jetën e personave me aftësi të kufizuara, duke arritur rezultate të qëndrueshme në përfshirjen e tyre në shoqëri, si qytetarë të cilët e gëzojnë të drejtën për mundësi të barabarta dhe i gëzojnë të gjitha të drejtat.

Me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe me udhëzimet përkatëse administrative për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe për qasjen në objektet ndërtimore, midis të tjerash, rregullohen kushtet dhe mënyra e planifikimit hapësinor, duke siguruar lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për të gjithë qytetarët. Të gjitha objektet që janë të dedikuara për qëllime publike dhe afariste, por edhe objektet e tjera për përdorim publik, duhet të projektohen, të ndërtohen dhe të mirëmbahen në atë mënyrë që t'u mundësojnë të gjithë përdoruesve qasje, lëvizje dhe qëndrim të papenguar, përkatësisht përdorim në

163 Neni 1 i Protokollit 12 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.



përputhje me rregulloret teknike përkatëse,<sup>164</sup> të cilat përfshijnë standarde që përcaktojnë masa teknike të detyrueshme dhe kushte të projektimit, të planifikimit dhe të ndërtimit, të cilat u sigurojnë lëvizje dhe qasje të papenguar personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve dhe të moshuarve.<sup>165</sup>

Avokati i Popullit vlerëson se sigurimi i qasjes në objekte dhe në shërbime paraqet parakusht themelor për jetë të pavarur të personave me aftësi të kufizuara, sepse ua mundëson atyre të marrin pjesë aktive në të gjitha fushat e jetës në baza të barabarta. Në qoftë se vetëm njëri nga elementet e qasjes nuk është adekuat, një person me aftësi të kufizuara do të gjendet në situatën e të ashtuquajturës “*ndërprerje e zinxhirit të lëvizjes*”, përkatësisht do të gjendet në situatën ku nuk ka mundësi të funksionojë në mënyrë të pavarur.

Mosndërmarrja e veprimeve që siguron qasje fizike për të gjithë në hapësirat e Zyrës Regjionale të Administratës Pensionale në Prishtinë sjell deri te pamundësia që shërbimet e Administratës Pensionale në Prishtinë të mundë t'i shfrytëzojnë në kushte të njëjta dhe të barabarta të gjithë qytetarët. U pamundëson personave me nevoja të veçanta që në mënyrë të pavarur t'i shfrytëzojnë shërbimet e ofruara në këtë ndërtesë dhe në këtë mënyrë t'i realizojnë të drejtat e tyre të garantuara me ligj e që paraqet akt të diskriminimit të drejtpërdrejtë.

Për këtë Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Punëve të Brendshme, në koordinim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, të sigurojë qasjen e pavarur dhe të papenguar për të gjithë personat në pjesën e objektit ku ndodhet Zyra Regjionale e Administratës Pensionale në Prishtinë, duke përfshirë këtu edhe sigurimin e vendparkimeve për automjetet e personave me aftësi të kufizuara ose duke e zhvendosur këtë zyrë në një hapësirë tjetër të përshtatshme që i plotëson të gjitha kushtet për qasje të papenguar për personat me aftësi të kufizuara.

## **Opinion i Avokatit të Popullit për rastin ex officio nr. 39/2022, vlerësimi i strukturës së re tarifore në Kosovë kundrejt të drejtave të njeriut**

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRR-E) më 13 dhjetor 2021 hapi shqyrtimin e jashtëzakonshëm tarifor. ZRR-E-ja argumentonte se shtrenjtimi i çmimeve në tregjet ndërkombëtare kombinuar me rritjen e kërkesës së brendshme të energjisë e bënte të domosdoshme një rishikim të tarifave. Duke qenë se prodhimi vendor nuk mund ta plotësonte tërë kërkesën për energji elektrike, paraqitej nevoja për import, që do t'i tejkalonte sasi të lejuara nga ZRR-E-ja gjatë shqyrtimit të rregullt tarifor. Importi shtesë paraqiste edhe kosto shtesë për operatorët, të cilat nuk ishin parashikuar në të hyrat e lejuara maksimale për vitin relevant tarifor 2021.<sup>166</sup>

Ky Opinion vlerëson ligjshmërinë dhe mbi të gjitha elementet e të drejtave të njeriut që mund të jenë shkelur me vendimin e ZRR-E-së për përcaktimin e strukturës tarifore në koordinim me përkushtimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës (më tej: Qeveria) për ta subvencionuar

164 Udhëzimi administrativ MMPH – nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor.

165 Udhëzimi administrativ nr. 33/2007 për akses në objektet ndërtimore për personat me aftësi të kufizuara.

166 Zyra e Rregullatorit për Energji (2021), Njoftim për medie në lidhje me hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm tarifor, Prishtinë: ZRR-E.

tarifën. Gjithashtu kemi shikuar praktikën e vendeve evropiane dhe të vendeve të tjera për përcaktimin e tarifave në tregje të rregulluara dhe të parregulluara.

Kosova është palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë qysh nga viti 2006 dhe si e tillë duhet ta përfaqësojë dhe zbatojë legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) i renditur në nenin 10 të Traktatit që themelon Komunitetin e Energjisë. Për më tepër, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) e vitit 2016, për sa i përket energjisë, e vendos Komunitetin e Energjisë në bazën e integritit të Kosovës në tregjet energjetike të BE-së. Neni 114 – Energjia - thekson se bashkëpunimi do të fokusohet në fushat me prioritet që lidhen me acquis të Komunitetit në fushën e energjisë dhe do të bazohet në Traktat me qëllim të integritit gradual të Kosovës në tregjet energjetike të Evropës. Më tej prioritetet afatmesme të acquis-it, Kapitulli 15 – Energjia, dhe Kapitulli 21.

Duke qenë palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, legjislacioni i zbatueshëm drejtpërdrejt në nivel të Komunitetit ka zbatim të drejtpërdrejtë në Kosovë. Ky legjislacion përfshin edhe dispozitat për promovim të konkurrencës së ndershme dhe qasje të lehtë për furnitorë të ndryshëm dhe nxitja e kapaciteteve për prodhim të ri të energjisë elektrike duhet të jetë i një rëndësie të madhe për shtetet anëtare, në mënyrë që të lejohen konsumatorët të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e një tregu të brendshëm të liberalizuar të energjisë elektrike.<sup>167</sup>

Kosova ndodhet gjithashtu përballë kontekstit të nënshkrimit të Deklaratës së Samitit të Sofjes për zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Kosovën. Kjo deklaratë ndër të tjera bën thirrje që vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, t'i informojnë konsumatorët dhe ta zbatojnë legjislacionin për mbrojtjen e tyre. Gjithashtu, gjatë vitit 2022 dhe deri në vitin 2023, Kosova pritet ta përmbyllë miratimin e Strategjisë së Energjisë dhe të Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë, dokumente këto që gjithashtu do t'i përshpejtojnë reformat në tregun e energjisë përfshirë në dizajnin e tregut dhe promovimin e një tregu plotësisht konkurrues.

Në këtë opinion Avokati i Popullit nxjerr përfundimin se Republika e Kosovës, si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, është e përkushtuar dhe ka marrë obligime për një treg të liberalizuar të energjisë, një treg që avancojnë konkurrencën, transparencën dhe mbrojnë të drejtat e konsumatorëve. Për të arritur deri tek ky treg, Kosova ka miratuar një Udhëzues të Liberalizimit të Tregut, i cili përcakton afate kohore deri kur grupet e konsumatorëve, të lidhura në tension të ndryshëm, duhet të kalojnë në tregun e hapur. Kosova gjithashtu është e obliguar me legjislacionin horizontal për garantimin e të drejtave të konsumatorit, përfshirë të drejtën në informim dhe të drejtën për mbrojtje të interesave ekonomike të konsumatorëve.

Në Kosovë ka pasur një proces historik të vendosjes së strukturës tarifore dhe rregullimi i çmimeve përmes bllok-tarifave ka qenë një praktikë e pranishme edhe në të kaluarën. Para vitit 2017, karakteri i strukturës tarifore me blloqe ka qenë më social duke paraparë edhe shkallë të çmimit nën koston e prodhimit, gjë që është ndaluar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe me Ligjin për Energjinë Elektrike. Struktura tarifore e vitit 2021 është gjithashtu unike për shkak të kufirit të konsumit deri në 800 kw dhe mbi 800 kw, gjë që nuk ka qenë para vitit 2017.

167 THE ENERGY COMMUNITY LEGAL FRAMEWORK 4.2 Edition – faqe 69.

Blllok-tarifa në sistemin tonë të brendshëm nuk është paraparë me legjislacion, por përkundrazi, dispozitat e Ligjit për Energjinë, të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, që rrjedhin nga pakoja e tretë evropiane e legjislacionit për energjinë, inkurajojnë çmime të çrregulluara dhe konkurrencë në treg. Për më tepër, ZRrE-ja, ndonëse arsyeton vendimin me nevojën për stimuj të efikasitetit të energjisë, neni 20 i Ligjit për Efikasitetin e Energjisë përcakton vetëm obligimin që ZRrE-ja të ketë parasysh stimuj për përmirësimin e efikasitetit të rrjetit dhe atë ndaj operatorëve të tregut të energjisë dhe jo ndaj kategorive të ndryshme të konsumatorëve bazuar në konsum.

Vendimi për faturim retroaktiv dhe mosreflektimi i saj në faturë si dhe mosreflektimi i nivelit të subvencionimit në faturë përbën gjithashtu shkelje të së drejtës së konsumatorëve për informim.

Vendimi i ZRrE-së ka elemente të diskriminimit dhe të trajtimit të pabarabartë ndaj konsumatorëve. Tarifat e ndryshme e të bazuara në nivel të konsumit të energjisë elektrike janë në kundërshtim me nenin 47 të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, ku theksohet domosdoshmëria që tarifat të kenë karakter jodiskriminues. Vendimi i ZRrE-së për t'i përjashtuar konsumatorët e veriut të Kosovës nga shtrenjtimi i rrymës krijon situatë të diskriminimit të pjesës tjetër të konsumatorëve. Gjithashtu subvencionimi mes kategorive të konsumatorëve me çmime të rregulluara vë gjithashtu ZRrE-në në pozicion diskriminues.

Blllok-tarifa është një praktikë e tregjeve të reja të energjisë dhe e tregjeve me karakter qendror dhe të pa decentralizuar. Pakoja e tretë e legjislacionit të energjisë vë theksin te liberalizimi i tregut dhe heqja e diskriminimit mes kategorive të konsumit. Mbështetja ndaj konsumatorëve të cenueshëm dhe të kategorive të tjera sociale bëhet përmes skemave të tjera dhe jodiskriminuese dhe jo përmes subvencionimit të drejtpërdrejtë në tarifë. Në asnjërin prej vendeve të BE-së blllok-tarifa nuk aplikohet dhe ruhet karakteri i trajtimit të barabartë të konsumatorëve.

Faturimi pa njehsor dhe përcaktimi i një tarife të konsumit për konsumin pa njehsor bie ndesh me legjislacionin në fushën e energjisë, në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe me vetë rregullativën e Zyrës së Rregullatorit për Energji. Konsumatorët kanë probleme edhe me cilësinë e shërbimit, por edhe me faturimin paushall dhe me faturimin që nuk korrespondon me sasinë e shpenzuar të energjisë. Andaj duhet që të fuqizohen kapacitetet monitoruese për ta ndaluar faturimin pa njehsor. Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të sigurojë që kapacitetet e stafit për monitorim dhe menaxhim të ankesave të qytetarëve shtohen në mënyrë që të mos lejohen faturime paushall dhe pa njehsor të kalibruar që matin energjinë e shpenzuar. Në paketë e reja të paralajmëruara të legjislacionit të fushës së energjisë, të fuqizohen dispozitat që ndalojnë ZRrE-në dhe ndërmarrjet e energjisë nga përcaktimi i tarifave pa njehsor apo aplikimi i faturimit paushall.

Nuk ka një përcaktim të qartë në legjislacionin tonë dhe në kornizën e politikave sa i përket varfërisë energjetike dhe se kush mund të konsiderohet konsumator i cenueshëm. Një ndër çështjet kryesore që një ndryshim kaq rrënjësor i strukturës tarifore dhe i çmimeve do të duhej ta kishte parasysh është çështja e përballimit të çmimeve. Megjithatë, pa një mekanizëm adekuat, siç e ka paraparë ligji, nuk mund të zbuten efektet e rritjes për ata që kanë më së shumti nevojë. Në të kundërtën, përfundohet duke diskriminuar. Prandaj Qeveria duhet urgjentisht ta themelojë Fondin e Konsumatorëve në Nevojë. Pakoja e re e paralajmëruar e legjislacionit në fushën e energjisë të përcaktojë qartësisht kufirin e varfërisë energjetike dhe ta ndërlikojë atë me të hyrat familjare, në mënyrë që mbështetja për konsumatorët e cenueshëm të jetë e qëndrueshme, dinamike dhe të reflektojë situatën socio-ekonomike të tyre pa diskriminuar të tjerët.

Ligji për Obiliqin, në pjesën e vendosjes së tarifave më të ulëta të energjisë për konsumatorët fundorë, nuk ka gjetur zbatim deri më tani dhe ndonëse qytetarëve të Obiliqit u ishte krijuar pritja se do të kishte çmime të reduktuara të energjisë. Ligji bie ndesh me legjislacionin aktual në fushën e energjisë dhe nuk ka pasur përpjekje për harmonizimin e tyre deri më tani. Në shqyrtimet e pakos së ardhshme të legjislacionit të energjisë duhet të bëhet harmonizimi i ligjeve të energjisë me Ligjin për Obiliqin ose anasjelltas. Duhet kuptuar që lehtësirat në uljen e çmimit të rregulluar janë vështirë të zbatueshme, pasi shkaktojnë diskriminim mes konsumatorëve, porse modalitete mund të gjinden përmes Fondit të Konsumatorëve në Nevojë.

Vendimi i ZRrE-së për shtrenjtim seleksionues të çmimit të energjisë për vendosje të bllok-tarifave dhe vendimi për subvencionim gjithashtu seleksionues bien në kundërshtim me parimet e vendosjes së tarifave të përshkruara në legjislacionin vendor, me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë në Vjenë dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit. Masat afirmative të vendosura në vendimin e ZRrE-së nuk i gëzojnë njëjtë të gjithë konsumatorët me çmime të rregulluara dhe nga shtrenjtimi nuk preken njëjtë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

## **Opinion i Avokatit të Popullit për rastin ex officio nr. 307/2022, lidhur me njohjen e marrëdhënieve familjare të personave me sekse të njëjta me Projektkodin Civil**

Ky Opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, përkatësisht i të drejtave që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës e që kanë të bëjnë me marrëdhëniet familjare për personat me sekse të njëjta. Projektkodi Civil, në Librin e katërt, në pjesën e dytë rregullon çështjet familjare, si: fejesa, martesë dhe bashkëjetesa, definicione këto që njohin vetëm raportet mes personave me sekse të kundërta. Drafti aktual i Projektkodit Civil të Republikës së Kosovës,<sup>168</sup> në Librin e katërt rregullon marrëdhëniet familjare, përkatësisht fejesën (neni 1133), martesën (neni 1138) dhe bashkëjetesën (neni 1164).

Avokati i Popullit vlerëson se Kushtetuta e përcakton të drejtën e secilit që t'i respektohet jeta private dhe familjare e po ashtu i garantohet secilit individ mbrojtja nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual, dhe po ashtu ajo i garanton secilit të drejtën për t'u martuar dhe për të krijuar familje.

Avokati i Popullit vëren se fejesën, martesën dhe bashkëjetesën, Projektkodi Civil i përkufizon si *marrëdhënie dypalëshe ndërmjet personave të sekseve të ndryshme*. Shih përkatësisht nenin 1138, paragrafi 1 (*"Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht ndërmjet dy bashkëshortëve të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku si burrë e grua"*), nenin 1133 (*"Fejesa është premtim i përbashkët i dy personave me sekse të kundërta për t'u martuar në të ardhmen"*), dhe nenin 1164, paragrafi 1 (*"Bashkëjetesa e një burri dhe një gruaje është marrëdhënie faktike ndërmjet një burri madhor të pamartuar dhe një gruaje madhore të pamartuar, të cilët haptazi jetojnë bashkë, e karakterizuar me jetën dhe punën e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdimësi"*).

168 Projekt – Kodi Civil i Republikës së Kosovës, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,94>

Avokati i Popullit vlerëson se përkufizimi i marrëdhënieve të martesës, fejesës dhe bashkëjetesës në bazë të seksit, paraqet shkelje të së drejtës për të mos u diskriminuar në bazë të orientimit seksual. Projektkodi Civil duhet të përkufizojë tri marrëdhëniet në diskutim *pa iu referuar konceptit të seksit*. Me fjalë të tjera, edhe dy persona të të njëjtit seks duhet të kenë të drejtë që martesë, fejesë apo bashkëjetesë e tyre të njihet ligjërisht, në të njëjtën mënyrë sikurse personave të sekseve të kundërta. Duke përkufizuar tri marrëdhëniet në diskutim mbi bazën e seksit apo gjinisë, *Projektkodi Civil paraqet shkelje të së drejtës për të mos u diskriminuar në bazë të orientimit seksual*.

Privimi i personave me sekse të njëjta nga njohja ligjore e martesës, fejesës dhe bashkëjetesës plotëson qartazi përkufizimin ligjor të diskriminimit. Është e pamohueshme që një përjashtim i tillë: “Zhvleftëson ose cenon njohjen, gëzimin [dhe] ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga (...) ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës” (theks i shtuar). Përkatësisht, sipas Projektkodit aktual, e drejta e dy personave me sekse të njëjta për t’u martuar, për t’u fejuar dhe për të bashkëjetuar, shprehimisht nuk njihet, nuk gëzohet apo nuk ushtrohet në të njëjtën mënyrë me personat me sekse të kundërta. Prandaj, sipas kriterit të përcaktuar nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përkufizimi i tri marrëdhënieve në diskutim paraqet shkelje të së drejtës ligjore për të mos u diskriminuar në bazë të orientimit seksual.

Avokati i Popullit vëren se Projektkodi aktual, në nenin 1138, paragrafi 2, përcakton:

*“Bashkësitë e regjistruara civile ndërmjet personave me sekse të njëjta janë të lejuara. Kushtet dhe procedura rregullohen me ligj të veçantë.”*

Megjithatë, Avokati i Popullit vlerëson se formulimi aktual i Projektkodit Civil për lejimin e bashkësive të regjistruara civile ndërmjet personave me sekse të njëjta, pa e definuar qartë se çfarë paraqet një “bashkësi e regjistruar civile” dhe duke përcaktuar se kushtet dhe procedura për njohjen e këtyre bashkësive do të rregullohen me ligj të veçantë, nuk paraqet zgjidhje dhe nuk i reflekton të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

Mirëpo, Avokati i Popullit konsideron se vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) për sa i përket çështjes së martesave të personave me sekse të njëjta, nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për të konstatuar se dispozitat përkatëse të Projektkodit nuk janë diskriminuese në bazë të orientimit seksual. Kjo është për arsye se dy bazat specifike për vlerësimin e GjEDNj-së mbi këtë çështje nuk janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Së pari, GjEDNj ka marrë vendim për të mos njohur të drejtën e martesës së personave me sekse të njëjta, për shkak se neni 12 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) përcakton: *“Burri dhe gruaja që kanë mbushur moshën për martesë kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.”* Përderisa Konventa mbron vetëm të drejtën e martesës ndërmjet burrit dhe gruas, gjykata nuk ndihej e lirë të konstatonte se mosnjohja e martesave të personave me sekse të njëjta ishte diskriminuese (shih *Schalk dhe Kopf, op. cit., § 55*).

Çështja është pak me e ndërlikuar në nivelin kushtetues, për arsye se GjEDNJ-ja ende nuk ua ka njohur personave me sekse të njëjta të drejtën për t'u martuar, sipas KEDNJ-së. Në këtë drejtim, *shih, p.sh., Schalk dhe Kopf kundër Austrisë*, Aplikimi Nr. 30141/04 (2010), § 108; *Chapin dhe Charpentier kundër Francës*, Aplikimi Nr. 40183/07 (2016), § 39; dhe *Orlandi dhe të tjerë kundër Italisë*, Aplikimet Nr. 26431/12, 26742/12, 44057/12 dhe 60088/12 (2017), § 192.

Mirëpo, Kushtetuta e Republikës së Kosovës dallon prej KEDNJ-së në këtë drejtim. Sipas nenit 37 të Kushtetutës: “Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin.” Prandaj ndryshe nga KEDNJ-ja, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke mos përcaktuar shprehimisht se e drejta e martesës është e drejtë e “burrit dhe gruas”, nuk paraqet asnjë pengesë për të konstatuar se privimi i personave me sekse të njëjta nga e drejta e martesës paraqet shkelje të së drejtës për të mos u diskriminuar në bazë të orientimit seksual.

Arsyeja e dytë pse GjEDNJ-ja ende nuk e ka njohur të drejtën e personave me sekse të njëjta për t'u martuar është se ende nuk ekziston një konsensus evropian për ta njohur këtë të drejtë. Në këto rrethana, sipas gjykatës, Shtetet Palë gëzojnë një diskrecion (“margin of appreciation”) të gjerë për të vendosur për ose kundër njohjes të së drejtës së martesës mes personave me sekse të njëjta.

Njësoj sikur me arsyen e parë, edhe kjo arsye nuk është e aplikueshme në Republikën e Kosovës. GjEDNJ-ja e ka përgjegjësinë për ta interpretuar Konventën për tërë 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Për këtë arsye, sipas doktrinës së “margin of appreciation”, njohja e të drejtave të reja, në nivelin rajonal të Këshillit të Evropës, është detyrimisht e kufizuar në rastet ku nuk ka një konsensus të gjerë mes shteteve të Këshillit të Evropës për t'i njohur këto të drejta të reja. Mirëpo kjo nuk paraqet asnjë pengesë që një shtet individual, sikurse Republika e Kosovës, të njohë një të drejtë në nivelin kombëtar, në bazë të Kushtetutës së vet dhe ligjeve të veta, edhe pse GjEDNJ-ja ka vlerësuar se nuk ka një konsensus mjaft të gjerë për ta njohur atë të drejtë në nivelin rajonal.

Për këto arsye, vendimet e lartpërmendura të GjEDNJ-së në këtë fushë nuk janë vendimtare në vlerësimin kushtetues të Projektkodit. Në vend të kësaj, në mënyrë që të konstatohet nëse Projektkodi, duke mos lejuar martesat e personave me sekse të njëjta, paraqet shkelje të së drejtës kushtetuese për të mos u diskriminuar në bazë të orientimit seksual, kriteret e mosdiskriminimit të përcaktuara nga GjEDNJ-ja duhet të shqyrtohen në nivelin kombëtar të Kosovës, jo në nivelin rajonal të Këshillit të Evropës.

Sipas kriterëve të GjEDNJ-së: “E drejta (...) për të mos u diskriminuar (...) shkelet kur Shtetet trajtojnë në mënyrë jo të barabartë persona në situata të ngjashme pa dhënë një justifikim objektiv dhe të arsyeshem” (*Thlimmenos v. Greece*, Aplikimi Nr. 34369/97 (2000), § 44). Dhe në mënyrë që një justifikim i tillë të jetë “objektiv dhe i arsyeshem”, duhet t'i kalojë dy hapa të tjerë: Së pari, duhet të ketë një “qëllim legjitim” për pabarazinë në fjalë; dhe, së dyti, duhet të ketë një “lidhje të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjetit të përdorur dhe qëllimit të synuar” (“*Relating to Certain Aspects of the Laws on the Use of Languages in Education in Belgium*” kundër Belgjikës, Aplikimet Nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63, 2126/64 (1968), § 10; *shih gjithashtu X dhe të tjerë kundër Austrisë*, Aplikimi Nr. 19010/07 (2013), § 98).

Avokati i Popullit vëren se nuk është e qartë në Projektkod se cilit qëllim legjitim do t'i shërbente mosnjohja e martesave të personave me sekse të njëjta. Po ashtu nuk është e qartë nëse hartuesit e Projektkodit i



kanë marrë parasysh këto pesë kritere kur kanë vendosur t'i privojnë personat me sekse të njëjta nga njohja ligjore e së drejtës së martesës.

Avokati i Popullit vëren se në mungesë të një qëllimi legjitim për përjashtim të çifteve me sekse të njëjta dhe në mungesë të shqyrtimit eksplicit të pesë kritereve të lartpërmendura, Projektkodi paraqet shkelje të së drejtës kushtetuese për të mos u diskriminuar në bazë të orientimit seksual. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se Ministria e Drejtësisë duhet ta rishqyrtojë njohjen e martesave të personave me sekse të njëjta gjatë fazës së rishikimit të Projektkodit.

GjEDNj-ja e ka bërë të qartë se dështimi i një shteti për t'ua dhënë personave me sekse të njëjta mundësinë e njohjes ligjore të marrëdhënieve të tyre, qoftë edhe në formë jomartesore, paraqet shkelje të kësaj të drejte. Për shembull, në rastin *Oliari dhe të tjerë kundër Italisë*, Aplikimet Nr. 18766/11 dhe 36030/11 (2015), gjykata konstatoi se Qeveria e Italisë “dështoi të përmbushte obligimin e saj për të siguruar që aplikuesit të kenë në dispozicion një kornizë ligjore specifike që jep njohjen dhe mbrojtjen e marrëdhënieve të tyre të seksit të njëjtë” (po aty, § 185; shih gjithashtu *Orlandi*, op. cit., § 210).

Në të njëjtën mënyrë, edhe Projektkodi “dështon të përmbushë obligimin e [Republikës së Kosovës] për të siguruar që [personat me sekse të njëjta] të kenë në dispozicion një kornizë ligjore specifike që jep njohjen dhe mbrojtjen e marrëdhënieve të tyre të seksit të njëjtë”.

Ky dështim i Projektkodit nuk mund të justifikohet me anë të nenit 1138, par. 2, i cili përcakton: “Format tjera të bashkësive civile rregullohen me ligj të veçantë.” Kjo është për tri arsye:

Së pari, përderisa Libri i Katërt i Projektkodit pretendon të rregullojë marrëdhëniet familjare në përgjithësi, atëherë duhet parimisht të gjejë një vend edhe për njohjen e marrëdhënieve të personave me sekse të njëjta, sidomos duke marrë parasysh se GjEDNj-ja ka kërkuar një njohje të tillë pikërisht si pjesë e së drejtës për respektimin e jetës familjare.

Së dyti, mospërfshirja e “formave të tjera të bashkësive civile” në Projektkod duket edhe më e çuditshme duke qenë se Projektkodi, edhe në *versionin aktual*, i jep njohje ligjore një forme tjetër të bashkësisë jomartesore, përkatësisht, asaj të bashkëjetesës jomartesore të një burri dhe një gruaje: “Bashkëjetesa e një burri dhe një gruaje është marrëdhënie faktike ndërmjet një burri madhor të pamartuar dhe një gruaje madhore të pamartuar, të cilët haptazi jetojnë bashkë, e karakterizuar me jetën dhe punën e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdimësie” (po aty, neni 1164, par. 1); “Bashkëjetesa e një burri dhe një gruaje është e barabartë me statusin e bashkëshortëve martesorë nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve për përkujdesje, mbështetje financiare të ndërsjellë, dhe të drejtave pasurore ashtu siç është saktësuar në këtë Kod” (po aty, neni 1164, par. 2). Përderisa ekziston një dispozitë e tillë në Projektkod, Avokati i Popullit e konsideron të pajustificueshme mospërfshirjen e dispozitave të ngjashme që u japin njohje edhe marrëdhënieve të personave me sekse të njëjta, qoftë edhe në formë jomartesore.

Së treti, mosnjohja në Projektkod e çifteve me sekse të njëjta garanton që këto çifte do të duhet të presin edhe më gjatë derisa të respektohet plotësisht e drejta e tyre kushtetuese për respektimin e jetës familjare. Dhe, sigurisht, sa më shumë kohë që të kalojë, aq më shumë do të rritet mundësia që “ligji i veçantë”, i premtuar në nenin 1138, nuk do të hartohet apo miratohet fare, duke e lënë Republikën e Kosovës në mospajtim me kërkesat e nenit 36 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të KEDNj-së.



Avokati i Popullit konstaton se sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, secili person ka të drejtë të martohet dhe të krijojë familje në pajtim me ligjin. Përderisa Libri i Katërt i Projektkodit synon t'i rregullojë marrëdhëniet familjare në përgjithësi, atëherë duhet ta përfshijë edhe njohjen e marrëdhënieve të personave me sekse të njëjta, në mënyrë që të respektohet parimi i barazisë para ligjit në rregullimin e marrëdhënieve familjare. Prandaj, dispozitat e Projektkodit Civil, me të cilat rregullohen marrëdhëniet familjare, duhet shprehimisht të përcaktojnë njohjen e marrëdhënieve familjare të personave me sekse të njëjta.

### **Raport për rastin A. nr. 676/2021 lidhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2020 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna**

Raporti është ndërtuar mbi bazën e ankesës individuale parashtruar kundër MAPL-së, përkitazi me UA nr. 02/2020, përkatësisht nenin 8, paragrafi 3. Qëllim i këtij raporti është të tërheqë vëmendjen së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (në tekstin e mëtejme: MAPL), lidhur me shkeljen e të drejtave të komuniteteve joshumicë me Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 02/2020 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna (në tekstin e mëtejme: UA nr. 02/2020).

UA nr. 02/2020, përkatësisht nenit 8 [Kushtet për emërimin e nënkyetarëve], paragrafi 3, përcakton: *“Nënkyetari i Komunës për komunitete emërohet nga radhët e komunitetit jo shumicë, i cili për nga numri përbën komunitetin jo shumicë më të madh në komuna.”*

Avokati i Popullit theksoi se Kushtetuta e Republikës së Kosovës u garanton komuniteteve joshumicë zëvendëskryetarin për komunitete të kuvendit komunës në rastet kur së paku 10% të qytetarëve u përkasin komuniteteve joshumicë dhe vëren se Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ua ka njohur komuniteteve të drejtën që ta kenë një nënkyetar komune për komunitete nëse të paktën 10 për qind e qytetarëve të asaj komune u përkasin komuniteteve joshumicë. Sipas këtij përcaktimi, ligji nuk bën ndarjen e komuniteteve joshumicë, mirëpo e përcakton atë si tërësi, e cila duhet të jetë jo më pak se 10 për qind e të gjithë qytetarëve të një komune. Sipas vlerësimit të Avokatit, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale ka bartur frymën kushtetuese, e cila ka rregulluar çështjen e nënkyetarit për komunitete të kuvendit komunal, sepse njëjtë Kushtetuta u është referuar si tërësi qytetarëve që i përkasin komunitetit joshumicë, pa e bërë dallimin mes komuniteteve.

Fryma e dispozitave të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, deri diku, është bartur edhe tek UA nr. 02/2020, tek e drejta e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë që ta kenë një nënkyetar komune për komunitete, nëse të paktën 10 për qind e qytetarëve të asaj komune u përkasin komuniteteve joshumicë.

Për më tepër, Avokati i Popullit konsideron se UA nr. 02/2020 ka avancuar për sa u përket mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve joshumicë, sepse e ka lënë mundësinë e komunave që varësisht nga mundësitë financiare, ta emërojnë nënkyetarin e komunës për komunitete edhe në rastet kur numri i qytetarëve është më i vogël se 10% e popullatës së komunës.

Mirëpo neni 8, paragrafi 3, i UA nr. 02/2020 duket se komuniteteve joshumicë, që nuk e përbëjnë komunitetin më të madh joshumicë, ua mohon mundësinë që ta kenë nënkyetarin për komunitete nga radhët e veta. Si rrjedhojë e kësaj, Avokati i Popullit konsideron se neni 8, paragrafi 3, i UA nr. 02/2020

nuk është në harmoni me Ligjin nr. 04/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përkatësisht nenin 61, paragrafi 1, dhe se i njëjti duhet të ndryshohet.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit konstaton se çfarëdo kufizimi në Udhëzimin Administrativ, sipas të cilit do t'i jepej përparësi ndonjërit nga komunitetet joshumicë për propozimin e nënkryetarit të komunës për komunitete, e cenon të drejtën e komuniteteve të tjera joshumicë, që nuk janë komuniteti më i madh joshumicë, që ta propozojnë nënkryetarin e komunës për komunitete. Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit ka vërejtur mospërputhje edhe mes dispozitave të UA nr. 02/2020, përkatësisht mospërputhje mes nenit 6, paragrafi 1, dhe nenit 8, paragrafi 3.

Përderisa neni 6, paragrafi 1, i UA nr. 02/2020 përcakton se kryetari i komunës ia propozon kuvendit të komunës për emërim kandidatin për nënkryetar për komunitete, në konsultim me të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve në komunë (theks i shtuar), neni 8, paragrafi 3, këtë të drejtë ia njuh komunitetit joshumicë që për nga numri e përbën komunitetin joshumicë më të madh.

Në këtë rast, Avokati i Popullit konsideron se neni 6, paragrafi 1, i UA nr. 02/2020 e ka bartur frymën e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, përkatësisht frymën e nenit 61, paragrafi 1, i cili i ka paraqitur komunitetet joshumicë si tërësi, sepse shprehimisht e ka përcaktuar se numri i tyre duhet të jetë së paku 10 për qind e qytetarëve të një komune, ndërsa neni 8, paragrafi 3, i UA nr. 02/2020 bie në kundërshtim me nenin 61, paragrafi 1, sepse përcakton se kandidati duhet t'i takojë komunitetit joshumicë që për nga numri përbën komunitetin joshumicë më të madh.

Për këtë Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që të ndryshojë Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 02/2020 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, përkatësisht ta fshijë paragrafin 3 të nenit 8, si dhe në nenin 8 ta shtojë një paragraf të ri, i cili do jetë në harmoni me nenin 61, paragrafi 1, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, për sa u përket kushteve për emërimin e nënkryetarëve të komunës për komunitetet joshumicë.

## **Raport për rastin A. nr. 125/2021 lidhur me kriterin diskriminues në Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”**

Raporti ka për qëllim identifikimin e shkeljeve dhe ofrimin e rekomandimeve me qëllim që të rivendoset e drejta e shkelur nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (në tekstin e mëtejme: UP) lidhur me kriterin e vendosur në Shtojcën IV, pika a [*vlerësimi kuantitativ i aktiviteteve të kandidatëve, të cilët emërohen për herë të parë në thirrjen prof.ass.dr.*], të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, me nr. prot.886, datë 27.4.2022 (më tej: Rregullorja nr. prot 886). Si dhe me kriterin e vendosur në Shtojcën V, pika a (fusnota 13) [*vlerësimi kuantitativ i kandidatëve, të cilët emërohen për herë të parë në thirrjen asistent, lektor dhe korepetitor*], të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” (nr. prot.887, datë 27.04.2022) (më tej: Rregullorja nr. prot 887).

Avokati i Popullit vlerëson se kriteri i përcaktuar me fusnotën 15 të Rregullores me nr. prot. 886 dhe në fusnotën 13 të Rregullores me nr. prot.887 lidhur me përparësinë e kandidatëve që studimet i kanë përfunduar në UP ndaj atyre kandidatëve që studimet i kanë përfunduar në institucione të tjera të arsimit të lartë në Kosovë dhe në vende fqinje nuk ka mbështetje në Statutin e UP-së dhe as në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dhe se kriteret të tilla diskriminuese nuk mund të vendosen me asnjë akt normativ, qoftë të UP-së apo të legjislacionit në përgjithësi.

Avokati i Popullit vlerëson se diplomat e fituara në institucionet e arsimit të lartë që lëshohen nga universitete publike në Republikën e Kosovës dhe në kolegje private të akredituara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim vlejnë njëjtë sikur diplomat e fituara në UP. Në anën tjetër, diplomat e fituara jashtë vendit i nënshtrohen një procedure për njohje dhe barasvlerë në institucione përkatëse sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme në vend, prandaj secila diplomë që me sukses e kalon këtë procedurë konsiderohet e barasvlerë me një diplomë të fituar në UP. Prandaj kriteri i vendosur përmes fusnotave 15 në Shtojcën IV të Rregullores me nr. prot.886 dhe në fusnotës 13 të Shtojcës V të Rregullores me nr. prot. 887, paraqesin pengesë për kandidatët të cilët studimet nuk i kanë përfunduar në UP.

Avokati i Popullit konsideron se nuk ekziston një *lidhje e arsyeshme e proporcionalitetit*, sepse vendosja e kriterit të tillë përjashtues, me qëllim të vlerësimit të shkollimit cilësor dhe kriterëve të tjera përkatëse do të duhej të ishte detyrë e komisioneve vlerësuese pa paragjykuar vendin ku është kryer shkollimi dhe jo që apriori të paraqitet pengesë për kandidatët potencialë në procedurën për emërim, riemërim ose avancim në pozita përkatëse. Duke u nisur nga këto që u thanë, Avokati i Popullit i rekomandoi Senatit dhe rektorit të Universitetit të Prishtinës që Senati të fshijë fusnotën nr. 15 në Shtojcën IV të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. prot.886, datë 27.4.2022, dhe po ashtu të fshijë edhe fusnotën nr. 13 në Shtojcën V të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. prot.887, datë 27.4.2022.

## **Raport për rastin A. nr. 444/2021 lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim**

Raporti bazohet në ankesë individuale të parashtruar nga drejtori ekzekutiv i Institutit për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (në tekstin e mëtejme: IKAF), sipas vlerësimit të të cilit dispozitat e nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33, paragrafi 3, të Ligjit nr. 06-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim janë dispozita diskriminuese dhe duke qenë të tilla kërkohet që ato të ndryshohen. Raporti ka për qëllim t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim dhe Auditim, harmonizimin me Kushtetutën dhe me Ligjin nr.05-L/021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi të dispozitave të nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33, paragrafi 3, me të cilat parashihet anëtarësimi në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve i shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe të auditimit dhe pasojat e mosrespektimit të kërkesave për këtë anëtarësim.

Në ankesën e tij, IKAF-i theksonte se shoqata profesionale me status të organizatave joqeveritare është themeluar në vitin 2005 me qëllim të kryerjes së aktiviteteve edukative, përkatësisht për ofrimin e arsimit dhe certifikimit profesional në çështjet e kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar. IKAF-i është

licencuar në vitin 2013 në bazë të Ligjit nr. 04-L/014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, i cili asokohe ishte i vlefshëm. Licencimi i IKAF-it është bërë nga autoriteti kompetent – Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF), pas konfirmimit se IKAF-i ka përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara me ligj dhe ka plotësuar standardet, udhëzimet dhe rekomandimet e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (në tekstin e mëtejshëm: FNK) dhe se anëtarët e shoqatës veprojnë në pajtueshmëri me Kodin e Mirësjelljes Profesionale dhe me Kodin e Etikës të FNK-së. Këto kushte kanë qenë të parapara me ligjin në fuqi në kohën e licencimit dhe kushte identike parasheh edhe ligji aktual në fuqi, Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim dhe Auditim, në nenin 33.

IKAF-i më tej thekson se dispozita e ligjit aktual në fuqi, Ligji nr. 06/L-032, neni 3, paragrafi 1, pika 1.13, shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe të auditimit ua vendos kushtin e anëtarësimit të detyrueshëm në FNK. Sipas tyre, detyrimi për t'u anëtarësuar në FNK, e cila është një shoqatë profesionale ndërkombëtare, nuk mund të jetë një kriter ligjor imperativ për një shoqatë profesionale, e cila është licencuar nga KKRF-ja.

IKAF-i thekson se shoqatat profesionale të cilat ofrojnë veprimtari edukative për kualifikime profesionale në fushën e kontabilitetit dhe të auditimit, duhet të ofrojnë edhe shërbime arsimimi profesional në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të parapara nga ana e FNK-së. Mirëpo respektimi i këtij kushti nuk mund ta imponojë detyrimin e anëtarësimit duke pasur parasysh se ai nuk ka efekt juridik, sepse mbikëqyrjen e shoqatave të kontabilistëve dhe të auditorëve e bën KKRF-ja.

Në këtë raport Avokati i Popullit vlerësoi se legjislacioni kundër diskriminimit parasheh parimin e barazisë pa asnjë diskriminim, duke përfshirë diskriminimin në bazë të asociimit, kështu që është e rregulluar që të gjithë janë të barabartë dhe gëzojnë status të barabartë dhe mbrojtje të barabartë juridike, pavarësisht nga karakteristikat personale, prandaj secili është i detyruar ta respektojë parimin e barazisë, përkatësisht ndalimin e diskriminimit. Diskriminimi në bazë të asociimit nënkupton që palët e treta diskriminohen edhe pse nuk i përkasin një grupi të caktuar, por janë palët e treta që lidhen me ato grupe.

Në rastin konkret, shoqatat që nuk janë anëtare të FNK-së trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se ato që janë anëtare të FNK-së. Anëtarësimi i detyrueshëm dhe kushtëzimi për vazhdimin e licencës me anëtarësim në FNK është një karakteristikë që diskriminon palët e treta joanëtare. Me zbatimin e një praktike të tillë, shoqatat që nuk janë anëtare të FNK-së diskriminohen pa arsye objektive dhe të arsyeshme, sepse ato trajtohen ndryshe për faktin se nuk janë anëtare të FNK-së, që është një karakteristikë përcaktuese që çon në trajtimin e tyre të pabarabartë dhe trajtimin e pabarabartë të anëtarëve e tyre, në raport me shoqatat që janë anëtare në FNK.

Me detyrimin për anëtarësim dhe trajtimin siç e rregullon ligji aktual licencimin e shoqatave që nuk janë anëtare të FNK-së vjen deri te diskriminimi i anëtarëve të tyre, të cilët tashmë janë të licencuar ose janë kandidatë për licencim dhe arsimim të vazhdueshëm profesional. Kjo do të thotë se në qoftë se atyre që nuk janë anëtarë të FNK-së do t'u hiqej licenca nga KKRF-ja, kjo automatikisht do të sillte revokim të licencave të anëtarëve të tyre dhe pamundësi për të punuar dhe ushtruar profesionin.

Në rastin konkret, shoqatat profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve diskriminohen pa arsye objektive dhe të arsyeshme dhe vihen në pozitë të pafavorshme në bazë të anëtarësimit në FNK-së. Nga ajo që u tha më sipër, futja e këtij kriteri nuk mund të pranohet si e justifikuar për shoqatat e kontabilistëve dhe auditorëve të Kosovës.

Avokati i Popullit konstaton se Shoqatat e Kontabilitetit dhe Auditimit mund të bëhen anëtare të FNK-së, por anëtarësimi duhet të jetë në baza vullnetare dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të imponohet si imperativ ligjor.

Avokati i Popullit thekson se kushtet për licencimin dhe ushtrimin e profesionit të kontabilistëve dhe të auditorëve duhet të jenë objektive dhe të barabarta për të gjithë dhe nuk duhet të lidhen me natyrën e anëtarësimit në një organizatë ndërkombëtare. Licencimi dhe ushtrimi i profesionit të kontabilistëve dhe të auditorëve duhet të jenë të qasshme për të gjithë qytetarët e kualifikuar në kushte të barabarta, dhe për këtë Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, përkatësisht fshirjen e nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33, paragrafi 3.

### **Opinion i Avokatit të Popullit për kërkesën e Gjykatës Supreme dërguar në Gjykatën Kushtetuese lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të nenit 17, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, që ndërlidhet me nenin 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës**

Gjykata Kushtetuese ia dërgoi Avokatit të Popullit njoftimin për regjistrim të rastit K0147/22, lidhur me kërkesën e parashtruar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, nëpërmjet së cilës kjo gjykatë ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të nenit 17, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, që ndërlidhet me nenin 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Çështja që Gjykata Supreme e ka ngritur si pyetje në Gjykatën Kushtetuese ka të bëjë me atë se a është në përputhshme me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dispozita e nenit 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, e cila parasheh kushtet për zgjedhjen në pozitën profesor asistent ku thuhet: *“1.6 Kandidati i cili zgjidhet për herë të parë, nuk duhet të jetë më i vjetër se 50 vjet.”*

Gjykata Themelore në Prishtinë, si gjykatë e shkallës së parë, me Aktgjykimin C.nr.35/2019, datë 17 dhjetor 2020, e kishte aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e kishte anuluar Vendimin numër 4/472 të Senatit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, datë 5 tetor 2018, si të kundërligjshëm. Gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se aplikimi i nenit 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës është diskriminues dhe në kundërshtim me dispozitat e neneve 22, 24 dhe 53 të Kushtetutës, me nenin 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, me dispozitat e Ligjit nr.03/L-212 të Punës, me Ligjin nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe me Ligjin nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.

Duke vepruar sipas ankesës së të paditurit, Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, me Aktgjykimin Ac.nr.1360/2021, datë 9 qershor 2021, e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe e kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas revizionit të të paditurit, ka suspenduar procedurën në Gjykatën Supreme të Kosovës deri në nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata Kushtetuese. Gjykata Supreme konsideron se për ta shqyrtuar përputhshmërinë e nenit 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, gjykatat e instancave më të ulëta kanë tejkaluar kompetencën, sepse një tagër i tillë i takon Gjykatës Kushtetuese, e cila sipas Kushtetutës, është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së akteve ligjore me Kushtetutën.

Referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, jo të gjitha dallimet në trajtim, ose dështimi për të trajtuar ndryshëm persona në situata përkatëse të ndryshme, përbëjnë diskriminim, por vetëm ato pa “një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.”<sup>169</sup> Gjatë vendosjes për rastet e diskriminimit, gjykata do ta zbatojë testin: a) A ka pasur dallime në trajtimin e personave në situata analoge apo përkatësisht të ngjashme – apo dështim për të trajtuar ndryshe personat në situata të ndryshme përkatëse? b) Nëse po, a është i justifikuar objektivisht një ndryshim i tillë apo mungesa e dallimit? Veçanërisht a ndjek trajtimi një qëllim legjitim? A janë mjetet e përdorura në mënyrë të arsyeshme proporcionale me qëllimin e ndjekur?

Bazuar në dispozita ligjore të lartpërmendura, Avokati i Popullit thekson se diskriminimi në moshë ndodh kur bazuar në moshën e tij/saj një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa personi i një grupmoshe tjetër, në rrethana të njëjta apo të ngjashme, pa një justifikim objektiv që ndjek një qëllim legjitim.

Për sa i përket funksionimit të bartësit publik të arsimit të lartë, Avokati i Popullit vëren se Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës parasheh në nenin 17, paragrafi 1: “Funksionimi dhe menaxhimi i bartësit publik të arsimit të lartë përcaktohet në statut të propozuar nga ana e Ministrisë dhe të miratuar nga Kuvendi.” Neni 26, paragrafi 1, i të njëjtit ligj specifikon: “Titujt dhe gradat e personelit, kriteret e emërimeve dhe riemërimeve dhe çështje të tjera të lidhura me këto, specifikohen në statutin e çdo bartësi të arsimit të lartë. Ato duhet të jenë [...] në pajtim me legjislacionin në fuqi për marrëdhënien e punës në Republikën e Kosovës.” Pra autonomia e bartësve të arsimit të lartë që vetë të përzgjedhin staf akademik duhet të jetë në përputhje me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.<sup>170</sup>

Sipas nenit 26, paragrafi 3, të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, kandidatët për pozita akademike “duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë një sfond të suksesshëm të mësimdhënies, hulumtimit dhe të praktikës profesionale.” Kjo do të thotë se vetëm kualifikimet profesionale kërkohen sipas ligjit për zgjedhje në pozita akademike, duke përfshirë pozitën e profesorit asistent.

Avokati i Popullit thekson që Kushtetuta dhe ligji i aplikueshëm në Kosovë ndalojnë diskriminimin apo çdo lloj dallimi, përjashtimi, kufizimi ose preference që cenon ushtrimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet e aplikueshme. Në rastin konkret, dispozita e nenit 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, e cila parasheh kushtin e moshës për zgjedhjen në pozitën profesor asistent, nuk mundëson zgjedhjen e kandidatëve më të vjetër se 50 vjeç dhe në këtë mënyrë i diskriminon ata duke i privuar nga gëzimi i së drejtës për punë e garantuar me Kushtetutë.

169 Shih Molla Sali kundër Greqisë [GC], 2018, para. 135; Fabris kundër Francës [GC], 2013, para. 56; D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GC], 2007, para. 175.

170 Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, neni 67 [Organizimi i konkursit], paragrafi 7: “Personel profesional është personeli që kryen dhënien profesionale të shërbimit, si, p.sh. personeli mësimdhënës në institucionet e sistemit arsimor, personeli mjekësor në një institucion të sistemit shëndetësor, etj.”



Mbrojtja e së drejtës për punë nënkupton zbatimin e plotë të kriterit të kapacitetit profesional dhe ofrimin e konkurrencës së hapur dhe të barabartë në procesin e punësimit të të gjithë kandidatëve të interesuar. Prandaj detyrimi për ta respektuar këtë të drejtë kërkon shmangien e masave që e pengojnë ose e parandalojnë gëzimin e së drejtës për punë dhe përfshin respektimin e parimit të barazisë në procedurat e aplikimit për punësim pa kritere diskriminuese.

Barazia në punësim është pjesë e barazisë para ligjit. Prandaj një person, për shkak të ndonjë karakteristike të tij personale, përkatësisht në rastin konkret - të moshës së tij, nuk mund të privohet nga e drejta për punë, pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në rastet kur ekziston një qëllim legjitim dhe duke përdorur mjete proporcionale që ndjekin këtë qëllim legjitim.

Avokati i Popullit vlerëson se dispozita e nenit 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, e cila parasheh kushtet për zgjedhjen në pozitën *profesor asistent* është diskriminuese dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi. Kjo për arsye se dispozita në fjalë kufizon moshën për punësim në pozitën *profesor asistent* në Universitetin e Prishtinës në 50 vjeç, edhe pse Ligji nr.03/L-212 i Punës parashikon që moshja e punësimit në Republikën e Kosovës është 18 deri në 65 vjeç.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për revizion, të paraqitur nga Universiteti i Prishtinës (Rev.nr.505/2022), ka konstatuar se për ta shqyrtuar përputhshmërinë e nenit 177, pika 1.6, të Statutit të Universitetit të Prishtinës me Kushtetutën, gjykatat e instancës më të ulët kanë tejkaluar kompetencën, sepse një tagër i tillë i takon Gjykatës Kushtetuese.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit vëren se Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin për rastin nr. KI 10/22,<sup>171</sup> në vlerësimin lidhur me çështjen e kontrollit të kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së akteve juridike dhe rolin e gjykatave të rregullta në zbatimin e drejtpërdrejtë të normave kushtetuese, ka ritheksuar praktikën e saj, sipas së cilës rezulton që gjykatat e rregullta kanë të drejtë dhe, për me tepër, obligim që gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjykojnë, fillimisht sipas Kushtetutës, e pastaj sipas ligjit. Për me tepër, duke pasur parasysh hierarkinë e normave juridike, gjykatat e rregullta janë të obliguara që t'i interpretojnë normat ligjore në harmoni me normat kushtetuese. (Aktgjykimi për rastin KI 10/22, paragrafi 72).

Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin për rastin nr.KI 10/22, ka vlerësuar se e drejta dhe detyrimi për të zbatuar dhe interpretuar Kushtetutën u njihet të gjitha gjykatave të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, si instancë më e lartë gjyqësore në nivel të republikës. Rrjedhimisht, Kushtetuta autorizimin për të interpretuar Kushtetutën si dhe autorizimin për të interpretuar ligjet në pajtim me Kushtetutën ua njeh të gjitha gjykatave dhe autoriteteve të tjera publike në Republikën e Kosovës. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese është autoriteti i vetëm në Republikën e Kosovës me autorizim ekskluziv kushtetues për ta shfuqizuar një ligj ose normë ligjore si dhe për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me të (Aktgjykimi për rastin KI 10/22, paragrafi 73).

<sup>171</sup> Parashtrues Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ.nr. 115/2021, të 18 nëntorit 2021 (Nr. ref.:AGJ 2040/22), 15 gusht 2022.



## Letër rekomandimi për rastin A. nr. 675/2021, lidhur me ndryshimin e Rregullores 01.Nr. 154 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale të Komunës së Ferizajt dhe harmonizimin e saj me legjislacionin përkatës

Avokati i Popullit në këtë rast trajton ankesën individuale të parashtruar kundër Komunës së Ferizajt, përkitazi me detyrimin që në emër të vërtetimit për humbjen e shtetësisë të paguajë në vlerën prej 50 (pesëdhjetë) eurosh. Ankuesi pohoi se kjo shumë është joligjore, ngase qytetarët e komunave të tjera, të njëjtin vërtetim mund ta siguronin me një shumë simbolike.

Sipas të dhënave, Kuvendi i Komunës së Ferizajt e kishte miratuar Rregulloren Komunale 01 nr. 154 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale<sup>172</sup>, më 30 dhjetor 2019. Rregullorja për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt më 30 dhjetor 2019: *"... ka për qëllim që të caktojë lartësinë e taksave, tarifave, ngarkesave dhe gjobave, për shërbimet e zhvilluara me procedurë administrative në territorin e Komunës së Ferizajt."* (neni 1). *"Kjo rregullore aplikohet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, të cilët marrin shërbime administrative në Komunën e Ferizajt."* (neni 2). Ndërsa sipas nenit 3 të rregullores në fjalë: *"Taksat, tarifat, ngarkesat dhe gjobat e caktuara – shqiptuara sipas kësaj rregullore, aplikohen për lëshimin e dokumenteve publike, përpilimin e shkresave dhe ofrimin e shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve dhe sipas detyrës zyrtare (...)."*

Meqenëse sipas kërkesave të Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, në mesin e akteve të komunave që i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë janë edhe rregulloret e komunës dhe e njëjta i ishte nënshtuar këtij kontrolli. Sipas kësaj rregulloreje, Ministria mund të themelojë një komision ndërministror për shqyrtimin e akteve që prekin fushat e dy e më shumë ministrive. Për këtë qëllim, sekretarja e përgjithshme e MAPL-së, me Vendimin nr. 02-1097, kishte themeluar komisionin ndërministror për vlerësim. Ky komision kishte vlerësuar se Rregullorja Komunale për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Mirëpo, pavarësisht të gjeturave të komisionit në fjalë, e njëjta rregullore vazhdon ende të zbatohet nga autoritetet komunale.

Avokati i Popullit konstaton se rregullorja në fjalë, përveç që përmban shkelje të theksuara të dispozitave të legjislacionit: mbi kompetencën, diskrecionin, tarifin, lartësinë e tyre etj., ajo që e bën më shqetësuese çështjen është fakti se organet komunale nuk kanë ndërmarrë veprime në drejtim të harmonizimit të rregullores edhe me aktet të tjera nënligjore të nxjerra nga niveli qendror.

Brenda kësaj periudhe (2019-2022) janë shfuqizuar, janë nxjerrë, janë ndryshuar si dhe janë plotësuar akte të caktuara, ndër të cilat: Udhëzimi Administrativ (MEA) Nr. 09/2020 për Tarifin e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, i datës 12 nëntor 2020, i cili ishte ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.05/2021, datë 8 dhjetor 2021; Rregullorja (QRK) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e datës 23 tetor 2021 etj., të cilat sinjalizojnë për hapat urgjent që duhet t'i bëjnë autoritetet

172 Rregullorja Komunale 01. nr. 154 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, e datës 30 dhjetor 2019.

e qeverisjes lokale në drejtim të nxjerrjes së akteve komunale, gjithsesi duke i harmonizuar ato me legjislacionin më të ri.

Duke u nisur nga fakti se Rregullorja Komunale 01.Nr.154 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, e datës 30 dhjetor 2019, e Komunës së Ferizajt, nuk është në përputhje me legjislacionin, dhe me qëllim të përmirësimit dhe të rritjes së efikasitetit të autoriteteve të qeverisjes lokale, në kuptim të respektimit të parimit të ligjshmërisë, si një nga premisat themelore të sigurisë juridike, Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Ferizajt që të hartojë Rregulloren e re për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale të Komunës së Ferizajt duke pasur parasysh shkresën e MAPL-së të datës 29 janar 2020, nenin 13, paragrafi 13.1, të Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe të njëjtën Rregullore ta nxjerrë në diskutim publik, në mënyrë që të mundë të adresohen sugjerimet e qytetarëve, siç është edhe rasti që trajtuam më lart.

# E Drejta për Jetën dhe E Drejta e Integritetit Personal

## Raport për rastin ex officio nr. 13/2022 përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën në jetë dhe për të siguruar mbrojtje nga dhuna në familje

Ky rast është iniciuar për hetim sipas detyrës zyrtare duke u bazuar në raportimet e portalit “Gazeta Express”, me titullin: “*Vrasja e gruas në Llaushë të Skënderajt, krejt çka dihet deri tash*”, ku ishte raportua se më 5 janar 2022, në fshatin Llaushë në Skenderaj, ishte gjetur e vrarë me armë zjarri një grua (me inicialet: L. Q.). Raporti ka për qëllim të vlerësojë përmbushjen e detyrimeve pozitive nga ana e autoriteteve përgjegjëse për të mbrojtur të drejtën në jetë të qytetarëve, të analizojë veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve përkitazi me të drejtën për jetë, zbatimin e dispozitave kushtetuese, instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, praktikën e Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, ligjet, politikat dhe strategjitë kundër dhunës në familje.

Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut është thelbësore dhe shumë e rëndësishme për një përgjigje efektive në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Republikën e Kosovë. Përkundër faktit se janë bërë përparime në krijimin e mekanizmave reagues ndaj rasteve të dhunës në familje, ka ende aspekte që kërkojnë vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse, përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën për jetë. Viktimat e dhunës në familje vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme, sidomos nga mosfunksionimi i organeve përgjegjëse për parandalimin e kësaj dukurie shqetësuese, e cila në shumë raste po përfundon me fatalitet.

Kushtetuta, akti më i lartë juridik, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve që t’i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet.

Shteti ka detyrim që t’i ndërmarrë të gjitha masat për ta mbrojtur qytetarin, veçanërisht kur rrezikohet integriteti dhe jeta e njeriut. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në Aktgjykimin KI 41-12, ka gjetur se kishte shkelje të së drejtës për jetë në rastet kur organet kompetente të shtetit nuk u ofronin mbrojtje të mjaftueshme qytetarëve të ekspozuar ndaj dhunës në familje dhe kur për këtë e kërkonin rrethanat e rastit. Gjykata Kushtetuese, gjatë trajtimit të kësaj kategorie të të drejtave, ka proklamuar se e drejta për jetë është e drejta më e rëndësishme prej të gjitha të drejtave njerëzore, nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera dhe ka sqaruar se ekzistojnë detyrime pozitive për organet e pushtetit që të

ndërmarrin masa parandaluese dhe operative për ta mbrojtur jetën e të gjithë atyre që i janë ekspozuar rrezikut.

Sipas Konventës së Stambollit, luftimi i dhunës ndaj grave nuk duhet të kuptohet si një çështje e kontrollit të krimit, por kërkon masa gjithëpërfshirëse që të arrihet një barazi me e madhe midis grave dhe burrave. Vetëm barazia e vërtetë midis grave dhe burrave me të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi, me mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës dhe kur kontributi i tyre në shoqëri vlerësohet dhe respektohet në mënyrë të barabartë bashkë me një ndryshim në dinamikën si dhe qëndrimet e pushtetit, mund të eliminojë me të vërtetë dhunën ndaj grave.

Me këtë raport Avokati i Popullit ndër të tjera konstaton se autoritetet shtetërore kanë dështuar në përmbushjen e obligimeve pozitive dhe të mbrojnë të drejtën në jetë. Përkundër faktit se nga viti 2013 është miratuar Procedura Standarde e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, në të cilën janë përcaktuar edhe lista të kontrollit për veprimet që duhet t'i ndërmarrin autoritetet përgjegjëse, në rastin konkret këto procedura nuk janë respektuar, dhe se autoritetet nuk e trajtuan me vëmendjen e duhur rastin dhe nuk i ofruan mbrojtje adekuate viktimës.

Ka munguar koordinimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve, gjë që shtron nevojën e përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve për rastet e dhunës në familje dhe forcimin e mekanizmeve të kontrollit të secilit institucion, prej momentit të paraqitjes së rastit të dhunës në familje e deri në përfundimin e tij. Shqiptimi i masave disiplinore mund të ketë efekt individual nëse është proporcional me shkeljen, por është e nevojshme që të synohet ndërtimi i politikave të qëndrueshme institucionale.

Me numrin e rasteve në rritje të dhunës në familje vazhdon të ketë numër të pamjaftueshëm të mbrojtësve të viktimave dhe justifikimi i autoriteteve përgjegjëse se viktima kishte deklaruar se ka përkrahjen nga familja nuk arsyeton mosndërmarrjen e veprimeve nga këto autoritete. Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit i rekomandoi Policisë së Kosovës që në rastet e dhunës në familje, të gjitha stacionet policore, nëpërmjet zyrtarëve përgjegjës të veprojnë në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit; në rastet e dhunës në familje, zyrtarët përgjegjës të veprojnë në përputhje me nenin 24, paragrafi 4, të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Procedurat Standarde të Veprimit; në të gjitha rastet e dhunës në familje që raportohen jashtë orarit të punës së gjykatave, policia, pas vlerësimit të rrezikut të veprojnë në përputhje me nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Procedurat Standarde të Veprimit. Ndërsa Këshillit Prokurorial të Kosovës i rekomandoi që të rishikojë procedura standarde të veprimit për rastet e dhunës në familje me qëllim që të ndërtohen politika të qarta dhe të qëndrueshme institucionale të vlerësimit real të rrezikshmërisë së rasteve dhe masat urgjente që duhen ndërmarrë për sigurinë e viktimës dhe parandalimin e dhunës në familje; në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, të përgatisë module të veçanta trajnimi për prokurorë për të ngritur kapacitetet përkitazi me trajtimin e rasteve të dhunës në familje me fokus vlerësimin e rrezikshmërisë dhe masat për sigurinë e viktimës; të shtohet numri i mbrojtësve të viktimave në raport me numrin e rasteve në rritje të dhunës, e veçmas të dhunës në familje.

# Ndalimi i Torturës, Trajtimit Misor, Çnjerëzor ose Poshtëruës

## Raportet e Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të torturës (më tej: MKP), në bazë në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, realizon vizita të rregullta dhe pa paralajmërim, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin në qendrat e emigracionit dhe në çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut.<sup>173</sup>

MKP-ja, duke u mbështetur në mandatin ligjor, gjatë këtij viti ka realizuar gjithsej 62 vizita. Prej tyre 20 janë vizita të përgjithshme, 19 vizita ad-hoc, 21 vizita përcjellëse, 1 vizitë tematike dhe 1 vizitë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, në kuadër të monitorimit të operacioneve të kthimit me forcë nga shteti i Zvicrës në kuadër të bashkëpunimit me Komisionin Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës.

Për sa u përket raporteve me rekomandime të publikuar gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja ka publikuar tetë raporte me rekomandime pas vizitave të realizuara në institucionet e monitoruara. Nëpërmjet këtyre raporteve MKP-ja u ka adresuar autoriteteve kompetente 38 rekomandime me qëllim të avancimit të të drejtave themelore të personave të privuar lirie.<sup>174</sup>

## Raport për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë

Në përgjithësi gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe në ato të paraburgimit gjatë vitit 2022, në përgjithësi nuk kemi marrë ankesa për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Gjatë vizitave në institucionet korrektuese, MKP-ja, në përgjithësi ka vërejtur një komunikim të mirë ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues.

Përkundër kësaj, gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese në Dubravë, të realizuar më 21 deri më 23 shkurt 2022, kemi marrë një ankesë me pretendimin për keqtrajtim nga zyrtarët korrektues. Lidhur me këto

173 Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 2.

174 <https://oik-rks.org/mekanizmi-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-mkpt/raporte-mkpt/>

pohime, MKP-ja pas vizitës ka biseduar me drejtorin e QKD-së lidhur me këtë pretendim, me ç' rast është njoftuar se për këtë çështje është formuar një komision hetues dhe se MKP-së do t'i dërgohej raporti i hetimit të brendshëm.

Drejtori i QKD-së, më 28 shkurt 2022, nëpërmjet një shkrese zyrtare e ka njoftuar MKP-në se lidhur me këtë rast, komisioni nuk ka gjetur ndonjë provë apo dëshmi, përmes së cilës do të mundë të vërtetoheshin pretendimet e të burgosurit për përdorim të forcës ndaj tij nga ana e mbikëqyrësit apo stafit tjetër që ishin në detyrë. Kjo është vërtetuar plotësisht përmes deklaratave të stafit dhe të burgosurve të dhomës, të cilët e kanë mohuar një gjë të tillë.<sup>175</sup>

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese në Dubravë,<sup>176</sup> MKP-ja vëren se kushtet e akomodimit në përgjithësi mund të konsiderohen se janë në pajtim me LESP-në dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

Në raste të caktuara MKP-ja mori disa vërejtje nga të burgosurit se mungonte uji i ngrohtë si dhe se shtypja e ujit gjatë verës është e ulët (pavijonet 1, 3, 4 dhe 5). Sipas tyre, uji i ngrohtë nuk është i mjaftueshëm për pastrim dhe mirëmbajtje të higjienës. MKP-ja vëren se nenin 37 i LESP-së përcakton: *“Me qëllim të sigurimit të higjienës së personave të dënuar dhe higjienës së lokaleve, personave të dënuarve të iu sigurohet sasi e mjaftueshme e ujit të ftohtë dhe të nxehtë si dhe, artikuj adekuat për pastrim dhe tualet. Pajisjet dhe mjetet për higjienë personale sigurojnë privatësinë e mjaftueshme të dënuarit dhe ata mirëmbahet dhe pastrohen në rregull.”*<sup>177</sup>

MKP-ja gjatë monitorimit në këtë qendër po ashtu ka pranuar disa ankesa nga të dënuarit se ka mungesë të dyshekëve dhe të jastëkëve cilësorë (pavijonet 1, 3, 5 dhe Pavijoni Gjysmë i Hapur (PGjH). Kjo çështje është adresuar menjëherë tek zyrtarët kompetentë.

Lidhur me këto pohime, Avokati i Popullit, në raportin për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë, i publikuar më 14 prill 2022, i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë, që të dënuarit të furnizohen mjaftueshëm me ujë të ngrohtë dhe me dyshekë cilësorë.<sup>178</sup>

Për sa u përket kushteve të akomodimit në Spitalin e Qendrës Korrektuese në Dubravë, MKP-ja vëren se objekti në përgjithësi nuk i plotëson kushtet as për të hospitalizuarit dhe as për stafin shëndetësor edhe përkundër renovimeve që janë bërë. Po ashtu duhet theksuar se spitali i QKD-së ka dy kate dhe posedon vetëm shkallë, kjo paraqet vështirësi për pacientët e sidomos për personat me aftësi të kufizuar.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit, në raportin me rekomandim për Qendrën Korrektuese në Dubravë, i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të krijohen kushte adekuate për të hospitalizuarit në spitalin e burgut.<sup>179</sup>

175 <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

176 <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

177 Ligji nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 37, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

178 <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

179 <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

Ministria e Drejtësisë lidhur me këtë rekomandim është përgjigjur se në bashkëpunim me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve (DShB) në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, më herët janë pajtuar për përshtatjen e ambienteve në Pavijonin D për të vendosur të dënuarit me probleme mendore duke përfshirë krijimin e gjitha kushteve në pikëpamje të infrastrukturës dhe personelit adekuat për trajtimin e tyre sipas nevojave specifike dhe standardeve ndërkombëtare në këtë fushë. ShKK me DShB-në janë në fazën përfundimtare të përgatitjeve për vendosjen e një numri prej rreth 60 të dënuarve në këto hapësira dhe pritet që kjo të realizohet përfundimisht deri në fund të këtij viti. Ndërsa edhe në Pavijonin 7 do të krijohen hapësira shtesë për vendosjen e një numri më të madh të të dënuarve me nevoja të veçanta.”

Gjatë vizitës përcjellëse të MKP-së, të realizuar më 6 dhjetor 2022, në QKD, ekipi i MKP-së është informuar nga menaxhmenti i Qendrës Korrektuese në Dubravë se janë në finalizim të adaptimit të Pavijonit D, ku pritet të vendosen të burgosurit me probleme mendore. Po ashtu, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve ka hapur konkurs për rekrutimin e stafit shëndetësor të dedikuar për këtë pavijon.

MKP-ja gjatë këtij viti pranoi ankesa nga të burgosurit për sa i përket trajtimit mjekësor në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit. MKP-ja, në të gjitha rastet përveç vizitave, kërkoi nga DShB-ja raporte të hollësishme për trajtimin shëndetësor të ankuesve në fjalë. MKP-ja këto raste vazhdon t'i përcjellë edhe përgjatë viteve në vijim.

## Raport për vizitën në Qendrën Edukuese-Korrektuese për të Mitur dhe në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan

MKP-ja më 20 prill 2022 dhe më 15 maj 2022, vizitoi Qendrën Edukuese-Korrektuese për të Mitur (QEKM) dhe Qendrën Korrektuese për të Mitur (QKM) në Lipjan. Qëllimi i këtyre vizitave ishte monitorimi i respektimit të të drejtave themelore të personave të mitur të privuar nga liria, të cilët gjendeshin në këto qendra, në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Gjatë vizitës në Qendrën Edukuese-Korrektuese për të Mitur, MKP-ja është njoftuar nga drejtorja se kapaciteti i kësaj qendre është 36 shtretër dhe momentalisht janë të vendosur 10 të mitur me masë edukuese.

Ndërsa gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese për të Mitur, MKP-ja ka vërejtur se ishin të akomoduar dyzet e shtatë (47) të mitur, prej tyre njëzet e pesë (25) të mitur me Masë Edukative Korrektuese, të cilët ishin të vendosur në Pavijonin A, njëmbëdhjetë (11) të mitur të dënuar, të cilët ishin të vendosur në katin e parë të Pavijonit D, dhe njëmbëdhjetë (11) të mitur të paraburgosur, të vendosur në katin e dytë të Pavijonit D.

Ekipi i MKP-së gjatë vizitës ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të miturve në këto dy qendra dhe nuk ka marrë ankesa për keqtrajtim fizik, psikologjik apo përdorim të forcës së tepruar nga zyrtarët korrektues. Përveç kësaj, MKP-ja ka vërejtur se ekziston një klimë pozitive e marrëdhënieve ndërmjet të miturve të të dy qendrave korrektuese dhe zyrtarëve korrektues.

Për sa u përket kushteve të akomodimit, MKP-ja vëren se kushtet ku mbaheshin të miturit e gjinisë mashkullore në Qendrën Edukuese-Korrektuese për të Mitur, ishin të mira, dhomat ishin të pastra dhe



të ndriçuara, shtretërit e të miturve ishin furnizuar me çarçafë, batanije. Dyshekët janë të vjetruar dhe jociësorë. Dhomat ku qëndronin të miturit ishin të mëdha dhe kishin ndriçim të mjaftueshëm, posedonin TV, dollapë personale. Secila dhomë kishte tualete të cilat ishin në gjendje të rregullt, të përshtatshme dhe kishin ujë të ngrohtë pandërprerë. Po ashtu, dhomat dhe tualetet, të cilat ishin të dedikuara për personat me nevoja të veçanta, i plotësonin kushtet për këtë kategori. MKP-ja konsideron se QEKM-ja i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të të miturve.<sup>180</sup>

Ndërsa për kushtet e akomodimit në Qendrën Korrektuese për të Mitur, MKP-ja ka vërejtur se në dhoma kishte dritë të mjaftueshme natyrale dhe artificiale. Në përgjithësi MKP-ja konsideron se Qendra Korrektuese për të Mitur plotëson kushtet adekuate për akomodimin e të miturit të burgosur.<sup>181</sup>

Lidhur me regjimin për të miturit, MKP-ja ka vërejtur se atyre, përveç ajrimit ditor, u ofrohet një regjim gjithëpërfshirës, përfshirë shkollimin, trajnime për fusha të ndryshme, punë, si dhe aktivitete sportive dhe rekreative. MKP-ja është njoftuar nga punëtori social se në QKM, përveç rutinës ditore, të miturit kanë programin rehabilitues TOPS, program i cili u ofron të miturve 4 module: menaxhimi i zemërimit, shkathtësitë sociale, aspekte të vendimmarrjes, ndihma e ndërsjellë, që gjithsej zgjat 12 javë.

Mirëpo MKP-ja është njoftuar nga personeli i QKM-së dhe i QEKM-së se është sfidë mospërfshirja në shkollim e të miturve me vështirësi në shkrim-lexim (analfabet) nga klasat 1-5, për shkak të mungesës së arsimtarëve klasorë. Lidhur me këtë, personat përgjegjës në QKM na kanë njoftuar se disa herë me shkresa zyrtare i janë drejtuar Drejtorisë për Arsim në KK Lipjan, mirëpo asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje.

Lidhur me këtë, neni 83, paragrafi 1, i LESP-së, përcakton: *“Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm.”* Gjithashtu në ligj theksohet se përgjegjës për arsimimin fillor dhe të mesëm në institucionin korrektues është ministria kompetente për arsim.

MKP-ja ka vërejtur se Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.15/2017 për Planifikim dhe Organizim të Procesit Mësimor në Arsimin Parauniversitar për Personat e Privuar Lirie në Institucionet Korrektuese, në nenin 2, paragrafi 1, parasheh si në vijim: *“Planifikimi dhe organizimi i procesit mësimor në institucionet korrektuese realizohet për të gjithë personat e privuar lirie në nivel I, II dhe III të arsimit para universitar.”*

Lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit: *“Ta organizoi procesin mësimor për nivelin e parë (I) të arsimit për të miturit, si dhe të miturve me Masë Edukative Institucionale të cilët janë vlerësuar nga ekipi shumë disiplinor dhe nuk kanë rrezikshmëri për komunitetin t’u mundësohet procesi mësimor në nivelet e tjera në shkollat e komunës përkatëse, sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 15/2017.”*<sup>182</sup>

180 <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-edukuese-korrektuese-per-te-mitur-dhe-ne-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>

181 <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-edukuese-korrektuese-per-te-mitur-dhe-ne-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>

182 <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-edukuese-korrektuese-per-te-mitur-dhe-ne-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>

## Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë

Gjatë vizitës së MKP-së në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi kishte qasje në të gjitha hapësirat e QPP-së dhe iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme dhe po ashtu iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues. Kapaciteti i QPP-së është tetëdhjetë (80) shtretër dhe në kohën e vizitës ishin të akomoduar gjithsej shtatëdhjetë e katër (74) të burgosur, prej tyre nëntë (9) të dënuar dhe gjashtëdhjetë e pesë (65) të paraburgosur.

Gjatë vizitës u intervistuan një numër të konsiderueshëm i të paraburgosurve dhe i të dënuarve dhe nuk morëm ndonjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Po ashtu nuk morëm ndonjë ankesë lidhur me sjelljet e zyrtarëve korrektues, të cilat do të përbënin trajtim që nuk është në pajtim me respektimin e dinjitetit njerëzor të të burgosurve. Gjatë vizitës është vërejtur komunikim interaktiv dhe miqësor ndërmjet personelit korrektues dhe të burgosurve. Po ashtu të gjithë të paraburgosurit e intervistuar pohuan se janë trajtuar në mënyrë korrekte dhe profesionale nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe se janë respektuar të drejtat e tyre themelore.

Për sa u përket kushteve të akomodimit të personave në këtë qendër, MKP-ja edhe gjatë këtij viti konstaton se kushtet e akomodimit në këtë qendër nuk janë në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) e as me standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT). Evidentohet mungesë e hapësirës dhe ndriçimit natyral e artificial të ambienteve të kësaj qendre.

Avokati i Popullit përmes raportit të publikuar më 16 nëntor 2022, ka ripërsëritur rekomandimin që kushtet e akomodimit në QPP, përderisa kjo qendër është në përdorim, të jenë në pajtim me standardet e përcaktuara në LESP; me standardet e KPT-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.<sup>183</sup>

## Raport për vizitën në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan

Ekipi i MKP-së gjatë vizitës në Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan intervistoi një numër të të burgosurve dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për mënyrën se si ato trajtoheshin nga stafi korrektues.

MKP-ja gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese për Femra<sup>184</sup>, realizuar më 13 tetor 2022, vërejti se qelitë ku akomodohen të burgosurat kanë ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, si dhe nuk kanë lagështi. Për sa i përket hapësirës për banim për të burgosurat, MKP-ja vërejti se hapësira në dispozicion është në pajtim me dispozitat e LESP-së dhe me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT).<sup>185</sup> Po ashtu MKP-ja gjatë vizitës nuk vërejti mbipopullim në QKF dhe shumica e të burgosurve qenë të vendosura vetëm në dhoma, sipas kërkesave të tyre.

183 <https://oik-rks.org/2022/11/17/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-peje/>

184 <https://oik-rks.org/2022/11/25/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-per-femra-ne-lipjan/>

185 Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449/>

MKP-ja edhe gjatë vizitës së këtij viti mori përsëri ankesa nga të burgosurat se dushet dhe makineritë në lavanderi, si pasojë e gjendjes teknike, nuk janë funksionale.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit, përmes raportit me rekomandime, publikuar më 23 nëntor 2022<sup>186</sup>, ka ripërsëritur rekomandimet drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, që të bëhen rregullimet teknike të dusheve dhe makinerive në lavanderi.

MKP-ja gjatë këtij viti i kushtojë rendësi të veçantë funksionimit të Shtëpisë së Nenave në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan<sup>187</sup>. MKP-ja ka realizuar vizitë më 7 korrik 2022, ka intervistuar të burgosurën M. I., e cila ishte e vendosur së bashku me fëmijën e saj tetëmuajshe dhe ishte evidentuar se Shtëpia e Nenave nuk i plotësonte kushtet elementare për akomodim në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe as me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurave me fëmijë.

Lidhur me këtë çështje, MKP-ja, më 15 korrik 2022, i është drejtuar me shkresë zyrtare drejtorit të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe në po të njëjtën ditë është njoftuar se Shërbimit Korrektues i është ndarë buxhet për ndërtimin e Shtëpisë së re të Nënës me Fëmijë, për vitin 2023. Mirëpo deri në realizimin e këtij projekti, sipas drejtorit, ShKK-ja me urgjencë do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për funksionalizimin dhe rinovimin e Shtëpisë së Nenave. Renovimet e kryera MKP-ja i ka vërejtur gjatë vizitës se realizuar në tetor të këtij viti.

Lidhur me këtë, MKP-ja, përmes raportit me rekomandime, i publikuar më 23 nëntor 2022<sup>188</sup>, i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë, që Shtëpia e Nenave të pajisjet me inventar të ri, përderisa kjo shtëpi është në përdorim.

## Raport për vizitën në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll

Bazuar në mandatin ligjor, MKP-ja, më 19 maj dhe më 30 qershor 2022, së bashku me personelin e Komisionerit të Lartë për Refugjatë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNHCR) dhe personelin e Civil Rights Program Kosovo (CRPK), ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt (QMH).

QMH-ja funksionon në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DShAM) i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Sipas nenit 2 të Rregullores (MPB) nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve (në tekstin e mëtejme: Rregullorja), në këtë qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe të huajt për të cilët konsiderohet se e cenojnë sigurinë publike, me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre dhe për arsye të tjera. Kapaciteti i QMH-së është për 70 persona, ndërsa gjatë vizitës së bërë nga MKP-ja ishin të pranishëm 3 të huajt.

186 <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/Raport-i-AP-MKPT-lidhur-me-viziten-ne-Qendren-Korrektuese-per-Femra-ne-Lipjan-1-1.pdf>

187 <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/Raport-i-AP-MKPT-lidhur-me-viziten-ne-Qendren-Korrektuese-per-Femra-ne-Lipjan-1-1.pdf>

188 <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/Raport-i-AP-MKPT-lidhur-me-viziten-ne-Qendren-Korrektuese-per-Femra-ne-Lipjan-1-1.pdf>

Gjatë vizitës së realizuar nga MKP-ja në QMH, ishin të pranishëm 3 persona të huaj të ndaluar. MKP-ja ka kontrolluar dosjet e tyre dhe ka realizuar intervista grupore përmes përkthyesit të gjuhës arabe. MKP-ja nuk ka marrë asnjë ankesë nga personat e intervistuar për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës fizike apo për sjellje nga zyrtarët e sigurisë dhe zyrtarët e QMH-së, gjë që nuk do të ishte në pajtim me respektimin e dinjitetit të tyre. Përkundrazi, të huajt në ndalim u shprehën në favor të një trajtimi shumë të mirë nga Policia e Kosovës dhe nga zyrtarët e MPB-së.

Mirëpo ekipi i MKP-së, në vizitën e realizuar më 30 qershor 2022 në QMH, ka vizituar të huajin E. T., i cili ishte i akomoduar në QMH së bashku me djalin e tij, O. T. Gjatë vizitës MKP-ja ka intervistuar E. T., i cili nuk kishte ankesa për sa u përket kushteve dhe trajtimit në QMH. Ankuesi shprehu shqetësimin se djali tij, O. T., gjatë qëndrimit në Qendrën e Azilit është bullizuar nga një banor tjetër në atë qendër.<sup>189</sup>

Lidhur me këtë çështje MKP-ja ka shqyrtuar dokumentacionin për rastin O. T., përfshirë dosjen shëndetësore, raportin e policisë dhe vendimet e gjykatës. Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, MKP-ja nuk ka vërejtur shenja të keqtrajtitimit fizik. Po ashtu, MKP-ja ka kontaktuar edhe avokaten e autorizuar, që e ka përfaqësuar palën në gjykatë, e cila ka pohuar se gjatë gjithë mbrojtjes në gjykatë, pala nuk ka shprehur shqetësim për keqtrajtim dhe nuk janë vërejtur shenja të keqtrajtitimit fizik.

Ndërsa për kushtetve akomodimit, MKP-ja konsideron se kushtet e akomodimit në QMH janë në nivel shumë të mirë. Të gjitha dhomat ofronin akomodim të denjë, ngrohje, ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, si dhe dushe të cilat ishin në gjendje shumë të mirë. Të huajt në QMH mund të kenë qasje në dushe sa herë që ata duan.

## Raport për vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë

MKP-ja, më 26 korrik dhe më 28 shtator 2022, vizitoi Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës. Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të personave të cilët kanë kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, të cilët janë subjekt i urdhrit të gjykatës kompetente për trajtim të detyrueshëm psikiatrik; të personave të cilët janë subjekt i urdhrit të gjykatës për vlerësim psikiatrik me ndalim në institucionin shëndetësor; të të burgosurve që kanë zhvilluar çrregullim mendor gjatë burgimit e të cilët janë vendosur në njërin nga repartet e IPFK-së, të cilat të drejta u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

MKP-ja gjatë vizitës nuk mori ankesa për keqtrajtim fizik, mirëpo as nuk vërejt shenja të dhunës fizike tek pacientet. Ekipi intervistoi pacientët e pranishëm, të cilët pohuan për një trajtim të duhur nga stafi mjekësor.

189 Raporti i Avokatit të Popullit me Rekomandim për Qendrën për të Huaj në Vranidoll <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-mbajtjes-per-te-huaj-ne-vranidoll/>

Kushtet e akomodimit kushtet materiale në IPFK janë deri diku të mira. Vlen të ceket se inventari ishte i demeluar, sidomos në pjesën e qëndrimit ditor. Në Repartin B, kur të lëshohen klimat, pikon ujë në korridore, në një dhomë në Repartin B kishte lagështi, dyshekët në përgjithësi nuk janë të mirë, dyert e dhomave nuk janë të sigurta dhe janë me xhama transparentë. Dy dhomat e izolimit në Repartin C, për shkak të kushteve jo të mira, janë jashtë funksionit, kamerat nuk punonin, xhami i derës së dhomës ishte i thyer. Kushtet higjienike janë në rregull, pacientët kanë qasje në dritë natyrale, ventilim si dhe privatësia në dushe dhe në tualete ishte në nivelin e duhur.

Hapësirat e vizitave familjare në të gjitha repartet janë në korridore, pa dyer, ku nuk sigurohet privatësia dhe janë të vrazhda, si për pacientin po ashtu edhe për familjarin. Pjesa ku realizohen vizitat familjare në Repartin C ishte një dhomë shumë e vogël pa dritare, e erret, me një tavolinë me dy karrige dhe privatësia nuk ishte në nivelin e duhur.

Në IPFK, përveç vlerësimit, trajtimit me medikamente, ofrohen edhe aktivitete psiko-social. Trajtimi psiko-social konsiston në aktivitetet, si: lojëra, shikim televizori, vizatime, daljet ditore brenda institucionit (në shëtitore të IPFK-së), seanca individuale dhe grupe me psikologun etj. Orari i aktiviteteve ditore ishte i vendosur në vende të dukshme, por ky orar është uniform.

Gjatë vizitës MKP-ja vërejt një arritje lidhur me aktivitetet psiko-sociale, të cilat evidentohen në regjistra të veçantë, si: Regjistri i Aktiviteteve Sociale dhe Regjistri i Aktiviteteve Psikologjike. Për më tepër, MKP-ja vërejt se shumica e pacientëve kishin plane individuale të trajtimit. MKP-ja ndër vite vëren se trajtimi në thelb është me farmakoterapi.

Për sa i përket kontaktit me botën e jashtme, personat e akomoduar në IPFK kanë të drejtë në vizita familjare dy herë në javë nga 30 minuta. Përpos vizitave, pacientët kanë të drejtë edhe për telefonata. IPFK-ja i praktikon edhe vikendet terapeutike, gjë e cila deri më tani është treguar e suksesshme. MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga pacientët për kontakt me botën e jashtme.

Ndërsa lidhur me konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore, MKP-ja gjatë vizitave të realizuara gjatë vitit 2022, ka vërejtur se shërbimet mjekësore pacientëve në IPFK u jepen pa praninë e zyrtarëve të sigurimit, përveç nëse personeli mjekësor në raste të caktuara shprehimisht e kërkon një gjë të tillë.

## Raport për vizitën në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë

Shtëpia e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare (ShPMPF) është institucion me karakter social dhe vepron në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejshëm: MFPT). Kapaciteti zyrtar i këtij institucioni është për 100 persona. Gjatë vizitës MKP-ja vërejt se në ShPMPF ishin të akomoduar 63 rezidentë, prej tyre 28 meshkuj dhe 35 femra. Nga ta, 3 persona janë nën moshën 65 vjeç.

Sipas rregullores, në ShPMPF vendosen rezidentët si në vijim: Shfrytëzuesit e varur (të palëvizshëm), të cilët nuk mund t'i realizojnë nevojat e tyre jetësore në mënyrë të pavarur, por duhet të ndihmohen gjithmonë nga të tjerët. Kategoria e rezidentëve gjysmë të varur, gjendja shëndetësore e të cilëve ka

shënuar rënie dhe pranojnë kujdes të veçantë. Kategoria tjetër janë shfrytëzuesit e pavarur, të cilët, edhe pse janë të moshuar, plotësojnë nevojat e tyre jetësore pa ndihmën e të tjerëve.<sup>190</sup>

Gjatë vizitës, MKP-ja ka intervistuar një numër të rezidentëve dhe nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo abuzime verbale, si dhe për sjellje të cilat do ta shkelnin dinjitetin.

Për sa u përket kushteve të akomodimit, MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se oborri dhe trotuaret e institucionit ishin rregulluar dhe qasja për të moshuarit dhe për personat me aftësi të kufizuara ishte dukshëm më e lehtë. Ndërsa dhomat ku vendosen rezidentët kishin ndriçim të mjaftueshëm, në përgjithësi nuk kishin lagështi, por inventari ishte i vjetërsuar dhe i dëmtuar në disa dhoma. Po ashtu, edhe banjat janë shumë të dëmtuara.

Lidhur me kushtet në ShPMPF, MKP-ja gjatë vizitës ka marrë ankesë nga rezidenti G. S., i cili është me aftësi të kufizuara në karrocë dhe i cili pohoi se që tri vjet nuk ka pasur qasje në oborr, për shkak të hapësirës së vogël të ashensorit. Lidhur me këtë ankesë, MKP-ja sërish ka kërkuar nga organet kompetente që gjendja e krijuar të përmirësohet sa me shpejt, duke i bërë aranzhimet e nevojshme në mënyrë që rezidenti ta gëzojë të drejtën e vet, në mënyrë të barabartë me banorët e tjerë dhe pa asnjë diskriminim.

Për sa i përket kujdesit mjekësor në ShPMPF, personeli shëndetësor përbëhet nga: 1 mjek i rregullt, i cili është në specializim dhe punon nga ora 14:00; një stomatolog me orar të plotë; një kryeinfermier dhe 9 infermierë, të cilët punojnë me ndërrime (12/12); dhe një ndihmës asistente për shërbime stomatologjike me orar të plotë; një farmacist me orar të plotë (8-16), 2 fizioterapeutë me orar të plotë, 1 teknik sanitar, 1 punëtorë në lavanderi, 2 mirëmbajtës të higjienës. Në përbërje të personelit mjekësor janë edhe 14 ndihmës mjekësorë, të cilët kujdesen për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe për personat e palëvizshëm.

Përkujdesja ndaj këtyre personave bëhet me mbikëqyrje të vazhdueshme, ku personeli kujdeset për higjienën e tyre personale, për ushqimin e rregullt, si dhe për nevojat e tjera të rastit.

190 Raporti i Avokatit të Popullit për Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare <https://oik-rks.org/2022/11/24/raporti-mkpt-se-per-viziten-ne-shtepine-per-personat-e-moshuar-dhe-pa-perkujdesje-familjare-ne-prishtine/>

# E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm dhe Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave

## Raport për rastin A. nr. 642/2018, zvarritje e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Raporti është i bazuar në ankesë individuale dhe ka për qëllim që t'ia tërheqë vëmendjen Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr.1244/2016, pa vonesa të mëtutjeshme.

Ankuesi kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër të paditurit - Korporatës Energjetike të Kosovës, për kompensimin e paluajtshmerisë ose shpronësimit të shtëpisë dhe lënda ishte evidentuar me numrin C.nr.1244/2016 dhe deri në ditën e publikimit të këtij raporti, gjykata nuk ka vendosur lidhur me lëndën.

Avokati i Popullit në këtë raport theksoi se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih mes të tjerash aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005, dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005). Neni 13 i KEDNj-së pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht t'i mbrojtë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë për një individ, që bën të mundur që ai/ajo t'i gëzojë të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efektive nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrojë këtë ankesë te një autoritet vendor. Kërkesat e nenit 13 mbështesin kërkesat e nenit 6 (shih aktgjykimin *Kudla kundër Polonisë*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv tek një autoritet vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Pasi rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.

Avokatit të Populli konstatoi se në këtë rast zvarritja e tillë, pa vendim përfundimtar, shkel të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuar dhe të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së; të drejtën për mjete efektive juridike, e mbrojtur me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të



KEDNj-së; të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për këtë i rekomandoi Gjykatës Themelore në Prishtinë që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr. 1244/2016.

## **Raport për rastin A. nr. 469/2020, zvarritje e procedurës gjyqësore në Gjykatën e Apelit**

Raporti është i bazuar në ankesën individuale të Xh. Sh. (në tekstin e mëtejme: ankuesja) dhe ka për qëllim të tërheqë vëmendjen Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. nr. 3263/19, pa vonesa të mëtutjeshme.

Ankuesja, në cilësinë e paditëses, kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (GjThP), me numër C.nr.2248/14, për anulimin e vendimit të punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankueses dhe për kthim në vendin e punës. Me Aktgjykimin C.nr. 2248/14, GjThP-ja kishte aprovuar padinë e paditëses, ndërsa pala e paditur kishte parashtruar ankesë në GjA. Veprimi i fundit në gjykatë ishte më 14 qershor 2019 kur ankuesja kishte parashtruar përgjigje në ankesën e së paditurës. Ndërsa në komunikimin që Avokati i Popullit kishte me gjykatë është njoftuar vetëm se lënda është ndarë në punë dhe ende nuk është përfunduar.

Avokati i Popullit nëpërmjet këtij raporti rikujton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, në rastet kur palët në procedurë nuk kanë mjete efektive për ankim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit ligjor vendor (shih Aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe Aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999). Me këtë raport Avokati i Popullit rekomandoi që Gjykata e Apelit pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për të vendosur për lëndën AC. nr. 3263/19.

## **Raport për rastin A. nr. 703/2020, zvarritje e procedurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës**

Më 25 mars 2022, Avokati i Popullit publikoi raportin për rastin A. nr. 703/2020 që i referohet ankesës individuale dhe ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën C-IV-13-0964. Ankuesja kishte parashtruar ankesë në DhPGjSK kundër Vendimit nr. PRZ006 – 0023 të AKP-së, nr. prot. 123, datë 5 qershor 2013, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara për bashkëshortin e saj të ndjerë, në shumën bruto prej 1.170.28 eurosh, dhe meqenëse kishte kaluar një periudhë relativisht e gjatë prej më shumë se tetë vjetësh, ajo i adresoi ankesë Avokatit të Popullit.

Nga komunikimi i Avokatit të Popullit me DhPGjSK-në është njoftuar se Gjykata me aktvendim kishte ndërprerë procedurën për shkak të vdekjes së bashkëshortit të ankueses. Në aktvendim specifikohet se procedura e ndërprerë do të vazhdohej kur trashëgimtarët e të ndjerit të kërkonin vazhdimin, [...], apo kur gjykata në bazë të propozimit të palës së kundërt kërkon që palët ta vazhdojnë procedurën.

Nga të dhënat e rastit kuptohet se procedura pranë DhPGjSK-së ishte iniciuar nga ankuesja, pas vdekjes së bashkëshortit, ndërsa DhPGjSK-ja nuk kishte vlerësuar legjitimitetin aktiv të palës, në këtë rast ankueses dhe se këtë e ka bërë 8 vjet më vonë me anë të aktvendimit të sipërpërmendur.

Avokati i Popullit konstaton se zvarritja e procedurës në DhPGjSK përbën shkelje të së drejtës për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor, i garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas të cilit *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile [...], çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm [...].”* dhe se ashtu siç e ka theksuar edhe GjEDNj-ja, e drejta e palës që për çështjen e tij të vendoset brenda një afati të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Për këtë dhe çështje të tjera të theksuara në raport, i rekomandoi *Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C-IV-13-0964.*

## **Letër rekomandimi për rastin A. nr. 585/2021, zvarritje e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë**

Avokati i Popullit në këtë rast trajton ankesën individuale parashtruar kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP), përkitazi me zvarritjen e procedurës gjyqësore lidhur me lëndën C.nr.1070/19. Në ankesë, ankuesi pohon se që nga parashtrimi i padisë në vitin 2019 gjykata nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim procedural në trajtimin e lëndës së tij.

Në komunikimin që Avokati i Popullit kishte me Gjykatën u njoftua se meqenëse objekti i kontestit në këtë çështje është kërkesa për kompensimin e dëmit, sipas strategjisë së KGJK-së për reduktimin e rasteve nuk hyn në radhën e lëndëve me prioritet dhe se lënda në fjalë nuk është ende në radhë për t’u trajtuar.

Avokati i Popullit vlerëson se është obligim kushtetues i shtetit që qytetarëve t’u garantojë që çështjet e tyre të dëgjohen drejtësisht, publikisht nga gjykata dhe brenda një afati të arsyeshëm, si dhe t’u garantojë mjete juridike efektive. Këto të drejta janë të garantuara me nenet 6 dhe 13 të KEDNj-së, të cilat përcaktojnë: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme (...).”* (neni 6); dhe: *“Çdo njeri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për mjetet ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar (...).”* (neni 13). Pra kërkesat e nenit 13 mbështesin kërkesat e nenit 6 (*shih aktgjykimin: Kudla kundër Polonisë*).

Në këtë rast Avokati i Popullit konsideroi se zvarritja e mëtejshme e procedurës gjyqësore në këtë çështje përbën shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe i rekomandoi Gjykatës Themelore në Prishtinë që të ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe pa vonesa të mëtutjeshme ta trajtojë rastin C.nr.1070/19.

## Letër rekomandimi për rastin A. nr. 230/2021, zvarritje e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogvc

Avokati i Popullit në këtë rast trajton ankesën individuale të parashtruar kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogvc, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurave gjyqësore.

Ankuesi kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogvc për shkak të moszbatimit të vendimit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Glllogvc (Nr.09-610/01-58205, datë 4/10/2019) si dhe të rekomandimeve të Inspektoratit të Arsimit, datë 5 mars 2020, të cilët fëmijës së tij ia kishin njohur të drejtën për përfshirje në çerdhe. Me moszbatimin e vendimit sipas pohimeve të tij vazhdonte të pësonte dëme materiale, meqenëse fëmijën e tij duhej ta regjistronte në një kopsht privat ku shpenzimet mujore arrinin 150 euro, përfshirë edhe 15 euro pagesë për psikologun që duhej ta siguronte një herë në javë, meqë fëmija i tij është me aftësi të kufizuara. Një situatë e tillë e ka vështirësuar gjendjen materiale dhe emocionale të paditësit si dhe të fëmijës me aftësi të kufizuara duke e cenuar mirëqenien e tij. Nga parashtrimi i padisë, gjykata nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për ta proceduar rastin e tij.

Në komunikimin që Avokati i Popullit kishte me Gjykatën, ishte njoftuar se meqenëse objekti i kontestit në këtë çështje është kërkesa për kompensimin e dëmit, si e tillë nuk është lëndë me prioritet ligjor dhe se ende janë duke u trajtuar lëndët e vitit 2015-2016.

Avokati i Popullit vlerësoi se lënda në fjalë do të duhej të trajtohej me prioritet duke qenë se ka të bëjë me një grup të ndjeshëm të personave, në këtë rast fëmijë me aftësi të kufizuara, në pajtim me obligimet kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen e fëmijës. Neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës] obligon: *“Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”* Ky parim është i mishëruar edhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, e cila zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë [neni 20] si dhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili në nenin 5, paragrafi 4, thekson: *“Për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës duhet të respektohen parimet si në vijim: 4.3. vendimet administrative dhe gjyqësore që prekin fëmijën duhet të merren dhe zbatohen me shpejtësi dhe pa vonesa të paarsyeshme.”* Sipas Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, si autoriteti kryesor në interpretimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës në Komentin e Përgjithshëm nr.14, interesi më i mirë i fëmijës është koncept i trefishtë që përfshin: një të drejtë substanciale, parim ligjor interpretues dhe rregull të procedurës. Si rregull i procedurës, sa herë që do të merret një vendim që do të ndikojë në një fëmijë të caktuar, në një grup të identifikuar fëmijësh ose në fëmijët në përgjithësi, procesi i vendimmarrjes duhet të përfshijë një vlerësim të ndikimit të mundshëm (pozitiv ose negativ) të vendimit mbi fëmijën ose fëmijët në fjalë. Për më tepër, Neni 46 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës shprehimisht parasheh mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ku të gjitha institucionet kanë për obligim: *“[...] që të eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive që fëmijët me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj.”*

Në këtë rast, vendimi i Gjykatës lidhur me rastin e kompensimit të dëmit është tejet i rëndësishëm për të siguruar që fëmija me aftësi të kufizuara, i cili është gjithashtu palë e dëmtuar, do të ketë mundësi që me anë të këtij kompensimit të ketë qasje në shërbime arsimore dhe shëndetësore kualitative. Zvarritja

e mëtutjeshme e lëndës do të kishte pasoja negative në mirëqenien e fëmijës dhe si e tillë nuk është në interesin më të mirë të fëmijës.

Avokati i Popullit, pa synuar që të ndërhyjë në vendimmarrjen e gjykatës apo në çfarëdo mënyre të ndikojë në përmbajtjen e lëndës, kërkoi nga gjykata të ndërmarrë veprimet e nevojshme që pa vonesa të mëtutjeshme ta trajtojë këtë rast.

## **Mendim juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) për rastin A. nr. 30/2022 lidhur me zhvillimin e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë**

Ky mendim i Avokatit të Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës, ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, përkatësisht kriteret që duhet të plotësohen sipas Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike për shkarkimin e anëtarit të Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

Sipas pohimeve të ankueses, ajo me Vendimin nr. 07-V-083, i datës 29 tetor 2020, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ishte zgjedhur anëtare e Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut" (KOSTT). Ankuesja po ashtu ka njoftuar se ajo është drejtoreshë e Njesisë së Auditimit në Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror (AShNA). Duke pasur parasysh faktin se i mban dy pozita, ajo i ishte drejtuar Agjencisë Kundër Korrupsionit me kërkesë për vlerësimin e konfliktit të interesit.

Përkitazi me këtë çështje, Agjencia Kundër Korrupsionit e kishte njoftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës se ankuesja mund ta mbante pozitën e anëtares së Bordit të KOSTT-it, mirëpo nuk mund të realizonte pagën sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 05-V-389, të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë çështje, ankuesja kishte njoftuar se i ishte drejtuar me kërkesë Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti që ta shqyrtonte çështjen e pagës së saj si anëtare e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it dhe ta përcaktonte kompensimin për ushtrimin e funksionit në fjalë. Ky komision kishte nxjerrë përfundim sipas të cilit ankueses i kërkohej që të përcaktohej se cilën pozitë dëshironte ta ushtronte.

Pas kësaj, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare e mbajtur më 12 gusht 2021, kishte nxjerrë Vendim nr. 08-V-063, me të cilin ankuesja ishte shkarkuar nga pozita e anëtares së Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it.

Këtë vendim për shkarkim nga Kuvendi ankuesja e konsideron të kundërligjshëm, sepse sipas saj, nuk ishin përmbushur kriteret për shkarkim sipas Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, përkatësisht nuk ishin përmbushur rrethanat sipas nenit 14, paragrafi 11, dhe për këtë kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit vëren se çështja e emërimit dhe e shkarkimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it rregullohet me Ligjin nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike. Neni 14, paragrafi 11, përcakton kushtet për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, pa plotësimin e të cilave nuk mund të bëhet shkarkimi i tyre, dhe se Kuvendi i Republikës së Kosovës, në rastin e nxjerrjes së

Vendimit nr. 08-V- 063, datë 12 gusht 2021, me të cilin ankuesja ishte shkarkuar nga pozita e anëtares së Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, nuk kishte dhënë sqarime rreth ekzistencës së rrethanave të përcaktuara në nenin 14, paragrafi 11, të Ligjit për Energjinë Elektrike.

Mbajtja e pozitës së drejtorit në ASHNA-s krahas ushtrimit të funksionit publik si anëtare e Bordit të Drejtorëve në KOSTT nuk është në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 2, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Avokati i Popullit konsideron se çështja e ndalesës së pagesës, sipas mendimit të AKK-së, do të duhej të shqyrtohej nga Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti dhe të vendosej në seancë plenare nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

### **Mendim juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) për rastin A. nr. 274/2022, lidhur me Padinë e parashtruar nga Avokatura Shtetërore në çështjen e emërimit të nënkryetarit të komunës për komunitete në Fushë Kosovë**

Ky mendim i Avokatit të Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës ka për qëllim ta argumentojë bazën ligjore dhe të ofrojë një analizë përkitazi me rastin e bazuar në ankesën individuale të ankuesit lidhur me veprimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (në tekstin e mëtejme: MAPL), që kanë të bëjnë me çështjen e emërimit të nënkryetarit të komunës për komunitete në Fushë Kosovë. Komuna e Fushë Kosovës më 4 shkurt 2022, në pozitën e nënkryetarit të komunës për komunitete kishte emëruar ankuesin, përfaqësues i subjektit politik "Iniciativa e Fushë Kosovës për Egjiptian dhe Ashkali".

Pas kësaj MAPL-ja kërkoi nga Komuna e Fushë Kosovës rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit për emërimin e nënkryetarit të komunës për komunitete në këtë komunë, duke konsideruar se ai është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, pasi në Udhëzimin Administrativ 02/2020 për procedurat e emërimit të nënkryetarëve në komuna, përcaktohet: "*Nënkryetari i komunës për komunitete emërohet nga radhët e komunitetit joshumicë, i cili për nga numri përbën komunitetin joshumicë më të madh në komuna.*" (neni 8.3). Duke qenë se komuniteti ashkali përbën komunitetin joshumicë më të madh në Fushë Kosovë, si dhe duke qenë se ankuesi i përket komunitetit egjiptian dhe jo atij ashkali, sipas MAPL-së, emërimi i tij ishte në kundërshtim me dispozitën e lartcekur të Udhëzimit Administrativ 02/2020. Prandaj MAPL-ja i ka rekomanduar Komunës së Fushë Kosovës rishqyrtimin e vendimit në fjalë.

Meqenëse Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës nuk kishte ndërmarrë veprime për rishqyrtimin e këtij akti, Avokatura Shtetërore e Kosovës, bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe në Ligjin për Avokaturën Shtetërore, më 29 prill 2022, në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative inicioi padi për konflikt administrativ për anulimin e vendimit me të cilin ankuesi është emëruar në pozitën e nënkryetarit të komunës për komunitetet në Fushë Kosovë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 62 përcakton rregullën që vendi i nënkryetarit është i rezervuar për komunitetet në ato komuna ku më së paku 10% të banorëve janë nga radhët e komuniteteve pakicë, në mënyrë që këto komunitete, të cilat në ato komuna nuk përbëjnë shumicë, të kenë përfaqësim përkatës në organet publike dhe lokale. Për më tepër, roli i nënkryetarit për komunitete i komunës është

mjaft i rëndësishëm, duke pasur parasysh se ai është kompetent për avancimin e dialogut ndërmjet tyre dhe paraqet personin zyrtar që është i autorizuar për zgjidhjen e problemeve dhe të interesave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, të cilat nuk e përbëjnë shumicën.<sup>191</sup>

Avokati i Popullit thekson se në mënyrë që përfaqësuesit e komuniteteve pakicë të mundë t'i realizojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, është e domosdoshme që t'u sigurohet përfaqësimi përkatës në organet lokale publike. Kështu, në komunat ku më së paku 10% e banorëve u takojnë komuniteteve pakicë, të cilat në atë komunë nuk përbëjnë shumicën, vendi i nënkryetarit është i rezervuar për një përfaqësues të komunitetit (neni 62, paragrafi 1, i Kushtetutës).

Sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, as Udhëzimi Administrativ (i asokohshëm) nr. 2014/01 dhe as Udhëzimi Administrativ (që është në fuqi) nr. 02/2020 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna nuk e përçojnë frymën e Kushtetutës dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Nuk është e qëndrueshme juridikisht që të vlejë qëndrimi se nënkryetari për komunitete duhet të jetë pjesëtar i komunitetit më të madh joshumicë në një komunë të caktuar.

Në këtë drejtim Avokati i Popullit konstaton se çfarëdo kufizimi në Udhëzimin Administrativ, sipas të cilit do t'i jepej përparësi ndonjërit nga komunitetet joshumicë për propozimin e nënkryetarit për komunitete i komunës, e cenon të drejtën e komuniteteve të tjera joshumicë, që nuk janë komuniteti më i madh joshumicë, që ta propozojnë nënkryetarin për komunitete të komunës.<sup>192</sup> Prandaj Avokati i Popullit vlerëson se Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2020 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna është në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale që është në fuqi.

191 Prof. dr. Enver Hasani / Prof. dr. Ivan Čukalović, Botimi I, dhjetor 2013, Prishtinë, Komentari i Kushtetutës, faqe 251, neni 62.

192 A. nr. 676/2021.

# E Drejta për Mjete Juridike

## Raport për rastin ex officio nr. 412/2022 lidhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr. 01/2022 mbi Përcaktimin e Procedurave për Funkcionimin e Njësive Organizative për Gjopa dhe Ndëshkime e Administratës Tatimore të Kosovës

Avokati i Popullit në këtë rast filloi hetimet sipas detyrës zyrtare duke u bazuar në artikullin e publikuar në portalin “Nacionale”, me titull: *“Paguaj dënimin 50% më lirë, por s’ ke të drejtë ankese – a po e shkel ATK-ja Kushtetutën?”*<sup>193</sup>, të datës 15 korrik 2022. Artikulli në fjalë shpjegonte se ATK-ja ka miratuar Rregulloren nr. 01/2022 mbi Përcaktimin e Procedurave për Funkcionimin e Njësive Organizative për Gjopa dhe Ndëshkime (ZGjoNA). Më tej, artikulli sqaronte se Rregullorja nr. 01/2022 përcakton: *“Në rast se tatimpaguesi paguan gjobën e shqiptuar brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit nga ZGjoNA, tatimpaguesi lirohet nga pagesa e pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së gjobës së shqiptuar dhe në këtë rast procedura e ankimit suprimohet dhe rasti konsiderohet i mbyllur.”*

Raporti për këtë rast ka për qëllim të tërheqë vëmendjen së Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: ATK) lidhur me shkeljen e së drejtës së tatimpaguesve për ankesë ndaj vendimeve të Njësive Organizative për Gjopa dhe Ndëshkime (ZGjoNA), e cila është bërë me Rregulloren nr. 01/2022 mbi Përcaktimin e Procedurave për Funkcionimin e Njësive Organizative për Gjopa dhe Ndëshkime (në tekstin e mëtejme: Rregullorja nr. 01/2022).

Në ueb-faqen zyrtare ATK-ja kishte publikuar njoftimin me titull: *“Njoftim për tatimpagues - Gjobat mund të paguhen vetëm 50%, nëse paguhen brenda 15 ditëve.”*<sup>194</sup>, ku ndër të tjera njoftohej për nxjerrjen e rregullores së re, e cila kishte përcaktuar se në rast se gjopa paguhej brenda 15 ditësh, ankesa suprimohej dhe rasti konsiderohej i mbyllur.

Avokati i Popullit vëren se në kuptim të së drejtës kushtetuese për mjete juridike, personat ndaj të cilëve është shqiptuar kundërvajtja kanë të drejtë t’i apelojnë dënimet e tyre. Ligji për Kundërvajtje përcakton në nenin 58: *“Për kundërvajtje dhe për shqiptimin e sanksionit të kundërvajtjes vendos gjykata, përkatësisht organi i kundërvajtjes me vendim, kundër të cilave lejohen mjetet juridike të përcaktuara me këtë ligj.”*

193 Paguaj dënimin 50% më lirë, por s'ke të drejtë ankese – a po e shkel ATK-ja Kushtetutën? - [https://nacionale.com/sociale/paguaj-denimin-50-me-lire-por-ske-te-drejte-ankese-a-po-e-shkele-atk-ja-kushtetuten?fbclid=IwAR3Han7k35-vFtQU21M\\_JhMGPTAgouHsx2GjvHIUR\\_YqV05-FDC5nN\\_xeng](https://nacionale.com/sociale/paguaj-denimin-50-me-lire-por-ske-te-drejte-ankese-a-po-e-shkele-atk-ja-kushtetuten?fbclid=IwAR3Han7k35-vFtQU21M_JhMGPTAgouHsx2GjvHIUR_YqV05-FDC5nN_xeng)

194 Njoftim për tatimpagues - Gjobat mund të paguhen vetëm 50%, nëse paguhen brenda 15 ditëve - <https://www.atk-ks.org/njoftim-per-tatimpagues-gjobat-mund-te-paguhen-vetem-50-nese-paguhen-brenda-15-diteve/>



Për më tepër, neni 54 të Ligjit për Kundërvajtje parasheh dyshkallëshin e procedurës së kundërvajtjes, duke përcaktuar: *“Kundër vendimit të nxjerrë në shkallën e parë mund të paraqitet ankesa, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.”* Pra e drejta e ankimit të vendimeve për kundërvajtje është e paraparë me ligj dhe përjashtimet nga kjo e drejtë caktohen me ligj. Sipas rregullit, ankesa, si mjet i rregullt juridik, e cila mundëson atakimin e një vendimi të organit për kundërvajtje, nuk lejohet vetëm nëse ligji shprehimisht e parasheh kështu. Sipas nenit 63 të Ligjit për Kundërvajtje, organi i kundërvajtjes, me rastin e zhvillimit të procedurës së kundërvajtjes, përshtatshëmrisht i zbaton dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative. Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenin 13, parasheh parimin e së drejtës për mjete juridike. Sipas këtij përcaktimi, ankesa, si mjet juridik në procedurën e kundërvajtjes para organit të kundërvajtjes, në raste të caktuara mund të përjashtohet shprehimisht me ligj dhe nuk është e mundur të mohohet me akt nënligjor siç është rasti me Rregulloren nr. 01/2022.

Avokati i Popullit konsideron se është thelbësore të bëhet dallimi në mes të procedurave gjyqësore dhe procedurave para organeve administrative. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në Udhëzimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, datë 2 tetor 2020, sipas të cilit Gjykata Supreme ka gjetur se organet e administratës nuk mund t'u referohen rregullave gjyqësore. Kjo sepse Ligji për Kundërvajtje pagimin e gjobave të shqiptuara nga gjykata e rregullon ndaras nga dispozitat e urdhrin kundërvajtës që shqipton gjobat nga organi kompetent i kundërvajtjes.

Gjatë trajtimit të këtij rasti, por edhe të rasteve të ngjashme në të kaluarën Avokati i Popullit, vëren se kushtëzimi i qytetarëve në forma të tilla paraqet cenim të ndarjes së pushteteve, të përcaktuar me nenin 4 të Kushtetutës. Nga rastet e trajtuara deri më tani, vërehet se me vendosjen e kushtëzimeve për qytetarët të cilat drejtpërdrejt nuk lidhen me çështjen kryesore, tentohet të anashkalohe pushteti gjyqësor për të ardhur te rezultatet e shpejta, qoftë nga ana e autoriteteve në nivelin komunal, ashtu edhe në atë qendror. Një ndërhyrje e tillë jo vetëm që cenon ndarjen e pushteteve, por ka ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e garantuara me Kushtetutë, konkretisht në të drejtën për mjetet juridike. Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit i rekomandoi Administratës Tatimore të Kosovës që të ndryshojë Rregulloren nr. 01/2022 mbi Përcaktimin e Procedurave për Funksonimin e Njërive Organizative për Gjopa dhe Ndëshkime (ZGjoNA), përkatësisht nenin 12, paragrafi 3, ta riformulojë në atë mënyrë që të mos humbë e drejta për ankesë.

## **Raport për rastin A. nr. 700/2020 përkitazi me pretendimet e ankuesit për mospërgjigje në kërkesë dhe në ankesë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**

Raporti bazohet në ankesë individuale dhe vlerëson veprimet, respektivisht mosveprimet e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si autoritet përgjegjës, në lidhje me trajtimin e kërkesës së ankuesit I. M. Sipas pohimeve të ankuesit dhe të dokumentacionit të paraqitur, nga data 20 nëntor 2017 e deri më 30 shtator 2019 kishte punuar me kontratë për shërbime të veçanta në Divizionin për Komunikim me Publikun në MI. Më 6 mars 2020 ankuesi nëpërmjet kërkesës (nr. 2684) drejtuar MI-së kishte kërkuar të pajisej me certifikatën e kontributit pensional dhe mbajtjes në burim të tatimit në paga për periudhën e punësimit të tij në MI. Meqë ankuesi nuk kishte marrë përgjigje në këtë kërkesë, ai më 24 qershor 2020 e kishte përsëritur kërkesën e tij nëpërmjet postës elektronike. Meqenëse ankuesi

edhe në këtë shkresë nuk kishte marrë përgjigje, më 8 korrik 2020 i ishte drejtuar MI-së me ankesë për mospërgjigje në këto kërkesa.

Pas kësaj, më 16 korrik 2020, ankuesi nëpërmjet postës elektronike kishte marrë një përgjigje nga zyrtarja e kontabilitetit në këtë ministri, nëpërmjet së cilës ishte njoftuar se zyrtarja në fjalë nuk ishte kompetente të lëshonte certifikatën e kontributit pensional dhe mbajtjes në burim të tatimit në paga dhe se kompetentë për këtë çështje ishin zyrtarë të tjerë në ministri. Pas kësaj ai nuk ka marrë asnjë lloj informacioni tjetër.

Në këtë raport Avokati i Popullit konstatoi se mospërgjigja e ministrisë në kërkesën e ankuesit është në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Mosarritja e organit kompetent që veprimet e tij në çështjen konkrete t'i mbështesë në parimin e ligjshmërisë, në parimin e joformalitetit dhe të efikasitetit, në parimin e informimit dhe të ndihmës aktive, si parime bazë që sigurojnë funksionimin e shtetit demokratik, është tregues i qartë i shkeljes së të drejtave të ankuesit për sigurimin e një procesi efektiv administrativ në përputhje me ligjin.

Po ashtu Avokati i Popullit konsideron se mosveprimi i ministrisë për sigurimin e certifikatës së kontributit pensional dhe mbajtjes në burim të tatimit në paga, për periudhën e punësimit të ankuesit në MI, është në kundërshtim edhe me Ligjin nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale si dhe në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2016 për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale. Me këtë raport Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Infrastrukturës që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme përkitazi me kërkesën e ankuesit dhe t'i përgjigjet atij, në pajtim me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe me Ligjin nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

## **Raport për rastin A. nr. 723/2021 në lidhje me cenimin e së drejtës për informim dhe ushtrim të mjeteve juridike**

Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Fakultetit Juridik të Universitetit "Haxhi Zeka" (UHZ) në Pejë lidhur me cenimin e së drejtës për informim dhe shfrytëzim të mjeteve efektive juridike të ankuesit që ka të bëjë me shpalljen e rezultateve të Konkursit nr. 2803 për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njëjësive akademike të UHZ-së, për vitin akademik 2021/2022.

Ankuesi, nëpërmjet aplikimit online, kishte aplikuar në dy pozitat e shpallura në Kursin me nr. 2803 për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njëjësive akademike të UHZ-së për vitin akademik 2021/2022. Duke qenë se rezultatet e konkursit në fjalë nuk ishin publikuar, ai kishte kërkuar dy herë radhazi që të informohej nga Fakulteti Juridik për rezultatet e konkursit, por nuk kishte marrë përgjigje në kërkesën e tij.

Pas kërkesës së Avokatit të Popullit drejtuar Rektorit të UHZ-së që të informohej në lidhje me këtë, ai kishte marrë përgjigje nga rektori dhe nga dekani, nëpërmjet së cilës ndër të tjera ishte njoftuar se ishte marrë Vendimi i Këshillit të Fakultetit Juridik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe i cili ishte shpallur në tabelën e shpalljeve në Fakultet Juridik, dhe se ankuesi nuk e kishte shfrytëzuar të drejtën e ankesës në afatin prej 8 ditësh.

Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit sjell në vëmendje se informimi i palëve për ecurinë e një procedure administrative, ku është vendosur për ndonjë të drejtë apo detyrim të tij, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme të informimit është i vetmi mjet i cili mundëson ushtrimin e së drejtës për mjete juridike, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë dhe me instrumente ndërkombëtare.

Avokati i Popullit konsideron se shpallja e vendimit të Këshillit të Fakultetit Juridik në tabelën e shpalljeve të këtij fakulteti dhe jo në ueb-faqen e universitetit, formë e përcaktuar me Rregulloren nr. 2327 të procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UHZ, ka cenuar të drejtën e palës për informim përmes mjeteve të qasshme të informimit. Si rrjedhojë, Avokati i Popullit ia rikujton autoritetit se çdo veprim administrativ që kufizon apo mund të kufizojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar vetëm me ligj. Për këtë Avokati i Popullit i rekomandoi Fakultetit Juridik të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë që të publikonte vendimin e Këshillit të Fakultetit Juridik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm lidhur me Konkursin me nr. 2803, në përputhje me nenin 8, paragrafi 2, të Rregullores nr. 2327, ashtu që afati i ushtrimit të mjeteve juridike të rridhte nga koha e publikimit të vendimit në përputhje me rregulloren në fjalë.

## **Raport për rastin A. nr. 369/2021 lidhur me moszbatimin e vendimit të plotfuqishëm të organit të shkallës së dytë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**

Raporti bazohet në ankesë individuale që ka të bëjë me moszbatimin e Vendimit të plotfuqishëm A-18/19 të datës 15 maj 2019, i nxjerrë nga organi i shkallës së dytë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), i cili përcakton obligimin e Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës të veprojë sipas kërkesës së ankuesit dhe Rregullores 01Nr.110-288305 për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karaktere të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridikë.

Avokati i Popullit vlerëson se kundër Vendimit Nr. A-18/19, datë 15 maj 2019, i nxjerrë nga MMPH-ja, si organ epror, nga Komuna e Prishtinës nuk ishte iniciuar në gjykatë padi për konflikt administrativ. Me kalimin e afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh, vendimi është bërë i plotfuqishëm, dhe si rrjedhojë organi i administratës, respektivisht DU në Komunën e Prishtinës është e obliguar ta zbatojë atë. DU-ja në Komunën e Prishtinës, në vend se të vepronte sipas detyrimit të dhënë me vendim përfundimtar dhe obligues të organit epror në MMPH, në lidhje me çështjen e ankuesit ka vazhduar me nxjerrje të vendimeve të tjera (05NR.350/02-0265139/18, datë 15 shtator 2020; 05 Nr.02-0265139/18, datë 2 tetor 2019, i vlerësuar nga MMPH-ja si i paligjshëm; 05 Nr.070/01-192404/21, datë 1 tetor 2021).

Avokati i Popullit rikujton se autoritetet kompetente kanë obligim pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor, e edhe në atë praktik, i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme.

Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit thekson se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi ligjor do të lejonte që një vendim administrativ i plotfuqishëm të mbetet i paefektshëm në dëm të ankuesit. Prandaj, moszbatimi i vendimeve administrative të plotfuqishme prodhon efekte negative, të cilat sjellin para situatave që nuk

janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, parim të cilin autoritetet e Republikës së Kosovës janë të obliguara ta respektojnë.<sup>195</sup>

Moszbatimi i vendimit të plotfuqishëm të organit epror, respektivisht të organit të shkallës së dytë nga DU-ja në Komunën e Prishtinës, është në kundërshtim me sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike, dhe si i tillë përbën shkelje të të drejtave të njeriut, shkel të drejtën për mjete juridike efektive, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë. Për këtë Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Prishtinës që të ndërmarrë veprime në drejtim të zbatimit të Vendimit të plotfuqishëm A-18/19, të datës 15 maj 2019.

## **Letër rekomandimi për rastin A. nr. 114/2021 që ka të bëjë shkeljen e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative**

Avokati i Popullit në këtë rast trajton ankesën individuale parashtruar kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ankuesja i ishte nënshtruar intervistimit për pozitën asistent/e ekzekutiv/e në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Cyrih të Zvicrës, në bazë të konkursit të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme në të cilin kishte aplikuar. Ajo nuk është njoftuar zyrtarisht nga MPJD-ja për mospërzgjedhjen e saj në pozitën e lartcekur, andaj e njëjta i është drejtuar Konsullatës së Republikës së Kosovës në Cyrih me kërkesë për informata, por nuk ka marrë përgjigje. Më pas ankuesja nëpërmjet përfaqësuesit të saj të autorizuar i është drejtuar MPJD-së me kërkesë për njoftim në lidhje me përzgjedhjen e kandidatit për pozitën asistent/e ekzekutiv/e në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Cyrih të Zvicrës, por kërkesa e ankueses nuk është pranuar dhe po ashtu nuk është regjistruar nga MPJD-ja. Duke qenë se kërkesa për njoftim nuk është pranuar, ankuesja kërkesën e ka dërguar edhe nëpërmjet postës, por e njëjta gjithashtu nuk është pranuar nga MPJD-ja dhe i është kthyer.

Avokati i Popullit konsideron se refuzimi i pranimit, mosregjistrimit dhe mospërgjigjja e MPJD-së në kërkesën që të njoftohet përkitazi me përzgjedhjen e kandidatit për pozitën asistent/e ekzekutiv/e në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Cyrih të Zvicrës është tregues i qartë i shkeljes së të drejtave të njeriut për faktin se është në kundërshtim me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe gjithashtu në kundërshtim me parimet bazë të shtetit demokratik, siç është: parimi i ligjshmërisë dhe parimi i informimit dhe i ndihmës aktive. MPJD-ja ka dështuar t'i përmbushte obligimet ligjore që burojnë nga Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 75, paragrafi 1, dhe neni 76, paragrafët 1 dhe 2.

Qëllimi i miradministrimit të organeve të administratës publike, ndër të tjera, është edhe krijimi i praktikave të mira, duke promovuar një kulturë administrative, transparente, të harmonizuar dhe me fokus te qytetarët dhe për këtë Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme përkitazi me kërkesën e ankueses dhe t'i përgjigjet asaj, në pajtim me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

<sup>195</sup> Neni 7, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

## **Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me Kërkesën KI 10/22 të Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme**

Ky Opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit shikuar nga këndvështrimi i përdorimit të mjeteve juridike në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me çështjen e ngritur në Gjykatën Kushtetuese nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore, e cila ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit A.nr. 1430/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të Aktvendimit AA.nr. 651/2021 të Gjykatës së Apelit dhe të Aktgjykimit ARJ nr. 115/2021 të Gjykatës Supreme, që kanë të bëjnë me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores MD - Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore ka ngritur në Gjykatën Supreme çështjen në fjalë me pretendimin e mospërputhjes së Rregullores MD - Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore, përkatësisht me nenin 15 [Veprimtaria e Institutit] të ligjit.

Meqenëse, Gjykata Supreme ka nxjerrë Aktgjykim ARJ 115/2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore kishte kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të vlerësohet kushtetutshmëria e Aktgjykimit ARJ 115/2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Siç u tha më lart, Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore kishte parashtruar kërkesë për vlerësimin e ligjshmërisë së rregullores në gjykatat e rregullta në Republikën e Kosovës. Kërkesa për vlerësimin e ligjshmërisë së rregullores së theksuar më sipër është refuzuar si e pabazuar nga GjThP-ja, GjA-ja dhe GjS-ja, duke e bërë të paqartë se cili institucion është përgjegjës për vlerësimin e akteve nënligjore apo nëse rregulloret e brendshme konsiderohen akte të përgjithshme, të cilat mund t'i nënshtrohen kontrollit gjyqësor.

Mjetet juridike për vlerësimin e ligjshmërisë/kushtetutshmërisë së rregulloreve të brendshme të institucioneve mbeten të vendosen nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa çështja e vlerësimit të ligjshmërisë/kushtetutshmërisë së udhëzimeve administrative nuk qartësohet krejtësisht me Ligjin Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Për më shumë, praktika e gjykatave të rregullta, konkretisht Aktvendimi A.nr.2886/2019, datë 11.6.2020, sipas të cilit kundër udhëzimit administrativ nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ dhe se për çështjen në fjalë ishte siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ, pa dhënë ndonjë sqarim se cila është mbrojtja gjyqësore e siguruar jashtë konfliktit administrativ, krijon një situatë të paqartë juridike, e cila kërkon një zgjidhje që do t'u mundësonte qytetarëve përdorimin efikas të mjeteve juridike.

Avokati i Popullit konsideron se është e rëndësishme të sqarohet përgjegjësia e institucionit kompetent për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve nënligjore. Kjo do të mundësonte vlerësimin e pajtueshmërisë së akteve nënligjore me ligjin, por edhe realizimin e së drejtës kushtetuese, përkatësisht nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], sipas të cilit përcaktohet:

*“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”*

Po ashtu, një vlerësim i tillë do t'i kontribuonte edhe zbatimit të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, sipas të cilit:

*“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*

Avokati i Popullit konsideron se situatat e tilla do të duhej të përcaktoheshin qartë në dispozitat e ligjeve (Ligjit për Aktet Normative, i cili aktualisht është në shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe Ligji për Konfliktet Administrative, i cili është në fazën e draftimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike). Kjo do të krijonte pasqyrë të qartë se cilat janë akte të përgjithshme normative, cilat nga këto akte i nënshtrohen kontrollit gjyqësor e cilat jo dhe të përcaktohej kompetenca e organit kompetent për vlerësimin e ligjshmërisë/kushtetutshmërisë së akteve të tilla. Andaj Avokati i Popullit e vlerëson si të domosdoshëm vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjet në fjalë e që drejtpërsëdrejti kanë ndikim në të drejtën për mbrojtje gjyqësore dhe për mjete juridike.

# E Drejta e Privatësisë

## Raport për rastin ex officio nr. 95/2022 lidhur me instalimin e kamerave në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur

Bazuar në shkrimet e mediave të shkruara dhe elektronike të publikuara më 7 shkurt 2022, se në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, në disa qeli ku mbahen të burgosurat të cilat vuajnë nga probleme serioze shëndetësore mendore, autoritetet e qendrës korrektuese instaluan kamera të sigurisë.

Ekipi i MKP-së, më 8 shkurt 2022, vizitoi qendrën në fjalë dhe vërejti se në disa qeli janë instaluar kamera të sigurisë në të cilat vendosen të burgosurat me gjendje të rëndë të shëndetit mendor, të cilat në parim do të duhej të trajtoheshin në institucione adekuata shëndetësore. Ekipi vërejti se kamerat e sigurisë mbulonin vetëm shtretërit dhe dritaret e qelive, nuk mbulonin tualetet, dushet dhe lavamanin. MKP-ja u njoftua se arsyeja e instalimit të kamerave të sigurisë në këto qeli ishte mbrojtja e të burgosurave të cilat përbëjnë rrezik për vetëlëndim apo vetëvrasje për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore. Gjatë vizitës ekipi MKP-së u njoftua se lidhur me këtë çështje dy zyrtarë të Qendrës Korrektuese për Femra janë suspenduar.

Avokati i Popullit, për rastin në fjalë, konstatoi se mungon akti normativ konkret me të cilin do të rregullohej vendosja e kamerave të sigurisë në qelinë e të burgosurit dhe i cili do të ofronte garancitë e duhura procedurale nga ndërhyrja arbitrare e autoriteteve. Andaj, lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit nxori raportin nëpërmjet të cilit i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të miratojë akt nënligjor, i cili do të përfshinte të gjitha garancitë procedurale kundër ndërhyrjes arbitrare në privatësinë e të burgosurve të cilët i nënshtrohen vëzhgimit me kamera të sigurisë në qelitë e tyre, të parapara me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, me vendimet e GjEDNj-së dhe me standardet e KPT-së, të cekura më lart.

Avokati i Popullit u njoftua nga Ministria e Drejtësisë se Shërbimi Korrektuese i Kosovës e ka formuar grupin punues për hartimin e Rregullores së brendshme për procedurat dhe masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale.



# E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike

## Raport për rastin A. nr. 418/2022, e drejta e qasjes në dokumente publike

Qëllim i këtij raporti është trajtimi i ankesës së L. H., gazetare në gazeta online “Insajderi” (në tekstin e mëtejme: ankuesja), lidhur me refuzimin e kërkesës për qasje në dokumente publike nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD).

Ankuesja i është drejtuar MPJD-së me kërkesë për qasje në dokumente publike, përkatësisht për qasje në shpenzimet për derivate të njërit nga diplomatët, nga muaji shkurt i vitit 2019 deri në muajin shkurt 2022. Pas refuzimit të kërkesës për qasje në dokumente publike, ankuesja i është drejtuar me ankesë Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), e cila, pas shqyrtimit të ankesës, nxjerr Vendim nr. A-272/2022, datë 2.6.2022 (nr. prot. 232), me të cilin ka obliguar MPJD-në që t'i ofronte qasje ankueses. Pavarësisht njoftimit të AIP-it për shqiptimin e gjobës administrative, datë 1 korrik 2022, MPJD-ja nuk ka ndërmarrë asnjë veprim sipas vendimit të AIP-it. AIP-i më 22.7.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr. Gj-272/2022 (datë 22.7.2022) për shqiptimin e gjobës ndaj MPJD-së, në shumën prej 13 000 eurosh.

Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit ia rikujtoi MPJD-së se kërkesat për qasje në dokumente publike që u drejtohen institucioneve publike nga qytetarë, nga shoqëria civile, nga media etj., janë kërkesa të cilat parashtrohen duke u nisur nga garancitë kushtetuese e ligjore në vend. Përveç kësaj, LQDP-ja shprehimisht e përcakton se kërkesat për qasje në dokumente publike, apo për ripërdorim të dokumenteve publike, trajtohen me shpejtësi dhe sipas parimit të objektivitetit dhe paanshmërisë sipas ligjit përkatës për procedurën e përgjithshme administrative (neni 11.6).

Avokati i Popullit nëpërmjet këtij raporti theksoi se llogaridhënia është thelbësore në drejtim të promovimit dhe të forcimit të demokracisë dhe të qeverisjes së mirë. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt kanë qytetarët, shoqëria civile dhe mediat. Trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike është detyrim ligjor për të gjitha subjektet që ushtrojnë autorizime publike. Rrjedhimisht kërkesat për qasje në dokumente publike, të parashtruara në institucione që ushtrojnë autorizime publike, nuk mund të trajtohen ndryshe përveçse sipas dispozitave ligjore në fuqi e që hyjnë në fushën e punëve të përditshme të administratës publike e shtetërore. Për këto që u thanë më lart, i rekomandoi Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që t'i ofrojë qasje në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

# Liria e Asociimit

## Raport për rastin A. nr. 474/2021 lidhur me pretendimet për diskriminim në bazë të lirisë së asociimit si anëtarë në Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës

Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Autoritetit të Aviacionit Civil (më tej: AAC) lidhur me nevojën e krijimit të hapësirës së mjaftueshme të veprimit për Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (më tej referuar si: shoqata sindikale), respektimin e lirisë së asociimit dhe gjetjes së gjuhës së përbashkët duke krijuar mundësi të përfshirjes së kësaj sindikate edhe në ndërtimin e politikave të institucionit pa i anashkaluar dhe diskriminuar ata.

Avokati i Popullit pas analizimit të ankesës dhe komunikimit me autoritetin përgjegjës konstaton se edhe pse liria e asociimit është e garantuar, vërehet se ka munguar vullneti i shprehur për bashkëpunim me shoqatën sindikale. Mosbashkëpunimi krijon divergjenca dhe probleme me efekte zinxhirore.

Liria sindikale përfshin të drejtën për qasje në sindikatë pa diskriminim dhe që në sindikatë të veprohet lirshëm. Veprimet e menaxhmentit të AAC-së ndaj zyrtarëve anëtarë të shoqatës sindikale, përveç që kanë efekt negativ tek ushtrimi i veprimtarisë sindikale, krijojnë frikë dhe pasiguri edhe tek zyrtarët e tjerë dhe pengojnë lirinë e asociimit. Zyrtarët e shoqatës sindikale, përfaqësuesit e tyre të angazhuar në negociata kolektive apo edhe anëtarët e sindikatës nuk duhet që për shkak të të qenët pjesë e sindikatës të kenë pasoja të dëmshme në formë të largimit nga puna apo masa të tjera të ushtrimit të presionit. Shoqatës sindikale në AAC duhet t'i sigurohet qasje e papenguar brenda fushëveprimit të saj në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të saj dhe në rastin konkret AAC-ja duhet ta mbështesë shoqatën sindikale duke e promovuar si vlerë e shtuar në AAC.

Bazuar në atë që u tha më sipër, Avokati i Popullit i rekomandoi Autoritetit të Aviacionit Civil që të ndërmarrë të gjitha masat në respektim të drejtës së asociimit të dhe organizimit sindikal pa asnjë pengesë ose masë që kufizon ose diskriminon anëtarët në organizimin sindikal; të rritet niveli i bashkëpunimit me Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në ushtrimin e plotë të detyrave sipas qëllimit të themelimit dhe përmbushjes me sukses të funksionit për të cilin është krijuar; në kuadër të hartimit të politikave të brendshme në Autoritetin e Aviacionit Civil, t'i mundësojë qasje edhe shoqatës sindikale, në mënyrë që të dëgjohen edhe propozimet e sindikatës në politikëbërjen e institucionit.

Ndërsa Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i rekomandoi që brenda kompetencave të ushtrisë mbikëqyrje në funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil, përfshirë gjendjen e krijuar në raportet sindikatë – udhëheqje e institucionit.

# Mbrojtja e Pronës

## Raport për rastin A. nr. 353/2021 lidhur me Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 01. Nr. 110-2782 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale

Ky raport bazohet në ankesën individuale të parashtruar kundër Komunës së Prishtinës, përkitazi me pagimin e tarifës për transaksion të pronës së paluajtshme. Sipas ankuesit, ai dhe familjarët e tij janë detyruar të paguanin rreth 14 000 euro tarifë në transaksion të pronës për pronat e trashëguara. Ankuesi pretendon se Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale e Komunës së Prishtinës është e kundërligjshme dhe e papërbalueshme për qytetarët e komunës së Prishtinës.

Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Komunës së Prishtinës lidhur me shkeljen e të drejtave të pronarëve të paluajtshmërive në territorin e komunës së Prishtinës, të cilët detyrohen ta paguajnë tarifën e taksës për transaksionet në pronën e paluajtshme, të përcaktuar me Rregulloren 01-413/04-0253531/17 (e datës 10 tetor 2017) për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 01 nr. 110-2782 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale (e datës 2.12.2011). Kjo Rregullore, neni 4, përcakton tarifën për transaksion të pronës. Ndërsa Rregullorja 01 NR110-2782 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, e datës 2.12.2011 (2017), në nenin 1 ndryshon nenin 4 të rregullores bazë. Sipas nenit 1, paragrafët 1 dhe 2, tarifa e taksës për transaksionin për pronën e paluajtshme përcaktohet si në vijim: Një njësi llogaritet në vlerën prej 150 euro; Kur një person fizik/juridik fiton të drejtën e pronësisë me një akt juridik, do të caktohet lartësia e taksës në vlerën prej 150 euro për njësi.

Komuna e Prishtinës, më 10 tetor 2017, kishte miratuar Rregulloren 01-413/04-0253531/17 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 01 nr. 110-2782 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, përmes së cilës kishte përcaktuar pagesën e tarifës për transaksion të pronës së paluajtshme në territorin e komunës së Prishtinës.

Lidhur me këtë çështje, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave kanë bërë vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të theksuar më sipër dhe nuk e kanë aprovuar vendimin për ndryshimin e rregullores së lartcekur duke përsëritur qëndrimin e tyre të datës 17 maj 2017 se Komuna e Prishtinës i ngarkon qytetarët me taksa të dyfishta në momentin e transaksionit të pronës. Këto dy ministri e kanë njoftuar Komunën e Prishtinës për nevojën e nxjerrjes së një rregulloreje të re ku nuk duhet të përfshihet pagesa e tarifës në transaksion të pronës së paluajtshme, sepse kjo konsiderohet taksë e dyfishtë në momentin e transaksionit të pronës, mirëpo kjo nuk është marrë parasysh nga Komuna e Prishtinës. Megjithatë, asnjëra nga këto ministri nuk ka vepruar në pajtim me nenin 9, paragrafi 6, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, sipas të cilit, institucionet kompetente për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të komunave duhet t'i ndërmarrin veprimet konkrete për fillimin e procedurave gjyqësore, në rast se komunat nuk i përfillojnë kërkesat për rishqyrtimin e akteve të tyre.

Avokati i Popullit vlerësoi se obligimi i qytetarëve të komunës së Prishtinës që ta paguajnë tarifën për transaksion të pronës së paluajtshme e cenon të drejtën e tyre pronësore, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë dhe me KEDNJ dhe i rekomandoi Komunës së Prishtinës të shfuqizojë Rregulloren 01-413/04-0253531/17, e datës 10 tetor 2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 01 nr. 110-2782 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, të datës 2.12.2011; ndërsa Ministrisë së Pushtetit Lokal të ndërmarrë masa për fillimin e procedurave gjyqësore lidhur me kontestimin e akteve komunale, në rastet kur komunat refuzojnë kërkesën e ministrisë për rishqyrtimin e akteve komunale.

## **Raport për rastin A. nr. 700/2021 lidhur me obligimet e organeve të administratës komunale për ndërmarrjen e veprimeve për sa i përket procesit të kthimit**

Raporti është hartuar bazuar në ankesën individuale dhe ka për qëllim t'i analizojë pohimet ankimore të ankueses dhe në përgjithësi rrethanat e rastit, në raport me obligimet e organeve të administratës komunale për ndërmarrjen e veprimeve për sa i përket procesit të kthimit të ankueses, e cila ishte zhvendosur nga komuna e Gjakovës si pasojë e luftës në Kosovë në vitin 1999.

Ankuesja i kishte parashtruar kërkesë Drejtorisë për Urbanizëm e Komunës së Gjakovës që t'ia lejonte asaj rinovimin e banesës dhe ndërrimin derës së hyrjes, por nuk kishte pranuar asnjëherë përgjigje. Në ankesën drejtuar Avokatit të Popullit, ajo kishte përshkruar procesin e kthimit dhe kishte theksuar se kthimi i saj si person i zhvendosur, e cila në mënyrë ligjore e ktheu të drejtën e shfrytëzimit të banesës, Komuna e Gjakovës mbi çdo bazë pamundëson, parandalon ose dëbon nga banesa pa dhënë asnjë justifikim të vlefshëm.

Ajo ishte larguar nga banesa në vitin 1999 për arsye sigurie, siç kishte pohuar ajo, për shkak të luftës në Kosovë. Gjatë viteve në vijim, sipas ankueses, palët e treta kishin uzurpuar në mënyrë të përsëritur pronën e paluajtshme, ndërsa Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore i kishte njohur asaj të drejtën e posedimit të banesës në fjalë, ndërsa në vitin 2021 nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës ishte lëshuar Protokolli mbi Dorëzimin e Çelësave – Fletëdorëzim, i cili vërtetonte se ankuesja kishte pranuar çelësat e pronës - objekt i kërkesës. Me rastin e kthimit të ankueses në banesë, UNHCR-ja kishin hartuar një formular vlerësimi për të kthyerit vullnetarë nga komunitetet pakicë, ku thuhej: *“Zonja është kthyer në banesën e cila ishte uzurpuar, por është liruar nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) dhe Policia e Kosovës. Apartamenti është plotësisht i zbrazët, kemi nevojë urgjente për mobilje dhe ushqim. Ajo vuan nga diabeti, merr insulinë, ndaj duhet një frigorifer që të mos prishet insulina. Apartamenti ka nevojë për rinovim pasi është në gjendje shumë të keqe.”*

Pas kësaj nga organet komunale nuk ia lejuan ankueses vendosjen e derës së hyrjes së banesës dhe renovimin e banesës duke kërkuar nga ajo që të ndjekë procedurat administrative. Pas parashtrimit të kërkesës ajo nuk mori përgjigje, përveç kërkesës nga komuna që ajo të dëshmojë pronësinë.

Komuna e Gjakovës pretendoi se kjo banesë është pronë e komunës, ani pse nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të menaxhimit të asaj banese deri me rastin e kthimit të ankuesës. Për këtë ata parashtruan padi në Gjykatën Themelore në Gjakovë për anulimin e kontratës për dhënie me qira të banesës, me propozim për caktimin e masës së sigurisë.

Me këtë raport Avokati i Popullit theksoi se parimi i barazisë është parimi themelor i rendit juridik shtetëror, bazë mbi të cilën bazohet dhe ndërtohet rendi juridik, por edhe e drejta themelore e qytetarëve e garantuar me Kushtetutë dhe se vendimet e organeve të administratës ndikojnë në realizimin e të drejtave të qytetarëve, të parashikuara me ligj. Ato vendosin norma të përgjithshme në një fushë të gjerë të veprimtarisë administrative, prandaj qoftë nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, qoftë nga pikëpamja e shtetit të së drejtës, është e rëndësishme që vendimet e organeve administrative të jenë të ligjshme dhe në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut. Zbatimi unik i ligjit, pra edhe i së drejtës administrative, është padyshim një detyrim i çdo sistemi juridik.

Është i pakontestueshëm fakti se ankuesja është vendosur në një banesë në pronësi komunale në bazë të një kontrate për shfrytëzimin e banesës dhe një kontrate qiraje duke e fituar të drejtën për ta përdorur atë për t'i përmbushur nevojat e saj familjare për strehim. E njëjta marrëveshje përcaktonte të drejtat dhe detyrimet e palëve në përdorimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e banesës. E drejta e shfrytëzimit të banesës është e drejtë e konfirmuar edhe me vendimet e mëvonshme të Agjencisë Kosovare të Pronave.

Obligimet e autoriteteve vendore përkitazi me kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur i përcakton Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila në nenin 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit] thekson: *“Republika e Kosovës promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre.”* Më këtë përcaktohet detyrimi i organeve shtetërore që të punojnë në dy drejtime: “promovon” - që do të thotë punon në drejtim të krijimit të një ambienti të përshtatshëm dhe të sigurt për kthim; dhe “lehtëson” - që do të thotë krijimin e lehtësirave për personat që dëshirojnë të kthehen në vend.

Nga ankesa parashtruar Avokatit të Popullit, ankuesja ka theksuar dështimin e Komunës së Gjakovës që t'i përgjigjej kërkesës së saj për ta marrë pëlqimin për renovimin e banesës dhe që pala përgjegjëse njoftimet e veta dhe vendimet administrative ia dorëzoi asaj vetëm në gjuhën shqipe. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 5 [Gjuhët], paragrafi 1, thekson: *“Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe.”*

Në këtë raport Avokati i Popullit konstatoi se si ankuesja kishte vendosur individualisht dhe në mënyrë spontane të kthehej në banesë me të drejtë posedimi tanimë të konfirmuar. Edhe pse autoritetet përkatëse komunale nuk ishin njoftuar paraprakisht dhe procesi i kthimit nuk ishte i koordinuar përmes tyre, nuk do të thotë se po ato autoritete shkëputen nga përgjegjësia që kanë për të miradministruar proceset që zhvillohen në territorin ku shtrihet kompetenca e tyre. Kthimi i personave të zhvendosur ka dimensionin kompleks në vetvete dhe autoritetet duhet të jenë të ndërgjegjshme dhe të përgjegjshme për mënyrën se si i përmbushin detyrimet dhe rolin që kanë. Standardi i miradministritimit nënkupton një qëndrim aktiv dhe të angazhuar të organit të administratës ndaj kryerjes së detyrave brenda fushëveprimit të tij dhe kryerjes së ligjshme të atyre detyrave për ta arritur qëllimin, për të cilin këtij organi i janë dhënë kompetenca publike.

Rregullorja Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme do të duhej të shërbente si bazë mbi të cilën autoritetet komunale do të ushtronin veprimtarinë e tyre në drejtim të krijimit të një ambienti të përshtatshëm për kthimin e ankueses, e që në këtë rast duket se ka munguar zbatimi i plotë i saj.

Avokati i Popullit konstaton se periudha e gjatë kohore e procedurave administrative në Komunën e Gjakovës, si dhe komunikimi joefikas, ka krijuar një situatë të paqartë për ankuesen, në lidhje me mundësinë e saj për të gëzuar në mënyrë paqësore të drejtat e garantuara. Organet komunale nuk arritën t'ia siguronin ankueses të drejtën e saj për shfrytëzimin e një të drejte të konfirmuar me vendime administrative.

Avokati i Popullit konstaton se komunikimi zyrtar i organeve të administratës me ankuesen është në kundërshtim me nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare.

E drejta e shfrytëzimit të banesës ishte konfirmuar me vendimet e organit kompetent që trajton çështjet pronësore të kësaj natyre në Kosovë. Asnjë procedurë gjyqësore dhe asnjë veprim tjetër administrativ për kontestimin e kësaj nuk u ndërmor nga organet komunale në lidhje me këtë pronë deri në momentin e kthimit të ankueses. Për këto që u thanë më lart Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Gjakovës që të respektohet Rregullorja Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, të lejohet parashtruesja e ankesës ta përshtatë ambientin e brendshëm të pronës në fjalë, si dhe t'i mundësohet asaj ta shfrytëzojë lirshëm atë dhe pa pengesa të tjera, si dhe që organet e administratës komunale ta zbatojnë ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe komunikimi zyrtar me parashtruesen e ankesës të zhvillohet sipas kërkesave të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

## **Kërkesë e Avokatit të Popullit për pezullimin e zbatimit të vendimit mbi lirimin e pronës dhe kthimin e saj në Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahasim të Pronës**

Avokati i Popullit ka pranuar një ankesë individuale të parashtruar nga një qytetar i Kosovës kundër Agjencisë Kosovare për Verifikim dhe Krahasim të Pronës (AKKVP). Sipas informatave të ofruara nga ankuesi kuptohet se në vitin 2001 kishte blerë një banesë për shitblerjen e së cilës kishin nënshkruar kontratë shitblerje të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë në atë kohë. Në vitin 2007 ai ishte njoftuar nga Agjencia Kosovare për Prona se për banesën në fjalë, një person tjetër, pretendonte të drejtën e pronësisë, pasi ishte larguar me dhunë nga ajo banesë gjatë luftës. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) kishte vendosur që ankuesi duhet ta lironte banesën në fjalë dhe aty të vendosej pala që pretendonte.

Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit, pas trajtimit të këtij rasti vëren se puna juridike mbi të cilën ankuesi kishte fituar pronësinë nuk ishte anuluar dhe ishte akoma në fuqi. Gjithashtu, pala e cila pretendon pronësinë, prej momentit të nxjerrjes së Vendimit HPCC/REC/74/2006, datë 19 tetor 2006, nuk e kishte regjistruar pronësinë mbi pronën e theksuar më sipër dhe as nuk kishte bërë kërkesë për regjistrimin e pronësisë.

Avokati i Popullit, nëpërmjet kësaj kërkesë për pezullim, vlerësoi se është me rëndësi substanciale që rasti konkret të sqarohet në pikat e theksuara më lart, dhe për këtë, duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 5, të Ligjit për Avokatin e Popullit, kërkoi pezullimin e zbatimit të Njoftimit nr. DS004209 mbi lirimin e pronës dhe kthimin e saj AKKVP-së, i datës 25.5.2021, deri në përfundim të hetimeve nga Avokati i Popullit.

Avokati i Popullit konsideron se kriteri substancial i një kërkesë për një pezullim të tillë është përmbushur qartazi në këtë rast, për shkak se veprimet sipas Njoftimit nr. DS004209 shkaktojnë dëme të pariparueshme të të drejtave të ankuesit.

# E Drejta për Arsimin dhe Të Drejtat e Fëmijës

## Raport për rastin ex officio nr. 331/2022 lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar të Kosovës me të drejtat e fëmijëve në arsim

Raporti ka për qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve në sektorin e arsimit nga autoritetet dhe institucionet e arsimit të Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon: (i) Shkollimin themelor publik pa pagesë për fëmijët dhe (ii) mundësi të barabarta për të gjithë për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tyre. Këto dy dispozita kushtetuese ngërthejnë tri aspekte themelore: (i) Sistemi arsimor duhet të ofrojë qasje në arsim, përfshirë arsimin themelor të detyrueshëm; (ii) arsimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe duhet të ofrojë mundësi të barabarta për arsimim; dhe (iii) arsimi duhet të shërbejë për përmbushjen e nevojave themelore dhe specifike të çdo fëmije. Përderisa aspekti i parë i referohet *qasjes ose pjesëmarrjes në arsim*, si një e drejtë themelore dhe (në këtë rast) kushtetuese e njeriut, aspekti i dytë dhe i tretë trajtojnë gjithëpërfshirjen dhe rëndësinë e arsimit të ofruar në Kosovë për *zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijëve sipas nevojave dhe aftësive të tyre specifike*. Prandaj raporti heton pjesëmarrjen e fëmijëve, gjithëpërfshirjen e institucioneve arsimore dhe rëndësinë e arsimit të ofruar në Kosovë për të përcaktuar nëse ato shërbejnë për ta përmbushur të drejtën e fëmijëve në arsim, si një e drejtë themelore e njeriut.

Pjesëmarrja në arsim - përkufizohet si: *“Shpeshësia me të cilën një nxënës ndjek të njëjtat aktivitete arsimore si nxënësit/studentët e tjerë, kombinuar me intensitetin e përfshirjes që nxënësi e percepton në aktivitetet e ndjekura.”*<sup>196</sup> Ky përkufizim përbëhet nga tre komponentë kryesorë: (i) Ndjekja e shkollimit, (ii) barazia me nxënësit e tjerë, (iii) përfshirja aktive e nxënësve individualë në një mjedis arsimor. Më tej kjo pjesëmarrje përfshin edhe *“nëse mjedisi është i përshtatur dhe pranohet nga fëmija derisa përshkruan intensitetin e përfshirjes ose angazhimit në një aktivitet”*. Në mënyrë që ky mjedis të jetë i favorshëm, duhet

196 M. G. L. A. Gregor R Maxwell, «Inclusion Through Participation: Understanding Participation in the International Classification of Functioning, Disability, and Health as a Methodological Research Tool for Investigating Inclusion,» *Frontiers in Education*, vëll. i 3, nr. June 2018, p. 16, June 2018.



të analizohen pesë dimensione me rendësi<sup>197</sup>, si: disponueshmëria;<sup>198</sup> qasshmëria;<sup>199</sup> përballueshmëria;<sup>200</sup> mundësia e përshtatjes/adaptimit;<sup>201</sup> dhe pranueshmëria.<sup>202</sup> Për qëllime të këtij hetimi, këto pesë dimensione janë përdorur për ta lehtësuar të kuptuarit dhe mjedisin mësimor gjatë vizitave në terren në shkolla.

Përfshirja në arsim - një përkufizim përgjithësisht i pranuar dhe i gjerë i përfshirjes është ai i paraqitur në Deklaratën e Salamankës<sup>203</sup>, i cili thotë: *“Parimi themelor i shkollës gjithëpërfshirëse është që të gjithë fëmijët duhet të mësojnë së bashku, kudo që është e mundur, pavarësisht vështirësive apo dallimeve që mund të kenë. Shkollat gjithëpërfshirëse duhet të kuptojnë dhe t’u përgjigjen nevojave të ndryshme të nxënësve të tyre, duke përshtatur stile dhe shkallë të ndryshme të të mësuarit dhe duke siguruar arsim cilësor për të gjithë nëpërmjet kurrikulave të duhura, rregullimeve organizative, strategjive të mësimdhënies, përdorimit të mjeteve dhe partneriteteve me komunitetet e tyre.”* Kjo deklaratë rezultoi me një qasje të re në arsim, e cila promovoi integrimin në shkollimin e rregullt të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Megjithatë: *“Ndryshe nga synimet, zbatimi i integritit në praktikë nuk eliminoi ndarjen, marginalizimin, diskriminimin apo zhvlerësimin në mjediset e shkollave të zakonshme. Integrimi ishte kryesisht një reformë në nivel të sistemit, duke marrë si të mirëqenë se ndryshimet në sistemim (vendosje) do të ndikonin në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në klasë në mënyrën më të mirë për “nxënësit që integroheshin.”*<sup>204</sup> Rreth 15 vjet pas fillimit të zbatimit të konceptit të integritit, ky hetim shqyrtoi shkurtimisht rezultatet e mundshme dhe ndikimin që ka pasur qasja e re në shkollimin në Kosovë për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

Rëndësia e arsimit- lidhur me rëndësinë e arsimit dhe se për çfarë qëllimesh shërben dhe duhet të shërbejë ai, studiuesit kryesorë të kësaj fushe ndahen në dy grupe: (i) Grupi i parë deklaron se arsimi duhet t’i shërbejë qëllimit utilitar të zhvillimit ekonomik individual dhe shoqëror. Ai zakonisht u referohet vlerave të jashtme, rezultateve arsimore, kontributeve në zhvillimin ekonomik, ndërtimit të kapitalit njerëzor e kështu me radhë, të gjitha këto që i shërbejnë përfitimeve të përbashkëta shoqërore dhe që i përjashtojnë vlerat e brendshme;<sup>205</sup> (ii) Grupi i dytë fokusohet në nxënësin, duke theksuar: *“(…) kuptimi i plotë i motivimit të nxënësit dhe efekteve kontekstuale që ndikojnë në motivim është thelbësor drejt transformimit të shkollave nga të qenit burgje të perceptuara intelektuale, pa rëndësi dhe domethënie personale, në mjedise që mbështesin eksplorimin, mësimnxënien dhe kreativitetin tek të gjithë nxënësit.”*<sup>206</sup> Andaj arsimi duhet jo vetëm t’i përmbushë prioritetet e autoriteteve shoqërore, por edhe t’i përmirësojë arritjet akademike të nxënësve, motivimin dhe pasionin e vazhdueshëm për të mësuar.<sup>207</sup>

197 Këto pesë dimensione kanë rezultuar të rëndësishme në vlerësimin e mjedisit shkollor gjatë vizitave në shkolla si pjesë e këtij hulumtimi. Formulimi i përshkrimit të pesë dimensioneve është modifikuar pak për ta kuptuar më lehtë pa e ndryshuar substancën ose kuptimin.

198 Përshkruan mundësinë objektive për t’u angazhuar në arsim.

199 Përshkruan se a mundeni, apo e perceptoni se mundeni, të keni qasje në kontekstin arsimor.

200 Mbulon jo vetëm kufizimet financiare, por edhe nëse shpaguhen përpjekjet, si në aspektin e kohës ashtu edhe të energjisë së shpenzuar, për t’u angazhuar në arsim.

201 Përshkruan nëse një situatë mund të përshtatet [për nevojat e nxënësve].

202 Mbulon pranimin nga njerëzit të pranisë së një personi në një situatë.

203 UNESCO, «The Salamanca Statement and Framework,» UNESCO, Paris, 1994.

204 P. Haug, «Understanding inclusive education: ideals and reality,» Scandinavian Journal of Disability Research, vëll. i 19, nr. 3, pp. 206-217, 2017.

205 M. Gibbons, «Relevance of Higher Education in the 21st Century,» The World Bank, Washington, 1998.

206 E. M. A. Rich Gilman, «Motivation and its relevance to school psychology: An introduction to the special issue,» Journal of School Psychology, vëll. i 44, nr. 5, pp. 325-329, 2006.

207 J. Dewey, The School and Society, Chicago: The Chicago University Press, 1900.

Përkufizimi i fundit ishte ai që i dha drejtim hetimit për këtë raport, pasi është në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, e cila fokusohet në zhvillimin e fëmijëve sipas aftësive dhe nevojave të tyre specifike. Hetimi synon t'i adresojë tri pyetje kryesore: (i) A ofrohet qasje e barabartë në arsimin publik pa pagesë për të gjithë fëmijët në Kosovë, si një nga të drejtat themelore të njeriut? (ii) A është sistemi arsimor mjaft gjithëpërfshirës dhe a ndihen të gjithë nxënësit mirë dhe të pranuar brenda sistemit? (iii) A ofrohet arsimim adekuat dhe a shërben ai për zhvillimin e personalitetit, talentit dhe aftësive mendore dhe fizike të nxënësve në potencialin e tyre maksimal dhe bazuar në nevojat dhe aftësitë e tyre specifike?

Pas analizimit të legjislacionit përkatës, të instrumenteve ndërkombëtare, të dokumentacionit të çështjes, të informatave dhe të të dhënave që IAP-ja i ka, del se gjatë dekadës së fundit Kosova ka bërë përparim në fushën e zbatimit të të drejtave të njeriut në arsim. Ka pasur progres jo të barabartë në nënsektorë të ndryshëm sa i përket pjesëmarrjes, përfshirjes dhe zhvillimit të fëmijëve sipas nevojave dhe aftësive të tyre.

Sidoqoftë, ajo çfarë është shqetësuese është rezultati PISA në arsim në përgjithësi. Avokati i Popullit konsideron se cilësia e arsimit nuk është në nivelin e duhur për të përgatitur nxënësit për jetën dhe rikujton se komentari i nenit 29 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës nënvizon të drejtën individuale dhe subjektive për një cilësi specifike të arsimit.

Për më tepër, pandemia COVID-19 i dha një goditje të rëndë procesit të përmirësimeve të vazhdueshme në zbatimin e të drejtave të njeriut në sistemin arsimor të Kosovës. Të gjitha trendet dhe proceset pozitive ose kanë ngecur, në rastin më të keq (si ai për fëmijët me aftësi të kufizuara), ose janë kthyer mbrapsht gjatë pandemisë (mars 2020 - mars 2022).

Për sa i përket pjesëmarrjes në arsim, me pak përjashtime, fëmijët shkojnë në shkollë. Me fjalë të tjera, për sa i përket pjesëmarrjes, Kosova në përgjithësi ka arritur pjesëmarrje pothuajse universale në arsimin e përgjithshëm parauniversitar, me përjashtim të arsimit parashkollor, ku të dhënat janë jashtëzakonisht të ulëta, përkundër disa përmirësimeve në rritje në vitet e fundit.

Avokati i Popullit vlerëson se situata nuk është e mirë as kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në arsim të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe për pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Për kundër përparimeve të bëra në përmirësimin e pjesëmarrjes së fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim, ata ende mbeten dukshëm prapa komuniteteve të tjera, veçanërisht në arsimin parashkollor dhe në atë të mesëm të lartë.

Avokati i Popullit vlerëson se pjesëmarrja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë në arsimin e rregullt ka shënuar progres, mirëpo është ende larg përfshirjes të paktën 50% të këtyre fëmijëve në arsimin e ofruar, siç parashihet me PSAK 2017-2021.

Për sa i përket përfshirjes në arsim, përkundër mungesës së madhe të resurseve, shkollat janë përgjithësisht gjithëpërfshirëse dhe pranuese për të gjithë nxënësit, si dhe më miqësore dhe më të hapura ndaj diversitetit krahasuar me një dekadë më parë.

Avokati i Popullit gjithashtu vlerëson se mbetet shumë për të bërë në fushën e gjithëpërfshirjes në sistemi arsimor sidomos në evitimin e problemeve që ndërlidhet me performancën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ngjashëm, sistemi arsimor është ballafaquar me problemin e mungesës së teksteve shkollore për mësim në gjuhët boshnjake dhe turke, i cili pjesërisht është zgjidhur por që ka nevojë për përmirësim.

Të gjithë treguesit, nga hetimi i dokumentacionit dhe gjetjet nga hulumtimi empirik, tregojnë se sistemi arsimor i Kosovës është larg nga mundësia për ta zhvilluar plotësisht potencialin e fëmijëve sipas nevojave dhe aftësive të tyre specifike. Raporti në shtojcën e tij në formë tabelore përshkruan në mënyrë më të detajuar gjetjet e hetimit mbi zbatimin e të drejtave të njeriut të fëmijëve në arsim në Kosovë: *“Identifikimi i çështjeve kyçe në (mos)harmonizimin e shërbimeve arsimore me të drejtat e fëmijëve në arsimin e përgjithshëm parauniversitar në Kosovë.”*

Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit i rekomandon Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit që të hartojë dhe zbatojë një strategji për të përmirësuar pjesëmarrjen, cilësinë dhe njohjen e hershme të aftësisë së kufizuar në të paktën dy vjet të arsimit parashkollor (moshat 3 dhe 4), përfshirë përdorimin e ambienteve të shkollës për të hapur shërbime/grupe të edukimit parashkollor; t'i rishikojë aktet nënligjore që rregullojnë funksionimin e ekipeve komunale të vlerësimit dhe të mbështetjes për ta siguruar vlerësimin e hershëm të fëmijëve dhe një rol më aktiv të qendrave burimore dhe të shkollave në vlerësimin e fëmijëve; të angazhohet drejtpërdrejt dhe t'i koordinojë politikat dhe praktikën me komunat dhe me shkollat për ta përmirësuar pjesëmarrjen në nivel të arsimit parashkollor; të hartojë dhe të zbatojë politika të reja lidhur me kohën që duhet kaluar në mësim në arsimin parauniversitar, veçanërisht në klasën parafillore; t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar përfshirjen dhe përmirësimin e rezultateve të fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë, në të gjitha nivelet e arsimit; ta rregullojë, ta fuqizojë dhe ta rrisë mbështetjen për përmirësimin e funksionimit të qendrave mësimore në mbështetje të të gjithë fëmijëve që kanë nevojë për përfshirje dhe përmirësim të rezultateve në shkollë, në mënyrë që ta vazhdojnë shkollimin dhe ta kenë më të lehtë kalimin në nivele më të larta të arsimit; ta hartojë dhe ta zbatojë një plan të veprimit për furnizimin e shkollave me teknologji dhe me materiale të reja mësimore; ta rishikojë formulën ekzistuese për shpërndarjen dhe menaxhimin e fondeve në arsim, për ta lejuar delegimin e pushtetit në shkolla dhe më shumë investime në materialet mësimore, në teknologji të reja dhe në kushte të punës që lidhen drejtpërdrejt me mësimdhënien dhe me mësimnxënien (përfshirë edhe brenda në klasë); ta rishikojë udhëzimin administrativ që rregullon raportin mes nxënësve dhe mësimdhënësve dhe madhësinë minimale të klasës për t'i përmirësuar masat afirmative për edukimin e komuniteteve; të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar plotësisht tekstet shkollore për mësim në gjuhët boshnjake dhe turke në shkollat e Kosovës; t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar fonde shtesë për diversifikimin dhe përmirësimin e arsimit të ofruar në institucionet arsimore duke mundësuar këshillim cilësor për karrierë, për aktivitete psikologjike dhe për klubet e nxënësve (për teknologji, shkenca dhe art) për ta përmirësuar përfshirjen dhe rëndësinë e arsimit.

Komunave të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit u rekomandoi që të funksionalizohen ekipet e parandalimit dhe të reagimit në nivel të shkollës dhe të komunës; të rrisin bashkëpunimin dhe koordinimin mes të gjitha palëve të interesuara (përfshirë qendrat mësimore) për ta adresuar çështjen e braktisjes së shkollës dhe dhunën në shkollë, veçanërisht në arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë; ta ketë prioritet dhe ta rrisin financimin për ofrimin e edukimit dhe të arsimit parashkollor dhe parafillor në komunë, për t'i shtrirë shërbimet parashkollore edhe në zonat rurale; t'i delegojnë planifikimin dhe menaxhimin e

plotë financiare në shkolla; t'i angazhojnë DKA-të në monitorimin e planifikimit dhe të menaxhimit të kujdesshëm; të angazhohen në zgjatjen e kohës mësimore në shkolla, me fokus në klasat parafillore dhe në aktivitetet e nxënësve në klube të ndryshme (të paktën për shkencë, për art dhe për teknologji); të hartojnë dhe të zbatojnë fushata ndërgjegjësuese që i adresohen komuniteteve dhe prindërve në fushën e përfshirjes dhe të arsimimit të fëmijëve dhe të të rinjve me aftësi të kufizuara.

Po ashtu komunave iu rekomanduara që të ndërmarrin masa dhe shkollat të planifikojnë dhe të zbatojnë aktivitete që i angazhojnë nxënësit në aktivitete plotësuese shkollore dhe jashtëshkollore; shkollat të angazhohen në një qasje ekipore në adresimin e përfshirjes dhe të edukimit të nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e tyre; shkollat t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim të hartimit të PIA-s për fëmijët me aftësi të kufizuara; shkollat ta përmirësojnë bashkëpunimin me prindërit dhe me komunitetet për ta përmirësuar cilësinë e arsimit në shkolla; shkollat ta bëjnë mësimdhënien dhe mësimnxënien të orientuar drejt nxënësit dhe më tërheqëse, duke u larguar pak nga mbajtja e thjeshtë e mësimi dhe bartja e njohurive; shkollat të bashkëpunojnë me organizatat e komuniteteve dhe me prindërit për ta përmirësuar përfshirjen në shkolla të të gjitha komuniteteve dhe të grupeve të nxënësve.

## **Raport për rastin ex officio nr. 411/2021 lidhur me themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara**

Duke qenë se Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme: LAPRK) rregullon edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it<sup>208</sup>, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele, dhe kërkon që çdo komunë duhet që vetë apo në bashkëpunim me komunat e tjera të themelojë ekip profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore, të përbërë nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe të rehabilitimit, si mbështetje e jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit.

Për të vlerësuar nëse komunat e përmbushin këtë kërkesë ligjore e me këtë edhe ofrimin e qasjes në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsim, Avokati i Popullit filloi hetim sipas detyrës zyrtare. Për këtë u kërkuan nga të gjitha komunat e Kosovës informacione në lidhje me atë se a kanë vepruar në kuadër të përgjegjësive ligjore për themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Avokati i Popullit nuk mori përgjigje nga komunat: Mamushë, Istog, Deçan, Skenderaj, Kamenicë, Shtime, Leposaviq, Partesh, Mitrovicë Veriore dhe Graçanicë. Në këtë rast këto komuna kanë dështuar të përgjigjeshin në kërkesat e Avokatit të Popullit duke shkelur dispozitat përkatëse kushtetuese dhe të Ligjit për Avokatin e Popullit. Sidoqoftë, kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit që t'i japë konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me çështjen.

<sup>208</sup> LAPRK, neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.21.

Marrë parasysh rëndësinë e së drejtës për arsim, ajo fillimisht ishte shpallur për herë të parë në vitin 1948 përmes Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, më vonë e konkretizuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Këto instrumente ndërkombëtare deklarojnë që të paktën arsimit fillor është falas dhe i detyrueshëm, ndërsa arsimit i mesëm dhe i lartë do të bëhen në mënyrë progresive të arritshme për të gjithë, edhe pse jo domosdoshmërisht falas. Pra, edukimi është parë si faktor kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm të njeriut, përmes të cilit rritet përmirësimi i cilësisë së jetës në nivel individual, familjar, shoqëror dhe global.

Konsideratë mbizotëruese e interesit më të mirë të fëmijës i jep edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm: Konventa), e cila sipas Kushtetutës, është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë. Prandaj çdo veprim i organeve shtetërore duhet të jetë në pajtim të plotë me qëllimin e Konventës. Shkelja eventuale e dispozitave të kësaj Konvente paraqet shkelje të Kushtetutës. Komiteti i Konventës ka identifikuar interesin më të mirë të fëmijës si një nga katër parimet e përgjithshme të Konventës për interpretimin e saj dhe duke e zbatuar atë në raport me të gjitha të drejtat e tjera të fëmijës.<sup>209</sup> Ajo është një koncept dinamik që kërkon një vlerësim të përshtatshëm për çdo rast specifik. Ky parim është i mishëruar edhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF). Në rastin konkret, e drejta për arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara interpretohet në interesin më të mirë të tyre për t'ua mundësuar atyre qasjen sa më të lehtë dhe efektive në realizimin e kësaj të drejte.

LAPRK-ja obligon institucionet e përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për ta avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social. Moszbatimi i duhur i kësaj dispozite kontribuon që fëmijët me aftësi të kufizuara të vazhdojnë të përjetojnë vështirësi serioze dhe të përballen me pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të përcaktuara me ligj, përfshirë këtu edhe të drejtën për arsimim gjithëpërfshirës.

LAPRK-ja obligon komunat që t'i regjistrojnë nxënësit me vështirësi në të nxënë apo me aftësi të kufizuara dhe më pas të veprojnë sipas procedurave të parapara në nenin 41 të këtij ligji lidhur me vlerësimin profesional të tyre. Në frymën e kësaj, ky ligj obligon komunat që vetë apo në bashkëpunim me komunat e tjera të themelojnë ekip profesional vlerësues dhe përkrahës. Ky ekip duhet të jetë i veçantë për nevojat e posaçme arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të përbëhet nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe të rehabilitimit, si mbështetje e jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Për më tepër, ky ligj parasheh procedurën e vlerësimit nga ekipi profesional si dhe qëllimet e vlerësimit të nxënësit me aftësi të kufizuara.<sup>210</sup>

209 Komiteti i Konventës, Komentit i përgjithshëm Nr.5, në: [https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fGC%2f2003%2f5&Lang=en](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fGC%2f2003%2f5&Lang=en).

210 LAPRK, neni 41, nënparagrafët: 3.1. për të vlerësuar aftësitë, interesimet dhe nevojat e fëmijës; 3.2. për të dhënë rekomandime mbi metodat e mësimdhënies, mjetet e mësimdhënies dhe mbi përshtatjet e tjera të nevojshme për mësimnxënie dhe mirëqenien e fëmijës; 3.3. për të përkufizuar nevojat për pajisjet të posaçme që nevojiten në mësimdhënie; 3.4. për të dhënë rekomandime për regjistrimin e nxënësit.

Rrjedhimisht, në pajtim me LMF-në, me LAPRK-në, me Konventën si dhe me Kushtetutën, themelimi i ekipit profesional të vlerësimit paraqet një hap të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për realizimin e së drejtës për arsimim të fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe respektimin e parimit të arsimit gjithëpërfshirës.

Avokati i Popullit në këtë raport vlerëson se autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore e as standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës në lidhje me themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Avokati i Popullit, në bazë të dokumentacionit që ka pranuar nga komunat, vëren se vetëm 21 komuna i kanë themeluar ekipet profesionale vlerësues dhe përkrahëse për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Për këtë Avokati i Popullit u ka rekomanduar 17 komunave<sup>211</sup> të themelojnë ekipin profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, sipas nenit 41 të LAPRK-së.

---

211 Mamushë, Lipjan, Istog, Deçan, Skenderaj, Kamenicë, Shtime, Rahovec, Zveçan, Zubin Potok, Shtërpçë, Leposaviq, Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Kllokot, Graçanicë.

# E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit

## Opinion i Avokatit të Popullit për rastet A. nr. 505/2021 dhe A. nr. 712/2021 lidhur me llogaritjen e pushimit vjetor në bazë të përvojës së punës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë

Ankuesit në ankesat parashtruar Avokatit të Popullit theksojnë se pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, llogaritja e pushimit vjetor për nëpunësit civilë po bëhet në atë mënyrë që atyre po u humbin ditët e pushimit vjetor të fituara me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ky Opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, përkatësisht i të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, respektivisht me llogaritjen e pushimit vjetor në bazë të përvojës së punës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit ka vërejtur se llogaritja e pushimit vjetor deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë është bërë sipas dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil. Ky ligj ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2010 dhe se nga ajo kohë nëpunësit civilë kanë fituar të drejtën e llogaritjes së pushimit vjetor sipas nenit 39 të këtij ligji.

Ligji për Zyrtarët Publikë ka hyrë në fuqi në korrik 2020, prandaj llogaritja e pushimit vjetor duhet të bëhet nga muaji korrik 2020 e në vazhdim, duke mos e cenuar të drejtën (pushimin vjetor në bazë të përvojës së punës) e cila është fituar gjatë periudhës së zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil. Avokati i Popullit thekson se e drejta e fituar me Ligjin për Shërbimin Civil nuk mund të humbë me Ligjin për Zyrtarët Publikë, sepse kjo përbën zbatim prapaveprues të ligjit, gjë që ndalohe, përveç nëse shprehimisht parashihet me ligj. Zbatimi prapaveprues i ligjit cenon pritshmërinë e ligjshme të nëpunësve civilë e po ashtu edhe sigurinë juridike.

Koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Sipas GjEDNj-së (*shih rastet Kopecky v. Slovakia, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, § 45-52; Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 39794/98, § 73, GjEDNj 2002-VII*), "pritshmëria legjitime" duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime e nëpunësve civilë për realizimin e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës bazohet në të drejtën e fituar nga dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, gjatë periudhës sa ky ligj ka qenë në zbatim.



Avokati i Popullit konsideron se e drejta e fituar me Ligjin për Shërbimin Civil është e garantuar dhe se nëpunësit civilë kanë fituar të drejtën për pushimin vjetor sipas përvojës së punës gjatë periudhës kur Ligji për Shërbimin Civil ka qenë në zbatim. Mosllogaritja e pushimit vjetor të fituar sipas këtij ligji e cenon sigurinë juridike të nëpunësve civilë dhe krijon një praktikë pasigurie që do t'i vendoste nëpunësit civilë dhe zyrtarët publikë në përgjithësi në pozitë pasigurie për sa u përket të drejtave të cilat fitohen nga dispozitat e ligjeve në Republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit thekson se zbatuesit e ligjeve duhet të kenë kujdes që gjatë zbatimit dhe interpretimit të ligjeve të mos cenohen të drejtat e fituara me ligje të mëhershme. Pra, zbatuesit e ligjeve duhet të kenë gjithmonë parasysh sigurinë juridike të normës, nga e cila subjektet realizojnë të drejtat e tyre subjektive. Një normë e mëvonshme nuk mund t'ua mohojë subjekteve të drejtat që janë fituar nga një normë e mëhershme, rrjedhimisht një normë kurrsesi nuk mund të ketë veprim prapaveprues përveç rasteve specifike që parashihen me ligj dhe vetëm nëse një gjë e tillë është në të mirë të subjekteve.

Prandaj Avokati i Popullit konstaton se llogaritja e përvojës së punës sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë duhet të bëhet duke filluar nga periudha kur ky ligj ka hyrë në fuqi e në vazhdim, duke mos e cenuar numrin e ditëve të pushimit vjetor që janë fituar me Ligjin për Shërbimin Civil.

### **Opinion i Avokatit të Popullit për rastin A. nr. 473/2021 lidhur me çështjen e interpretimit të konceptit “përvoja e punës profesionale” në kontekstin e vlerësimit në konkurset për punësim në institucione publike**

Ky Opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit lidhur me llogaritjen e përvojës profesionale të punës në rastin e konkursit për pozitën e prokurorit të shtetit, si dhe në rastet e tjera që lidhen me marrëdhënien e punës ku kërkohet përvojë profesionale e punës.

Në ankesën e parashtruar kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës ankuesi pretendon se është diskriminuar në procesin e rekrutimit për prokuror të shtetit<sup>212</sup> dhe se nuk i është vlerësuar drejt përvoja profesionale e punës. Sipas pohimeve të tij, ai është eliminuar nga procedurat e rekrutimit në konkursin për prokuror të shtetit, me arsyetimin se nuk e plotësonte kriterin e përvojës profesionale të punës. Nga informacionet e ofruara nga ankuesi kuptohet se ai ka diplomuar më 8 korrik 2009, në ciklin e shkurtër të arsimit të lartë, i cili, sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, vlerësohet të jetë niveli 5 me 180 ECTS, dhe pas përfundimit të studimeve ka fituar titullin Bachelor i Drejtësisë, ashtu siç parashihet me Ligjin për Arsimin e Lartë (neni 4). Më tej ankuesi ka njoftuar se në tetor të viti 2018 ka përfunduar studimet Master me 120 ECTS.

Në konkursin e shpallur, përveç kriterit për të pasur diplomë të vlefshme në Republikën e Kosovës, kërkohet edhe kriteri i përvojës së punës, sipas të cilit kandidati duhet “*të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune në fushën juridike*”.

<sup>212</sup> Konkurs i shpallur nga KPK-ja për prokuror të shtetit, në qershor të vitit 2020 dhe i rishpallur në muajin maj 2021.

Pas përfundimit të studimeve dhe pajisjes me diplomë me të cilën ka marrë titullin Baçelor i Drejtësisë, ankuesi ka punuar në pozita që sipas përshkrimit të detyrave të punës përbëjnë punë nga fusha juridike, të vlefshme për t'u llogaritur si përvojë profesionale, gjë që paraqet çështje kontestuese në rastin konkret.

Sipas Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 4 [Objektivat dhe organizimi i arsimit të lartë], arsimit të lartë organizohet në tri nivele. Niveli i parë konsiston me 3 deri 4 vite studime, me të cilat studenti arrin 180, **përkatësisht 240 kredi/ECTS**, dhe merr diplomën Baçelor. Në rastin e ankuesit, titulli i fituar pas përfundimit të studimeve të nivelit të parë, me 3 vjet studime në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" është Baçelor i Drejtësisë, titull ky që fitohet edhe pas përfundimit të studimeve të nivelit të parë me 4 vjet studime. Ndërsa sipas Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, përkatësisht sipas nenit 2, diploma nënkupton dokumentin që jepet pas përfundimit të një programi<sup>213</sup> ekstensiv të arsimit.

Avokati i Popullit vëren se sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës njihen studimet e larta ku studenti arrin 180 ECTS dhe në rastin konkret ankuesi këto i ka arritur më 2009, kur edhe ka fituar titullin Baçelor i Drejtësisë.

Avokati i Popullit ka vërejtur se në konkurs dhe në kriteret e përcaktuara sipas Ligjit nr.05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit nuk kërkohet që diploma universitare të jetë e programit 4-vjeçar (240 ECTS), por kërkohet vetëm "*të ketë diplomë të fakultetit juridik të vlefshme në Kosovë*". Ndërsa ankuesi, me rastin e aplikimit në konkursin e shpallur për prokuror të shtetit, kishte paraqitur dëshmi se më 16 nëntor 2018 kishte përfunduar studimet Master në UP "Hasan Prishtina" me gjithsej 120 kredi/ECTS, duke fituar titullin Master i Shkencave (Ma.SC.) Juridike-Penale (niveli i kualifikimeve sipas KKK 7). Ndërsa më 22 maj 2019 ankuesi ka kaluar provimin e jurisprudencës.

Për sa i përket paraleles së tërhequr nga KPK-ja ndërmjet Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe Ligjit për Provimin e Jurisprudencës, Avokati i Popullit vëren se këto dy ligje rregullojnë fusha të ndryshme. Ligji nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe Ligji nr.05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit rregullon organizimin, juridiksionin, funksionimin, kompetencat dhe detyrat e prokurorit të shtetit, si dhe i ka përcaktuar kushtet e përgjithshme për kandidatët për emërim për prokurorë të shtetit. Meqenëse Ligji për Prokuror të Shtetit nuk ka zbrazëtitirë të normës në rregullimin e kushteve për kandidatë, atëherë edhe referimi me analogji tek Ligji për Provimin e Jurisprudencës nuk ka kuptim.

Avokati i Popullit vlerëson se në situata të tilla KPK-ja duhet t'i vlerësojë ndaras kriteret e shkollimit dhe të përvojës profesionale të punës. Këtë vlerësim Avokati i Popullit e mbështet në faktin se diploma universitare me 180 ECTS njihet si shkollim universitar nga Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës. Po ashtu fakt tjetër është përvoja profesionale e punës, e cila fitohet nga momenti kur personi ka lidhur një marrëdhënie pune ku është kërkuar diploma universitare, pa specifikuar numrin e ECTS-ve. Pra, Avokati i Popullit konsideron se personat që kanë lidhur marrëdhënie pune me diplomë universitare 180 ECTS dhe që kanë kryer punë profesionale relevante, duhet t'u njihet përvoja profesionale e punës që nga momenti i themelimit të marrëdhënies së punës.

<sup>213</sup> Program studimi që shpie në një kualifikim ose diplomë, që jepet nga një bartës i arsimit të lartë.

Avokati i Popullit e ka parasysh që shpallja e konkurseve mund të përfshijë kriteret të hollësishme në mënyrën siç praktikohet në shtete të tjera,<sup>214</sup> megjithatë, në rastin në fjalë, konkursi i shpallur i është referuar dispozitave përkatëse të Ligjit për Prokuror të Shtetit që përcaktojnë kushte të përgjithshme për pozitat e kërkuara, prandaj vlerëson se kriteri i shkollimit dhe përvojës profesionale e punës, sikurse në rastin e ankuesit, duhet të vlerësohet ndaras njëra nga tjetra.

Për sa u përket pretendimeve të ankuesit për diskriminim, Avokati Popullit konsideron se nëse KPK-ja ka zbatuar praktikën e njëjtë për të gjitha rastet, ani pse një praktikë e tillë, sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, është e gabuar, dhe duke marrë parasysh se ankuesi nuk ka specifikuar se cila është karakteristika e mbrojtur, e përcaktuar me nenin 1 të Ligjit 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi bazën e së cilës ai pretendon se është diskriminuar, Avokati i Popullit vlerëson se nuk bëhet fjalë për diskriminim, por për zbatim të gabuar të ligjit.

Kriteret e konkursit për pozitën e prokurorit të shtetit janë të përcaktuara qartë në Ligjin nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe në Ligjin nr.05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit.

Referimi tek ligjet e tjera të cilat nuk e rregullojnë fushën e prokurorisë mund të sjellë pasiguri dhe paqartësi juridike nga të cilat mund të cenohen të drejtat e kandidatëve në konkurset publike, siç është rasti i konkurseve të theksuara më sipër, dhe kriteret në konkurs duhet të vendosen duke pasur parasysh përcaktimet ligjore të cilat e kanë rregulluar shprehimisht këtë çështje.

Përvoja profesionale e punës së kandidatëve, në rrethana të ngjashme si në rastin konkret, duhet të llogaritet prej momentit kur ata kanë lidhur marrëdhënie pune dhe natyra e punës është e njëjtë me fushën në të cilën kandidati i ka përfunduar studimet dhe është pajisur me diplomë, sipas përcaktimeve ligjore në vend. Ndërsa kriteri i shkollimit duhet të aplikohet siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe të Ligjit nr.05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit.

## **Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me llogaritjen e përvojës profesionale të punës në rastin e konkursit për drejtor të Baletit Kombëtar të Kosovës**

Ky opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit lidhur me përlllogaritjen e përvojës profesionale të punës në rastin e konkursit për pozitën e drejtorit të Baletit Kombëtar të Kosovës si dhe rastet e tjera që lidhen me marrëdhënien e punës së balerinëve në Baletin Kombëtar të Kosovës.

Ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës njoftoi se llogaritja e përvojës profesionale të punës së balerinëve të Baletit Kombëtar të Kosovës nuk bëhet në bazë të datës së fillimit të marrëdhënies së tyre

<sup>214</sup> Për shembull, në Britaninë e Madhe, shpallja e pozitës në shërbimin civil "Menaxher i lartë i projektit", Departamenti për Mjedis, Ushqim dhe Çështje Rurale jep një listë të gjatë dhe specifike të përvojës profesionale që kërkohet për këtë vend të punës, shih në [https://www.civilservicejobs.service.gov.uk/csr/jobs.cgi?owner=5070000&ownertype=fair&jcode=1566838&posting\\_code=0&language=](https://www.civilservicejobs.service.gov.uk/csr/jobs.cgi?owner=5070000&ownertype=fair&jcode=1566838&posting_code=0&language=).

të punës, por llogaritja bëhet pas përfundimit universitar, kriter ky i cili nuk kërkohet për të themeluar marrëdhënie pune në cilësinë e balerinëve.

Avokati i Popullit vëren se në Republikën e Kosovës nivel më i lartë i arsimimit në fushën e baletit është shkollimin i mesëm, përkatësisht shkolla e mesme e lartë profesionale, diploma e së cilës shërben si bazë për lidhjen e marrëdhënies së punës në cilësinë e balerinëve. Në këtë rast vërehet se balerinët që kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë profesional pajisen me diplomë për kryerjen e shkollës së mesme të lartë profesionale dhe mund të lidhin marrëdhënie pune dhe të ushtrojnë aktivitetin profesional në fushën e baletit. Ngjashëm është vepruar në rastin e balerinëve të Baletit Kombëtar të Kosovës, të cilët posedojnë diplomat e shkollimit të mesëm të lartë profesional.

Sipas konkursit të shpallur nga MKRS-ja, kandidatët për drejtor të Baletit Kombëtar të Kosovës duhet të plotësojnë kriterin e shkollimit dhe të përvojës së punës, si në vijim:

*“- Drejtor i Baletit Kombëtar të Kosovës, zgjedhet personi me përgatitje profesionale universitare në fushën e artit dhe kulturës.*

Duhet të ketë (7) vite përvojë pune, duke përfshirë (4) vite përvojë pune në vende udhëheqëse.

[. . .].”

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit konsideron se vlerësimi i këtyre kriterëve duhet të bëhet ndaras nga njëra-tjetra. Së pari, kriteri i vendosur për shkollimin universitar, edhe pse nuk është kriter i vendosur sipas Ligjit nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Avokati i Popullit e vlerëson si të arsyeshëm përderisa bëhet fjalë për një pozicion udhëheqës të një institucioni kombëtar, siç është rasti i pozitës së drejtorit të Baletit Kombëtar të Kosovës. Së dyti, Avokati i Popullit konsideron se kriteri rreth përvojës profesionale të punës duhet të vlerësohet ndaras nga kriteri i shkollimit universitar, për shkak se këto kriterë nuk janë të lidhura njëra me tjetrën. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se shkollimi universitar nuk është kriter për të lidhur marrëdhënie pune në Baletin Kombëtar të Kosovës, por shkollimi i mesëm profesional, prandaj edhe llogaritja e përvojës profesionale të punës duhet të bëhet duke llogaritur periudhën prej lidhjes së marrëdhënies së punës. Në situata të tilla, të dyja kriteret e theksuara më sipër (shkollimi universitar dhe përvoja e punës) duhet të plotësohen ndaras njëra nga tjetra.

Në këtë rast, Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se në Republikën e Kosovës niveli më i lartë i arsimimit në fushën e baletit është shkollimi i mesëm, përkatësisht shkolla e mesme e lartë profesionale, konsideron se balerinët e plotësojnë kushtin për të lidhur marrëdhënie pune, me përfundimin e shkollimit të mesëm profesional dhe me pajisjen me diplomë të shkollimit të mesëm të lartë profesional. Në këtë drejtim përvoja profesionale e punës për balerinët duhet të llogaritet periudha nga momenti i lidhjes së marrëdhënies së punës me Baletin Kombëtar të Kosovës.

Prandaj, sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, në konkursin e theksuar më sipër kriteri i shkollimit universitar duhet të dëshmohet me paraqitjen e diplomës universitare, ndërsa kriteri i përvojës së punës duhet të dëshmohet me dokumentin përkatës të përvojës së punës, duke mos u llogaritur vetëm ajo periudhë pas përfundimit të shkollimit universitar, por përvoja prej momentit fillestar të lidhjes së marrëdhënies së punës.

# **Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore**

# Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore

**Opinion i Avokatit të Popullit për rastin ex officio nr. 40/2022, përkitazi me arsyeshmërinë e masave të marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas Vendimit nr. 01/55, të datës 21 janar 2022, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës, në raport me kufizimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2022, nxori Vendimin nr. 01/55 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës. Qeveria miratoi masa të cilat në aspektin e politikave kufitare e kufizojnë/pamundësojnë hyrjen në territorin e Kosovës për ata persona të cilët nuk kanë dëshmi për tri doza të vaksinës kundër COVID-19, ose së paku nuk kanë dy doza dhe test PCR negativ jo më të vjetër se 48 orë para nisjes.

Qëllim i këtij Opinioni është të analizojë arsyeshmërinë e masave të marra nga Qeveria e Kosovës me Vendimin nr. 01/55 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës, në raport me kufizimet e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Ky opinion nuk duhet kuptuar si kontestim i vullnetit të mirë, si kontestim i synimit të Qeverisë për të mbrojtur shëndetin publik në Kosovë, apo kontestim i vlerësimit të ekspertëve shëndetësorë. Por, shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, kufizimet e vendosura deri në këtë masë duket sikur janë të ashpra, jo proporcionale dhe si të tilla pa dyshim që ndikojnë në të drejtat e njeriut. Këto masa të aplikuara tani nga Qeveria janë më të ashpra, krahasuar me masat që kanë aplikuar vendet e tjera në rajon e që për nga shkalla e infektiveve me virus nuk qëndrojnë më mirë sesa vendi ynë.

Dy pikat më të diskutuara të masave që u aplikuan me këtë vendim të Qeverisë ishin pika B dhe pika D, që kanë të bëjnë me hyrjet dhe daljet e qytetarëve në dhe nga Republika e Kosovës dhe kufizimi i qarkullimit:

## **“B. [Hyrjet dhe daljet e qytetarëve në dhe nga Republika e Kosovës]**

2. Çdo person i cili hyn në Republikën e Kosovës duhet të posedojë një nga dëshmitë e mëposhtme:

2.1 Certifikatën e vaksinimit me tri (3) doza (ose me një dozë të vaksinës Janssen dhe dozë përforcuese) kundër COVID-19;

2.2 Certifikatën e vaksinimit me dy doza (ose me një dozë të vaksinës Janssen) kundër COVID-19, bashkë me testin RT-PCR negativ për COVID-19, jo më herët se 48 orë para nisjes (për udhëtarët që hyjnë në rrugë ajrore) ose 48 orë para mbërritjes në pikën kufitare (për ata që hyjnë në rrugë tokësore)

3. Nga kërkesa për të poseduar ndonjërin nga dëshmitë sipas pikës 2.1 deri 2.2 lirohen:

3.1 Personat të cilët hyjnë në Kosovë përmes aeroportit apo përmes pikave kufitare tokësore dhe largohen nga Kosova (tranzit) brenda tre (3) orësh përmes aeroportit ose pikave kufitare tokësore, me kusht që në hyrje të nënshkruaj deklaratën se do ta lëshojë Kosovën brenda tre (3) orësh dhe që dalja në pikë kufitare të jetë e ndryshme nga hyrja kufitare;

3.2 Personat, të cilët punojnë si transportues profesionist (vozitës), me kusht që të respektojnë protokollin për transport ndërkombëtarë për mbrojtje nga COVID-19;

3.3 Shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë dalë jashtë Kosovës në 12 orët e fundit;

3.4 Qytetarët e huaj, të cilët kalojnë nëpër Kosovë përmes transportit të organizuar me autobus ose me linjë të rregullt ndërkombëtare, transit, me kusht që të nënshkruhet deklarata se do ta lëshojnë territorin e Kosovës brenda pesë (5) orësh;

3.5 Diplomatët e huaj, të akredituar në Kosovë dhe pjesëtarët e trupave tëKFOR;

3.6 Personat nën moshën dymbëdhjetë (12) vjeçare;

3.7 Shtetasit e Republikës së Kosovës që nuk i kanë dy doza të vaksinës janë të detyruar të kryejnë karantinim shtëpiak për një periudhë prej shtatë (7) ditësh që nga hyrja në territorin e Republikës së Kosovës;

3.8 Personat me dëshmi mjekësore nga mjeku specialist i fushës përkatëse se kanë kundërintikacione dhe janë të liruar nga vaksinimi. Personat e tillë duhet të paraqesin testin RT-PCR negativ për COVID-19, të administruar jo më herët se 48 orë para nisjes (për udhëtarët që hyjnë në rrugë ajrore) ose 48 orë para mbërritjes në pikën kufitare (për ata që hyjnë në rrugë tokësore).

3.9 Personat nga moshën 12 vjeçare deri në moshën 16 vjeçare duhet të posedojnë testin RT-PCR negativ jo më të vjetër se 48 orë.

[...]

#### **D. [Kufizimi i qarkullimit]**

14. Kufizimi i qarkullimit të qytetarëve do të jetë nga ora 22:00 deri në ora 05:00, përveç:

14.1 Rasteve të natyrës urgjente (për të kërkuar ndihmë mjekësore, blerje të barnave, për të ofruar kujdes ose ndihmë mjekësore, për të shmangur dëmtimin ose për t'i shpëtuar një rreziku lëndimi);

14.2 Qarkullimit për personelin shëndetësor, të sigurisë dhe operatorët që kryejnë punë apo shërbime publike; 14.3 Personelin e ndërrimit të natës të operatorëve ekonomikë që sigurojnë funksionimin e zinxhirit



të furnizimit (përfshirë transportin e mallrave/shërbimeve), por me kusht që të pajisen me leje të veçantë nga sistemi EDI i Administratës Tatimore të Kosovës;

14.4 Personat të cilët ofrojnë dëshmi se duhet të jenë në aeroport gjatë orarit të kufizimit të qarkullimit, për shkak se kanë për të udhëtuar përmes aeroplanit;

14.5 Personave ndaj të cilët aplikohet leja e veçantë e përkohshme që lëshohet nga Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas pikës 16, për shkak të domosdoshmërisë së qarkullimit gjatë orës policore.

15. Obligohen punëdhënësit të sigurojnë që punëtorët e tyre që i nënshtrohen kufizimit nga pika 14 të kenë kohë të mjaftueshme për të udhëtuar në banesat e tyre.

16. Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Punëve të Brendshme mundet që të lëshojë leje të veçantë, për persona të cilët ofrojnë dëshmi të mjaftueshme për domosdoshmërinë që kufizimi i qarkullimit të orarit të ju zgjatet përkohësisht.”

Me hyrjen në fuqi të vendimit dhe fillimin e aplikimit të masave të reja nga autoritetet kufitare, në vendkalimet kufitare të Kosovës me vendet fqinje u shkaktua huti dhe pakënaqësi te qytetarët të cilët nuk u lejuan të hyjnë në territorin tonë si rezultat i aplikimit të masave të reja.

Avokati i Popullit, nisur nga praktikat e vendeve të rajonit shihet se asnjëra prej tyre nuk kërkon nga qytetarët tri doza të vaksinës. Si rrjedhojë e vendimit të fundit të Qeverisë së Kosovës kishte edhe kundërshtime, reagime dhe protesta (shih paragrafët më lartë). Këto shqetësime duhet t'i marrë parasysh Qeveria e Republikës së Kosovës në mënyrë që të rishikohen masat në këtë drejtim meqenëse gjendja epidemiologjike e Kosovës dhe shteteve përreth aktualisht nuk ka ndonjë dallim rrënjësor. Pjesa dërmuese e shteteve që nga fillimi i pandemisë në hyrje-dalje të kufijve të tyre i kanë pranuar testet antigen. Këto teste janë më të shpejta dhe më të përbalueshme për xhepin e qytetarëve, por pavarësisht kësaj ato ende nuk po pranohen për hyrje-daljet në pika kufitare të Kosovës, por qytetarëve u kërkohej testi RT-PCR, i cili është dyfish më i shtrenjtë dhe merrte më gjatë kohë për t'u përpunuar në laborator.

Për këtë Avokati i Popullit e konsideroi të nevojshme që Qeveria të rishqyrtonte edhe masën e kufizimit të qarkullimit nga ora 22:00 deri në 05:00. Në vend të kësaj do të ishte më e dobishme që të fuqizoheshin mekanizmat e kontrollit sanitar dhe inspektoratet, në mënyrë që të ushtroheshin kontrole të rrepta për të vlerësuar nëse po zbatoheshin masat e përgjithshme, tanimë të ditura.

Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet t'i kushtojë kujdes esencës të së drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim sa më të vogël apo deri në atë masë sa është e domosdoshme për arritjen e qëllimit legjitim, masa këto që të konsiderohen si të nevojshme në një shoqëri të hapur dhe demokratike.

**Promovimi i drejtave dhe  
i lirive themelore  
të njeriut nga IAP-ja gjatë  
vitit 2022**

# Promovimi i drejtave dhe i lirive themelore të njeriut nga IAP-ja gjatë vitit 2022

## IAP-ja, si promovuese e të drejtave të njeriut dhe barazisë

Avokati i Popullit, si mekanizëm kushtetues dhe ligjor për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore, edhe përgjatë vitit 2022 është angazhuar në mënyrë aktive në ndërmarrjen e iniciativave të reja në drejtim të përmbushjes efektive të mandatit në promovimin dhe edukimin mbi të drejtat e njeriut dhe ngritjen e vetëdijesimit, me qëllim të krijimit të një mjedisi ku të drejtat e njeriut njihen nga qytetarët e vendit dhe respektohen.

Më 1 mars, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Zero Diskriminim, Avokati i Popullit organizoi një tryezë diskutimi, me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga legjislativi, ekzekutivi dhe organizata joqeveritare që merren me çështje të të drejtave të njeriut, për të diskutuar për sfidat dhe problemet në luftimin e diskriminimit në vend dhe veçanërisht për të diskutuar për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë ditë Avokati i Popullit hapi fushatën “Barazi për të gjithë”.



Qëllimi i kësaj fushate ka qenë: rritja e ndërgjegjësimit të publikut për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore; informimi i publikut mbi rolin dhe mandatin e IAP-së; fuqizimi i bashkëpunimit të qytetarëve me institucionet publike dhe identifikimi i problemeve që reflektojnë në të drejtat e njeriut. Gjatë fushatës janë realizuar takime të diskutimit me përfaqësues të shoqërisë civile, qytetarë e

aktivistë të të drejtave të njeriut, pjesëtarë të komuniteteve joshumicë dhe përfaqësues të institucioneve publike lokale. Fushata ka pasur karakter gjithëpërfshirës, e cila është shtrirë në 11 komuna të ndryshme të Kosovës, duke përfshirë edhe komunat e banuara nga qytetarët e komuniteteve joshumicë dhe atë në: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë (dy tryeza), Graçanicë, Kamenicë dhe Suharekë. Një nga këto takime është dedikuar veçanërisht për t'i takuar dhe diskutuar për sfidat dhe problemet me të cilat jetojnë dhe ballafaqohen qytetarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu në një tryezë të veçantë Avokati i Popullit ka takuar personat me aftësi të kufizuara, ku janë diskutuar sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara në vend. Ndërmjet shumë çështjeve që janë trajtuar gjatë fushatës, me një përqendrim më të madh janë theksuar ankesat e qytetarëve që ndërlidhen me mosrespektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Nga të dhënat e mbledhura nga terreni vërehet se problematikat më të shpeshta me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara janë: *moszbatimi i Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara; rastet e dhunës ndaj fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara - mungesa e strehimoreve; mungesa e qasjes në infrastrukturë, veçanërisht në objektet e gjykatave dhe prokurorive si dhe QPS-ve nëpër komuna të ndryshme; vendimet shabllone të komisioneve mjekësore për refuzim të njohjes të së drejtës për pension apo ndërprerje të pensioneve për këtë kategori; përkrahja e pamjaftueshme për personat me autizëm dhe personat me zhvillim të vonshëm mendor; personat shtatshkurtër nuk janë përfitues të pensioneve; mungesa e qendrave për studentë me aftësi të kufizuara; mungesa e materialeve informuese në alfabetin brail; mungesa e sinjalizimeve në semaforë për personat e verbër; zvarritjet procedurale në gjykata për rastet që ndërlidhen me njohjen e së*

*drejtës për pension, të personave me aftësi të kufizuara etj.*



Më 18 mars, në Institucionin e Avokatit të Popullit u mbajt tryeza me temë: “Mbledhja e të dhënave dhe raportimi i të dhënave në sektorin shëndetësor”. Tryeza u iniciua nga Grupi punues për operacionalizimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet IAP-së dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), me qëllim mbështetjen e zbatimit dhe matjen e të drejtave të njeriut dhe Agjendën 2030. Kjo tryezë kishte në fokus nxjerrjen në pah të papajtueshmërive në metodologjinë dhe standardet e mbledhjes së të dhënave brenda sektorit shëndetësor dhe raportimin e tyre në ASK. Gjatë diskutimeve u theksuan problemet kyçe në zinxhirin e grumbullimit dhe raportimit të të dhënave, domosdoshmërinë për qartësimin e roleve institucionale, përkritazi me përgjegjësitë në këtë aspekt dhe nevojën e një pune bashkëpunuese



dhe koordinuese, për të pasur të dhëna të plota, të sakta, kredibile dhe në kohë.

Më 21 qershor 2022, Avokati i Popullit ka organizuar tryezë në të cilën është trajtuar shkelja e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe zgjidhja efektive e zvarritjeve të procedurës gjyqësore. Gjatë tryezës Avokati i Popullit ritheksoi nevojën për ndërmarrjen e nismës legislative për propozimin e ligjit për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, me të cilin do të përcaktoheshin mjetet efektive juridike për rastet që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave gjyqësore, rekomandime këto që ishin adresuar në raportin me rekomandime ex-officio të publikuar më 6 mars 2018.<sup>215</sup> Nga tryeza dolën këto konkluzione: nevoja për angazhim të institucioneve përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve për krijimin e mekanizmit për zgjidhjen efektive lidhur me rastet e zvarritjeve të procedurës gjyqësore; kompensimin e viktimave të shkeljes të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm; ngritjen e kapaciteteve dhe buxhetit të gjykatave me qëllim të shkurtimit të periudhës kohore për përfundimin e lëndëve në gjykata; bashkëpunimin e ndërsjellë të të tria pushteteve, me qëllim të realizimit të suksesshëm të reformës në drejtësi.


Më 27 qershor 2022, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit, në bashkëpunim organizuan tryezën me temën: *“Ujërat, e drejtë e njeriut – mbikëqyrja dhe llogaridhënia”*. Në këtë tryezë u diskutua mbi gjendjen e ujërave në vend, mbi problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohemi, si dhe veprimet e autoriteteve publike në drejtim të mbrojtjes së ujërave, me qëllim të mbrojtjes të së drejtës për një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për qytetarët në vend, si e drejtë themelore e njeriut. Njëherësh gjatë tryezës u ritheksuan të gjeturat dhe qëndrimet e Avokatit të Popullit të dala nga raporti me rekomandime i Avokatit të Popullit lidhur me çështjen e ligjshmërisë së procedurave që kanë të bëjnë me hidrocentralet në vend dhe qasjes në dokumente përkitazi me hidrocentralet.<sup>216</sup> Në këtë tryezë është konkluduar se duhet të rritet bashkëpunimi, koordinimi si dhe përgjegjësia në punë e institucioneve që janë hallka përgjegjëse të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së procesit të licencimit dhe operimit të hidrocentraleve. Rekomandimet e Avokatit të Popullit duhet të implementohen, e po ashtu informimi i publikut dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje duhet të prioritetizohet.



215 <https://oik-rks.org/2018/03/29/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-1292018/>

216 <https://oik-rks.org/2021/02/03/raport-me-rekomandime-ex-officio-3652018-kunder-ministrise-se-ekonomise-dhe-ambientit-lidhur-me-ceshtjen-e-ligjshmerise-se-procedurave-qe-kane-te-bejne-me-hidrocentralet-ne-vend-dhe-qasjes-ne-dokum/>

Po ashtu, me rastin e shënimit të kësaj dite, ndërtesa e IAP-së është ndriçuar me ngjyrë të gjelbër, si aktivitet simbolik për vetëdijesim dhe mbrojtje të mjedisit.



Më 7 korrik 2022, Institucioni i Avokatit të Popullit organizoi një tryezë me qëllim të diskutimit mbi sfidat në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjatë tryezës është diskutuar mbi rastet dhe format e ndryshme të diskriminimit, me të cilat ballafaqohen qytetarët e vendit, duke vënë theksin për nevojën e ndërmarrjes së veprimeve urgjente nga ana e institucioneve publike, në zbatim të ligjit dhe promovim më të madh të obligimeve të derivuara nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Më 2 dhjetor 2022, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar, Avokati i Popullit dhe Zyra e OSBE-së në Kosovë

organizuan një tryezë diskutimi për sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohen akoma personat me aftësi të kufizuara në vend. Ndër tjerash gjatë tryezës janë prezantuar edhe të gjeturat e marra nga terreni, të cilat ndërlidhen me ankesat e pranuar nga qytetarët dhe aktivistët gjatë fushatës “Barazi për të gjithë” lidhur me mosrespektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Gjatë diskutimit me përfaqësues të institucioneve publike, Avokati i Popullit ka kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të përfshijë në Kushtetutë Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, si ombrellë gjithëpërfshirëse legjislative që detyrimisht kërkon edhe përafrimin e legjislacionit me parimet dhe detyrimet që dalin nga kjo konventë, rekomandim i cili ka gjetur mbështetje.<sup>217</sup>



217 Qeveria e Republikës së Kosovës, më 13 dhjetor 2022, ka marrë Vendimin nr.02/112, përmes të cilit i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës, Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të përfshirjes në Kushtetutë të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68240>



## Edukimi mbi të drejtat e njeriut

Edukimi mbi të drejtat e njeriut është qenësor, me qëllim të promovimit të vlerave universale, respektimit të ndërsjellë, mosdiskriminimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e edukimit mbi të drejtat e njeriut që nga mosha e re, Avokati i Popullit edhe këtë vit, në kuadër të fushatës informuese: *“Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit”*, ka zhvilluar 35 vizita në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta në vend. Vizita të shumta janë realizuar me një përqendrim të theksuar në zonat rurale të regjioneve të ndryshme të Kosovës. Qëllimi kryesor i fushatës është që të informojë nxënësit për rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe mundësinë e tyre për adresimin në IAP të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Po ashtu fushata ua ofroi mundësinë fëmijëve që të dëgjoheshin nga përfaqësuesit e IAP-së për probleme të ndryshme, me të cilat ballafaqohen në jetën e përditshme. Përveç të tjerash, fushata synon avancimin e njohurive të mësimdhënësve për mandatin e IAP-së, veçanërisht vetëdijësimin e tyre për domosdoshmërinë e parandalimit të ndëshkimit trupor nëpër shkolla si dhe respektimin e së drejtës së fëmijëve për t’u dëgjuar.



Më 1 qershor 2022, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, Avokati i Popullit me përfaqësuesit e tij ka pritur nxënës nga shkolla fillore “Ismajl Qemali” në Prishtinë. Me këtë rast fëmijët kishin mundësinë e bashkëbisedimit me Avokatin e Popullit, përkatësisht të shprehnin mendimet, qëndrimet apo shqetësimet e tyre për probleme të ndryshme me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë jo vetëm në shkollë, por edhe në jetën e përditshme. Po në këtë ditë Avokati i Popullit me përfaqësuesit e tij vizituan qendrën burimore për mësim dhe këshillim “Përparimi” në Prishtinë. Gjatë vizitës Avokati i Popullit u njoftua më për së afërmi me punën dhe sfidat në ofrimin e mësimin dhe të aktiviteteve për fëmijë me aftësi të kufizuara.

Ndërsa për nder të shënimit të Ditës Universale të Fëmijëve, më 18 nëntor 2022 Institucioni i Avokatit të Popullit ka pritur një grup të fëmijëve të udhëhequr nga mësueset e tyre, për të diskutuar për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e tyre. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit takuan fëmijët dhe diskutuan me ata për të drejtat e njeriut edhe në regjione të tjera të vendit, si: në Pejë, në Gjiilan, në Ferizaj dhe në Gjakovë.





Më 24 nëntor 2022, Avokati i Popullit vizitoi SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, ku u njoh lidhur me punën e tyre në kujdes të fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe gjithashtu gjatë vizitës bashkëbisedoi edhe me fëmijët e fshatit, lidhur me të drejtat e fëmijëve dhe rolin e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e tyre.

Avokati i Popullit po ashtu ka mbështetur edhe fushatën e nisur në media sociale "Ama dorën, jo shuplakën", organizuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve, duke dhënë mesazhe edukative, me qëllim të kontributit në ndërgjegjësimin dhe luftimin e dhunës kundër fëmijëve dhe të rinjve dhe inkurajimin e tyre për ta raportuar dhunën dhe abuzimin.

Duke pasur parasysh rëndësinë e pazëvendësueshme të edukimit dhe informimit mbi të drejtat e njeriut dhe me qëllim të përmbushjes së mandatit të Avokatit të Popullit në edukimin e brezave të rinj mbi të drejtat e njeriut, Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 ka mbajtur 4 ligjërata me studentë të universiteteve publike dhe private në Kosovë. Gjatë ligjëratave studentët janë informuar për kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe kompetencat dhe misionin e Avokatit të Popullit në mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.



Avokati i Popullit, me mbështetje të OSBE-së, gjatë vitit 2022 ka hapur konkurs dhe ka pranuar 10 praktikantë të diplomuar/a në fakultetin juridik, me qëllim të përfitimit nga puna praktike në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe aftësimit të tyre në çështje që ndërlidhen me të drejtat e njeriut, mandatin, fushëveprimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit.

## Fuqizimi i edukimit mbi të drejtat e njeriut dhe marrja e praktikave më të mira

Në kuadër të projektit të mbështetur nga Qeveria e Luksemburgut dhe e Norvegjisë, i implementuar nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit së bashku me përfaqësues nga MASHT-i dhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", kanë realizuar vizitë studimore në Institutin Danez për të Drejtat e

Njeriut në Kopenhagë të Danimarkës. Fokusi i vizitës studimore kishte përqendrim në shkëmbimin e praktikave më të mira mbi edukimin për të drejtat e njeriut, duke filluar nga edukimi fillor deri tek ai universitar, si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në përfshirjen e edukimit mbi të drejtat e njeriut në politikat e edukimit. Gjithashtu vizitë është realizuar edhe në Zyrën e Ombudsmanit të Danimarkës, me ç' rast janë shkëmbyer informata dhe praktika më të mira të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut midis dyja vendeve.



Pas vizitës studimore, në kuadër të këtij projekti është mbajtur edhe një punëtori në Kosovë, me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve të stafit të IAP-së në edukimin mbi të drejtat e njeriut të target-grupeve të ndryshme, duke filluar nga nxënësit e shkollave fillore, të mesme, universitete, punëtorë shëndetësorë, zyrtarë policorë, shërbyes civilë, gjyqtarë e prokurorë. Kjo punëtori ka kontribuar në pajtimin mbi ndërmarrjen e iniciativave të reja të bashkëpunimit ndërmjet IAP-së dhe MASHT-it gjatë vitit 2023, në fuqizimin e edukimit mbi të drejtat e njeriut dhe përfshirjen adekuate të këtij koncepti në kurrikulat dhe politikat e edukimit në të gjitha nivelet e arsimimit.





## Arritjet në promovimin e të drejtave të njeriut dhe të barazisë si dhe planifikimet për vitin 2023


Avokati i Popullit edhe gjatë vitit 2022 është përkushtuar në përmbushjen e mandatit ligjor që buron nga Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe nga aktet e ndryshme ndërkombëtare për promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Me qëllim të promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, objektiv ky i paraparë edhe me Strategjinë e Institucionit të Avokatit të Popullit 2021 - 2025, gjatë vitit 2022 IAP-ja ka ndërmarrë një sërë aktivitete me karakter informues, edukues dhe vetëdijesues për të drejtat e njeriut.

Gjatë vitit 2022 Institucioni i Avokatit të Popullit ka organizuar 6 tryeza tematike të diskutimit; 11

tryeza diskutimi në kuadër të fushatës “Barazi për të gjithë”; 35 vizita në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta në kuadër të fushatës “Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit”; mbi 20 deklarata të publikuara për çështje të ndryshme të trajtimit të të drejtave të njeriut; 4 ligjërata me studentë; 3 takime regionale në kuadër të Task-Forcës Avokuese joformale mbi Standardet e ndjeshme gjinore të Sigurisë dhe Shëndetin në Punë dhe Punës së denjë; 3 takime me shoqërinë civile në kuadër të Forumit për Dialog mes Avokatit të Popullit dhe OShC-së si dhe vizita të shumta në terren në organizata joqeveritare që merren me çështje të të drejtave të njeriut dhe në institucione publike.

Si rezultat i angazhimit dhe përkushtimit në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, IAP-ja vazhdon të vlerësohet si institucioni më i besuar në vend dhe më gjerë. Sipas Raportit të Barometrit të Ballkanit, të publikuar më 24 qershor 2022 nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), i cili ndër të tjerash është një hulumtim mbi perceptimin e opinionit të publikut mbi besueshmërinë dhe pavarësinë e institucioneve publike, 68% e të anketuarve i besojnë Institucionit të Avokatit të Popullit (39% në 2020, një ngritje me 29%). Për sa i përket opinionit të publikut mbi pavarësinë e institucioneve publike nga ndikimi politik, vërehet se 60% e të anketuarve besojnë se Institucioni i Avokatit të Popullit është i pavarur nga ndikimi politik (që në vitin 2020 ishte 32%). Po ashtu 63% e të anketuarve konfirmojnë se ky institucion është i aftë ta bëjë mbikëqyrjen e Qeverisë dhe ta bëjë atë të përgjegjshme ndaj qytetarëve.<sup>218</sup>

### PUBLICATIONS



## Raporti i Barometrit të Ballkanit për vitin 2022

Besueshmëria në institucione publike	Pavarësia dhe ndikimi politik në institucionet publike	Efektiviteti i mbikëqyrjes së Qeverisë nga institucionet relevante dhe përgjegjshmëria e tij ndaj qytetarëve
Në Kosovë 68% e të anketuarve i besojnë Institucionit të Avokatit të Popullit (39% në 2020, një ngritje me 29%)	Në Kosovë, 60% e të anketuarve besojnë se Institucioni i Avokatit të Popullit është i pavarur nga ndikimi politik (ky vlerësim në vitin 2020 ishte 32%)	Kosova kryeson në këtë fakt, ku 63% e të anketuarve konfirmojnë se Institucioni i Avokatit të Popullit është i aftë ta bëjë mbikëqyrjen e Qeverisë dhe ta bëjë atë të përgjegjshme ndaj qytetarëve

Gjatë vitit 2023 një vëmendje më të theksuar do t'i kushtohet avancimit të edukimit për të drejtat e njeriut, në aspektin e harmonizimit të kurrikulave të edukimit, me politikën e edukimit mbi të drejtat e njeriut. Në këtë drejtim edhe gjatë vitit 2023 do të vazhdojë fushata informuese mbi të drejtat e njeriut dhe misionin e IAP-së: *"Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit"*, me nxënës dhe mësues të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta. Po ashtu do të vazhdojë deri në përmblyllje edhe fushata: *"Barazi për të gjithë"*, në kuadër të së cilës gjatë vitit 2023 planifikohen disa takime diskutimi me qytetarët e komuniteteve joshumicë. Po ashtu edhe gjatë vitit 2023 do të vazhdohet me takime të rregullta me shoqërinë civile në kuadër të punës së Forumit për Dialog, e po ashtu do të vazhdojnë takimet tematike në regjione të ndryshme të Kosovës në kuadër të Task-Forcës Avokuese joformale mbi Standardet e ndjeshme gjinore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe Punës së denjë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka nxjerrë Rregulloren (IAP) nr. 01/2019 për procedurat e veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave të paraqitura nga fëmijët apo ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Në mënyrë që kjo Rregullore të jetë sa më e kuptueshme dhe e qasshme për fëmijët, Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2023 planifikon finalizimin e dokumentit miqësor për ta. Institucioni

i Avokatit të Popullit, në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit, është duke e hartuar një Program të përhershëm që fëmijët të ndërgjegjësohen për të drejtat e tyre dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e tyre. Ky program synon të ndërgjegjësojë fëmijët për të drejtat e tyre dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e këtyre të drejtave sipas Kushtetutës, Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe legjislacionit në fuqi në Kosovë. Gjithashtu gjatë vitit 2023 do të mbahen edhe ditë të hapura me qytetarë dhe fëmijë, me qëllim të dëgjimit të ankesave të tyre dhe diskutimit me Avokatin e Popullit, për adresim të mëtutjeshëm të shqetësimeve të qytetarëve për pretendimet mbi mosrespektim apo shkelje të të drejtave të tyre.

## Bashkëpunimi me shoqërinë civile

### Pjesëmarrja në aktivitetet e shoqërisë civile

Shoqëria civile në vendin tonë, si një zë i fuqishëm i qytetarëve, vazhdon të ketë një rol të rëndësishëm aktiv në mbrojtjen dhe avokimin mbi respektimin e të drejtave të njeriut në vend. Bashkëpunimi me shoqërinë civile në drejtim të realizimit të aktiviteteve të përbashkëta për avokim dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut ka qenë mjaft i shprehur edhe gjatë vitit 2022. Avokati i Popullit, zëvendësit e tij dhe i gjithë stafi kanë marrë pjesë në rreth 105 tryeza diskutimi, 15 konferenca, 8 punëtori,



trajnime, debate publike e takime konsultative me tematika të ndryshme mbi aspekte të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Po ashtu gjatë vitit 2022 janë nënshkruar edhe 4 marrëveshje të reja të bashkëpunimit ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut.



Më 17 maj 2022, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare Kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë, Avokati i Popullit, nëpërmjet një deklarate të publikuar ka tërhequr vëmendjen tek situatat diskriminuese me të cilat ballafaqohen qytetarët e komunitetit LGBTI+, si rezultat i paragjytimeve, stigmatizimit dhe dhunës së ushtruar ndaj tyre. Avokati i Popullit u ka bërë thirrje të gjitha autoriteteve publike për detyrimin që kanë në mbrojtje nga diskriminimi për grupet e cenuara dhe marrjen e masave ligjore për njohjen e të gjitha të drejtave të garantuara me kushtetutë. Po në këtë ditë si shenjë solidarizimi dhe shënimit të kësaj dite, ndërtesa e IAP-së është ndriçuar me ngjyra që simbolizojnë të drejtat e këtij komuniteti. Ndërkaq më 9 qershor 2022 Avokati i Popullit së bashku me stafin, morën pjesë në paradën e Javës së Krenarisë që u mbajt në Prishtinë, në përkrahje për të drejtat e komunitetit LGBTI+.



Me rastin e hapjes së fushatës “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”, e organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe përkrahur nga zyra e “UN Women” në Kosovë, Avokati i Popullit ka theksuar nevojën e angazhimit të gjithmbarshëm për ndryshimin e normave shoqërore, duke promovuar barazinë, mosdiskriminimin dhe mirëqenien.



Avokati i Popullit, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës në Baza Gjinore, në deklaratën e publikuar ka shprehur shqetësimin mbi dukurinë e vrasjes së grave dhe nevojën e ndërmarrjes së veprimeve urgjente të të gjitha hallkave shtetërore në luftimin e kësaj dukurie dhe marrjen e masave preventive. Po ashtu

në këtë ditë si shenjë solidarizimi me viktimat e dhunës në familje në bazë gjinore, ndërtesa e IAP-së është ndriçuar në ngjyrën portokalli, si ngjyrë e fushatës globale.

Përkrahja e Avokatit të Popullit për vetëdijesimin e publikut mbi respektimin e barazisë, mosdiskriminimit dhe luftimit të dhunës në baza gjinore, nuk ka munguar edhe në fushata mediale të organizuara nga shoqëria civile, nëpërmjet dhënies së mesazheve me karakter edukues dhe vetëdijesues.

Avokati i Popullit në kuadër të projektit “Bëhu Partneri Im për Mirëqenie”, i implementuar nga organizata Advancing Together, ka mbajtur katër tryeza të diskutimit me qytetarë nga komunitetet joshumicë në: Gjilan, Novobërdë, Klinë dhe Graçanicë. Gjatë këtyre takimeve qytetarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian dhe të komuniteteve të tjera, janë njohur me mandatin e Avokatit të Popullit dhe punën e tij në drejtim të promovimit, avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve në vend. Po ashtu ata janë dëgjuar dhe kanë shprehur shqetësimet për mosrespektim të të drejtave të tyre, shqetësime të cilat do të adresohen nga Avokati i Popullit.





Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me “UN Women”, në vitin 2021 ka themeluar “Task Forcën Avokuese joformale mbi Standardet e Ndjeshme Gjinore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe Punës së denjë” në Kosovë, e cila ka për qëllim avokimin dhe promovim e sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë. Në kuadër të Task Forcës, gjatë vitit 2022 janë mbajtur dy takime konsultative në Pejë dhe në Gjakovë dhe një takim i rregullt i punës. Së bashku me përfaqësues të Task Forcës, përfaqësues të sindikatave në nivel regjional, përfaqësues të zyrave regjionale të Inspektoratit të Punës dhe OJQ-ve, me fokus në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe të punës, është diskutuar mbi Ligjin e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë si dhe mbrojtjen nga shkelja e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Më 8 gusht 2022, në bashkëpunim me Platformën Civikos, është organizuar një diskutim me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Tema e tryezës ka qenë: “Roli i Zyrave Rajonale të Avokatit të Popullit dhe mundësia e bashkëpunimit me organizatat lokale”, qëllimi i së cilës ka qenë promovimi i punës së zyrave rajonale të Avokatit të Popullit dhe mundësitë e bashkëpunimit mes tyre dhe organizatave lokale të shoqërisë civile me bazë në komunitet.

Edhe këtë vit, me rastin e shënimit të 10-dhjetorit të Ditës Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Avokati i Popullit, së bashku me shoqërinë civile, organizuan tubimin me moton: “Çohu për të Drejtat e Njeriut”, tanimë traditë e filluar që nga viti 2018, i cili ka për qëllim dërgimin e një mesazhi për angazhim më të shtuar, gjithëpërfshirës dhe ndërinstitucional për promovimin dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Tubimi u shoqërua me një fjalim rasti nga Avokati i Popullit dhe i një përfaqësuesi të shoqërisë civile.



### Forumi për Dialog me Shoqërinë Civile

Forumi për Dialog mes Avokatit të Popullit dhe Shoqërisë Civile, i themeluar në tetor të vitit 2021, është një nismë e re e ndërmarrë me qëllim të krijimit të një platforme të përbashkët të bashkëpunimit mes Avokatit të Popullit dhe Organizatave të Shoqërisë Civile, për avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, për identifikimin e sfidave dhe shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së tyre. Forumi për dialog luan një rol të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për të diskutuar dhe adresuar zhvillimet aktuale nga fusha e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në vend. Kësaj nisme i janë bashkuar një numër i konsiderueshëm i organizatave aktive të shoqërisë civile, që merren



me të drejtat e njeriut në fusha dhe perspektiva të ndryshme. Forumi është i orientuar në katër objektiva kryesore: 1. Avancimin e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kosovë; 2. Identifikimin dhe adresimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut; 3. Promovimin e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit dhe të Organizatave të Shoqërisë Civile që punojnë në çështjet e të drejtave të njeriut; dhe 4. Avokimin e përbashkët në zbatimin e rekomandimeve të IAP-së dhe të OShC-së.

Gjatë vitit 2022, Forumi ka mbajtur dy takime të rregullta të punës dhe një takim ad-hoc, sipas kërkesës së shoqërisë civile. Takimi i parë i rregullt i punës për vitin 2022 i Forumit është mbajtur më 25 maj 2022. Në këtë takim është shpalosur Dokumenti Strategjik mbi bazën e së cilit është themeluar ky forum dhe i cili rregullon mënyrën e funksionimit të Forumit dhe parimet e punës. Në këtë takim janë trajtuar shumë çështje si: *gjuha e përdorur në diskursin publik, dispozitat e Projektkodit Civil lidhur me njohjen e marrëdhënieve midis personave me sekse të njëjta. Po ashtu si shqetësim është ngritur edhe mosmiratimi për vite me radhë i dy projektligjeve mjaft me rëndësi që në mënyrë të drejtpërdrejtë prekin të drejta të kategorive të ndryshme më të cenueshme në vend, atë të Financave të pushtetit lokal dhe projektligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare.* Për këtë qëllim, më 9 gusht 2022 Institucioni i Avokatit të Popullit, Koalicioni i Organizatave për Mbrojtje të Fëmijëve (KOMF) dhe Lidhja e Qendrave për Punë Sociale të Kosovës (LQPSK) kanë paraqitur një qëndrim të përbashkët, duke i dërguar letër Qeverisë së Kosovës, me kërkesë për miratim të këtyre ligjeve brenda afatit të përcaktuar në agjendën legjislative.



Më 23 qershor 2022 Avokati i Popullit ka pritur në takim përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile për të diskutuar rreth të gjeturave dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021 dhe modalitetet e adresimit të përbashkët të tyre. Në këtë takim, i cili ka qenë takim ad-hoc në kuadër të Forumit, u shtruan për diskutim: *sfidat dhe nevojat aktuale për adresim lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara duke filluar nga qasja në infrastrukturë, edukim dhe arsimim, shëndetësi, punësim, transport etj.; trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi; puna e komisioneve mjekësore për vlerësim të aftësisë të kufizuar; respektimi i të drejtave të komuniteteve joshumicë; qasja e tyre në edukim dhe punësim; gjuha e urrejtjes në diskursin publik si dhe avancimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.*

Ndërsa më 16 nëntor 2022 është mbajtur takimi i dytë i rregullt i punës së Forumit të Dialogut. Kësaj radhe takimi u organizua edhe përmes platformës zoom, kjo me qëllim të lehtësimit të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të OJQ-ve, të cilët operojnë në qytete të ndryshme të Kosovës. Gjatë këtij takimi u prezantuan dhe u diskutuan zhvillimet dhe iniciativat e ndërmarra pas takimit të parë të rregullt të Forumit. Po ashtu u prezantuan dhe u diskutuan konkluzionet e Avokatit të Popullit në raport me të gjeturat e Raportit të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut në Kosovë për vitin 2021. Ndërmjet shumë temave të diskutuara me rëndësi, anëtarët e Forumit ngritën si çështje me nevojë për adresim të mëtutjeshëm: *ndikimin e korrupsionit në të drejtat e njeriut, për të cilin Avokati i Popullit veçse ka nisur një hetim preliminar; numrin e ulët të nxënësve me aftësi të kufizuara që gëzojnë mbështetje nga asistentët personal; mbrojtja e të drejtave dhe dinjitetit të të moshuarve dhe nevojën e mbikëqyrjes së institucioneve publike dhe private për kujdes të të moshuarve, të cilën çështje Avokati i Popullit planifikon ta trajtojë përmes një hetimi dhe raporti ex-officio në vitin 2023.* Avokati i Popullit në raportin ex-officio 331/2022, publikuar në vitin 2022, lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar me të drejtat e fëmijëve në arsim, ka referuar në raport edhe shqetësimet e vazhdueshme të ngritura nga shoqëria civile. Ky raport ka trajtuar jo vetëm numrin e pamjaftueshëm të asistentëve për nxënësit me aftësi të kufizuara, por edhe efikasitetin dhe efektivitetin e punës së tyre për integrim dhe përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimim.<sup>219</sup>

Pas informatës të marrë gjatë diskutimit në Forum, Avokati i Popullit ka iniciuar hetime ex-officio lidhur me pohimin për rrezikim të shëndetit të banorëve të fshatit Nakull - Komuna e Pejës, për

shkak të kundërmimit të kanalizimit, e cila kalon në afërsi të shtëpive të banorëve të këtij fshati të banuar kryesisht nga qytetarët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

219 <https://oik-rks.org/2022/11/10/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-3312022-lidhur-me-perafrimin-e-dispozitave-te-sistemit-te-arsimit-te-pergjithshem-parauniversitar-te-kosoves-me-te-drejtat-e-femijeve-ne-arsim/>

# Bashkëpunimi ndërkombëtar i IAP-së

Bashkëpunimi ndërkombëtar është pjesë e rëndësishme e mandatit të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNj), siç është edhe Avokati i Popullit, dhe kërkesë thelbësore e *Parimeve të Parisit*<sup>220</sup> dhe *Parimeve të Venedikut*.<sup>221</sup> Mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut i kushtojnë një rëndësi të veçantë fuqizimit të institucioneve të tilla të pavarura, sepse ato veprojnë si urë lidhëse në mbikëqyrjen e zbatimit efektiv të obligimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Përveç instrumenteve ndërkombëtare të miratuara më parë dhe ato në vitet paraprake për fuqizimin e rolit të IKDNj-ve, më 27 shtator 2022, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi një përmbledhje udhëzimesh që synojnë të ndihmojnë shtetet anëtare në përpjekjet e tyre për të përmbushur detyrimet e tyre për t'u siguruar të gjithëve, brenda juridiksionit të tyre, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>222</sup>

Këtë vit është bërë një hap shumë i rëndësishëm edhe për forcimin e rolit dhe pavarësisë së organeve të barazisë, meqë Komisioni Evropian, më 7 dhjetor 2022, miratoi propozimet për dy direktiva të reja, të cilat do të vendosin standardet minimale obliguese për të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës edhe gjatë vitit 2022 ishte shumë aktiv në sferën ndërkombëtare.

Përkundër faktit se Republika e Kosovës ende nuk është anëtarësuar në mekanizmat kyçë ndërkombëtarë dhe Institucioni i Avokatit të Popullit e ka të kufizuar mundësinë për të kontribuar në sistemin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, kjo për shkak të statusit të pazgjidhur të Kosovës.

Avokati i Popullit, si institucion i pavarur kushtetues, është i përkushtuar që të veprojë si urë lidhëse për shkëmbimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe të kontribuojë aty ku ka mundësi, por edhe të përgatisë kapacitetet e tij, që në një të ardhme, kurdo që të ndodhë anëtarësimi, të jetë në gjendje të marrë përsipër obligimet e veta në kuadër të sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Për më tepër, Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM) ka vlerësuar gatishmërinë dhe Projekt-Propozimin e Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës dhe me këtë rast Takimi i 12-të i Asociacionit të Ombudsmanëve të Mesdheut do të mbahet më 24-25 maj 2023 në Kosovë. Tema e konferencës që do të mbahet ditën e parë do të jetë: *"Integriteti dhe Pavarësia e Institucioneve të*

220 Parimet e Parisit janë kriteret minimale që duhet të ketë një institucion kombëtar për të drejtat e njeriut që të konsiderohet kredibil, i pavarur dhe efektiv në arenën ndërkombëtare.

221 Parimet për Mbrojtjen dhe Promovimin e Institucioneve të Ombudsmanëve (Parimet e Venedikut) e Venedikut për Institucionet e Ombudsmanëve, Komisioni i Venedikut, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)005-e)

222 <https://www.coe.int/en/web/human-rights-rule-of-law/-/new-council-of-europe-guidelines-on-preventing-and-remedying-violations-of-the-european-convention-on-human-rights>

*Ombudsmanëve - Qëndrueshmëria në mes të Sfidave*”, që synon të krijojë një mundësi për të hartuar llojin e kërcënimeve ndaj pavarësisë së tyre që përjetojnë Institucionet e Ombudsmanëve, praktikat më të mira dhe reagimi efektiv ndaj tyre.

Më qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit me institucione homologe dhe me organizata e rrjete të ndryshme ndërkombëtare, përfshirë në ato të cilat tashmë është i anëtarësuar, ka marrë pjesë në 40 takime ndërkombëtare, një pjesë e të cilave janë realizuar në mënyrë virtuale, siç janë të listuara në mënyrë kronologjike në tabelën e mëposhtme.

**Tabela: Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare**

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Data	Organizatori
1.	Takim virtual bilateral ndërmjet Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës dhe Avokatit të Popullit dhe Auditorit të Përgjithshëm të Shtetit të Izraelit  Online	17 janar 2022	IAP
2.	Webinari i Këshillit të Evropës për Organet e Barazisë dhe Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut lidhur me të drejtat sociale  Online	2 shkurt 2022	EQUINET
3.	Forumi Regjional për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Konventën Ndërkombëtare për Çështje Ekonomike, Sociale dhe Kulturore  Online	8 shkurt 2022	OHCHR
4.	Konferenca ndërregjionale me temën “Promovimi i kulturës së tolerancës dhe respektit të ndërsjellë ndërmjet dy regjioneve”  Tiranë, Shqipëri	1-3 mars 2022	Fondi për Ballkanin Perëndimor
5.	Takimi i Organizatës Evropiane për Shoqatat Ushtarake  Online	8-9 mars 2022	EUROMIS
6.	Takimi vjetor i Aleancës Botërore për Institucione Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI)  Online	9-10 mars 2022	GANHRI
7.	Vizitë zyrtare në Preshevë dhe Bujanovc	10 mars 2022	IAP

8.	Tryeza e rumbullakët, me temën: “Rindërtimi i një Evrope më të drejtë pas Covid-19 duke zgjeruar mbrojtjen kundër diskriminimit në baza të reja”	30 mars 2022	EQUINET
	Online		
9.	Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut( ENNHRI)	31 mars 2022	ENNHRI
	Online		
10.	Forumi për barazi gjinore në Ballkanin Perëndimor	1-2 prill 2022	AIRE Centre
	Becici- Mal të Zi		
11.	Lansimi i bazës së të dhënave të ENNHRI lidhur me të drejtat e mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e hapësirës civile	11 prill 2022	ENNHRI
	Online		
12.	Takimi i ENNHRI/OHCHR lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut të të ikurve nga Ukraina: Perspektiva e IKDNj-ve	12 prill 2022	ENNHRI/OHCHR
	Online		
13.	Konferencë lidhur me planet e barazisë	19 maj 2022	EQUINET
	Online		
14.	Asambleja e Përgjithshme dhe Konferenca e regjionit Evropian në kuadër të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve ( IOI)	26-27 maj 2022	IOI
	Online		
15.	Takimi i Rrjetit të MKPT-ve nga Evropa Juglindore	20-22 qershor 2022	Bordi i Ombudsmanëve të Austrisë
	Vjenë, Austri		
16.	Vizitë studimore në Danimarkë	27-28 qershor 2022	Projekti KSV/019 Asistenca teknike për Integrim Evropian
	Kopenhagë, Danimarkë		
17.	Vizitë studimore në Holandë	1-2 gusht 2022	Projekti IPA “Mbështetje për Avokatin e Popullit”
	Hagë, Holandë		
18.	Konferenca e gjashtë rajonale e Rrjetit të Trupave të Barazisë nga Evropa Juglindore	5-7 shtator 2022	Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, i Maqedonisë së Veriut
	Shkup, Maqedoni e Veriut		

19.	Trajnimi regional lidhur me Integrimin e Çështjes së Dhunës Seksuale dhe asaj me bazë gjinore në monitorimin e vendeve të privuara nga liria  Varshavë, Poloni.	7-8 shtator 2022	ODIHR
20.	Takimi vjetor i Rrjetit të Ombudspersonëve për Fëmijë dhe Konferenca Vjetore me temën "Formësimi i së ardhmes: Të drejtat e fëmijëve në krizën klimatike  Rekjavik, Islandë	19-20 shtator 2022	ENOC
21.	Takimi i 12 i Platformës së COE-FRA-ENNHRI-EQUINET për të drejtat sociale dhe ekonomike - Fuqizimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile që punon për të drejtat sociale  Bratisllavë, Sllovakia	20 shtator 2022	COE-FRA-ENNHRI-EQUINET
22.	Takim i Nivelit të Lartë për situatën e të drejtave të njeriut lidhur me migrimin nga Ukraina  Online	22 shtator 2022	ENNHRI
23.	Programi trajnues Matra "Të drejtat e njeriut dhe minoritetet"  Online	26 shtator – 28 tetor 2022	Komiteti i Helsinkut të Holandës & Akademia e Hagës për Qeverisje Lokale & Shkolla e së Drejtës së Leiden & Ministria për Punë të Jashtme e Holandës
24.	Konferenca ndërkombëtare me temën: "Drejtat e të Moshuarve dhe Roli i Institucioneve të Ombudsmanëve dhe Mediatorëve"  Online	27 shtator 2022	AOM dhe Ombudsmani i Gjeorgjisë
25.	Konferenca përmbyllëse e projektit "Horisontal Facility për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë" – Faza II  Budva, Mali i Zi	27-28 shtator 2022	Këshilli i Evropës
26.	Vizitë zyrtare tek Avokati i Popullit në Shqipëri  Tiranë, Shqipëri	3 tetor 2022	IAP



27.	Konferenca e 14-të Ndërkombëtare e Ombudsmanëve për Forcat e Armatosura: “Të drejtat dhe detyrimet e personelin e forcave të armatosura në kohë paqeje dhe në kohë lufte: ndërmjet politikave dhe praktikave”  Oslo, Norvegji	3-4 tetor 2022	DCAF
28.	Takimi vjetor i Asamblesë së Përgjithshme të Equinet  Bruksel, Belgjikë	5 tetor 2022	Equinet
29.	Konferenca Evropiane e NPM-ve	5-6 tetor 2022	Këshilli i Evropës
30.	Vizitë studimore në Institucionin e Ombudsmanit në Kroaci  Zagreb, Kroaci	11-13 tetor 2022	OSBE
31.	Vizitë studimore lidhur me integrimin gjinor në Suedi  Stokholm, Suedi	18-19 tetor 2022	Un Eömen
32.	Punëtori lidhur me adresimin e urrejtjes përmes përmirësimit të mbledhjes së të dhënave, Strasburg, Francë	18-19 tetor 2022	Këshilli i Evropës
33.	Takimi i Grupit Punues të Equinet për të drejtën e barazisë dhe Trajnimi lidhur me përdorimin e të dhënave lidhur me barazinë në praktikën ligjore me raste.  Bruksel, Belgjikë	26-28 tetor 2022	Equinet
34.	Programi intensiv lidhur me të drejtën evropiane dhe ekonominë.  Riga, Letoni	7 nëntor-16 dhjetor 2022	Shkolla e Rigës për të drejtën, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Letonisë dhe Qeverinë e Kombeve të Bashkuara
35.	Takimi i dytë i Rrjetit të MKPT-ve nga Evropa Juglindore  Vjenë, Austri	15-16 nëntor 2022	Bordi i Ombudsmanëve të Austrisë dhe Këshilli i Evropës

36.	Trajnimi me temën “Institucionet e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësuesve: proceset dhe mjetet e intervenimit”	22-23 nëntor 2022	AOM & AOMF
	Rabat, Marok		
37.	Takimi vjetor i Asamblesë së Përgjithshme të ENNHRI	22-23 nëntor 2022	ENNHRI
	Bruksel, Belgjikë		
38.	Forumi i Nëntë regjional për sundimin e ligjit në Evropën Juglindore	25-26 nëntor 2022	Civil Rights Defenders Aire Centre
	Tiranë, Shqipëri		
39.	Konferenca për 30-vjetorin e themelimit të Institucionit të Ombudsmanit në Qipro, me temën: “Sundimi i ligjit, parimet dhe shkëmbimi i përvojave të mira në zbatimin e kompetencave të Institucionit të Ombudsmanëve si mjete për mbrojtje dhe promovim më të mirë të të drejtave të njeriut”	2 dhjetor 2022	AOM & Ombudsmani i Qipros
	Nikozia, Qipro		
40.	Simpoziumi Ndërkombëtar lidhur me Rolin e Legjislaturës në Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.	21-22 dhjetor 2022	Institucioni për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë i Turqisë
	Rize, Turqi		

## Bashkëpunimi me homologë dhe me organizata të tjera ndërkombëtare

Ndërveprimi i rregullt dhe konstruktiv me institucione homologe dhe organizata e rrjete të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut është thelbësor dhe shumë i rëndësishëm për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ) që në mënyrë efektive të zbatojnë mandatin e tyre, prandaj Institucioni i Avokatit të Popullit edhe këtë vit i ka kushtuar rëndësi të veçantë bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pjesëmarrjes së tij në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare, disa prej të cilave po i paraqesim më poshtë.

Më 17 janar 2022, Avokati i Popullit, z. Naim Qelaj dhe Auditorja e Përgjithshme, znj. Vlora Spanca, realizuan një takim njoftues virtual me z. Matanyahu Engelman, Auditor dhe Ombudsman i Izraelit, dhe znj. Dr. Esther Ben-Haim, Shefe e Zyrës së Ombudsmanit në Izrael. Ata gjatë takimit shkëmbyen informata lidhur me rolin, mandatin dhe bazën kushtetuese dhe ligjore mbi të cilën realizojnë misionin e tyre, por gjithashtu edhe për sfidat me të cilat përballen dhe mundësitë dhe vizionin e tyre për t'i trajtuar ato në të ardhmen. Në këtë takim gjithashtu u diskutua për mundësitë e ndërmarrjes së iniciativave për shkëmbimin e stafit si dhe për organizimin e tryezave të diskutimit me tematika të të drejtave të njeriut të cilat janë në interes të përbashkët. Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës e falënderoi homologun e tij izraelit për takimin

dhe e mirëpriti gatishmërinë e tij për bashkëpunim në të ardhmen. Si shtete me një lidhje shumë të fortë historike, të cilat kanë pasur fate të ngjashme, hapja e shtigjeve të reja për bashkëpunim është shumë e rëndësishme për të dy shtetet.

Më 1 dhe më 2 prill 2022, Avokati i Popullit mori pjesë në Forumin e parë Regjional për Barazi Gjinore në Ballkanin Perëndimor, i cili u organizua nga Qendra AIRE. Në këtë forum morën pjesë presidenti dhe zëvendës-presidenti i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komisionarja e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, si dhe përfaqësues të gjyqësorit dhe të institucioneve homologe nga i tërë rajoni. Në këtë forum u diskutuan parimet kryesore dhe standardet e përcaktuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për sa i përket barazisë gjinore dhe diskriminimit në bazë të seksit, duke përfshirë detyrimet kryesore thelbësore dhe procedurale për mbrojtjen e grave nga dhuna në familje dhe ajo me bazë gjinore.

IAP-ja edhe këtë vit mori pjesë në një sërë takimesh në kuadër të rrjeteve ku është i anëtarësuar, në vijim do të përmendim disa prej tyre.

Më datat 26-27 maj 2022, IAP-ja mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme dhe Konferencën e Grupit Evropian të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI), e cila u organizua nga Ombudsmani i Greqisë. Temë e kësaj konference ishte *“Ombudsmani i ri-plotësuar: Mandati dhe korniza operative në epokën post-moderne”* dhe ajo mbledhi përfaqësues të institucioneve të Ombudsmanëve nga e gjithë Evropa. Në kuadër të saj u diskutuan projektet aktuale të IOI, duke u ndalur specifikisht në Memorandumin e Mançesterit lidhur me rishikimin kolegjial (ang. peer review). Memorandumi i Mançesterit erdhi si rekomandim nga anketa e zhvilluar nga Ombudsmani Parlamentar për Shërbimet Shëndetësore i Uellsit,

me titull: *“Arti i Ombudsmanit: udhëheqja përmes krizës ndërkombëtare”*. Si përfundime të punimeve doli se mekanizmi i rishikimit kolegjial duhet të mbështetet nga të gjithë anëtarët, meqë do të ndihmojë të kemi institucione me kompakte dhe më kredibile në të ardhmen duke bërë që të zbatohen në praktikë edhe Parimet e Venedikut, si bazë reference për veprimet e të gjitha institucioneve të Ombudsmanëve. Gjithashtu u ripërsërit fakti se është e rëndësishme që të shfrytëzohen maksimalisht teknologjitë e reja për zbatimin e mandatit të institucioneve të Ombudsmanëve, por edhe të reagojë ashpër kur përmes tyre tentohet që të minohen të drejtat e njeriut.

Një sërë aktiviteteve në të cilat ka marrë pjesë IAP-ja gjatë këtij viti, janë realizuar edhe nga ENNHRI-ja.

Edhe këtë vit, ENNHRI-ja publikoi Raportin për Gjendjen e Sundimit të Ligjit në Evropë<sup>223</sup>, i cili paraqet perspektivën e të gjitha institucioneve anëtare të këtij rrjeti, për gjendjen e sundimit të ligjit në shtetet e tyre, bazuar në monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave nga institucionet anëtare, duke përfshirë edhe pjesën për Kosovën, sipas raportit të dërguar nga Institucioni i Avokatit të Popullit i Republikës së Kosovës. Të gjeturat e këtij raporti tregojnë një përkeqësim të mëtejshëm të sundimit të ligjit në gjithë Evropën në krahasim me vitin e kaluar. Raporti thekson se në disa shtete, Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut përballen me sulme dhe kërcënime ndaj pavarësisë së tyre, mungon bashkëpunimi nga autoritetet kombëtare dhe ato përballen me burime të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore. Raporti po ashtu identifikoi përkeqësimin e kushteve të funksionimit për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Ai gjithashtu nënvizon pengesat e vazhdueshme për qasjen në drejtësi, në lidhje me nivelet e korrupsionit

<sup>223</sup> Raporti i ENNHRI-së për Sundimin e Ligjit në Evropë, <https://ennhri.org/wp-content/uploads/2022/07/ENNHRI-Regional-RoL-Report-2022.pdf>

dhe mbrojtjen e pamjaftueshme të sinjalizuesve. IKDNj-të raportuan veçanërisht për një rënie të konsiderueshme në lirinë e mediave, pluralizmin në tregun medial dhe sigurinë e gazetarëve.

Kurse për sa u përket takimeve, janë realizuar disa gjatë vitit, por ne po e përmendim vetëm Takimin e Asamblesë së Përgjithshme të ENNHRI-së, i cili këtë vit për herë të parë që prej fillimit të pandemisë, u mbajt me pjesëmarrje fizike në Bruksel, në datat 22-23 nëntor 2022. Përveç çështjeve të brendshme të rrjetit, po ashtu, u diskutua lidhur me ndikimin në të drejtat e njeriut që ka pasur lufta në Ukrainë si dhe qëndrueshmëria e IKDNj-ve prej tre prizmeve, si: standardet regjionale dhe zbatimi i tyre, mjedisi për sundimin e ligjit në nivel kombëtar dhe mbështetja e qëndrueshmërisë institucionale dhe IKDNj-të nën kërcënim.<sup>224</sup>

Avokati i Popullit, në kuadër të mandatit si organ i barazisë, më 5 tetor 2022 mori pjesë në Asambleshën e Përgjithshme të Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET), ku përveç çështjeve të brendshme të rrjetit, u diskutua lidhur me standardet për organet e barazisë, me ç' rast anëtarët u ndan në grupe të vogla dhe diskutuan së bashku me politikëbërës nga Komisioni Evropian dhe përfaqësues të Presidencave aktuale dhe të ardhshme të Këshillit të BE-së për propozimin e ardhshëm legjislativ për standardet detyruese për organet e barazisë. Si konkluzion i takimit doli se organet e barazisë është e nevojshme që të kenë burimet e nevojshme financiare, njerëzore dhe operacionale, të cilat duhet të përfshihen në direktivën e re të BE-së. Çdo mandat shtesë duhet të shoqërohet me burime shtesë, të ndahet buxhet specifik për ndërveprimin me gjykatën (rastet strategjike gjyqësore), t'u sigurohen zyre në tërë territorin dhe të sigurohet pavarësia

e udhëheqësit të institucionit. Gjithashtu pas miratimit të direktivës, secili institucion të llojë me parlamentet kombëtare për transpozimin e saj në legjislacionin vendor.<sup>225</sup>

IAP-ja ka disa vite që merr pjesë edhe në konferencën vjetore të Rrjetit të Organeve të Barazisë nga Evropa Juglindore, e cila këtë vit u mbajt në Shkup të Maqedonisë, më datat 5-7 shtator 2022. Në këtë konferencë u diskutua roli i organeve të barazisë në proceset gjyqësore, duke përfshirë rastet strategjike gjyqësore dhe zhvendosja e barrës së provës në gjykatë.

Bashkëpunim i shtuar ndërkombëtar shtrihet edhe për sa i përket mandatit të IAP-së si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (MKP), në kuadër të të cilit mandat u zhvilluan disa takime. IAP-ja mori pjesë në dy takime të mbajtura në Vjenë të Austrisë, të organizuara nga Rrjeti i Mekanizmave Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Evropës Juglindore (SEE NPM). Takimi i parë u mbajt më datat 20-22 qershor 2022 dhe trajtoi dy tema: 1) Nevojat e veçanta të të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara fizike në vendet e ndalimit dhe 2) Marrëdhëniet e MKP-së me Publikun. Kurse *takimi i dytë* u mbajt më datat 15-16 nëntor 2022 dhe trajtoi këto tema: 1) Akomodimi dhe trajtimi i fëmijëve dhe adoleshentëve me probleme të shëndetit mendor dhe aftësi të kufizuara fizike dhe 2) Aplikimi i masave shtrënguese për adoleshentët dhe personat me çrregullime mendore.

Shtuar kësaj, më datat 5-6 tetor 2022, IAP-ja mori pjesë në Konferencën Evropiane të MKP-ve, e cila u organizua nga Këshilli i Evropës në Strasburg të Francës. Kjo konferencë kishte si temë "Monitorimi

224 ENNHRI, IKDNJ-të mblidhen për Asambleshën e Përgjithshme të ENNHRI, të parën me pjesëmarrje fizike që prej vitit 2019, e qasshme në: <https://ennhri.org/news-and-blog/nhris-gather-for-ennhri-first-general-assembly-in-person-since-2019/>

225 EQUINET, Asambleja e Përgjithshme e Equinet voton në Takimin e Përgjithshëm Vjetor, i qasshëm në: <https://equineteurope.org/equinet-general-assembly-votes-at-agm-2022/>

i grupeve të veçanta të personave të privuar nga liria” dhe kishte për fokus specifikat e monitorimit të kushteve të paraburgimit dhe trajtimit të kategorive të ndryshme të personave të cenueshëm të privuar nga liria. Pjesëmarrësit e konferencës diskutuan teknikat e veçanta të përdorura nga MKP-të gjatë vizitave parandaluese dhe shkëmbyen pikëpamjet dhe praktikat më të mira lidhur me mjetet juridike efektive që synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës së kategorive të personave të cenueshëm të privuar nga liria. Persona të tillë përfshijnë fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit, gratë, migrantët dhe minoritetet.

Më datat 2-4 tetor 2022, IAP-ja mori pjesë në Konferencën e 14-të Ndërkombëtare të Institucioneve të Ombudsëve për Forcat e Armatosura (14ICOAF), e cila u mbajt në Oslo të Norvegjisë. Kjo konferencë këtë vit shqyrtoi rolin e institucioneve të Ombudsëve para dhe gjatë konflikteve të armatosura, të drejtat dhe detyrimet e personelit të forcave të armatosura në kohë paqeje dhe rastet kur ato mbështesin zbatimin e ligjit. Veç të tjerash, gjatë Konferencës ishin paraparë sesione të veçanta për barazinë gjinore në forcat e armatosura; post-dislokimin dhe të drejtat shëndetësore, përfshirë shëndetin mendor të personelit të forcave të armatosura, si dhe për rolin e institucioneve të Ombudsëve përkritazi me Objektivin Zhvillimor të Qëndrueshme 16 - Paqe, Drejtësi dhe Institucione të forta. 14ICOAF paraqet tashmë një forum ndërkombëtar të rëndësishëm për të promovuar dhe fuqizuar mbikëqyrjen demokratike të forcave të armatosura, me pjesëmarrës që ndajnë bashkërisht aspirata të njëjta për parandalimin e keqqeverisjes dhe cenimit të të drejtave të njeriut, në të cilin IAP-ja merr pjesë çdo vit.

Për IAP-në është shumë e rëndësishme edhe ngritja e kapaciteteve të stafit dhe shkëmbimi i informatave dhe praktikave të mira me institucione të tjera homologe, prandaj edhe këtë vit, më këtë qëllim në mëndje u realizuan katër vizita studimore. *Vizita e parë*<sup>226</sup> u mbajt në Danimarkë më datat 26-29 qershor 2022, me fokus në shkëmbimin e informatave lidhur me edukimin për të drejtat e njeriut dhe përfshirjen e tij në programet dhe politikat e arsimit, në sistemin e edukimit formal dhe joformal, prej shkollave fillore tek niveli universitar, në mënyrë që të krijohet një kulturë për të drejtat e njeriut në shoqërinë tonë. *Vizita*, përveç përfaqësuesve të IAP-së, kishte pjesëmarrës edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Universiteti i Prishtinës. Gjatë kësaj vizite, Avokati i Popullit z. Naim Qelaj pati një drekë pune me z. Niels Fenger, Ombudsmani Parlamentar i Danimarkës, me të cilin diskutoi çështje të ndryshme të bashkëpunimit të ndërsjellë, me fokus të veçantë në marrëveshjen për dhënien me qira të burgjeve të Kosovës shtetit të Danimarkës. *Vizita e dytë*<sup>227</sup> u mbajt në Holandë, më datat 1-2 gusht 2022 dhe kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve të stafit të administratës, në çështjet e miradministrimit, menaxhimit, financave, burimeve njerëzore etj. *Vizita e tretë* u mbajt në Kroaci, më datat 11-12 tetor 2022, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe kishte për qëllim marrjen e praktikave të mira lidhur me monitorimin dhe reagimin në rastet e krimeve të urrejtjes, duke përfshirë mënyrat e mbledhjes dhe përcjelljes së të dhënave për krimet e urrejtje dhe gjuhën e urrejtjes si dhe raportimi për to. *Vizita e katërt* u mbajt më datat 17-20 tetor 2022, në Suedi, me mbështetjen e “UN Women”. Qëllimi i kësaj vizite ishte fuqizimi i rolit të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Institucioneve të Avokatit të Popullit, në rritjen e llogaridhënies, transparencës, monitorimit ndaj angazhimeve për barazi gjinore dhe buxhetimit

226 Kjo vizitë u organizua në kuadër të projektit KSV 019 Asistenca Teknike në kontekst të Integritimit Evropian, me mbështetje dhe financim nga Qeveria e Luksemburgut dhe e Norvegjisë, e implementuar nga Zyra e Kryeministrit të e Republikës së Kosovës.

227 Kjo vizitë u organizua në kuadër të projektit IPA: “Mbështetje për Avokatin e Popullit”, financuar nga Bashkimi Evropian.

gjinator, në lidhje me shkëmbimin i përvojave dhe praktikave të mira. Në këtë vizitë studimore morën pjesë përfaqësuesit e Institucioneve të Avokatit të Popullit dhe Institucioneve Supreme të Auditimit nga tri vendet të Ballkanit Perëndimor: Republika e Kosovës, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Pjesëmarrësit patën rastin të njiheshin për së afërmi me metodat e zhvilluara dhe praktikatat e mira të shtetit suedez lidhur me procesin e buxhetimit gjinor, procesin e auditimit të performancës si dhe instrumente të tjera shtetërore që aplikohen për një shoqëri më të barabartë.

IAP-ja ka prioritet bashkëpunimin ndërkombëtar dhe do të vazhdojë të jetë e pranishme në takime e forume të ndryshme ndërkombëtare, të cilat do të ndikojnë në forcimin e mëtutjeshëm të këtij bashkëpunimi dhe krijimin e bashkëpunimeve të reja, përmes të cilave do të jetë i informuar në vazhdimësi me të rejat në fushën e të drejtave të njeriut dhe punës së sistemit ndërkombëtar.

## Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare

Anëtarësimi i institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut (IKDNj) në mekanizma dhe rrjete ndërkombëtare shërben për të avancuar marrëdhëniet dinamike që duhet të ekzistojnë ndërmjet tyre dhe sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Meqë IAP-ja tashmë është anëtarësuar në rrjetet dhe organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, këtë vit është kujdesur që të ndërveprojë me to, duke mbajtur takime të përbashkëta, shkëmbim të informatave e praktikave të mira, që ndihmojnë në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Pas shumë sfidave dhe përpjekjeve, një sukses tjetër i radhës për IAP-në në strukturat ndërkombëtare

për të drejtat e njeriut është edhe anëtarësimi në Rrjetin Evropian të Ombudspersonëve për Fëmijë (ENOC). IAP-ja këtë vit përfundimisht mori konfirmimin për anëtarësim si anëtar i asociuar, duke iu bashkëngjitur edhe këtij rrjeti të rëndësishëm ndërkombëtar. ENOC-i është rrjet i institucioneve të pavarura për të drejtat e fëmijëve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Mandati i tij është të lehtësojë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, siç parashihet me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve e Kombeve të Bashkuara.<sup>228</sup> Rrjeti Evropian i Ombudspersonëve për Fëmijë po ashtu shërben për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen profesionale ndërmjet anëtarëve, të promovojë krijimin e institucioneve të pavarura të të drejtave të fëmijëve dhe të ofrojë mbështetje për iniciativa të tilla.

228 Rrjeti Evropian i Ombudspersonëve për Fëmijë (ENOC), i qasshëm në: [https://enoc.eu/?page\\_id=2316](https://enoc.eu/?page_id=2316)



Më poshtë paraqesim mekanizmat ndërkombëtarë ku IAP-ja është e anëtarësuar:

Nr.	Rrjeti/Mekanizmi	Viti i anëtarësimit
1.	Instituti Evropian i Ombudsmanëve (EOI)	2002
2.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Fëmijë i Evropës Juglindore (CRONSEE)	2009
3.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI)	2012
4.	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)	2013
5.	Asociacionin e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësve të Frankofonisë (AOMF)	2015
6.	Konferenca Ndërkombëtare e Institucioneve të Ombudsmanëve për Forcave të Armatosura (ICOAF)	2015
7.	Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)	2016
8.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Ambientin dhe të Drejtat e Njeriut <sup>228</sup>	2017
9.	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET)	2019
10.	Rrjeti Evropian i Ombudspersonëve për Fëmijë (ENOC)	2022

IAP-ja gjithashtu ftohet dhe merr pjesë edhe në aktivitete të disa mekanizmave dhe rrjeteve të tjera, në të cilat për shkak të barrierave politike është vetëm anëtar vëzhgues, si në:

- Aleanca Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut- GANHRI (nga e cila bëhet shqyrtimi i pajtueshmërisë së IKDNj-ve me Parimet e Parisit)<sup>230</sup>;
- Rrjeti i Mekanizmave Kombëtarë për Parandalimin e Torturës i Evropës Juglindore - SEE NPM (në kuadër të të cilit IAP-ja merr pjesë në takime të ndryshme që kanë për qëllim bashkëpunimin, promovimin dhe shkëmbimin e përvojës, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria).<sup>231</sup>

229 Ky rrjet është themeluar në vitin 2017 dhe është nënshkruar nga këto shtete: Bosnja, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Sllovenia.

230 Kusht për anëtarësinë në këtë organizatë është anëtarësimi i Kosovës në Kombet e Bashkuara.

231 Kusht për anëtarësimin në këtë rrjet rajonal është aderimi i Kosovës në Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës.

## Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë

IAP-ja çdo vit pranon pyetësorë të tematikave të ndryshme nga organizata ndërkombëtare për të raportuar për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe këtë vit janë dërguar disa kërkesa për raporte dhe pyetësorë të cilët janë të listuar në tabelën e mëposhtme.

**Tabela: Lista e raporteve të dërguara në organizata ndërkombëtare**

Data	Tema e raportit/hulumtimit	Organizata/institucionit të cilit i është dërguar raporti
4 shkurt 2022	Raport i Avokatit të Popullit lidhur me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë	Ombudsmani i Francës
7 shkurt 2022	Digjitalizimi i shërbimeve dhe roli i Ombudsmanit	Rrjeti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI)
2 mars 2022	Praktikat e mira lidhur me punën me mbrojtësit e të drejtave të njeriut	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)
21 mars 2022	Pyetësor lidhur me mandatin e Avokatit të Popullit të Kosovës	Rrjeti Evropian i Ombudsmanëve (EOI)
30 mars 2022	Roli i Institucioneve të Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësve në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit	Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR)
22 qershor 2022	Korrigjimi (redress) në rastet e diskriminimit: Sanksionet dhe mjetet juridike	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (Equinet)
20 tetor 2022	Ndryshimet pozitive të arritura nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut	Reporteri Special i Kombeve të Bashkuara për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut
14 nëntor 2022	Infrastruktura ligjore lidhur me Actio Popularis	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (Equinet)
15 nëntor 2022	Raport lidhur me praktikën në Kosovë lidhur me bartjen e simboleve fetare nga avokatët	UNIA - Organi i Barazisë në Belgjikë
8 dhjetor 2022	Raport vetëvlerësimi lidhur me mandatin për të drejtat e fëmijëve	Asociacioni i Ombudsmanëve të Frankofonisë (AOMF)

# Agjenda 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit, si Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut

Çrrënjësia e varfërisë, pabarazisë, realizimi i dinjitetit njerëzor dhe premtimi për të arritur ata që janë të lënë më anash e për të mos lënë askënd pas, kanë në fundament parimet e të drejtave të njeriut, të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe përbëjnë përkushtimin dhe premtimin e shteteve nëpërmjet Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Kjo Agjendë bazohet në Rezolutën A/RES/70/1 të Asamblesë së Përgjithshme të KB, e miratuar më 25 shtator 2015. Në kontekstin vendor, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 25 janar 2018, ka shprehur vullnetin politik dhe gatishmërinë për t'u angazhuar në zbatimin e kësaj kornize globale, nëpërmjet Rezolutës Nr. 06-R-001, për miratimin e Objektiveve për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ). Ndërkaq, në tetor 2018, Kuvendi ka themeluar Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm, si një mekanizëm ndërinstucional në kuadër të Kuvendit, në shërbim të koordinimit të proceseve drejt përmbushjes së kësaj Agjende.

Agjenda 2030 paraqet një plan veprimi të nivelit global, në linjë me të cilin shtetet kanë shprehur përkushtimin dhe përpiqen të jenë partnerë për të përmbushur 17 objektiva, me 169 caqe specifike të synuara, të cilave u korrespondojnë 231 tregues.<sup>232</sup> Ky dokument në thelbin e vet, si shtylla kyçe të vizionit universal që mbart, vë: *popullatën, prosperitetin, planetin, paqen dhe partneritetin* (të njohura si pesë P-të), e të cilat mbështetet zhvillimi i vërtetë dhe i qëndrueshëm.

Agjenda bën thirrje për gjithëpërfshirje dhe partneritet përkitazi me njohuritë, ekspertizën, përvojat, resurset etj., në mënyrë që progresi drejt arritjes së objektivave të ndodh gjithandej globalisht.

Objektivat dhe synimet e Agjendës 2030 shpërfaqin standardet e pranuar ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut dhe integrojnë parimet ndërsektoriale lidhur me to, në mënyrë që të realizohet përkushtimi për të mos lënë askënd pas

232 Për më tepër shih <https://unstats.un.org/sdgs/indicators/indicators-list/#:~:text=The%20global%20indicator%20frame%20includes%20231%20unique%20indicators>.

dhe për të ndikuar në gëzimin e këtyre të drejtave nga çdo kush dhe në çdo vend.

Nga perspektiva e të drejtave të njeriut, përafërsisht gjysma e indikatorëve të OZhQ-së ka potencial të prodhojë të dhëna që drejtpërdrejt kanë relevancë për monitorimin e instrumenteve specifike të të drejtave të njeriut, përderisa pjesa tjetër kanë relevancë të tërthortë apo ofrojnë informacion kontekstual dhe analitik.<sup>233</sup> Kjo ndërlidhje e Agjendës me të drejtat e njeriut theksohet tek Deklarata e Meridas<sup>234</sup> për rolin e IKDNj-së në zbatimin e Agjendës 2030.

Agjenda ka të mishëruar fuqishëm Kartën e Kombeve të Bashkuara<sup>235</sup>, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut<sup>236</sup>, traktate dhe instrumente ndërkombëtare. Një pjesë të këtyre Marrëveshjeve dhe Instrumenteve ndërkombëtare, Republika e Kosovës i ka të integruara në Kushtetutë (Neni 22).<sup>237</sup> Megjithatë, fakti se vendi ynë nuk është shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara, ka për rrjedhojë mosraportimin tek organet e traktateve, përfshirë Këshillin e të Drejtave të Njeriut dhe procesin e Rishikimit Periodik Universal (UPR).<sup>238</sup> Kjo gjë afekton mënyrën e të raportuarit në nivel

të mekanizmave dhe proceseve për monitorimin dhe zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare dhe progresin në këtë drejtim.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se mospërfshirja e Konventës Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Kushtetutën e vendit, nënkupton se Kosova është pa një instrument kyç për sa i përket arritjes së objektivave dhe synimeve të Agjendës 2030. Për më tepër, të dyja dokumentet (Konventa në fjalë dhe Agjenda 2030) e përplotësojnë dhe fuqizojnë njëra-tjetrën. Në këtë funksion do të ishte edhe përfshirja e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe e Kartës Sociale të Evropës (e rishikuar më 1996).

Përfshirja në Kushtetutë e kësaj Konvente, si dhe e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokolli Opsional dhe Kartës Sociale Evropiane (e rishikuar më 1996), kanë dalë si rekomandime<sup>239</sup> të veçanta drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Raporti ex officio nr. 577/2021, lidhur me të drejtat në shëndetin seksual dhe riprodhues - qasjen në informata dhe

233 Për më tepër, shih [https://www.humanrights.dk/what-we-do/sustainable-development-goals/sdgs-indicators-data#:~:text=Approximately%20half%20\(49%25\)%20of,enable%20or%20limit%20the%20realisation](https://www.humanrights.dk/what-we-do/sustainable-development-goals/sdgs-indicators-data#:~:text=Approximately%20half%20(49%25)%20of,enable%20or%20limit%20the%20realisation)

234 Deklarata e Meridas është miratuar nga Aleanca Globale e IKDNj-ve (GANHRI) në Konferencën e 12-të të Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ICC), e mbajtur në Merida, Jukatan, Meksikë, më 8-10 tetor 2015. Fokusi i Konferencës ishte në "Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe rolin e IKDNj-së në këtë kontekst. Për më tepër për rolin e IKDNj-ve sipas kësaj Deklarate, ju lutemi shihni në: <https://ennhri.org/our-work/topics/sustainable-development-goals/#:~:text=The%20M%C3%A9rida%20Declaration%2C%20adopted%20by,human%20rights%20and%20sustainable%20development>.

235 Për më tepër shih <https://www.un.org/en/about-us/un-charter>

236 Për më tepër shih <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

237 Për më tepër shih <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

238 Rishikimi Periodik Universal është një proces unik që përfshin rishikimin e të dhënave të të drejtave të njeriut të të gjitha shteteve anëtare të OKB-së. Si proces, drejtohet nga shteti, nën kujdesin e Këshillit të të Drejtave të Njeriut, i cili ofron mundësinë për çdo shtet të deklarojë se çfarë veprimesh kanë ndërmarrë për të përmirësuar situatën e të drejtave të njeriut në vendet e tyre dhe për të përmbushur detyrimet e tyre për të drejtat e njeriut. Si një nga tiparet kryesore të Këshillit, UPR është krijuar për të siguruar trajtim të barabartë për çdo vend kur vlerësohen situatat e tyre të të drejtave të njeriut. Qëllimi përfundimtar i këtij mekanizmi është përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut në të gjitha vendet dhe adresimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut kudo që ato ndodhin. Aktualisht nuk ekziston asnjë mekanizëm tjetër universal i këtij lloji. Informacioni i qasshëm në: <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/upr/pages/uprmain.aspx>

239 Të njëjtat Rekomandime kanë qenë të adresuara tek legjislativi edhe në vitin 2016 nëpërmjet Vlerësimit për të Drejtat në Shëndet Seksual dhe Riprodhues, por kanë mbetur të pazbatuara. Për më tepër, shih <https://oik-rks.org/2016/12/08/raporti-te-drejtat-ne-shendetin-seksual-dhe-riprodhues-ne-kosove-nje-realitet-per-tej-ligjit/>

shërbime kontracepsioni, në abort dhe kujdes pas abortit, si dhe kujdesi për shëndetin e nënës.

I njëjti raport, i adresuar tek autoritet në fund të dhjetorit 2022, ka ndërlidhje të ngushtë veçmas me Objektivin 3 - Shëndeti i mirë dhe mirëqenia dhe Objektivin 5 - Barazia gjinore, respektivisht treguesit përkatës relevantë (Treguesi 3.7.1; 3.7.2; 3.c.1; 3.8; 5.6.1) të këto dy objektiva specifike. Numri i madh i rekomandimeve që kanë dalë prej tij do të kërkojnë angazhim të veçantë dhe bashkëpunim të ngushtë nga institucionet përgjegjëse të cilat bie obligimi për përbushjen e tyre.

Bazuar në parimet e themelimit dhe funksionimit, Institucioni i Avokatit të Popullit është Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut, në pajtim me *Parimet e Parisit*.<sup>240</sup> Për shkak të rëndësisë që kanë këto institucione në nivel ndërkombëtar, Agjenda e ka vendosur tregues të veçantë ekzistimin e këtyre institucioneve në pajtueshmëri me *Parimet e Parisit* (Objekivi 16, treguesi 16.a.1).<sup>241</sup> Institucionet e kësaj natyre, gjithandë ku funksionojnë, aplikojnë përgjatë punës së tyre qasje të bazuar në të drejta të njeriut<sup>242</sup>, në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave e përgjegjësive që kanë.

Qasja e bazuar në të drejta të njeriut shërben për të fuqizuar mbajtësit e të drejtave të njeriut (individët,

komunitetet) të kërkojnë dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre, si dhe të rrit kapacitetet e bartësve të përgjegjësive, për të respektuar, mbrojtur e promovuar të drejtat dhe liritë e garantuara dhe për të përbushur detyrimet e obligimet që kanë.

Bazuar në Rezolutën për Agjendën 2030, është përgjegjësi e qeverive respektive përcjellja dhe vlerësimi i progresit për sa i përket arritjes së OZhQ-së dhe caqeve të synuara.

Për të ndihmuar në këtë aspekt dhe në shërbim të llogaridhënies nga ana e qeverive, është zhvilluar korniza globale e treguesve (indikatorëve).

Të dhënat e disagreguara, kualitative, të qasshme, të besueshme dhe në kohë janë thelbësore për vlerësimin e progresit në të drejta të njeriut, për të nxjerrë në pah pabarazitë, për të siguruar llogaridhënie dhe transparencë, si dhe për të ofruar informacionin e nevojshëm për vendimmarrësit.<sup>243</sup>

Duke e pasur parasysh rëndësinë e të dhënave shëndetësore dhe segmentet e shumta ku ato mund të shfrytëzohen dhe të shërbejnë (në funksion të përbushjes së Agjendën 2030<sup>244</sup>), iniciuar nga Grupi punues për operacionalizimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet IAP-së dhe ASK-së<sup>245</sup>, në mars 2022 është thirrur dhe

240 Parimet e Parisit kanë të bëjnë me statusin e institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 48/134, datë 20 dhjetor 1993.

241 Për më tepër, shih [https://www.ohchr.org/Documents/Issues/HRIndicators/SDG\\_Indicator\\_16a1\\_Metadata.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Issues/HRIndicators/SDG_Indicator_16a1_Metadata.pdf)

242 Për më tepër shih <https://ennhri.org/about-nhris/human-rights-based-approach/>

243 Për më tepër, shih [https://www.un.org/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E](https://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E)

244 Agjenda 2030 është bërë obligative për vendin, që nga miratimi i Rezolutës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në vitin 2018. Kjo Agjendë paraqet një plan veprimi të nivelit global, në linjë me të cilin shtetet kanë shprehur përkushtimin dhe përpqien të jenë partnerë për të përbushur 17 objektiva, me 169 caqe specifike të synuara, të cilave u korrespondojnë 231 tregues. Ky dokument në thelbin e vet, si shtylla kyçe të vizionit universal që mbart, vë: popullatën, prosperitetin, planetin, paqen dhe partneritetin (të njohura si pesë P-të), e të cilat mbështetet zhvillimi i vërtetë, rrjedhimisht edhe i qëndrueshëm (për më tepër SDG Indicators – SDG Indicators (un.org))

245 Në përbushje të obligimeve sipas Rezolutës së Parlamentit të vitit 2018, IAP-ja dhe ASK-ja kanë nënshkruar në janar 2020, një Memorandum dypalësh të Mirëkuptimit. Ky Memorandum është mbështetur nga Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejta të Njeriut (OHCHR) në Gjenevë, me ndërmjetësimin e Zyrës për të Drejta të Njeriut të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, me të cilën kanë vazhduar kontaktet dhe takimet edhe gjatë vitit 2021, përkritazi me çështjet e të drejtave dhe liritë të njeriut që janë në fokus të interesimit të përbashkët, përfshirë Agjendën 2030. Për më tepër, shih [https://www.un.org/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E](https://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E) si dhe Raportin vjetor për vitin 2021, fq. 44 [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/03/Aip\\_RaportiVjetor\\_ALB\\_22.04.pdf](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/03/Aip_RaportiVjetor_ALB_22.04.pdf)

mbajtur tryezë me temën: “Mbledhja e të dhënave dhe raportimi i të dhënave në sektorin shëndetësor”.

Tryeza, me qëllim mbështetjen e zbatimit dhe matjen e të drejtave të njeriut, vuri në pah papajtueshmërinë në metodologjinë dhe standardet e mbledhjes së të dhënave brenda sektorit shëndetësor dhe raportimin e tyre në ASK. Gjatë diskutimeve u theksuan problemet kyçe në zinxhirin e grumbullimit dhe raportimit të të dhënave, domosdoshmërinë për qartësimin e roleve institucionale përkitazi me përgjegjësitë në këtë aspekt dhe nevojën e një pune bashkëpunuese dhe koordinuese, për të pasur të dhëna të plota, të sakta, kredibile dhe në kohë.

Aktorë nga institucionet përgjegjëse të sektorit shëndetësor: Ministria e Shëndetësisë, Qendra Klinike Universitare, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Instituti i Mjekësisë Ligjore, organizata joqeveritare (AMC, CDF), përfaqësues nga Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, zyrat në Kosovë (OHCHR, WHO, UNFPA, UNICEF), bashkë me përfaqësues nga ASK-ja dhe IAP-ja, bashkëbiseduan në rrafsh profesional dhe teknik për problematikat e identifikuar.

Bazuar në diskutimet dhe konkludimet e kësaj tryeze, Avokati i Popullit ka filluar hetime sipas detyrës zyrtare, përkitazi me mbledhjen dhe raportimin e të dhënave shëndetësore në Republikën e Kosovës. Raporti pritet të adresohet në pjesën e parë të vitit 2023. Ky raport ka për qëllim të identifikojë problematikat ekzistuese përkitazi me mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në sektorin shëndetësor dhe t’u rekomandojë autoriteteve përgjegjëse për hapat që duhet të ndërmerren, me qëllim eliminimin gradual të problemeve në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në sektorin shëndetësor. Për më shumë, ka të bëjë me rëndësinë e saktësisë, të tërësisë dhe të besueshmërisë që

kanë të dhënat shëndetësore, si dhe për të skanuar gjendjen, përgjegjësitë, si dhe për të adresuar rekomandimet në funksion të gjetjes së zgjidhjeve në pajtim me standardet më të mira e në pajtim me OZhQ-në, saktësisht Objektivin 3 - Shëndeti i mirë dhe mirëqenia dhe përgjithësisht përkushtimin për të përmbushur Agjendën 2030 dhe synimin për të mos lënë askënd pas.

Tryeza që ka shërbyer për të diskutuar dhe iniciuar këtë Raport është menduar të pasohet nga disa tryeza me tematika specifike (për të dhënat nga ARC-ja, nga sistemi edukativo-arsimor, të dhënave nga aspekti social) dhe grumbullimin e raportimin e të dhënave lidhur me to, në funksion të përmbushjes së rolit që ka IAP-ja, si urë lidhëse ndërmjet mbajtësve të të drejtave dhe shtetit, lidhur me dizajnimin dhe monitorimin e politikave, strategjive dhe veprimeve. Megjithatë, në mungesë të gatishmërisë së ASK-së për të bashkëpunuar në këtë drejtim, iniciativa dhe insistimi i IAP-së, nëpërmjet anëtarëve që ka në Grupin Punues për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet dy institucioneve, ka mbetur e pazhvilluar më tutje dhe si përfundim e përealizuar gjatë vitit 2022.

Në raportin vjetor të vitit paraprak Avokati i Popullit vlerësoi se pozicionimi i ASK-së brenda strukturës institucionale të ministrisë kërkon vlerësim të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm dhe inkurajon Qeverinë dhe Kuvendin që ASK-ja të jetë në linjë të drejtpërdrejtë llogaridhënie ndaj Kuvendit ose Qeverisë.<sup>246</sup> Në lidhje me këtë Qeveria e Kosovës, me Vendimin nr. 05/84, datë 22 qershor 2022, vendosi që Agjencia e Statistikave të Kosovës nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të bartet në Zyrën e Kryeministrit.

Deklarata e Meridas definon rolin e IKDNj-së për sa i përket kompetencës së tyre këshilluese përkitazi me formësimin e treguesve kontekstualë dhe



sistemeve të shëndosha të mbledhjes së të dhënave, si dhe rolin monitorues për sa i përket progresit në zbatimin e Agjendës<sup>247</sup> dhe për rrjedhim logjike e funksionale mbikëqyrjen e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Identifikimi i treguesve përkatës, të cilët bazohen në udhëzimet mbi treguesit e të drejtave të njeriut dhe në qasjen ndaj të dhënave të bazuar në të drejtat e njeriut, të përpiluar nga Zyra e OHCHR-së, është i pashmangshëm për zbatimin e Agjendës 2030. Në këtë kontekst, IAP-ja rikujton se autoritetet përgjegjëse dhe kompetente për të drejtuar procesin për zhvillimin e treguesve në nivel vendi janë zyrat për statistika kombëtare, sikurse është Agjencia e Statistikave në Kosovë, meqë kanë njohuri për burimet në dispozicion të të dhënave dhe kanë njohuri për pengesat kryesore të cilat duhet të adresohen.

Përveç për rolin këshillues dhe monitorues, IKDNj-të po ashtu shihen si ura lidhëse ndërmjet mbajtësve të të drejtave dhe shtetit, lidhur me dizajnimin dhe monitorimin e politikave, strategjive dhe veprimeve. Si i tillë, IAP, në pajtim me mandatin që kryen, adreson në vazhdimësi çështje që prekin të drejtat e njeriut, duke vënë në fokus grupet e cenueshme dhe të lëna anash.

Përkitazi me masat ligjore dhe politikat për të eliminuar diskriminimin dhe pabarazitë e mëtutjeshme substanciale, IAP-ja mund të këshillojë dhe të ngre çështje që kërkojnë vëmendjen e menjëhershme apo masa të veçanta. IAP-ja ka rol këshillues dhe avokues në lidhje me obligimet përkitazi me të drejtat e njeriut, së këndejmi edhe me OZhQ-në dhe zbrazëtitë që cenojnë grupet e veçanta e më të cenueshme të mbajtësve të të drejtave.

247 Për më tepër, shih <https://www.theioi.org/ioi-news/current-news/merida-declaration-on-nhris-role-in-implementing-the-2030-agenda-for-sustainable-development>

# Komunikimi me publikun

Gjatë vitit 2022, mediat në përgjithësi kanë treguar interesim të madh për punët dhe aktivitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), ku Avokati i Popullit ka dhënë me dhjetëra intervista, prononcime dhe deklarime për mediat, si për televizione dhe portale, e po ashtu për radio stacione. Në anën tjetër, IAP-ja ka iniciuar 16 raste sipas detyrës zyrtare bazuar nga raportimet në media. Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka vënë në plan të parë: mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si bërthama e misionit të IAP-së; fuqizimin në publik të rolit dhe imazhit të IAP-së, si mbrojtës dhe avokues të të drejtave të qytetarit; ofrimin e informacionit të nevojshëm për kompetencat, përgjegjësitë dhe punën e IAP-së.

IAP-ja ka komunikuar nëpërmjet të gjitha kanaleve të informimit me publikun për të prezantuar punën dhe aktivitetet e Avokatit të Popullit. Janë publikuar mbi 100 informata, komunikata dhe njoftime në ueb-faqen zyrtare, e po ashtu të shpërndara edhe në llogaritë e saj në rrjetet sociale si Facebook, Instagram dhe Twitter. Mediat po ashtu kanë kërkuar për të marrë opinionet dhe qëndrimet e Avokatit të Popullit, ose edhe për të marrë të dhëna lidhur me raste apo fusha të caktuara të të drejtave dhe lirive të njeriut të trajtuara nga IAP-ja. Prezantimi i punës së IAP-së para publikut, qoftë në formatin e informacioneve të përmbledhura, qoftë në formën e raporteve, opinioneve apo mendimeve juridike në cilësinë e Mikut të Gjykatës (amicus curiae) është bërë në vazhdimësi, duke përshtatur mënyrën dhe mjetet e komunikimit në varësi të situatës, mesazhit apo grupit të shënjuar për komunikim.

Gjithashtu mbajtja e dhjetë tryezave tematike që kishin të bënin kryesisht për personat me aftësi të kufizuar, kanë shërbyer për të reflektuar mbi punën dhe rolin e IAP-së, por gjithashtu për të avokuar lidhur me çështje të të drejtave dhe lirive të njeriut të këtij komuniteti, duke takuar organizatat e shoqërisë civile, aktivistët për të drejtat e njeriut dhe përfaqësues nga institucionet lokale, si pjesë e fushatës “Barazi për të gjithë”. Në tryezat e mbajtura nëpër komuna, mediat lokale, kryesisht televizione, por edhe radio stacione, kanë mbuluar këto tema, duke i përfshirë ngjarjen por edhe intervistat me Avokatin e Popullit për çështjet që ndërlidhen me komunat përkatëse. Avokati i Popullit po ashtu ka qenë pjesë në disa fushata të përgatitura nga organizatat joqeveritare për tema të ndjeshme, si: dhuna në familje dhe tema të tjera që ndërlidhen me të drejtat e njeriut.

Zyra për Komunikim Publik po ashtu trajton kërkesat për qasje në dokumente publike. Gjatë vitit 2022, janë trajtuar 18 kërkesa, nga këto janë shtatë kërkesa nga shoqëria civile, 3 kërkesa nga gazetarët, pesë kërkesa janë bërë nga individë e kështu me radhë. Nga numri i përgjithshëm i kërkesave, kjo zyrë ka lejuar qasje të plotë, dy kërkesa janë refuzuar dhe një kërkesë është trajtuar me qasje të pjesshme. Të gjitha kërkesat janë paraqitur përmes postës elektronike dhe po ashtu përmes postës elektronike janë dërguar përgjigjet. Kërkuesit kanë kërkuar qasje në dokumente që kishin të bënin me konkurset në IAP-së, me statistika, me kontrata dhe me vendime.

# Strategjia e Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2025 dhe Plani i Zbatimit të Strategjisë së Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2023

Avokati i Popullit ka vazhduar ushtrimin e mandatit të tij nëpërmjet Strategjisë së Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2025, e cila është miratuar më 18 mars 2021. Strategjia zbatohet nëpërmjet planit trevjeçar të Zbatimit të Strategjisë 2021-2023. Strategjia ka përcaktuar vizionin, misionin, objektivat strategjike dhe ato specifike dhe veprimet që synojnë ta udhëheqin punën e IAP-së në periudhë afatmesme në zbatimin e përgjegjësive dhe të kompetencave kushtetuese, të Ligjit për Avokatin e Popullit, të Ligjit për Barazi Gjinore dhe të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, të legjislacionit tjetër në fuqi në Kosovë dhe të standardeve ndërkombëtare.

Strategjia e IAP-së ka për qëllim rritjen e ndikimit të punës së Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe në promovimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale, edukimin për të drejtat e njeriut, si dhe në parandalimin e shkeljeve nga ana e institucioneve publike. Identifikimi dhe hetimi i rasteve ex-officio dhe i shkeljeve sistematike, ngritja e numrit të rasteve individuale, hetimi dhe shqyrtimi efektiv i tyre janë synime në të cilat do të përqendrohen kapacitetet institucionale.

Të gjitha këto synime do të realizohen nëpërmjet katër qëllimeve strategjike:

1. Mbrojtja dhe mbikëqyrja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut përmes ndikimit të shtuar të Institucionit të Avokatit të Popullit në përmbushjen e mandatit të tij.
2. Promovimi i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut dhe roli i IAP-së.
3. Promovimi i Objektiveve për Zhvillim të Qëndrueshëm.
4. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale dhe i burimeve njerëzore të IAP-së.

Përkundër sfidave të dala në implementimin e planeve të IAP-së, vitet e kaluara nga pandemia COVID-19, Avokati i Popullit në vitin 2022, arriti në përgjithësi kryerjen e synimeve dhe përmbushjen e aktiviteteve. Krahas ushtrimit të mandatit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit ka arritur përmbushjen e planeve për sa i përket ngritjes së dukshme të organizimit të aktiviteteve promovuese të të drejtave të njeriut; perceptimit të publikut lidhur me rolin dhe mandatin e IAP-së, si dhe vetëdijesimin dhe edukimin e grupeve të ndryshme për të drejtat e njeriut

dhe liritë themelore. Përforcimi i bashkëpunimit me institucionet publike, OShC-të, mekanizmat ndërkombëtare ka vazhduar edhe në vitin 2022. Arritje e veçantë i IAP-së është ndërtimi i sistemit të ri të IT-së, sistemit të ri për menaxhimin e rasteve, si dhe sistemit për resurset humane dhe buxhet. Ndërsa krahas zhvillimeve të përmendura, vend i veçantë i është dhënë zhvillimit të kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore të IAP-së.

Strategjia e IAP-së 2021-2025, përveç si një dokument planifikues, shërben edhe si dokument me anë të të cilit duhet të vlerësohet performanca e institucionit. Strategjia, plani i saj i zbatimit 2021-2023 dhe procesi i saj i vazhdueshëm i monitorimit dhe i raportimit duhet të shërbejnë si bazë për përmirësimin e procesit të vendimmarrjes strategjike të IAP-së për pesë vjetët e ardhshme.

# Buxheti i IAP-së

IAP-ja është institucion i pavarur, i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit: “IAP e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.”<sup>248</sup> Po sipas kësaj dispozite ligjore, për IAP-në mund të ndahet buxhet i nevojshëm shtesë për rastet e shtimit të obligimeve dhe të kompetencave me këtë ligj dhe me ligjet e tjera, respektivisht edhe burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore.<sup>249</sup>

## Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës

IAP-ja, bazuar në procedurat ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore, e ka paraqitur kërkesën e vet buxhetore për vitin 2022 në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), sipas afatit ligjor.

Kërkesa buxhetore për vitin 2022 nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur mbi bazën e planifikimit të nevojave dhe të aktiviteteve të punës së IAP-së për vitin kalendarik 2022, bazuar në mandatin ligjor dhe në strategjinë zhvillimore të IAP-së.

Buxheti i IAP-së për vitin 2022, sipas Ligjit të Buxhetit, është ndarë në shumën prej 1.282.766.00

€, i cili buxhet është destinuar për këto kategori buxhetore:

- a. Paga dhe mëditje në shumën prej 987.766.00 €;
- b. Mallra dhe Shërbime në shumën prej 259.000.00 €;
- c. Shpenzime komunale në shumën prej 6.000.00 €;
- d. Shpenzime Kapitale në shumën prej 30.000.00 €.

Pasqyrimin e buxhetit të IAP-së për vitin 2022, sipas kërkesës buxhetore dhe në raport të buxhetit të ndarë sipas ligjit të buxhetit fillestar për 2022, të shpenzimeve buxhetore dhe në raport të deklarimit të kursimeve buxhetore nga IAP-ja dhe të shkurtimeve të tjera buxhetore me vendim të Qeverisë të Republikës të Kosovës, do ta paraqesim në formën tabelore dhe të të dhënave sipas kategorive ekonomike buxhetore. Kurse IAP-ja raportimin financiar të detajuar për vitin buxhetor 2022 do të hartojë veçmas për Kuvendin e Republikës së Kosovës, mbi bazën e raportimit të rregullt vjetor dhe të formularit të unifikuar për raportime financiare nga institucionet e pavarura, ashtu siç kërkohet nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës.<sup>250</sup>

Më konkretisht, në paraqitjen tabelore në vijim do të pasqyrohet buxheti i IAP-së për vitin 2022, duke e filluar me Kërkesën buxhetore, me buxhetin

<sup>248</sup> Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 35, paragrafi 3.

<sup>249</sup> Po aty.

<sup>250</sup> Raporti financiar i detajuar për buxhetin e IAP-së do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas formularit unik për raportime financiare.

filleshtar të Ligjit për Buxhetin e vitit 2022, sipas Deklarimet të kursimeve buxhetore nga IAP-ja, të shkurtimit të buxhetit me vendim të Qeverisë të Republikës të Kosovës dhe buxhetin final për vitin 2022.

**Tabela 1: Buxheti i IAP-së për vitin 2022, sipas të dhënave në vijim:**

Kategoria ekonomike	Kërkesa buxhetore e IAP-së për vitin 2022	Buxheti i ndarë me Ligjin e Buxhetit për vitin 2022	Deklarimi i kursimeve nga IAP-ja 2022	Shkurtimet me vendim të Qeverisë 2022	Buxheti final 2022
Paga dhe mëditje	1.075.900.70	987.766.00	50.000.00	0.00	987.766.00
Mallra dhe shërbime	286.928.00	259.000.00	50.000.00	0.00	209.000.00
Shpenzime komunale	12.000.00	6.000.00	0.00	0.00	6.000.00
Shpenzimet kapitale	30.000.00	30.000.00	12.550.00	0.00	30.000.00
<b>Gjithsej buxheti</b>	<b>1.404.828.70</b>	<b>1.282.766.00</b>	<b>112.550.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1.232.766.00</b>

Planifikimi i buxhetit, shpenzimi i buxhetit dhe deklarimi i kursimeve buxhetore për vitin 2022 është realizuar sipas nevojave të planifikuara dhe destinacionit të përcaktuar për plotësimin e nevojave dhe të aktiviteteve të punës së IAP-së, të cilat kanë qenë me interes të sigurimit të ushtrimit të mandatit, të mbarëvajtjes të punës dhe funksionimit të IAP-së. Kurse planifikimi dhe shpenzimet e buxhetit për vitin 2022 kanë qenë shumë të ndikuara nga situata e pandemisë, sepse një pjesë e madhe e aktiviteteve të punës nuk kanë mundur të realizoheshin sipas planit të punës së IAP-së, me ç' rast mosrealizimi i këtyre aktiviteteve të punës ka ndikuar direkt edhe në mosshpenzimin e buxhetit të planifikuara për vitin buxhetor 2022. Nga IAP-ja nuk ka munguar monitorimi dhe kontrolli i brendshëm në shfrytëzimin ekonomik dhe efikas të buxhetit.

Për në vitin 2022, sipas procedurave ligjore, IAP-ja ka bërë edhe deklarimin e kursimeve buxhetore 2022 në shumën totale prej 112.550.00 €, kurse nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve janë tërhequr vetëm 50.000.00 € nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve, por jo edhe shuma e deklarimit të kursimit buxhetor.



## Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022

Buxheti IAP-së për vitin buxhetor 2022 është realizuar në masën monetare 1.099.281.11 € apo shprehur në përqindje për 89.17%, në raport me buxhetin final të vitit buxhetor.

Në tabelën vijuese paraqesim gjendjen e buxhetit final në raport me shpenzimet buxhetore për vitin 2022, sipas të dhënave buxhetore të kategorive ekonomike si edhe të shprehura në përqindje.

**Tabela 2: Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022**

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti final për 2022	Buxheti i shpenzuar	Mjete të lira	Realizimi në %
1.	Paga dhe mëditje	987.766.00	916.089.52	71.676.48	92.74
2.	Mallra dhe shërbime	209.000.00	161.568.11	47.431.89	77.31
3.	Shpenzime komunale	6.000.00	4.173.48	1.826.52	69.56
4.	Shpenzime kapitale	30.000.00	17.450.00	12.550.00	58.17
<b>Gjithsej</b>		<b>1.232.766.00</b>	<b>1.099.281.11</b>	<b>133.484.89</b>	<b>89.17</b>



